

MATRICA E KOMPETENCAVE E VETËQEVERISJES VENDORE

2019



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

Në bashkëpunim me:



Zbatuar nga:



URBAN RESEARCH INSTITUTE



Financuar nga Bashkimi Evropian

Matrica e Kompetencave e Vetëqeverisjes Vendore

Shkurt 2019



Ky Raport u hartua nga Urban Research Institute, me autorë z. Edlir Vokopola, z. Drini Nushi, znj. Entela Kallamata, znj. Marinela Spahiu, z. Erni Kocani dhe mbështetjen e znj. Zana Vokopola, Drejtor Ekzekutiv i URI



Raporti u përgatit në kuadër të projektit “Matrica e Kompetencave”, financuar nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme.

Printimi i këtij raporti u mundësua nga projekti “Bashkitë për në Evropë”, i financuar nga BE.

Titulli Projektit: Matrica e Kompetencave

Financuesi: Buxheti i Përgjithshëm i Bashkimit Evropian
Nr. Referencës: CRIS No.: 2018/399-142
Data Fillimit: Shtator 2018
Data Mbarimit (Kohëzgjatja): Janar 2019 (5 muaj)
Nr. Kontratës: 399-142

Autoriteti Kontraktues: Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
Menaxheri Projektit: Orlando Fusco
Adresa: ABA Business Centre, K. 17, Rr. Papa Gjon Pali II; 1001 Tiranë, Shqipëri
Tel.: +355 4 222 8320 ext. 441
E-mail: Orlando.Fusco@eeas.europa.eu

I kontraktuari: Instituti i Kërkimeve Urbane
Adresa (Konsulenti): Rr: "Asim Vokshi", Nd.14, Hyrja 11, Ap. 56, Tiranë, Shqipëri
Tel (Konsulenti): +355 69 40 82 942
Drejtuesi i Projektit: Edlir Vokopola
Adresa: Rr: "Asim Vokshi", Nd.14, Hyrja 11, Ap. 56, Tiranë, Shqipëri
E-mail: evokopola@uri.org.al

Ekipi Projektit: Edlir Vokopola, Entela Kallamata, Drini Nushi, Marinela Spahiu, Erni Kocani
Adresa: Rr:"Asim Vokshi", Nd.14, Hyrja 11, Ap. 56, Tiranë, Shqipëri
Tel (Projektit): +355 69 40 82 942
E-mail: evokopola@uri.org.al
ekallamata@uri.org.al
dnushi@uri.org.al

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Urban Research Institute dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

MIRËNJOHJE

Ky Raport është hartuar nga ekipi i Institutit të Kërkimeve Urbane, i përbërë nga z. Edlir Vokopola, z. Drini Nushi, znj. Entela Kallamata, znj. Marinela Spahiu, z. Erni Kocani dhe mbështetjen e znj. Zana Vokopola, Drejtor Ekzekutiv i IKU. Në punën për grumbullimin e informacionit, dokumenteve dhe opinioneve, si dhe hartimin e këtij dokumenti, ekipi i IKU vlerëson shumë dhe është mirënjohës për mbështetjen dhe bashkëpunimin me ekipin e Ministrisë së Brendshme të drejtuar nga zëvendësministri znj. Romina Kuko dhe këshilltarët znj. Aida Gjika dhe z. Ledjon Shahini; duke përfshirë këtu edhe kontributin e veçantë të z. Fran Brahimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Z. Bekim Murati nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IKU gjen gjithashtu rastin të falënderojë kryetarët dhe personelin e bashkive Roskovec, Kamëz dhe Korçë të cilët pa asnjë rezervë u përkushtuan për të ndihmuar në evidentimin çështjeve të cilat janë objekt i trajtimit në këtë raport; si dhe personelin e ministrive të linjës me të cilët ekipi i IKU është takuar, përfshirë këtu Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë diskutuar dhe kanë ndarë informacion me ekipin e IKU për hartimin e Raportit.

Në mënyrë të veçantë ekipi i IKU shpreh mirënjohjen për z. Orlando Fusco, Menaxher i Projektit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri për besimin dhe inkurajimin e veçantë në realizimin e këtij projekti.

LISTA E KUTIZAVE

MIRËNJOHJE	iii
LISTA E KUTIZAVE.....	vii
LISTA E KUTIZAVE.....	viii
LISTA E SHKURTIMEVE.....	ix

0. PËRMBLEDHJE 1

0.1 HYRJE.....	1
0.2 Analiza Ligjore.....	1
0.3 Analiza Fianaciare	2

1. HYRJE 5

1.1 Projekti dhe nevoja për të.....	5
2 METODOLOGJIA E ANALIZËS.....	7
2.1 Skicë e matricës së kompetencave	9

3. VETQEVERISJA VENDORE NË SHQIPËRI 11

3.1 Decentralizimi.....	11
3.2 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020.....	12

4. LIGJI 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE” 15

5. ANALIZA E FUNKSIONEVE TË QEVERISË VENDORE 17

vi	5.1 Fusha e Infrastrukturës dhe shërbimeve publike	17
	5.1.1 Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimin me ujë të pijshëm (Neni 23/1), dhe mbledhja largimi dhe trajtimi i ujërave të ndoturara (Neni 23/2).....	17
	5.1.2 Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara (Neni 23/3).....	28
	5.1.3 Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimi rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore (Neni 23/4).....	32
	5.1.4 Ndriçimi i mjediseve publike (Neni 23/5).....	36
	5.1.5 Transporti publik vendor (Neni 23/6).....	39
	5.1.6 Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit (Neni 23/7).....	45
	5.1.7 Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike (Neni 23/9), Shërbimi i dekorit publik (Neni 23/8).....	47
	5.1.8 Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake (Neni 23/10).....	50
	5.1.9 Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale (Neni 23/11).....	57
	5.1.10 Administrimin dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe (Neni 23/12)	62
	5.1.11 Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik (Neni 23/13).....	66
	5.1.12 Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit (Neni 23/14).....	74
	5.2 Fusha e Shërbimeve Sociale	79

5.2.1	Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.. (Neni 24/1), ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore (Neni 24/3), krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj (Neni 24/4).....	79
5.2.2	Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social (Neni 24/2)	90
5.3	Fusha e Kulturës, Sportit dhe Shërbimeve Argëtuese	96
5.3.1	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve (Neni 25/1) Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve (Neni 25/2) Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave e ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve (Neni 25/3).....	96
5.3.2	Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve (Neni 25/4)..	104
5.4	Fusha e Mbrojtjes së Mjedisit.....	106
5.4.1	Sigurimi, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja. (Neni 26/1), sigurimi në nivel vendor, i masave për mbrojtjen nga ndotja akustike (Neni 26/2), zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit (Neni 26/3)	106
5.5	Fusha e Bujqësisë, Zhvillimit Rural, Pyjeve dhe Kullotave Publike, natyrës dhe Biodiversitetit.....	114
5.5.1	Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj (Neni 27/1).....	114
5.5.2	Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj (Neni 27/2)	119
5.5.3	Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.....	126
5.5.4	Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor (Neni 27/4)	127
5.5.5	Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi	128
5.5.6	Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi (neni 27/6).....	138
5.6	Fusha e Zhvillimit Ekonomik Vendor.....	139
5.6.1	Hartimin i planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor (Neni 28/1), ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë, (Neni 28/2) mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike(Neni 28/3), organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj. (Neni 28/4), publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj (Neni 28/5) si dhe dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor (Neni 28/6).....	139

5.7	Fusha e Sigurisë Publike.....	143
5.7.1	Mbrojtja civile ne nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse (Neni 29/1).....	143
5.7.2	Garantimi i shërbimit të zjarrefkësve, në nivel vendor, dhe administrimi i strukturave përkatëse (Neni 29/2).....	148
5.7.3	Garantimi i imbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet (Neni 29/3), parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore (Neni 29/4).....	153
6.	MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE	157
6.1	Parimi i mjaftueshmërisë financiare	157
6.2	Rregullimi i mjaftueshmërisë financiare	158
6.2.1	Mjaftueshmëria financiare e funksioneve të veta që financohen nga transfertat e pakushtëzuar	158
6.2.2	Mjaftueshmëria financiare e funksioneve të reja të veta.....	158
6.2.3	Mjaftueshmëria financiare e funksioneve të transferuara që financohen nga transfertat specifike.....	160
6.2.4	Mjaftueshmëria financiare e funksioneve të deleguara të financuara nga transfertat e kushtëzuar.....	160
6.2.5	Financimi i funksioneve të transferuara 2019-2021	161
6.2.6	Sistemi i planifikimit financiar të funksioneve të vetëqeverisjes vendore.....	161
6.2.7	Mjaftueshmëria financiare në lidhje me politikën fiskale të qeverisë qendrore	162
6.3	Mbrojtja në gjykatë e të drejtës për burime financiare të mjaftueshme.....	164
6.4	Projektet në zhvillim për të siguruar përmbushjen e parimit të mjaftueshmërisë financiare	164
7.	PËRFUNDIMI I ANALIZËS	167
7.1	Përmbledhe mbi gjëndjen e autonomisë së qeverisë vendore	167
	SHTOJCA A: REKOMANDIME PËR RREGULLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKTORIAL.....	173
	SHTOJCA B: BAZA LIGJORE E FUNKSIONEVE.....	195
	SHTOJCA C: RAPORTE DHE DOKUMENTE TË KONSULTUAR.....	213
	SHTOJCA D: AKTORËT E KONSULTUAR NË NIVEL BASHKIE.....	215
	SHTOJCA E: AKTORËT E KONSULTUAR NË NIVEL MINISTRIE	216
	SHTOJCA DIGJITALE.....	219

LISTA E KUTIZAVE

Kutiza 1:	17
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e prodhimit, trajtimit, transmetimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm si dhe mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura	
Kutiza 2:	32
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore dhe transportin publik	
Kutiza 3:	39
Gjetjet nga RAM për funksionin e transportit publik vendor	
Kutiza 4:	50
Drejtimit strategjike për funksionin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake	
Kutiza 5:	57
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.	
Kutiza 6:	66
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik	
Kutiza 7:	74
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e planifikimit, administrimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit	
Kutiza 8:	79
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e përkujdesit social	
Kutiza 9:	85
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e krijimit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve	
Kutiza 10:	90
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit dhe administrimit të banesave për strehimin social	
Kutiza 11:	96
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e zhvillimit, mbrojtjes dhe promovimit të vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	
Kutiza 12:	104
Drejtimit strategjike për funksionin e organizimit të aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	
Kutiza 13:	106
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për fushën e mbrojtjes së mjedisit	
Kutiza 14:	114
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e administrimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të transferuar në pronësi të tyre.	
Kutiza 15:	128
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e administrimit të fondit pyjor dhe kullor publik	
Kutiza 16:	139
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM në fushën e zhvillimit ekonomik vendor	
Kutiza 17:	143
Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e mbrojtjes civile	
Kutiza 18:	148
Drejtimit strategjike dhe gjetjet për funksionin e garantimit të shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse	
Kutiza 19:	153
Drejtimit strategjike për funksionin e garantimit të mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.	

LISTA E KUTIZAVE

Figura 1:	19
Organigrama për funksionin e furnizimit me ujë të pijshëm (Neni 23/1), dhe ujërave të ndotura (Neni 23/2)	25
Figura 2:	29
Organigrama e funksionit për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet (Neni 23/3)	35
Figura 3:	33
Organigrama e funksionit: Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve ... (Neni 23/4)	
Figura 4:	37
Organigrama e funksionit ndriçimi i mjediseve publike (Neni 23/5)	
Figura 5:	41
Organigrama e funksionit transporti publik vendor (Neni 23/6)	
Figura 6:	45
Organigrama e funksionit ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, ... (Neni 23/7)	
Figura 7:	48
Organigrama e funksionit parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike (Neni 23/9) Shërbimi i dekorit publik (Neni 23/8)	
Figura 8:	51
Organigrama e funksionit mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake (Neni 23/10)	
Figura 9:	58
Organigrama e funksionit të ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore ... (Neni 23/11)	
Figura 10:	62
Organigrama e funksionit të administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe (Neni 23/12)	
Figura 11:	67
Organigrama e funksionit të ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor ... (Neni 23/13)	
Figura 12:	71
Organigrama e funksionit të zbatimit të veprimtarive për zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese për mbrojtjen e shëndetit (Neni 23/13)	
Figura 13:	75
Organigrama e funksionit të planifikimit, administrimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit (Neni 23/14)	
Figura 14:	80
Organigrama e funksionit të zbatimit të administrimit të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar	
Figura 15:	86
Organigrama e funksionit të zbatimit të administrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe ndërtimit dhe administrimit të qendrave ...	
Figura 16:	90
Organigrama e funksionit të ndërtimit dhe administrimit të banesave për strehimin social (Neni 24/2)	
Figura 17:	97
Organigrama e funksionit të zhvillimit, mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor ... (Neni 25/1/2/3)	
Figura 18:	104
Organigrama e funksionit të organizimit të aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese ... (Neni 25/4)	
Figura 19:	107
Organigrama e funksionit të sigurimit, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja ... (Neni 26/1/2/3)	
Figura 20:	115
Organigrama e funksionit të administrimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ... (Neni 27/1)	
Figura 21:	119
Organigrama e funksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore... (Neni 27/2)	
Figura 22:	128
Organigrama e funksionit të administrimit të fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi	
Figura 23:	140
Organigrama e funksionit : Zhvillimi Ekonomik Vendor	
Figura 24:	143
Organigrama e funksionit të mbrojtjes civile në nivel vendor dhe administrimit të strukturave përkatëse	
Figura 25:	149
Organigrama e funksionit të garantimit të shërbimit zjarfikës, në nivel vendor, dhe administrimit të strukturave përkatëse	150

LISTA E SHKURTIMEVE

SHKURTIMI KUPTIMI

- ABU** Agjencitë e Baseneve Ujore
- AKM** Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- AKPT** Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
- AKU** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- AKUM** Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së mbetjeve
- AMBU** Agjencitë e Menaxhimit të Baseneve Ujore
- ARM** Agjencia Rajonale e Mjedisit
- ARRSH** Autoriteti Rrugor Shqiptar
- ASHR** Autoritetit Shëndetësor Rajonal
- DAMT** Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës
- DAR / ZA** Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore
- DPGJC** Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- DPMZSH** Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
- DPPEC** Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile
- DRTK** Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore
- DUK** Drejtoria e Ujit dhe Kullimit
- ERRU** Enti Rregullator i Ujit
- FNS** Federata Ndërkombëtare e Futbollit
- IKMTK** Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore
- IKRTK** Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
- IKTK** Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
- IMT** Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës
- ISHMT** Inspektoratit Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës
- ISHP** Instituti i Shëndetit Publik
- ISSH** Inspektorati Sanitar Shtetëror
- ITD** Inspektorati Teknik i Digave/dambave
- KB** Këshilli Bashkiak
- KBU** Këshilli i Basenit Ujor
- KE** Këshilli i Evropës
- KKDM** Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
- KKM** Këshilli Kombëtar i Muzeve
- KKMPK** Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore
- KKRR** Komisioni Kombëtar Rregullator
- KKT** Këshilli Kombëtar i Territorit
- KKTKJ** Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale
- KKTKM** Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale
- KKU** Këshilli Kombëtar i Ujit
- KLS** Këshilli i Lartë i Sportit
- KLSH** Kontrolli i Lartë i Shtetit
- KM** Këshilli i Ministrave

SHKURTIMI KUPTIMI

KMT	Komisioni i Mbrojtjes së Tokës
KNEC	Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile
KNSH	Komisioni i Ndihmës Shtetërore
KQ	Këshilli i Qarkut
KSHMT	Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës
KTPD	Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave
MASR	Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
MK	Ministria e Kulturës
MLTUN	Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHMS	Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJAPKA	Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike
NJQV	Njësitë e vetëqeverisjes vendore
OSHKSH	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
PAK	Personat me aftësi të kufizuara
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
PTTFUP	Prodhim, trajtim, transmetim dhe furnizimin me ujë të pijshëm
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QKVT	Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale
RAM	Rishikimit Afat-Mesëm
RSH	Republika e Shqipërisë
SAMT	Seksioni i Administrimit të Mbrojtjes së Tokës
SH.A	Shoqëri aksionere
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SKDM	Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha
SNDQV	Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore
UK	Ujësjellës - Kanalizime
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZABU	Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore
ZGJC	Zyrat e Gjendjes Civile
ZMMT	Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës

O. PËRMBLEDHJE

0.1 HYRJE

Qëllimi i analizës së kryer është të japë rekomandime për Ministrinë e Brendshme, përgjegjëse e bashkërendimit me qeverinë vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendor, për hapat që duhen ndërmarrë në vijim për të përmbushur masën e autonomisë vendore të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2019.

Analiza ka përfshirë rishikimin e rreth 400 akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorët e lidhur me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional sektorial është mëse i nevojshëm për të rritur eficiencën e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore, që qëndron si vizioni i Strategjisë; gjithashtu, siguron zhvillimin e qëndrueshëm të këtij niveli qeverisës, si një prej objektivave kryesore të Strategjisë.

Raporti është një instrument i cili do të ndihmojë të dy nivelet e qeverisjes në vend të harmonizojnë kuptimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fuqi që lidhet me funksionet e vetëqeverisjes vendore.

Zbatimi i rekomandimeve që vijnë nga brendia e këtij raporti do të kërkojnë rishikimin e Strategjisë dhe të afateve kohore të saj, por edhe burimet financiare e njerëzore të cilat do të kërkojnë për të mundësuar përballjen me sfidën e vazhdueshme për decentralizim dhe demokraci.

0.2 ANALIZA LIGJORE

Nëpërmjet shpërndarjes së veprimtarive të administrimit dhe rregullimit të secilit prej funksioneve të vetëqeverisjes vendore ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, qendror dhe vendor, mund të vërehet përqendrimi i përgjegjësive për ushtrimin e tyre në njërin ose në tjetrin nivel.

Kështu, vetëqeverisja vendore përgjithësisht nuk karakterizohet nga elementi i rregullimit të funksioneve të saj, i cili është gjerësisht i përqendruar tek qeveria qendrore, dhe kryesisht tek Këshilli i Ministrave; rregullime të qenësishme nga vetëqeverisja vendore vihen re vetëm në funksionin e transportit publik vendor si dhe në administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollor në çerdhe.

Sa i përket administrimit të funksioneve, vërehet një shpërndarje jo e njëtrajtshme e përgjegjësive ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, në varësi të sektorit.

Funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë qenë historikisht nën përgjegjësinë e tyre nuk kanë sjell zhvillime të qenësishme në objektivat e decentralizimit, mund të përmendim një nga funksionet më të rëndësishme të NJQV, prodhimi, furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura (Neni 23/1/2), i cili përveç rregullimeve kryesore nga institucionet qendrore, përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të funksionit.

Gjithashtu administrimi dhe rregullimi i kopshteve nuk është aspak një kompetencë që mund të konsiderohet si funksion i vet i NJQV-ve. Të gjitha rregullimet dhe pjesa kryesore e administrimit të këtij funksioni kryhen ende nga qeveria qendrore.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake (Neni 23/10), si një nga funksionet historikisht nën përgjegjësinë e NJQV-ve ka pësuar elementë centralizimi, me heqjen e kompetencave të përcaktimit nga NJQV-të, të tarifës së shërbimit.

Nga funksionet e reja të kaluara NJQV-ve, vihet re një rregullim më i përshtatshëm për të ushtruar funksionet nga NJQV-të në mënyrë autonome, se funksionet historikisht nën përgjegjësinë e NJQV-ve. Vlen për t'u përmendur garantimi i shërbimit zjarrfikës (Neni 29/2), administrimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (Neni 27/1), si dhe administrimi i fondit pyjor dhe kullosor (Neni 27/5).

Në të njëjtën kohë shumë funksione të reja të vetëqeverisjes vendore nuk janë shoqëruar ende me ndryshimet ligjore të nevojshme duke vështirësuar ushtrimin e funksioneve nga NJQV-të, vlen për tu përmendur funksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës bujqësore, ku njësitë e qeverisjes vendore janë të ndërruar ende nga këshillat e qarqeve që kanë kompetenca kryesore për zbatimin e këtij funksioni (inspektimin dhe marrjen e vendimeve për marrjen e masave).

Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit (Neni 27/6), e lidhur ngushtësisht me administrimin, mbrojtjen e tokës bujqësore, administrimin e pyjeve dhe kullotave nuk ka pësuar asnjë ndryshim për të reflektuar fushën e re të përgjegjësisë së NJQV-ve, në linjë me ndryshimet në legjislacionin sektorial për shërbimet në fondin pyjor dhe kullosor.

Një nga funksionet që mund të konsiderohet i përealizueshëm nga NJQV-të është funksioni i administrimit të granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural (Neni 27/4). Ligji sektorial parashikon ekskluzivisht Agjencinë e Pagesave si institucionin përgjegjës për administrimin e këtij funksioni.

Mungesa ligjore qenësisht të nevojshme për tu miratuar me qëllim lehtësimin e zbatimit të funksioneve nga NJQV-të vihen re në funksionin e mbledhjes dhe largimit të ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara (Neni 23/3), ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social (Neni 24/2), fusha e kulturës (Neni 25/1/2/3), krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi (Neni 27/3). Gjithashtu, funksionet në fushën e ndërtimit të ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor, dhe administrimi i qendrave të shëndetit publik, kanë nevojë për rregullime në lidhje me planifikim e tyre, për t'i bërë këto funksione të realizueshme.

2

0.3 ANALIZA FINANCIARE

Në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Vendore, ashtu si dhe në legjislacionin shqiptar mbi vetëqeverisjen vendore, parimi i mjaftueshmërisë financiare për ushtrimin e funksioneve të veta e të deleguara ka si kriter të vetëm përpjesëtueshmërinë e burimeve financiare me koston e ushtrimit të tyre. Për rrjedhojë, përmbushja e këtij parimi është në varësi të metodologjisë së përllogaritjes ose vlerësimit të koston të ushtrimit të funksioneve.

Në ndryshim nga Karta, ligji 139/2015 parashikon se burimet financiare të vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e funksioneve duhet të jenë të mjaftueshme për të përmbushur standardet dhe normat ligjore përkatëse; këto të fundit, për rrjedhojë, duhet të jenë pjesë e koston të ushtrimit të funksioneve. Ky rregullim nuk reflektohet i plotë në ligjin 68/2017, i cili përcakton se burimet e nevojshme financiare kanë madhësinë e koston historike të ushtrimit të funksioneve nga qeverisja qendrore para decentralizimit të tyre; në koston historike, niveli i standardeve dhe normave ligjore që është arritur nga institucioni qendror përkatës nuk është domosdoshmërisht niveli i kërkuar nga ligji. Në këtë mënyrë, në krahasim me ligjin 139/2015, ligji 68/2017 redukton madhësinë potenciale të financimit të mjaftueshëm që qeverisja qendrore duhet të sigurojë për vetëqeverisjen vendore.

Madhësia e transfertës së pakushtëzuar për funksionet e veta nuk është shprehimisht në përpjesëtim me koston e ushtrimit të funksioneve, dhe as në varësi të standardeve ligjore të ushtrimit të tyre, në ligjin 68/2017.

Ligji 139/2015 nuk ka një përkufizim të termit standard dhe norma (minimale) kombëtare të ushtrimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Në veçanti, nuk ka një përcaktim të lidhjes së tyre me politikat kombëtare dhe rajonale; kjo lidhje është e rëndësishme, për sa kohë edhe standardet e normat edhe politikat janë të dyja njëkohësisht baza të parimit të ushtrimit të funksioneve që vendos ligji, ndërsa vetëm standardet e normat janë kriter i mjaftueshmërisë financiare të funksioneve.

Mënyra e sigurimit të përmbushjes së parimit të mjaftueshmërisë financiare nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore nuk është e qartë. Veçanërisht, nuk është e qartë masa e përfshirjes së standardeve e normave ligjore të një funksioni në koston e ushtrimit të tij nëpërmjet programit të shpenzimit.

Sistemi i planifikimit financiar të funksioneve të vetëqeverisjes vendore, e për rrjedhojë dhe i administrimit të tyre, nuk ka një drejtim të vetëm e të qartë, i cili të mundësojë vlerësimin e shumës së burimeve financiare që janë të mjaftueshme për ushtrimin e këtyre funksioneve; sistemi drejtohet nga politikat kombëtare dhe rajonale, porse nuk është e qartë si dhe në çfarë mase drejtohet nga standardet dhe normat minimale kombëtare.

Nëpërmjet sistemit të buxhetimit afatmesëm të funksioneve të vetëqeverisjes vendore, baza kryesore e informacionit të MFE-së për koston e ushtrimit të funksioneve të saj vjen nga përllogaritjet dhe vlerësimet e vetë administratës së njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërsa nuk parashikohen instrumente të drejtpërdrejta të MFE-së për të kryer këto përllogaritje dhe vlerësime.

Raporte të qeverisë qendrore, sipas kërkesës së ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 26 dhe 27, të cilat duhet të japin informacion (dhe të konsultohen në Këshillin Konsultativ) për standardin e ofrimit të shërbimit dhe nivelin e shpërndarjes së tij sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, nuk janë hartuar asnjëherë deri më sot.



1. HYRJE

1.1 PROJEKTI DHE NEVOJA PËR TË

Qëllimi i kësaj analize është të japë rekomandime për Ministrinë e Brendshme, si ministria përgjegjëse e bashkërendimit me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendor, për hapat që duhen ndërmarrë në vijim për të përmbushur masën e autonomisë vendore të përcaktuar në Strategji, nëpërmjet rishikimit të legjislacionit sektorial, si dhe të vetë ligjit 139/2015.

Analiza ka përfshirë rreth 400 akte ligjore dhe nënligjore të sektorëve të ndryshëm të cilat afektojnë aktivitetin dhe ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Procesi ka filluar me ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; dhe vazhdon më tej me analizën e ligjeve sektoriale në mënyrë që të ndihmojë në harmonizimin e shpërndarjes së autoritetit në të dy nivelet qeverisëse për secilën fushë të funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Dy raportet e monitorimit të Strategjisë, të hartuara respektivisht në 2016 dhe 2017, kanë gjetur se mungesa e harmonizimit ligjor është e pranishme në shumë fusha të veprimtarisë funksionale të vetëqeverisjes vendore, e veçanërisht në funksionet e reja të cilat i janë transferuar këtij niveli qeverisës me ligjin 139/2015 dhe në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative të vitit 2015.

Analiza nuk ka objektiv të vlerësojë nëse organet e vetëqeverisjes vendore kanë aftësinë të vetëqeverisen sipas një mase të autonomisë që Strategjia dhe ligji 139/2015 u kanë përcaktuar, por të vlerësojë sa është kjo masë sipas Strategjisë dhe sa është sipas ligjit 139/2015, si dhe deri në çfarë niveli është përmbushur apo jo deri në vitin 2018, nëpërmjet legjislacionit sektorial.

Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional sektorial është mëse i nevojshëm për të rritur eficiencën e veprimtarisë së njësiteve të vetëqeverisjes vendore, që qëndron si vizioni i Strategjisë; gjithashtu siguron zhvillimin e qëndrueshëm të këtij niveli qeverisës, i cili në vetvete përbën dhe një prej objektivave kryesore të Strategjisë.

Ky raport është një instrument që do të ndihmojë që këto të dy nivelet e qeverisjes të ndajnë një kuptim të njëjtë mbi kuadrin aktual ligjor dhe institucional.

Zbatimi i rekomandimeve që vijnë nga brendia e këtij raporti do të kërkojë për një rishikim të Strategjisë dhe afatet kohore të saj, si edhe të burimeve financiare e njerëzore të nevojshme për të mundësuar përballjen me sfidën e vazhdueshme për decentralizim dhe demokraci.



2. METODOLOGJIA E ANALIZËS

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe akteve ligjore që rrjedhin prej saj, e veçanërisht ligjit për vetëqeverisjen vendore, sistemi i qeverisjes në Shqipëri përbëhet nga dy nivele:

1. niveli i qeverisjes qendrore, dhe
2. niveli i vetëqeverisjes vendore.

Niveli i dytë, ai i vetëqeverisjes vendore, përbëhet nga dy nën-nivele:

1. bashkitë (61), si njësia bazë, dhe
2. këshillat e qarkut (12), si nivel i dytë.

Për secilin funksion të vetëqeverisjes vendore, analiza ligjore zhvillohet sipas legjislacionit në fuqi të sektorit përkatës. Gjetjet e saj klasifikohen si mungesë, mbivendosje, mospërputhje ligjore në përcaktimin e funksionit, zbatimin, dhe monitorimin e vlerësimit të tij. Për këtë klasifikim, në përcaktimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e një funksioni:

- me *mungesë ligjore* kuptohet mungesa e rregullimit të një pjese të një funksioni, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet akteve ligjore;
- me *mbivendosje ligjore* kuptohet ngarkimi njëkohësisht i të dy niveleve të qeverisjes me përgjegjësi për të njëjtën pjesë të një funksioni;
- me *mospërputhje ligjore* kuptohet rregullimi i një pjese të një funksioni, nëpërmjet akteve ligjore që bien në kundërshtim me njëra tjetrën, me ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që krijojnë paqartësi në lidhje me njëra-tjetrën, ose që pengojnë zbatimin efektiv të funksionit nga njëri ose tjetri nivel qeverisjeje.

Përkufizimi i funksioneve analizohet sipas ligjit organik të sektorit përkatës dhe brenda kuadrit të përgjegjësi që i ngarkohen njësive të vetëqeverisjes vendore.

Zbatimi i funksioneve analizohet sipas legjislacionit në fuqi të sektorit përkatës, i grupuar sipas komponentëve të funksionit. Me komponent të një funksioni kuptohet çdo veprimtari që është objekt i (i) rregullimit dhe (ii) administrimit të funksionit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, e për rrjedhojë, i proceseve të ushtrimit të tij, sipas përkufizimit në ligjin 139/2015:

- a. rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje,
- b. standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin,
- c. planifikim,
- d. financim,
- e. organizim.

Komponentët e një funksioni rrjedhin nga ligji organik i sektorit.

Çdo komponent tjetër i një funksioni i cili nuk parashikohet në ligjin organik të sektorit, por është objekt rregullimi dhe administrimi nga bashk itë, kuptohet në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit 139/2015 mbi administrimin e shërbimeve publike, sipas të cilit “mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Analiza nuk merr parasysh mungesa, mbivendosje dhe mospërputhje ligjore që lidhen me institucionet e qeverisjes qendrore dhe nuk ndikojnë veprimtarinë e vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Monitorimi dhe vlerësimi i secilit funksion analizohet në kuadër të përcaktimeve të ligjit 139/2015, nenit 13, "Mbikëqyrja dhe Kontrolli". Sipas tij, për funksionet e qeverisë vendore janë objekt monitorimi zbatimi i normave e standardeve minimale kombëtare dhe i normave e standardeve vendore.

- Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore monitorohen nga organet e qeverisë qendrore si më poshtë:
 - Për zbatimin e normave e të standardeve minimale kombëtare të funksioneve, të përcaktuara në legjislacionin e sektorit përkatës, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen monitorimit nga ministritë, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë;
 - Për zbatimin e normave e të standardeve minimale kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore monitorojnë dhe vlerësojnë funksionet në kuadër të administrimit të shërbimeve publike, nëpërmjet një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, për zbatimin e standardeve vendore dhe/ose standardeve minimale kombëtare.

Aktualisht, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore nuk kanë vendosur ende një sistem administrimi të performancës së shërbimeve të tyre, rrjedhimisht nuk kryhet në mënyrë sistematike monitorimi e vlerësimi i standardeve vendore dhe/ose atyre minimale kombëtare.

Në këto kushte, monitorimi dhe vlerësimi i secilit funksion analizohet këtu në lidhje me monitorimin nga ministritë, për zbatimin e normave e të standardeve minimale kombëtare të funksioneve, të përcaktuara në legjislacionin e sektorit përkatës

8

Burimet financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore analizohen në kuadër të parimit të mjaftueshmërisë financiare të funksioneve të tyre, në përputhje me qëllimin e projektit për të qartësuar përgjegjësitë e të dy niveleve të qeverisjes në lidhje me funksionet e vetëqeverisjes vendore.

Në bazë të këtij parimi, për çdo funksion të transferuar apo deleguar tek vetëqeverisja vendore, qeverisja qendrore duhet të transferojë dhe burimet financiare në përpjesëtim me koston e ushtrimit të tyre. Për rrjedhojë, analiza e shpërndarjes së burimeve financiare nga qeverisja qendrore tek vetëqeverisja vendore për funksionet e transferuara ose të deleguara ngre pyetjen nëse transfertat e mësipërme janë në përpjesëtim me koston e ushtrimit të funksioneve të reja.

Në analizë janë marrë transfertat e qeverisë qendrore për zbatimin e funksioneve të veta, të transferuara dhe të deleguara të vetëqeverisjes vendore, në vijim:

- a. transfertat e pakushtëzuar,
- b. transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara,
- c. transfertat specifike për funksionet e reja të transferuara.

Analiza është ndërtuar sipas analizës së parimit të mjaftueshmërisë financiare të vetëqeverisjes vendore kryer nga Këshilli i Evropës për 47 vendet anëtare¹, në vitin 2016.

Burimi i të dhënave sasiore dhe cilësore për analizën është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

¹ Për referencën e plotë të dokumentit të Këshillit të Evropës mbi mjaftueshmërinë financiare shih bibliografinë e këtij raporti.

2.1 SKICË E MATRICËS SË KOMPETENCEVE

Ndarja ndërmjet dy niveleve të qeverisjes e përgjegjëse për administrimin, rregullimin dhe monitorimin e vlerësimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore paraqitet grafikisht nëpërmjet skemave si më poshtë:

- 1. Organigrama** e institucioneve bashkërisht përgjegjëse për ushtrimin e funksionit, në të cilën paraqitet hierarkia e institucioneve të secilit nivel të qeverisjes dhe ndërvaresitë mes tyre siç përcaktohen në legjislacionin sektorial përkatës;
- 2. Matrica e administrimit** të funksionit hartohet mbi bazën e komponentëve të funksionit të përcaktuar në legjislacionin sektorial dhe të grupuar sipas përkufizimit të funksionit në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe në disa raste edhe sipas përkufizimit të legjislacionit sektorial përkatës. Për secilin grup komponentësh/funksion trajtohen proceset e (i) planifikimit, dhe (ii) organizimit, të cilat janë përbërëse të administrimit të funksionit, sipas përkufizimit të tij në ligjin 139/2015.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Funksioni nr.	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
komponentë	
Organizim	
komponentë	

- 3. Matrica e rregullimit** të funksionit paraqet standardet e administrimit të funksionit të cilat janë objekt rregullimi sipas legjislacionit sektorial, së bashku me institucionet përgjegjëse për hartimin e tyre.

RREGULLIMI I FUNKSIONIT	
Objekti	Institucioni Përgjegjës
standardet	

- 4. Matrica e monitorimit vlerësimit** të funksionit paraqet standardet e administrimit të funksionit të cilat janë objekt monitorimi dhe vlerësimi sipas legjislacionit sektorial, së bashku me:
 - subjektin që monitorohet për zbatimin e këtyre standardeve, që mund të jetë institucion i qeverisë qendrore, vendore ose person fizik,
 - institucionin përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin,
 - institucionin përgjegjës për vendosjen e sanksioneve për kundërvajtje administrative.

Sipas funksionit paraqitet dhe sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, së bashku me institucionin përgjegjës për zbatimin e tij

MONITORIM DHE VLERËSIM			
Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
standardet			
Sistemi			

3. VETQEVERISJA VENDORE NË SHQIPËRI

3.1 DECENTRALIZIMI

Gjendja e sotme e vetëqeverisjes vendore është rezultat i dinamikave të faktorëve politikë, ekonomikë, dhe shoqërorë të tranzicionit, si dhe i historisë, traditës, kulturës dhe psikologjisë sociale shqiptare. Megjithëse veprimi/ndikimi i këtyre faktorëve ka qenë i dyanshëm, dhe hapat kryesorë të ndërmarrë në favor të decentralizimit, janë bazuar kryesisht në objektiva të centralizuara politikë, të gjitha proceset kanë qenë nxitëse dhe progresive, ndonëse me shpejtësi dhe shtrirje të ndryshme.

Qeverisja vendore në Shqipëri, përpara viteve 90, në thelb ishte një qeverisje e dekoncentruar, me organe të kufizuara vetëqeverisëse (këshillat popullore) brenda kuadrit të një sistemi vendimmarrës thellësisht të centralizuar, qeverisje kjo e ngarkuar për menaxhimin e zbatimit të planeve ekonomike të centralizuara dhe të detajuara të qeverisë.

Në vitet 90, sistemi u orientua drejt një modeli më të decentralizuar dhe qeverisjeje vendore autonome. Në gusht 1992 u krijuan të parat organe të qeverisjes vendore sipas Ligjit të asaj kohe mbi “Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal - qershor (1992)”, që për atë kohë ishte një arritje tepër e rëndësishme. Organeve vendore iu kaluan disa nga shërbimet dhe funksionet me përfitim të drejtpërdrejtë për publikun, së bashku me më shumë autonomi administrative dhe financiare. Megjithatë, përkundrejt qëndrueshmërisë së autonomisë politike, autonomia fiskale dhe administrative mbeti tejet e kufizuar.

Decentralizimi ka qenë në fokus të politikave të Qeverisë duke filluar që nga vitet 1998-1999. Hapat e parë të vegjël u zbatuan kryesisht në buxhet dhe fushat fiskale. Që prej këtyre hapave të para, reforma e decentralizimit ka përparuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve 1999 dhe 2000 bazuar në Kushtetutën (1998), Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale (e ratifikuar në nëntor 1999) dhe Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit e adoptuar në janar 2000 . Ligji mbi “Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore, nr. 8652 i datës 31 korrik, 2000” është konsideruar atëherë si një hap shumë i rëndësishëm në procesin faktik të decentralizimit në Shqipëri, si një nga reformat kryesore të vendit me një influencë të rëndësishme mbi reformat e tjera si financat publike, administratën publike, shërbimet publike, arsimin, shëndetësinë dhe asistencën sociale.

Nga viti 2000 e në vijim u hartuan një sërë ligjesh zbatimi i të cilave krijoi kushte të posaçme për një qeverisje vendore efektive dhe me një autonomi relative por gjithsesi me kufizime krahasuar me vitet e para të tranzicionit politik në Shqipëri. Gjithsesi kufizimet në burimet financiare dhe dhe në të drejtën e shpërndarjes së burimeve e kanë kufizuar në vijimësi autonominë vendore.

Reforma e Decentralizimit rivjen në vëmendje të plotë në vitin 2015 kur u hartua dhe u miratua në korrik 2015 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 (SNDQV). Strategjia e re u parapri nga një reformë intensive për konsolidimin administrativo-territorial duke miratuar Ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e cila çoi në zvogëlimin e numrit të njësisve vendore nga 373 (308 komuna dhe 65 bashki) në 61 bashki, gjithsesi me një juridiksion administrativ shumë më të madh nga sa mund të imagjinohej.

Reforma u mbështet nga hartimi dhe miratimi i ligjit të ri 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i cili e zgjeron më tej fushën e kompetencave, shtatë funksione të reja, duke e çuar

në 41 numrin total të funksioneve vendore. Në vijim u miratua Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të tre këto ligje e kanë riformatuar autoritetin e qeverisjes vendore në kontekstin e juridiksionit territorial, kompetencës ligjore dhe burimeve financiare.

Zbatimi i reformës së decentralizimit vendor ka synuar qartazi që të rrisë përgjegjësitë e njëjësive të qeverisjes vendore në shumë sektor publik, kryesisht shërbime të cilat përgjithësisht pranohet se janë më eficientë kur ato ushtrohen nga niveli qeverisës që është më afër qytetarëve.

Megjithatë, nga shumë raporte², përfshirë edhe këtë raport dhe matricën shoqëruese, të cilat analizojnë efektet e zbatimit të strategjisë dhe efektivitetin e veprimtarisë së NQV arrijnë në konkluzione të njëjta për sa s’fidave me të cilat përballet kjo reform dhe që kanë të bëjnë të paktën me: (i) mjaftueshmërinë e burimeve financiare dhe diskrecionin e NJQV në lidhje me shpërndarjen e këtyre burimeve; (ii) përputhshmëria e ligjit organik të NJQV me ligjet e tjera sektoriale; (iii) pamjaftueshmëria e burimeve dhe kapaciteteve njerzore; (iv) shtrirja dhe cilësia e dhënies së shërbimeve publike, dhe (v) efektiviteti i ushtrimit të funksioneve të NJQV.

3.2 STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIM DHE QEVERISJE VENDORE 2015-2020

Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 është: “Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe procesit të decentralizimit me qëllim garantimin e një efieience më të lartë të *qeverisjes vendore dhe rritjen e autonomisë financiare dhe funksionale*. Në fushën e funksioneve të veta, objektivat kryesorë të SNDQV 2015-2020 janë si më poshtë:

12

- Të rishikojë dhe të përmirësojë kuadrin ligjor në zbatimin e funksioneve dhe të veta
- Të përmirësojë cilësinë e infrastrukturës në bazë të standardeve minimale kombëtare të detyruara që duhen përcaktuar;
- Të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik vendor me anë të projektimit dhe zbatimit të kuadrit të përshtatshëm të politikave dhe mekanizmave të bashkërendimit të tyre.

SNDQV 2015-2020 përfundoi fazën e dytë të zbatimit në korrik 2017 dhe ka hyrë në të tretën. Rishikimi dhe ripërkufizimi i kuadrit ligjor dhe institucional të vetëqeverisjes vendore është një nga pjesët më të rëndësishme strategjike, pasi është argumentuar se ndarja e funksioneve dhe kompetencave janë të paqarta, paqartësi të cilat rrjedhin kryesisht nga kuadri ligjor sektorial i pazhvilluar dhe i paqartë që rregullon strukturën dhe ndan rolet dhe kompetencat e autoriteteve qendrore dhe vendore si në nivel bashkiak dhe në atë të këshillave të qarqeve; kjo paqartësi krijon pasiguri dhe dykuptimësi ose mbivendosje mbi rolin e qeverisjes vendore dhe institucioneve të dekoncentruara në lidhje me shumë prej funksioneve të cilat janë definuar si funksione të NJQV.

Ecuria e zbatimit të strategjisë së decentralizimit është vlerësuar nëpërmjet dy Raporteve Vjetore të Monitorimit të viteve 2016 dhe 2017. Së fundmi, përmes Raportit të Rishikimit Afat-Mesëm (RAM), është vlerësuar niveli i zbatimit për tre vitet e para të SNDQV 2015-2017.

Ligji i ri mbi Vetëqeverisjen Vendore rishikoi kompetencat e Kryetarit të Bashkisë me qëllim fuqizimin e kompetencave të tij mbikëqyrëse mbi administratën e brendshme si dhe menaxhimin e interesave pronësore të bashkisë, siç parashikohet në strategji.

Këshilli bashkiak merr një rol më të madh në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të ecurisë dhe performancës së administratës bashkiake, në raport me vendimet e këshillit dhe pritshmëritë

² “Monitorimi i funksioneve të reja që Pushteti qendror i’u transferoi bashkive”, dldp, 2017 “Funksionimi i bashkive në kuadër të Reformës Territoriale – Administrative”, KLSH, 2017

e qytetarëve. Ky ndryshim ligjor e vendos rolin e Këshillit Bashkiak në një pozicion të ri, duke e pozicionuar atë plotësisht si organi përfaqësues i interesave të komunitetit. Njëkohësisht ndryshimet ligjore forcojnë elementet e përgjegjshmërisë publike të këshilltarëve në kryerjen e funksionit të tyre dhe parandalimin e fenomeneve korruptive të hasura shpesh në vendimmarrjet e këshilltarëve bashkiakë, duke i përcaktuar ata si subjekt i legjislacionit për konfliktin e interesave.

Raporti i dytë i monitorimit konstaton se rezultatet kryesore të arritura janë: krijimi i Këshillit Konsultativ si instrumenti kryesor për koordinimin institucional dhe monitorimin e reformave të decentralizimit dhe zbatimin e strategjisë; miratimin e ligjit për Financat Vendore me qëllim rritjen e autonomisë fiskale vendore dhe menaxhimin financiar efektiv dhe efikas në nivel vendor, harmonizimin e legjislacionit në lidhje me menaxhimin e financave publike, rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe qëndrueshmërinë financiare vendore.

Miratimi i ligjit të ri për Prefektin e Qarkut rishikoi rolin e prefektit kundrejt koordinimit të autoriteteve qendrore në nivel rajonal; ku roli i Prefektit në lidhje me monitorimin e legjitimitetit të operacioneve të qeverisjes vendore është forcuar lehtësisht (nenet 15 – 17); ashtu siç është forcuar autoriteti i prefektit për krijimin e grupeve të punës dhe task forcave me pjesëmarrjen e detyrueshme të njëjësive të qeverisjes qendrore dhe vendore për të ndjekur politikat e nivelit kombëtar ose emergjencat rajonale.

Miratimi i ligjit për ujitje dhe kullim ka bërë që të fillojë procesi për decentralizimin e plotë të këtij funksioni; ndërsa strategjia e ujitjes / kullimit është duke u hartuar. Pavarësisht progresit të bërë në aspektin legjislativ, zbatimi i reformës në këtë funksion vazhdon të ballafaqohet me probleme në hartimin e akteve nënligjore dhe veçanërisht në lehtësimin e marrëdhënieve midis Bordeve të kullimit dhe bashkive.

E njëjta situatë vlen edhe për sistemin e pyjeve dhe kullotave. Një VKM e veçantë transferoi 100% të pyjeve dhe kullotave në pronësi të 61 bashkitë të reja; pavarësisht, ende ka paqartësi në lidhje me buxhetin e transferuar, mungesa të akteve nënligjore që qartësojnë kompetencat e bashkive dhe ndarjen e saktë të kufijve ndërmjet NJQV.

Megjithatë sipas RAM, strategjia lë jashtë disa çështje kryesore dhe disa probleme të pazgjidhura të cilat janë shumë të rëndësishme për njësitë e qeverisjes vendore, ndërlidhjet e tjera që ekzistojnë mes decentralizimit dhe politikës rajonale; roli i qarqeve; premiset kombëtare dhe lokale në financimin e zhvillimit lokal kombëtar/rajonal ose drejtime të mëtejshëm për zhvillimin e sistemit të transfertave ndërqeveritare (kryesisht granteve të kushtëzuara).

Një sistem i monitorimit të performancës së njëjësive të qeverisë vendore do të zhvillohet si një mekanizëm për sigurimin e llogaridhënies së administratës publike dhe eficiencën në dhënien shërbimeve në nivel vendor.

4. LIGJI 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

Ligji 139/2015 është një hap përpara në procesin e decentralizimit të qeverisjes në Shqipëri; më shumë funksione i janë transferuar bashkive të cilat besohet se mund të ofrohen më me efikasitet dhe efektivitet nga niveli qeverisës më afër qytetarëve, por edhe pse ky ligj përmban disa elementë të tjerë të cilët inkurajojnë bashkëpunimin ndër institucional, ndajnë qartazi kompetencat ndërmjet organeve të vetëqeverisjes, rrisin diskrecionin e NJQV mbi burimet financiare, si dhe supozimin mbi rritjen e rolit të shoqërisë civile dhe qytetarëve në përgjithësi.

Gjithsesi, një analizë e shkurtër e këtij ligji do të bëjë më të kuptueshme analizën e kuadrit institucional dhe ligjor sektorial që do të vijojë në këtë raport dhe ndoshta do të na bëjë të reflektojmë dhe të pranojmë nevojën për ndonjë ndryshim i cili i vjen në ndihmë këtij misioni.

Kësaj analize i vjen në ndihmë Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore (Karta) për të na sqaruar lidhur me disa prej përkufizimeve bazë të shprehur në ligj dhe interpretimit të tyre për të shpërndarë moskuptimin që vjen nëpërmjet legjislacionit dhe institucioneve sektoriale.

Analiza kufizohet vetëm mbi qartësimin e kuptimit mbi shprehjet e **“funksioneve”** dhe **“funksioneve të veta”** si dhe të instrumenteve **“administrimi”** dhe **“rregullimi”**.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton funksionet, [të drejtat dhe detyrat] e njësive të vetëqeverisjes vendore e të organeve përkatëse.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ka përkufizuar gjithashtu edhe konceptin e kompetencës së përgjithshme si një e drejtë ligjore për ushtrimin e funksioneve nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Ligji në nenin 4/1 “Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore”, në nenin 21/1 ligji ka përcaktuar se “Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara”, dhe në vijim (Neni 22/1) “Njësitë e vetëqeverisjes vendore **rregullojnë** dhe **administrojnë** ushtrimin e **funksioneve të veta** në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi”.

Këto dispozita përbëjnë koncepte shumë të rëndësishme për të cilat në nenin 2 ligji ka parashtruar disa përkufizime të cilat lehtësojnë kuptimin e termave në vijim:

- **“Autonomi vendore”** është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të **rregullojnë** dhe të **administrojnë** një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.
- **“Funksion”** është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.
- **“Kompetencë”** është autoriteti i dhënë me ligj një organi të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e një funksioni apo një pjese të tij.
- **“Funksione të deleguara”** janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore.
- **“Rregullimi”** është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin.
- **“Administrimi”** është e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni.

Duke u referuar me përkufizimet si më sipër, NJQV-të ushtrojnë “funksionet e veta” (Neni 23 e në vijim) kundrejt nenit 2 në të cilin jepet një përkufizim përgjithësues i kuptimit të “funksionit”, ndërsa mungon një përkufizim i posaçëm për çfarë kuptojmë me “funksion të vet” të NJQV-ve. Një përkufizim i tillë do të qartësonte përmbajtjen e funksioneve që NJQV-të ushtrojnë në kuptimin e këtij ligji.

Në kuptimin tonë dhe në vijimësi bazuar në të drejtën e “autonomisë vendore”, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të veta ne kuptojmë se NJQV-të kanë të drejtën kushtetuese të **rregullojnë** (neni 2/9) dhe **administrojnë** (neni 2/1) ushtrimin e funksioneve të veta; në këtë kontekst NJQV-të kanë të drejtën *“për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin” dhe të “drejtën për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni”*, ashtu siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 22 të këtij ligji.

Kur analizojmë funksionet e parashikuara në nenet 23 – 29, dhe referuar logjikës si më sipër, gjejmë p.sh se vetëm funksioni “administrim dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe (neni 23/12) dhe “... funksionet që nuk janë të përcaktuara nga ligje sektoriale ... (neni 32/2) mund të konsiderohen në mënyrë të mirëfilltë si “funksione të veta” të NJQV-ve.

Në këtë kontest mund të shtrohet pyetja: - Po funksionet e tjera (p.sh. “mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake” apo “mbledhja, largimi, trajtimi i ujërave të ndotura”), a janë funksione të veta të NJQV, apo thjesht ato ushtrojnë disa kompetenca për disa ose një grup aspektesh të funksioneve të përkufizuar si të tillë në përgjithësi?

Kjo paqartësi është konstatuar edhe nga “Opinionin i Këshillit të Evropës mbi Projektligjin e Vetëqeverisjes Vendore”, datë 12 tetor 2015, përpara miratimit të tij në Kuvend.

16

Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje, mund të merret në konsideratë **Rekomandimi** për të hapur një diskutim me aktorët e interesit me qëllim që të bëhen disa rregullime në ligjin 139/2015 që saktësojnë kuptimin e koncepteve të disa dispozitave ligjore që lidhen veçanërisht me përkufizimin e “funksioneve të veta” të NJQV dhe shprehjen e tyre në respekt të këtyre koncepteve të “rregulluara” në legjislacionin sektorial sa herë që rasti do të kërkojë harmonizimin e ndarjes së autoritetit ligjor ndërmjet autoriteteve vendore dhe qeverisë qendrore.

5. ANALIZA E FUNKSIONEVE TË QEVERISË VENDORE

5.1 FUSHA E INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Fusha e infrastrukturës përbëhet nga 14 funksione të cilat përfaqësohen përgjithësisht nga veprimtari ndërtimore dhe shërbime të lidhura kryesisht me fushën e ujësjellës kanalizime, largim të ujërave të shirave, ndërtim të rrugëve në pronësi të NJQV, varrezave, rrjetit të ndriçimit vendor, hapësirave publike, rrjetit të menaxhimit të mbetjeve, godinave të arsimit parauniversitar dhe çerdheve, ndërtesat e shërbimit shëndetësor. Si shërbime në këtë fushë janë përfshirë gjithashtu shërbimi i transportit rrugor, administrimi i kopshteve, çerdheve, qendrat shëndetësore, shërbimi i varrimeve si dhe shërbime në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

5.1.1 PRODHIMI, TRAJTIMI, TRANSMETIMI DHE FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM (NENI 23/1), DHE MBLEDHJA LARGIMI DHE TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURARA (NENI 23/2)

• Kutiza 1 •

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e prodhimit, trajtimit, transmetimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm si dhe mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura

Drejtimit strategjike

- *Krijimi i një legjislacioni për shërbimet publike/ndërmarrjet publike*, prioritet në periudhë afatshkurtër. Në kuadrin e reformës administrative ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve dhe asetet e tyre do t'i nënshtrohen rikonfigurimit/bashkimit të tyre sipas ndarjes së re administrative me 61 bashki.
- *Rishikim i kuadrit rregullator dhe financiar* duke synuar që të vendosen standarde të reja në sistemin e prodhimit të ujit, shpërndarjes dhe menaxhimit të ujërave të ndotura, prioritet në periudhë afatmesme.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Rishikimi i skemës së funksioneve dhe kompetencave në sektorin e ujësjellës-kanalizime ka riorganizuar kompanitë e ujësjellësve në përputhje me shtrirjen e re territoriale, duke forcuar kontrollin dhe përgjegjësinë e bashkive në menaxhimin e ujit.
- Qeveritë vendore kryejnë edhe funksione të tjera të lidhura me ujërat; si pjesëmarrja në komitetet rajonale të baseneve ujore (që buron nga ligjet e sektorit). Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të forcohen autoritetet monitoruese të bashkive, sidomos në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.
- RAM raporton se kohët e fundit qeveria qendrore ka nisur një proces për përpunimin e legjislacionit specifik për sektorin e ujit.
- Qeveria ka përpunuar një masterplan për impiantet e trajtimit të ujit të përdorur, i cili parashikon nevojën për të rishikuar tarifatat e zhvendosjes së ujit të përdorur.
- Sektori ka nevojë urgjente për investime të mëdha, të cilat nuk mund të sigurohen pa mbështetjen e buxhetit të shtetit. Hendeku financiar për sektorin është shumë domethënës, edhe për shkak të mirëmbajtjes së vonuar ndër vite.

Shërbimi i PTTFUP dhe MLTUN karakterizohet nga nën komponentët, burimi ujqor, prodhimi, grumbullimi, trajtimi i ujit të pijshëm, furnizimi dhe mbledhja, largimi e trajtimi i ujërave të ndotura.

Përkufizimi

Me PTTFUP, siç përcaktohet në legjislacionin sektorial kuptojmë veprimtarinë e grumbullimit, trajtimit dhe shpërndarjen e burimeve ujore për qëllime publike.

1. Me “prodhim të ujit”, ka të bëjë me të gjitha burimet natyrore të ujit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuiferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Ky përkufizim i bërë nga ligji 8102 nuk është i kuptueshëm. Një përkufizim i ndryshëm nga përkufizimi i bërë në ligjin nr. 8102 ka për qëllim të japë kuptimin e shfrytëzimit të këtyre burimeve për qëllimin e furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të një NJQV apo të gjithë vendit.

2. Me “grumbullim” kuptojmë të gjitha ato veprimtari që nëpërmjet strukturave apo mekanizmave të tillë, si: diga, puse, depo uji, cisterna, ujësjellës, tubacione, grumbullojnë, kanalizojnë, ndryshojnë drejtimin apo nxjerrin ujin për përfitim publik.
3. Me “trajtim” kuptojmë të gjitha metodat dhe mjetet, qofshin këto biologjike, kimike, mekanike, elektrike etj., që përdoren për pastrimin apo ndryshimin e gjendjes së ujit për përfitim publik.
4. Ligji nr. 8102 nuk përkufizon termin “transmetim”, këtë term mund ta kuptojmë si procesi i kalimit të ujit në sistem dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm pas prodhimit/trajtimit.
5. Me “shpërndarje të ujit”, kuptojmë të gjitha veprimtaritë me anë të cilave uji pompohet, transportohet dhe shpërndahet nga një vend në tjetrin për përfitim publik.

18

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, përkufizon termin “prodhimi i ujit” që ka të bëjë me të gjitha burimet natyrore të ujit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuiferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky term është i paqartë jo shterues.

Rekomandim [1]: Rekomandohet përkufizimi i termit “prodhimi i ujit” në mënyrë më shteruese, përkufizim i bërë nga ligji 8102 nuk është i kuptueshëm. Një përkufizim për këtë term mund të jetë: tërësia e proceseve inxhinierike të projektimit, zhvillimit, zbatimit, operimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit për shfrytëzimin e të gjitha burimeve natyrore të ujit, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuiferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore deri në nxjerrjen e një produkti me normat e caktuara nga legjislacioni sektorial ose në një formë tjetër teknikisht të përshtatshme.

Ligji nr. 8102 nuk përkufizon termin “transmetim”, këtë term mund ta kuptojmë si procesi i transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm pas prodhimit dhe trajtimit.

Rekomandim [2]: Rekomandohet përkufizimi i termit “transmetim”.

Rekomandimet si më sipër kanë për qëllim që të saktësojnë në mënyrë shteruese linjën e komponentëve përbërës të funksionit dhe të drejtave të NJQV përgjatë kësaj linje përgjegjësie.

Përkufizimi:

1. Me “ujëra të ndotura” do të kuptojmë të gjitha ato ujëra që janë përdorur për qëllime hidro-sanitare dhe industriale të ngjashme, grumbullimi, përpunimi dhe largimi i të cilave është urdhëruar për shëndetin dhe komoditetin publik.
2. Me “mbledhje të ujërave të ndotura” do të kuptojmë grumbullimin që ka të bëjë me të gjitha ato veprimtari që nëpërmjet sistemit të kanalizimeve që përfshin të gjitha tubacionet, kolektorët, pajisjet, ndërtesat dhe strukturat, që shërbejnë për mbledhjen e ujërave të ndotura, stacionet e pompimit ose paratrajtimi i ujërave të ndotura, por që nuk përfshijnë ujërat e shiut, ndryshojnë drejtimin e ujërave të ndotura.
3. Me “largim të ujërave të ndotura” do të kuptojmë veprimtarinë që nëpërmjet sistemit të kanalizimeve bën të mundur largimin e ujërave të ndotura deri në mekanizmat e trajtimit.
4. Me “trajtim të ujërave të ndotura” do të kuptojmë të gjitha metodat dhe mjetet, qofshin këto biologjike, kimike, mekanike, elektrike etj., që përdoren për pastrimin apo ndryshimin e gjendjes së ujit për përfitim publik.

Analiza e zbatimit të këtij funksioni (si dhe të gjithë funksioneve të tjera në vazhdim) është bërë mbi instrumentet ligjorë të “Administrimit” dhe “Rregullimit” siç janë përkufizuar në ligjin 139/2015, sipas mënyrës së shtjelluar në metodologji.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 1: Organigrma për funksionin furnizimin me ujë të pijshëm (Neni 23/1), dhe ujërave të ndoturara (Neni 23/2)

Aspekte të veçanta të këtij funksioni administrohen dhe rregullohen nga rreth 19 institucione të ndryshme duke përfshirë Këshillin e Ministrave, Entin Rregulator të Ujit dhe NJQV-të.

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar dhe përshkruar rolin e institucioneve të përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Burimi Ujor		Institucioni Përgjegjës
	Planifikim	
	Miraton plane dhe projekte, ndër rajonalë dhe kombëtare në urbanistikë kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave	KKU
	Harton dhe zbaton politika, strategji, plane, programe dhe projekte, që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre	
	Propozon K KU-së dhënie me koncesion të burimeve ujore	
	Propozon K KU-së dhënie e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit dhe shkarkimeve, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm	AMBU
	Harton inventarin kombëtar të burimeve ujore, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor	
20	Harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore	
	Përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike të burimeve ujore	
	Siguron ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujq	
	Siguron dhe shpërndan drejtë burimet ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujq, sipas qëllimeve të përdorimit	
	Drejton dhe administron burimet ujore	KBU
	Identifikon trupat ujorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje	
	Siguron mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet	
	Kryen pastrimin e burimeve ujore, me qëllim përftimin e ujit të pijshëm	
	Përpilon projektin e planit për burimet ujore për basenin përkatës dhe e paraqet për miratim në KBU	ZABU
	Harton inventarin e burimeve ujore në sasi dhe cilësi, si dhe bën periodikisht përditësimin e tij	
	Organizim	
	Jep me koncesione burimet ujore	KKU
Prodhim		Institucioni Përgjegjës
	Planifikim	

Harton, zbaton dhe ndjek politika të zhvillimit të infrastrukturës me tubacione për ujësjellës-kanalizimet	MIE
Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare	
Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve	
Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre	AKUKM
Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve	
Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi	
Organizim	
Jep leje dhe autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet	KKU
Jep leje për ndërtimin e strukturave dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura	KKT/NJQV
Grumbullim	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton, zbaton dhe ndjek politika të zhvillimit të infrastrukturës me tubacione për ujësjellës-kanalizimet	MIE
Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare	
Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve	
Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre	AKUKM
Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve	
Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi	

Organizim	
Licencon veprimtarinë e grumbullimit, shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik	KKRR (ERRU)
Jep leje për ndërtimin e strukturave dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura	KKT/NJQV
Trajtim i Ujit të Pijshëm	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton, zbaton dhe ndjek politika të zhvillimit të infrastrukturës me tubacione për ujësjellës-kanalizimet	MIE
Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare	
Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/ rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve	
Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre	AKUKM
Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve	
Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi	
Organizim	
Licencon veprimtarinë e grumbullimit, të shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik	KKRR (ERRU)
Jep leje për ndërtimin e strukturave dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura	KKT/NJQV
Furnizimi	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Miraton politikat dhe strategjitë kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë	KM
Harton, zbaton dhe ndjek politika të zhvillimit të infrastrukturës me tubacione për ujësjellës-kanalizimet	MIE

<p>Këshillon në hartimin e strategjive dhe të politikave kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura</p>	<p>KKRR (ERRU)</p>
<p>Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare</p>	
<p>Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve</p>	
<p>Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre</p>	<p>AKUM</p>
<p>Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve</p>	
<p>Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi</p>	
<p>Detyrojnë subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit</p>	<p>Organet e administrimit të burimeve ujore/ Inspektorati që mbulon fushën e mjedisit/ NJQV</p>
<p>Organizim</p>	
<p>Licencon veprimtarinë e grumbullimit, të shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik</p>	<p>KKRR (ERRU)</p>
<p>Jep leje për ndërtimin e strukturave dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura</p>	<p>KKT/NJQV</p>
<p>Mbledhja dhe Largimi i Ujërave të Ndotura</p>	<p>Institucioni Përgjegjës</p>
<p>Planifikim</p>	
<p>Miraton politikat dhe strategjitë kombëtare në sektorin e kanalizimeve</p>	<p>KM</p>
<p>Këshillon në hartimin e strategjive dhe të politikave kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura</p>	<p>KKRR (ERRU)</p>
<p>Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare</p>	<p>AKUM</p>
<p>Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve</p>	

Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre

Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve

Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi

Organizim

Licencon veprimtarinë e trajtimit të ujit, për përfitim publik

Jep leje për ndërtimin e strukturave dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura

AKUM

KKRR (ERRU)

KKT/NJQV

Trajtimi i Ujërave të Ndotura

**Institucioni
Përgjegjës**

24

Planifikim

Miraton politikat dhe strategjitë kombëtare në sektorin e kanalizimeve

Këshillon në hartimin e strategjive dhe të politikave kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura

Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare

Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale

Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre

Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve

Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi

AKUM

KKRR (ERRU)

KM

Ndërpret veprimtari apo pjesë të veçanta të saj, lidhur me shkarkimet e ujërave të paautorizuara	
Përcakton teknika, teknologji dhe metoda për trajtimin mjedisor	
Harton plane për trajtimin mjedisor në mënyre te integruar	
Krijon kuadrin ligjor	AMBU
Përsos rrjetin institucional përgjegjës	
Kontrollon veprimtaritë që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre	
Organizim	
Licencon veprimtarinë e trajtimit të ujit, për përfitim publik	KKRR (ERRU)
Jep leje për ndërtimin e strukturave dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura	KKT/NJQV

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Strategjinë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	
Kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm	
Rregullore për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet	
Normat e shkarkimeve të lëngshme	KM
Kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve	
Projektim, ndërtim dhe shfrytëzim i sistemeve të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura	
Standarde teknike të infrastrukturës	
Tregues dhe kritere në kontratën e performancës	MIE
Standarde të punës për të licencuarit	
Standarde për programet e investimeve dhe për shitjen e asetëve	
Kompetenca dhe funksione	
Standarde të shërbimit	KKRR (ERRU)
Afatet dhe kushtet e shërbimit	
Çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit të pijshëm, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre	
<i>Mendim për përcaktimin e tarifës së shitjes së ujit të pijshëm</i>	NJQV

Gjetje

Mungesë Legjislacioni

VKM-së nr. 643, datë 14.09.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve" i ka kaluar afati për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në të. Ky sektor aktualisht është pa strategji.

Rekomandim [3]: Rekomandohet rishikimi, përditësimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

KM si kërkesë e ligjit Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar; është përgjegjës për shpalljen e zonave të mbrojtura higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm. Ky vendim nuk rezulton të jetë miratuar.

Rekomandim [4]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për shpalljen e zonave të mbrojtura higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm.

Mospërputhje ligjore

VKM nr. 431 në pikën 13/g përcakton AKUKM përgjegjës për të mbështetur politikë bërësit për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore e të procedurave për procesin e kalimit të administrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë nga pushteti vendor në atë qendror, në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas kontratës së performancës, të lidhur ndërmjet palëve. Ky parashikim është në kundërshtim me objektivat kryesorë të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 si dhe më Kartën Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore ku theksohet që qeverisja vendore duhet të jetë sa më e lirë dhe e pavarur sa të jetë e mundur gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre publike, dhe të decentralizohen deri në atë nivel qeverisës që është më i afërti me popullatën. Ky pushtet i dhënë do të jetë sa më ekskluziv që të jetë e mundur dhe nuk do të kufizohet apo zhvlerësohet përmes mospërputhjeve të legjislacionit. Pavarësisht se forma të centralizimit mund të konsiderohen të arsyeshme nga pushteti qendror, centralizimi i këtij funksioni do kryhej në kundërshtim me nenin 23/1 i ligjit 139/2015 duke i hequr NJQV-ve një funksion të vetin.

Rekomandim [5]: Rekomandohet shfuqizimi i pikës 13/g të VKM-së 431.

VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për Miratimin e Modelit të Rregullores "Për Furnizimin me Ujë dhe për Kanalizimet në Zonën e Shërbimit të Ujës-jellës-Kanalizimeve sh.a." nuk ka dalë si kërkesë e ligjit dhe për rrjedhojë është në kundërshtim me Nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, i jep KM të drejtën e miratimit të politikave dhe strategjive kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura; në asnjë moment në këtë ligj nuk parashikohet që KM të miratojë rregulloren për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujës-jellës-kanalizimeve sh.a. Ndodhur në këto kushte kjo VKM bie ndesh me ligjin 139/2015, pasi nuk mund t'i njihen njësisë të vetëqeverisjes vendore funksione apo kompetenca pa u bazuar në ligj (neni 21/2,3 ligjit 139/2015).

Rekomandim [6]: Rekomandohet shfuqizimi i VKM nr. 1304. Nëse disa të drejta dhe detyrimet të përcaktuara në VKM nr. 1304 vlerësohen të nevojshme për kryerjen më me eficiencë të funksionit të PTFUP dhe MLTUN, rekomandohet që këto kompetenca të miratohen nga ERRU, që nxjerr rregulla për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Gjithashtu duhet mbajtur parasysh që disa nga rregullimet e kësaj VKM-je si mënyra e organizimit të UK-sha shkëlin autonominë e NJQV-ve për mënyrën e

administrimit të funksionit duke i dhënë detyrime në tejkalim të attributeve që jep ligji sektorial dhe neni 32 “Administrimi i shërbimeve publike” në ligjin 139/2015.

VKM-ja nr. 63, datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK” nuk ka dalë si kërkesë e ligjit në kundërshtim me Nenin 118 të Kushtetutës së Shqipërisë. Kjo VKM bie ndesh me ligjin 139/2015, pasi nuk mund t’i njihen NJQV-ve funksione apo kompetenca pa u bazuar në ligj (neni 21/2,3 ligjit 139/2015). Rregullimet e kësaj VKM-je për mënyrën e organizimit të UK-sha shkelin autonominë e NJQV-ve për të drejtën e vendosjes së mënyrës së administrimit të funksionit dhe bien ndesh me parashikimet e neni 32 “Administrimi i shërbimeve publike” në ligjin 139/2015.

Rekomandim [7]: Rekomandohet shfuqizimi i VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK”.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Standardet e punës			
Cilësia, eficienta, vazhdueshmëria e shërbimit		ERRU / NJQV	ERRU
Çmimet, tarifat dhe kushtet e tjera të shërbimit			
Standardet teknike të infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve		MIE	Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor
Rregullat teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit		AKUM	
Kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve	SH.A UK/ Ndërrmarje Shtetërore	AMBU/MTM	Inspektorati për Mjedisin dhe Pyjet
Normat e shkarkimeve të lëngëta		Inspektorati për Mjedisin dhe Pyjet	
Veprimtaritë që shkaktojnë ndotje të ujërave, subjektet që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre		MTM / NJQV	
Burimet dhe objektet e tjera të ujit të pijshëm dhe derdhja e ujërave të institucioneve të ndryshme pa u dezinfektuar ose dezaktivizuar		ISSH	ISSH
Uji i pijshëm		AKU	Inspektorati për Mjedisin dhe Pyjet

Instalimi i pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit	Persona fizikë apo juridikë përdorues të ujit	Organet e administrimit të burimeve ujore/ Inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit / NJQV	Inspektoratet kombëtare përgjegjëse për kontrollin e territorit, mjedisit dhe ujërave
Sistemi			
Programi i monitorimit të shërbimit të furnizimit me ujë		AKUM	

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligji 8102 në nenin 14 i njeh ERRU kompetencë për inkurajimin e standardeve dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin. Termi “inkurajim” krijon paqartësi pasi kjo kompetencë e ERRU nuk mund të konsiderohet si e detyrueshme për NJQV-të.

Rekomandim [8]: Rekomandohet riformulimi i nenit 14 i ligjit 8102, në mënyrë që përkufizimi i kësaj kompetence të ERRU të jetë shteruese.

Siç mund të vërehet nga skema për monitorim dhe vlerësimin e funksionit asnjë autoritet nuk monitoron NJQV-të si autoriteti përgjegjës në bazë të ligji të saj organik për ofrimin e këtij funksioni.

Rekomandim [9]: Rekomandohet që ERRU si institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e këtij funksioni të monitorojë përveç operatorit U.K sha edhe NJQV-në në lidhje me përgjegjësinë e saj për ofrimin e këtij shërbimi. Ky rekomandim kërkon që në ligjin organik të ERRU të bëhet një ndarje e qartë e kompetencave të NJQV-së për këtë funksion, si dhe për trajtimin e UK sha, ndërmarrjeve shtetërore apo çdo instrument tjetër të zgjedhur nga NJQV sipas mënyrës më të përshtatshme të vendosur prej saj për ofrimin e shërbimit.

Në përmbledhje të rekomandimeve të shumta të hasura në këtë sektor, duke qenë se vërehen mungesa dhe mospërputhje si në administrim, rregullim dhe në monitorim dhe vlerësim, mund të konsiderohet e arsyeshme hartimi dhe miratimi i një ligji të ri sektorial.

Rekomandim [10]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i një ligji të ri sektorial duke përcaktuar qartësisht përgjegjësitë e institucioneve të përfshira, në një model të përafërt me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

5.1.2 MBLEDHJA DHE LARGIMI I UJËRAVE TË SHIUT DHE MBROJTJA NGA PËRMBYTJET NË ZONAT E BANUARA (NENI 23/3)

Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara, është funksion i ndarë në 2 nën komponentë kryesorë në fushën ndërtimore, në të cilën përfshihen kryerja e investimeve ndërtimore për largimin e ujërave të shiut për të cilën nuk ka standarde të miratuara ndërtimore apo ndonjë specifikim të veçantë si dhe mbrojtja nga përmbytjet.

Përkufizimi

Me “përmbytje” kuptojmë mbulimin e përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura.

Me “zonat e banuara” kuptojmë hartën e zonave të banimit të përgatitur nga autoriteti vendor i planifikimit në një pjesë të territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara të tokës e ndërtimeve në të.

Gjetje

Mungesë ligjore

Nuk ka legjislacion sektorial që rregullon këtë pjesë të funksionit. Termi “mbledhje dhe largim të ujërave të shiut” nuk përkufizohet në legjislacionin sektorial për ujërat.

Rekomandim [11]: Rekomandohet përkufizimi i termit “mbledhje dhe largim të ujërave të shiut” në mënyrën si më poshtë ose në një mënyrë teknikisht më të përshtatshme.

Me “mbledhje dhe largim të ujërave të shiut” kuptojmë të gjithë proceset e sistemit në të cilat përfshihen infrastruktura për mbledhjen dhe transportin e përbërë nga tubacionet, kolektorët, pusët e kontrollit, ndërtesat dhe strukturat si dhe mekanizmat që shërbejnë për largimin e tyre drejt vendeve të përcaktuar për shkarkimin përfundimtar të tyre, të ndarë dhe duke përjashtuar përzjerjen me infrastrukturën e ujërave të ndotura.

Ky përkufizim mund të përfshihet në ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 2: Organigrama e funksionit për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet (Neni 23/3)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Mbledhja Largimi i Ujërave të Shiut	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Ndërton strukturat për mbledhjen dhe largimin e ujërave	NJQV
Organizim	
Jep leje ndërtimi për strukturat për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut	NJQV
Mbrojtja nga Përmbytja në Zonat Urbane	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Vendos kufizime për përdorimin e zonave të përmbytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit	KKU
Jep mendimin për vendosje kufizimi për përdorimin e zonave të përmbytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit	AMBU/NJQV
Parandalon, përballon dhe rehabiliton gjendjen e shkaktuar	
Harton planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet	AMBU/ ZABU
Mbledh të dhënat për digat/dambat	SKDM
Ndihmon për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave të aparaturave të dëgjimit, të vendosura në trupin e digës	KKDM
Vendos detyra për përmbushjen e sigurisë së digave	
Organizim	
Autorizon paraprakisht lejen për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje	AMBU
Jep leje për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje	NJQV
Miraton projekt idetë dhe projekt zbatimet, riparimet dhe përmirësimet e digave	KKDM

RREGULLIM I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet	KM

Gjetje

Mungesë ligjore

Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar në nenin 70 ngarkon KM, me propozimin e ministrit përgjegjës për emergjencat civile, pas miratimit paraprak nga KKKU, të miratojë aktin nënligjor për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, të hartuara nga AMBU.

Rekomandim [12]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet. Në këtë VKM të përcaktohen udhëzimet për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, standardet si dhe institucionet dhe mjetet për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të funksionit.

Mbledhja, largimi i ujërave të shiut nuk ka standarde të drejtpërdrejta ndërtimi.

Rekomandim [13]: Rekomandohet që MIE në përputhje me fushën e përgjegjësisë së saj për vendosjen e standardeve ndërtimore të miratojë standarde ndërtimore specifike për këtë pjesë të funksionit.

Mbivendosje ligjore

Neni 68, pika 2 e ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar Të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, ngarkon organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore në bashkëpunim me organet e NJQV-ve me përgjegjësinë për parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar nga përmbytjet. Ngarkimi njëkohësisht i dy organeve qeverisëse sjell për pasojë paqartësi në ndarjen e përgjegjësisë dhe rrjedhimisht paqartësi në ndarjen e fondeve financiare të nevojshme ndërmjet tyre. Duke marrë parasysh që mbrojtja nga përmbytjet realizohet kryesisht nëpërmjet marrjes së masave në trupat ujorë, dhe veprimeve të ndërvarura nëpërmjet institucioneve kjo situatë e paqartë mund të sjell problematika. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në ndryshim nga ligji i mëparshëm heq ndarjen në “funsione të veta” dhe “funsione të përbashkëta”. Ky ndryshim vjen në përputhje me Kushtetutën, e cila nuk e njeh konceptin e “funsionit të përbashkët” midis qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore. Kjo praktikë ka sjell shkelje të autonomisë së NJQV.

Rekomandim [14]: Rekomandohet ndryshimi i paragrafit 2 i nenit 68 i ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, të përcaktohen qartë përgjegjësitë e organeve menaxhuese dhe administruese të burimeve ujore dhe përgjegjësitë e NJQV-ve.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Ndërtimi i infrastrukturës së mbledhjes dhe largimit	Shoqëri Ndërtimi	MEI/ Inspektoriati Ndërtimor	Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor
Ndërtimi i digave		ITD/ KTPD/ NJQV	ITD/ Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
Sigurinë e digave			Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit/ Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor
Kontrollin teknik të veprave të mbrojtjes nga përmbytjet	NJQV/ Subjekte private	MBZHR/ NJQV	

5.1.3 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE VENDORE DHE SINJALIZIMI RRUGOR, TË TROTUAREVE DHE SHESHEVE PUBLIKE VENDORE (NENI 23/4)

Kutiza 2

Drejtimet strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore dhe transportin publik

Drejtimet strategjike

- Përfundim i inventarizimit i të gjithë sistemit të rrjetit rrugor urban dhe rural, brenda vitit 2017.
- Miratimi i standardeve të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore.
- Rritja e kapaciteteve menaxhuese për mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale.

Gjendja afatmesme e funksionit për rrugët

- Inventari i rrugëve është kryer, por nuk ka plane për të zhvilluar një kuadër të integruar të mirëmbajtjes së rrugëve, pavarësisht se ka qenë parashikuar në planin e veprimit të strategjisë.
- Transferimi i infrastrukturës rrugore duhet shoqëruar edhe me transferimin e plotë të fondeve për mirëmbajtjen e tyre pranë bashkive

Përkufizimi

Me “ndërtim” në kuptim të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar do të kuptojmë çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë.

Ndërsa në VKM 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, termat janë përkufizuar si më poshtë:

Me “rehabilitim” kuptojmë dy lloje ndërhyrjesh në infrastrukturë:

- Me “rindërtim” kuptojmë punimet që konsistojnë në prishjen dhe rindërtimin me të njëjtin vëllim dhe formë të objektit të mëparshëm.
- Me “punime rikonstruksioni” kuptojmë punimet që konsellojnë, konsolidojnë apo transformojnë objektin ekzistues përmes punimesh sistematike, ku objekti që i nënshtrohet rikonstruksionit mund të pësojë ndryshime, ku përfshihen zëvendësimi, eliminimi, ndryshimi i pjesëve strukturore të tij dhe elementeve të reja.

Me “mirëmbajtje”, kuptojmë dy kategori e mëposhtme:

- Me “mirëmbajtje së zakonshme” kuptojmë ndërhyrjet për riparimin apo zëvendësimin e rifiniturave ekzistuese të ndërtesave, si dhe ato që janë të nevojshme për të mbajtur në eficiencë impiantet teknologjike ekzistuese.
- “mirëmbajtje të jashtëzakonshme” kuptojmë punimet dhe ndryshimet e nevojshme për rinovimin ose zëvendësimin e pjesëve, edhe ato strukturore të ndërtesave, si dhe për realizimin e shërbimeve higjieno-sanitare dhe teknologjike, me kusht që këto punime të mos sjellin shtesë të numrit të njësive dhe/ose ndryshim të përdorimit, vëllimit apo sipërfaqes së njësive.

IME “rrugë vendore”, kuptojmë ato rrugë që sipas përdorimit, funksionimit dhe nevojave të karakterit administrativ, i përkasin NJQV-ve sipas përcaktimeve në nenin 2 pika 2 e Kodit Rrugor.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 3: Organigrama e funksionit ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtja e rrugëve ...(Neni 23/4)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINITRIMI I FUNKSIONIT	
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton dhe zbaton politika të zhvillimit të infrastrukturës, ku bëjnë pjesë infrastruktura dhe transporti	MIE
Drejton, menaxhon vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore	MIE/ Prefekti
Përcakton dhe klasifikon rrugët sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale	Prefekti
Përcakton qendrat e banuara	MIE
Përcakton për çdo rrugë në funksion të trafikut për dy arterie rrugore që kryqëzohen, karakteristikat teknike që duhen përshtatur për realizimin e hyrjeve dhe degëzimeve, si edhe kushtet teknike e administrative, mbi të cilat duhet të bazohet enti pronar i rrugës për lëshimin e autorizimit përkatës	Këshilli i Qarkut/ ARRSH/ NJQV
Harton dhe përditëson Planet Interurbane të Trafikut	NJQV
Harton dhe përditëson Planet Urbane të Trafikut	NJQV
Klasifikon rrjetin e rrugëve	NJQV
Krijon hartat e rrugëve dhe i mbajnë ato të azhurnuara, krijojnë kadastrën e rrugëve dhe të pjesëve që i përkasin asaj	NJQV
Kryen gjatë vitit matje dhe hulumtime të trafikut	NJQV
Organizim	
Autorizon vënien e sinjaleve që tregojnë vendet e shërbimit rrugor, duke përfshirë edhe sinjalet rrugore për në vendet e ndihmës së shpejtë	NJQV
Autorizojnë vendosjen e tabelave ose të mjeteve të tjera reklamuese gjatë rrugës apo në vende të dukshme	NJQV
Lëshon autorizimeve dhe leje për ndërtim dhe mbrojtje të rrugëve dhe zonave publike	NJQV
Lëshon leje për përshkime dhe përdorime të zonës rrugore dhe pjesëve përbërëse të saj, për kanale uji, tubacione uji, linja elektrike dhe telekomunikacioni ajrorë a nëntokësorë, nënkalime a mbikalime, teleferikë të çdo lloji, gazsjellës, depozita lëndësh djegëse të lëngëta ose të tjera impiante a vepra arti që mund të cenojnë gjithsesi pronësinë rrugore	NJQV
Deklasifikon rrugët vendore	Këshilli i Qarkut

Ndërton vepra mbrojtëse që shërbejnë vetëm për të mbrojtur ose për të mbajtur truallin ngjitur me rrugën	NJQV
Administron, mirëmban dhe pastron rrugët, pjesë që i përkasin rrugës, si pajisjet, impiantet dhe mjediset e shërbimeve	NJQV
Vendos dhe mirëmban sinjalizimin rrugor	NJQV
Urdhëron NJQV-të, të zëvendësojnë, zhvendosin, heqin a korrigjojnë çdo sinjal të papërshtatshëm për karakteristikat, mënyrën e zgjedhjes së simbolit, mënyrën e vendosjes dhe për vendin ku është vënë.	MEI
Urdhëron përmbushjen e detyrimeve për sinjalizimin rrugor nga NJQV	MEI

RREGULLIM I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Normat për përmasat, karakteristikat, vendvendosjen e mjeteve reklamuese përgjatë rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës dhe në stacionet e shërbimit dhe furnizimit me karburant	
Rregullat funksionale dhe gjeometrike për ndërtimin, kontrollin dhe kolaudimin e rrugëve dhe impianteve e mjedisëve të shërbimeve që kanë të bëjnë me to, me përjashtim të atyre për përdorim ushtarak	
Rregullat për pakësimin e ndotjes atmosferike dhe zanore	MIE
Organizimi i qarkullimit dhe të sinjalizimit rrugor	
Sigurinë rrugore dhe auditimin e saj	
Përcakton kriteret për hartimin dhe përditësimin e Planeve Urbane dhe Interurbane të Trafikut	

Gjetje

Mungese ligjore

Udhëzimi për përcaktimin e normave për përmasat, karakteristikat, vendvendosjen e mjeteve reklamuese përgjatë rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës dhe në stacionet e shërbimit dhe furnizimit me karburant nuk rezulton i miratuar nga MIE.

Rekomandim [15]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për përcaktimin e normave për përmasat, karakteristikat, vendvendosjen e mjeteve reklamuese përgjatë rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës dhe në stacionet e shërbimit dhe furnizimit me karburant.

Udhëzimi për përcaktimin e kriterëve për hartimin dhe përditësimin e Planeve Urbane dhe Interurbane të Trafikut nuk rezulton i miratuar.

Rekomandim [16]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për përcaktimin e kriterëve për hartimin dhe përditësimin e Planeve Urbane dhe Interurbane të Trafikut.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Standardet teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore	NJQV/ Subjekte private	MIE	Inspektorati Ndërtimit/ Autoritetet përgjegjëse për rrugët
Sigurinë rrugore			
Kontrollin teknik të gjendjes së rrugëve dhe të pjesëve që i përkasin rrugës	Subjektet private	NJQV	
Konstaton shkeljet në ndërtim dhe mbrojtje të rrugëve dhe zonave publike, si dhe të normave që përmbahen në autorizimet dhe lejet		NJQV	
Normat për përmasat, karakteristikat, vendvendosjen e mjeteve reklamuese përgjatë rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës dhe në stacionet e shërbimit dhe furnizimit me karburant	NJQV/ Subjekte private	MEI	

36

5.1.4 NDRIÇIMI I MJEDISEVE PUBLIKE (NENI 23/5)

Përkufizimi

Me “ndriçim” kuptojmë ndërtimin, vendosjen e strukturave të përbëra nga burime drite të ndryshme kryesisht të furnizuara me energji elektrike me qëllim rritjen e shikueshmërisë së mjedisit.

Me “hapësira publike” kuptojmë një zonë që përdoret nga publiku i gjerë dhe që përfshinë rrugët, vendqëndrimet e transportit publik vendor, institucione tregtare, parqe, lulishte nën përgjegjësi të NJQV-ve.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 4: Organigrama e funksionit Ndriçimi i mjediseve publike (Neni 23/5)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Ndriçimi i Mjediseve Publike	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Miraton planin kombëtar të veprimit për Eficiencën e energjisë elektrike	KM
Harton dhe zbaton politikën e përgjithshme shtetërore, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike	MIE
Harton politika kombëtare për eficiencën e energjisë	

Këshillon NJQV për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të eficientë të energjisë	Agjencia për Eficientë e Energjisë
Përgatit, zbaton dhe monitoron politikat dhe programet për përdorimin eficient të energjisë	
Krijon dhe përditëson bazën e nevojshme të të dhënave të energjisë	NJQV
Merr masa për përmirësimin e menaxhimit të energjisë, si dhe formulimit dhe zbatimit të masa teknike për kursimin e energjisë	
Mirëmban pajisjet që konsumojnë çdo formë energjie, përmirëson dhe mbikëqyr mënyrat e përdorimit të energjisë dhe kryen detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri	Menaxheri i Energjisë
Organizim	
Miraton investime në ndriçimin e mjediseve publike	NJQV
Cakton menaxherin e energjisë	

RREGULLIMI I FUNSKIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Standarde teknike për eficientë e energjisë	KM
Standarde urbane në ndërtim	MIE

38

Gjetje

Mungesë ligjore

Udhëzimi për përcaktimin e standardeve teknike ndërtimore për këtë funksion nuk rezulton të jetë miratuar nga MIE.

Rekomandim [17]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit të MIE për përcaktimin e standardeve teknike ndërtimore për këtë funksion.

VKM-ja për miratimin e standardeve dhe normave, që synojnë, para së gjithash, në përmirësimin e eficientë të energjisë të produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmirësimet në ndërtesat nuk rezulton e miratuar.

Rekomandim [18]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e standardeve dhe normave, që synojnë, para së gjithash, në përmirësimin e eficientë të energjisë të produkteve dhe shërbimeve.

Ligji nr. 124/2015 “Për eficientë e energjisë”, në nenin 9 të tij parashikon përfshirjen në rregullat e prokurimit publik parashikime, të cilat detyrojnë autoritetet kontraktore që të përcaktojnë në dokumentet e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, specifkime teknike, që përbushin kërkesat minimale të eficientë të energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nuk rezulton e ndryshuar me këto elementë.

Rekomandim [19]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për tu përshtatur me kërkesat e ligjit nr. 124/2015.

VKM-ja për miratimin e kategorive, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë nuk rezultojnë të miratuara.

Rekomandim [20]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e kategorive, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë.

Në lidhje me ndriçimin e hapësirave publike në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë nuk janë parashikuar objektiva individuale për kursimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj.

Rekomandim [21]: Rekomandohet përfshirja në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë objektivi lidhur me ndriçimin e mjediseve publike, si një sektor që kryesisht përfshihet si konsumator i madh energjie elektrike.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Standarde urbane në ndërtim	Shoqëri ndërtimi/ Nd. Shtetërore	MIE/ Inspektoriati i ndërtimit	Inspektoriati i Ndërtimit
Strategjia Kombëtare e eficiencës energjitike	NJQV	MIE/ Agjencia për Eficiencën e Energjisë	Agjencia për Eficiencën e Energjisë
Standardet, normat dhe rregulloret teknike të eficiencës së energjisë			

5.1.5 TRANSPORTI PUBLIK VENDOR (NENI 23/6)

Sektori i transportit publik rrugor vendor rregullohet nëpërmjet ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar. Format e tjera të njohura të transportit publik vendor si ai hekurudhor rregullohet nga ligji nr. 142/2016 “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe ai detar rregullohet nga ligji nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, nuk përcaktojnë të drejta e detyrime, standarde, rregulla apo specifikime për organet e vetëqeverisjes vendore.

• Kutiza 3 •

Gjetjet nga RAM për funksionin e transportit publik vendor

Gjendja afatmesme për funksionin e transportit publik vendor

Drejtimet strategjike

- Ndryshimet e fundit në ligjin e transportit rrugor kanë rritur autoritetin e qeverisjeve vendore në transportin rrugor, duke përfshirë autoritetin për të miratuar tarifatat e transportit publik dhe për të licencuar operatorët.
- Sipas RAM, qeveritë vendore tregojnë që ndryshimet e fundit e kanë ngushtuar autoritetin bashkiak në menaxhimin e itinerareve, orareve dhe licencave të transportit publik.

Përkufizimi

Shërbimi i transportit publik vendor ndahet në kategoritë e transporteve si transporti qytetës, transporti rrethqytetas dhe shërbimi taksi.

Transporti publik vendor rrugor, nuk përkufizohet në ligjin 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, por nënkuptohet që përfshinë transportin qytetës dhe rrethqytetas.

“Transporti qytetës” është një shërbim i veçantë që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbimin e rregullt me autobusë brenda vijave kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit. Transporti qytetës kryhet me autobus.

“Transporti rrethqytetas” është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

- njësive administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;
- njësive administrative përbërëse të së njëjtës bashki;
- fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësive administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësie administrative tjetër të së njëjtës bashki;
- fshatrave dhe njësive administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën

“Shërbim taksi” është shërbimi publik që siguron një transport të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë të udhëtarëve dhe bagazheve të tyre.

Gjetje

Mungesë Ligjore

Transporti publik vendor rrugor, nuk përkufizohet në ligjin 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, por nënkuptohet që përfshinë transportin qytetës dhe rrethqytetas.

Rekomandim [22]: Rekomandohet të përkufizohet termi “transporti publik vendor rrugor”, duke bërë një ndarje të qartë të funksioneve të veta të NJQV-ve dhe funksioneve të deleguara si shërbime të rregullta, të specializuara, transporte për llogari të vet dhe transporte të rastit.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 5: Organigrama e funksionit Transporti publik vendor (Neni 23/6)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Transporti qytetës	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton politika të zhvillimit të infrastrukturës së transportit.	
Drejton, përmirëson, zgjeron dhe zhvillon shërbimet e informacionit në transport dhe infrastrukturë	MIE
Organizim	
Përcakton rrjetin e linjave, stacionet e qëndrimit dhe oraret	
Përcakton vendet e nisjes e të mbërritjes së autobusëve	Këshilli Bashkiak
Përcakton vendndodhjen dhe ndërtimin e terminalit të autobusëve	

Licencon operatorët	
Lejon përkohsisht ushtrimin e veprimtarisë së transportit jashtë linjave të miratuara më parë	Kryetari i bashkisë
Licencon operatorët e terminaleve të autobusëve	
Transporti Rrethqytetas	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton politika të zhvillimit të infrastrukturës së transportit.	
Drejton, përmirëson, zgjeron dhe zhvillon shërbimet e informacionit në transport dhe infrastrukturë	MIE
Organizim	
Miraton rrjetin e linjave rrethqytetëse dhe oraret	
Përcakton vendet e nisjes e të mbërritjes së autobusëve	Këshilli Bashkiak
Përcakton vendndodhjen dhe ndërtimin e terminalit të autobusëve	
Përcakton rrjetin e linjave, stacionet e qëndrimit dhe oraret fshatrave dhe njësi administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën	Këshilli i Qarkut
Licencon operatorët	
Lejon përkohsisht ushtrimin e veprimtarisë së transportit jashtë linjave të miratuara më parë	Kryetari i bashkisë
Licencon operatorët e terminaleve të autobusëve	
Shërbimi Taksi	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton politika të zhvillimit të infrastrukturës së transportit.	
Drejton, përmirëson, zgjeron dhe zhvillon shërbimet e informacionit në transport dhe infrastrukturë	MIE
Organizim	
Licencon operatorët	Kryetari i bashkisë
Përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit	Këshilli Bashkiak

Gjetje

Mungesë ligjore

Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, në nenin 85 parashikon që KM përcakton masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e tarifave të transportit publik për udhëtarët që përfitojnë lehtësira në bazë të ligjeve të veçanta. Kjo VKM nuk rezulton e miratuar.

Rekomandim [23]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e masave, kriterëve dhe procedurave për kompensimin e tarifave të transportit publik për udhëtarët që përfitojnë lehtësira në bazë të ligjeve të veçanta.

Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar ka pësuar disa ndryshime gjatë viteve. Këto ndryshime kanë sjell përdorime të termave të ndryshëm për të njëjtin qëllim. Në ligj janë lënë terma të përgjithshëm për rregullimin e shërbimeve të transportit rrugor. Ligji shfaq shumë paqartësi, është i pandarë në kapituj dhe shpesh nuk ka referenca të qarta në kalimin nga një nen në tjetrin. Gjithashtu në ligj mungojnë përkufizime si “transporti publik vendor rrugor”.

- Në nenin 14 të tij përcaktohet Këshilli Bashkiak si autoriteti përgjegjës për përcaktimin e linjave, organizimin, financimin dhe vendosjen për shërbimin e transportit qytetas, gjithashtu në nenin 35 të po këtij ligji, Këshilli bashkiak është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të shërbimit taksit. Termat e përdorur, organizim, financim dhe funksionim krijojnë paqartësi pasi janë të pa detajuara.
- Në nenin 21/1 të këtij ligji Këshilli Bashkiak përcaktohet si autoriteti përgjegjës për përcaktimin e vendndodhjes së terminaleve të autobusëve. Nga takimi me specialistë të MIE, ky nen nënkupton se NJQV-të janë gjithashtu përgjegjëse për ndërtimin dhe operimin e terminaleve të autobusëve.
- Neni 23 i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar ngarkon njëkohësisht ministrinë dhe NJQV-në, në raste fatkeqësish natyrore ose në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, për plotësimin e nevojave të transportit, me urdhër, të lejojnë njëkohësisht ushtrimin e veprimtarisë së transportit jashtë linjave të miratuara më parë. Nga ky nen kuptohet se është e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë jashtë linjave të rregullta të jepet leja bashkërisht nga ministri dhe kryetari i bashkisë, ndërkohë që realisht kjo kompetencë bëhet respektivisht sipas fushës së përgjegjësisë.
- Kodi Rrugor shprehet ndryshe për termin qytetas, rrethqytetas apo ndërqytetas në terminologjinë ndërkombëtare, urbane, interurbane.

Rekomandim [24]: Rekomandohet hartimi i një ligji të ri për transportet rrugore i cili të jetë i qartë, i njëtrajtshëm në terminologjinë e shprehur në të gjithë dispozitat e tij, termat kryesorë të përkufizohen, të jetë i ndarë në kapituj sipas tematikës, në përputhje edhe me përkufizimet e ligjeve të tjera në fuqi, dhe veçanërisht të përcaktojë qartë autoritetin rregullator dhe monitorues të NJQV-ve.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendorsjen e Sanksioneve
Standarde të infrastrukturës në transport			
Standardeve për llojet e mjeteve të transportit dhe sigurinë teknike në sferën e shfrytëzimit.		MIE/ NJQV	MIE/ Organet e kontrollit në rrugë/ NJQV
Kushteve të mjeteve të transportit të udhëtarëve	Operatorët e transportit/ Nd. Shtetërore		
Kritereve, rregullat, afatet dhe dokumentacioni për dhënien e licencës, certifikatës dhe lejes		MIE	MIE/ Organet e kontrollit në rrugë/
Tarifat e transportit rrethqytetas dhe ndërqytetas			
Tarifa e transportit qytetas			
Shërbimi Taksi			
Kushtet dhe rregullat e përgjithshme			
Rregullat dhe kushtet për kërkesa të veçanta për mjetin taksi, si dhe për zbatimin e tarifave dhe të çmimeve	Operatorët e licencuar	MIE/ NJQV	MIE/ Organet e kontrollit në rrugë/ NJQV
Nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave		MIE	MIE/ Organet e kontrollit në rrugë/
Numrin maksimal të taksive			

5.1.6 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMI I SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT (NENI 23/7)

Përkufizimi

Me “ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike”, kuptojmë sigurimin e tokës dhe ngritjen e strukturave të nevojshme në rregulloren teknike “për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e republikës së Shqipërisë”.

Me “garantim të shërbimit të varrimit”, kuptojmë garantimin e veprimtarisë që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 6: Organigrama e funksionit Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, ... (Neni 23/7)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike		Institucioni Përgjegjës
Planifikim		
Shqyrton rastet kur është e nevojshme për ndërhyrje, me qëllim përmirësimin e shërbimit në varreza		NJQV
Miraton studimin e zonës për ndërtimin e varrezave		Këshilli Bashkiak
Organizim		
Ndërton, rehabiliton dhe mirëmban varrezat publike		NJQV
Mbyll varrezat		Këshilli Bashkiak
Zvogëlon, zmadhon dhe prish gjerësinë e zonës së rezervuar të varrezave		
Garantimin i shërbimit të varrimit		Institucioni Përgjegjës
Planifikim		
46	Përcakton zonat e qytetit për qëndrimin e makinave funerale dhe zyrat e shërbimit	NJQV
Organizim		
Kryejnë dhe financojnë heqjen, transportin dhe rivarrimin e eshtrave të të dënuarve në institucionet e riedukimit		NJQV
Licencon agjensitë e shërbimit funeral		
Propozon kryetarit të NJQV, masat përkatëse higjieno - sanitare		
Jep leje për zhvarrimet e zakonshme		
Autorizon zhvarrimin mbitokësor të arkivoleve		Kryetari i bashkisë/ ISHP
Autorizon transportimin e kufomave nga një bashki në një tjetër		
Autorizon transportimin e mbetjeve mortore		
Lëshon lejen e varrimit		Zyrat e Ghendjes Civile
Merr në dorëzim dhe ruan për çdo varrim lejen e varrimit		Shërbimi i Varrimit pranë NJQV

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Standardet teknike për projektimin dhe ndërtimin	KM
Administrimi dhe funksionimi i varrezave publike	
Kushtet e automjeteve të varrimit	MIE
Kriteret e licencimit të agjensive të shërbimi të varrimit	
Tarifat e shërbimit	Këshilli Bashkiak

Gjetje

Mungese ligjore

Udhëzimi për përcaktimin e kriterëve të licencimit të agjensive të shërbimit të varrimit nuk rezulton i miratuar.

Rekomandim [25]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit të MIE përcaktimin e kriterëve të licencimit të agjensive të shërbimi të varrimit.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendorsjen e Sanksioneve
Standardet teknike për projektimin dhe ndërtimin			Inspektorati Ndërtimor
Administrimi dhe funksionimi i varrezave publike	Shërbimi i Varrimit	NJQV	Policia Bashkiake
Kushtet e automjeteve të varrimit			Inpektorati Shëndetit Publik
Standarde higjieno-sanitare		ISHP	

5.1.7 PARQET, LULISHTET DHE HAPËSIRAT E GJELBRA PUBLIKE (NENI 23/9), SHËRBIMI I DEKORIT PUBLIK (NENI 23/8)

Përkufizimi

Me “hapësira publike”, siç përcaktohet në ligjin nr. 107/2014, datë 9.7.2015 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, kuptohet një hapësirë e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

Nga përcaktimi që i bëhet hapësirës publike në ligjin sektorial, me hapësirë të gjelbër publike, kuptojmë një hapësirë të jashtme, si lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, për të cilën menaxhimi mund të jetë publik ose privat.

Me “park”, kuptohet një sipërfaqe e madhe me barë dhe drurë zbukurues, me kalime, me stola për t’u ulur etj., që shërben si vend pushimi e çlodhjeje; shesh i pajisur me lodra ose me mjete të ndryshme për argëtim ose për ushtrime e lojëra sportive.

Me “lulishte”, kuptojmë një hapësirë të jashtme me gjelbërim të organizuar në shërbim të komunitetit.

Me “infrastrukturë publike” kuptohet tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e ndërtimeve ekzistuese ose të parashikuara në territor, si dhe e hapësirave publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë, administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e kundër zjarrit si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike ose private.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 7: Organigrama e funksionit parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike (Neni 23/9) Shërbimi i dekorit publik (Neni 23/8)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike	Institucioni përgjegjës
Planifikim	
Miraton planin e përgjithshëm vendor me parashikime për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra	KKT/ Këshilli Bashkiak
Miraton planet e detajuara vendore me parashikime për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra	Kryetari i Bashkisë
Planifikon shërbimin e dekorit publik	
Organizim	
Krijon hapësira publike përmes ndërtimit të infrastrukturave publike	
Mbron, mirëmban dhe përmirëson parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike	NJQV
Organizon shërbimin e dekorit publik	

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Rregullat, kushtet, procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike	
Standardet dhe treguesit e planifikimit për zonat dhe njësitë strukturore të banimit	KM
Standardet minimale për gjelbërimin	
Miraton rregulloreve për shfrytëzimin e hapësirave publike	Këshilli Bashkiak
Rregullon shërbimin e dekorit publik	NJQV

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Menaxhimin e hapësirave publike			
Standardet dhe treguesit e planifikimit për zonat dhe njësitë strukturore të banimit	Subjektet private	Kryetari i Bashkisë	Autoritetet e Inspektimit
Standardet minimale për gjelbërimin			

5.1.8 MBLEDHJA, LARGIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE TË NGURTA SHTËPIAKE (NENI 23/10)

Kutiza 4

Drejtimit strategjike për funksionin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake

Drejtimit strategjike

- Rregullimi i sistemit të tarifave të mbetjeve urbane duke synuar që standardizimi i formulës së përcaktimit të tarifave të bëhet nga një ent i pavarur shtetëror.
- Miratimi i standardeve të reja dhe zbatimi i tyre për administrimin e integruar dhe menaxhimin e mbetjeve urbane me anë të përdorimit të mekanizmave ekonomike për të inkurajuar ndarjen dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve në burim.
- Nxitja e riciklimit të mbetjeve si një përpjekje për të ulur depozitimin e mbetjeve dhe për të mundësuar djegjen e tyre me qëllim prodhimin e energjisë elektrike.
- Finalizimi dhe miratimi i të gjitha planeve rajonale për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve, duke monitoruar edhe zbatimin e tyre.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Do të punohet për të siguruar pronësinë e bashkive për menaxhimin e mbetjeve, duke rregulluar rolet e QQ për zbatim dhe investim lidhur veçanërisht me zonat problematike të depozitimit ilegal të mbetjeve, vend-depozitimet, landfillet dhe inceneratorët.
- Sipas MTR, strategjia e re e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve përgjithësisht është në linjë me parimet e decentralizimit: qeveria qendrore mban funksionet e politikës dhe monitorimit; ndërsa qeverisjet vendore kanë përgjegjësinë e shërbimit dhe investimit. Miratimi i dokumentit strategjik do të shoqërohet me rishikimin e kuadrit ligjor përkatës (ligjit nr. 10463/2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve i ndryshuar me 2013, dhe akteve të tjera nën ligjore).
- Një VKM e re për masat dhe kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve jep orientim për qeverisjet vendore.

50

Përkufizimi

Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” përkufizon termat e grumbullimit dhe të transportimit.

Me “grumbullim” kuptojmë mbledhjen, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.

Me “transportim” kuptojmë tërësinë e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të larguar mbetjet.

Me “trajtim” kuptojmë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

Me “mbetje të ngurtë” kuptojmë një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t'i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

Me “Mbetje shtëpiake” kuptojmë mbetjet e krijuara nga sektori familjar në bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta ose të ngjashme me mbetjet shtëpiake nga bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk përkufizon termat mbledhje dhe largim të mbetjeve të ngurta bashkiake ose përndryshe shtëpiake dhe të ngjashme.

Ky ligj nuk parashtron përgjegjësitë e NJQV-ve për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to.

Rekomandim [26]: Rekomandohet përkufizimi i termave “mbledhje dhe largim i mbetjeve të ngurta urbane” dhe parashtrimi i përgjegjësive të NJQV-ve për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake në ligjin 10 463.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 8: Organigramë e funksionit mbledhje, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake (Neni 23/10)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Mbledhja dhe largimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve	Këshilli Qarkut
Miraton planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve	Këshilli i Ministrave
Harton planin vendor të menaxhimit të mbetjeve	NJQV
Miraton planin vendor të menaxhimit të mbetjeve	Këshilli Qarkut
Organizim	
Jep leje subjekteve që operojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve (përfshirë transportuesit e mbetjeve)	MTM
Menaxhon dhe administron mbetjet që krijohen brenda territorit të NJQV	Kryetari i Bashkisë
Trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Ndërton dhe operon objekte të trajtimit të mbetjeve	NJQV
Organizim	
Menaxhon dhe administron mbetjet që krijohen brenda territorit të NJQV	Kryetari i Bashkisë
Jep leje për personat fizikë a juridikë që synojnë të kryejnë operacione për trajtimin e mbetjeve	AKM (MTM)
Jep leje ndërtimi për impiantet e trajtimit dhe strukturat e depozitimit të mbetjeve	KKT

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Mbledhja dhe largimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake	
Masat dhe afatet për zbatimin e rikuperimit, ripërdorimit dhe riciklimt të mbetjeve	
Kriteret, rregullat dhe afatet për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill	
Kërkesat minimale për ambalazhe, masat prandaluese, afatet si dhe ngritjen e sistemeve për ripërdorimin apo rikuperimin	KM
Specifikimet e rasteve të përgjegjësisë së krijuesit të mbetjeve	
Masat për hartimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	
Masa për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve	
Kriteret e largimit të mbeturinave	
Rregulla, përmbajtjes dhe afatet për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta	
Rregulla dhe standardet për grumbullimin e diferencuar, dhe treguesit për objektivat e reduktimit të mbetjeve shtëpiake nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit	MTM
Cakton tarifat për largimin publik të mbeturinave	NJQV
Trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake	
Rregullat për garancitë që duhet të ofrohen në lidhje me lejet e mjedisit për lëndfilllet	
Rregullat dhe specifikimet për incinerimin e mbetjeve, procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre	KM
Normat teknike minimale për operacionet e trajtimit të mbetjeve	
Standardet e trajtimit të mbetjeve	MTM
Kriteret e studimit e projektzbatimit për ndërtimin e lëndfilleve dhe për mbylljen e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane.	MIE/ MTM
Teknikat më të Mira të Disponueshme për instalimet e menaxhimit të mbetjeve	AKM (MTM)

Gjetje

Mungesë Ligjore

Në zbatim të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, KM miraton aktet e mëposhtme:

- Specifikimet e rasteve të përgjegjësisë së krijuesit të mbetjeve;
- Masat për hartimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;

- Masa për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Rregullat për garancitë që duhet të ofrohen në lidhje me lejet e mjedisit për lendfillet;
- Rregullat dhe specifikimet për incinerimin e mbetjeve, procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre;
- Normat teknike minimale për operacionet e trajtimit të mbetjeve

Rekomandim [27]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për specifikimet e rasteve të përgjegjësisë së zgjeruar të krijuesit të mbetjeve.

Rekomandim [28]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për masat për hartimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Rekomandim [29]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për masat për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Rekomandim [30]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për përcaktimin e rregullave për garancitë që duhet të ofrohen në lidhje me lejet e mjedisit për lendfillet.

Rekomandim [31]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për përcaktimin e rregullave dhe specifikimeve për incinerimin e mbetjeve, procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre.

Rekomandim [32]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për përcaktimin e normave teknike minimale për operacionet e trajtimit të mbetjeve.

Në veçanti, disa VKM janë hartuar dhe janë miratuar në zbatim të ligjit nr. 10 463. Vlen të përmenden disa prej tyre si p.sh.: VKM nr. 608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; VKM 418/2014 "për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM 687/2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave për mbetjet". Këto akte trajtojnë aspekte të veçanta të zbatimit të ligjit për 10 463, ngarkojnë përgjegjësi, vendosin objektiva dhe afatet për përmbushjen e tyre, por karakterizohen nga një veçori e përbashkët lidhur me detyrimin e NJQV-ve për të vendosur një sistem me tre kontejnerë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve; në këtë kontekst, këto VKM nuk janë zbatuar pasi kanë mospërputhje - pamundësi për tu zbatuar dhe mungesë të mbështetjes me financime për çdo akt, përgjegjësi apo objektiv që ato përcaktojnë. Gjithashtu, këto akte për sa i përket objektivave dhe treguesve për realizimin e tyre dhe afatet e vendosura në këto akte në shumë raste janë tejkaluar duke i bërë ato të pa zbatueshme.

Rekomandim [33]: Rekomandohet rishikimi dhe përditësimi i VKM nr. 608/2014, VKM 418/2014, VKM 687/2015, lidhur me afatet kohore dhe rishikimin e nivelit të synuar të treguesve sipas objektivave. Disa prej tyre nuk janë në përputhje me ligjin për MIM, ndaj është e domosdoshme të bëhet rishpërndarja e përgjegjësive dhe veçanërisht llogaritja e faturës dhe burimet e financimit për veprimet që ato përmbajnë.

Mbivendosje Ligjore

VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", dalë në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 10 463, veç shtojcës për llogaritjen e kostove, përmban edhe shtojcën për llogaritjen e tarifave, përkatësisht shtojcat 1 dhe 2 të aktit. Shtojca për llogaritjen e tarifave tejkalon atributet që i jep neni 20 i ligjit nr.10 463, i cili, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij ka objekt rregullimi vetëm për kostot.

Nga ana tjetër, duke përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së tarifës, dhe duke detyruar NJQV-të për zbatimin e saj, nëpërmjet kësaj VKM-je përcaktohen tarifat. Në këtë mënyrë,

përcaktimi i metodologjisë së tarifës cenon autonominë e NJQV-ve, pasi, sipas ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimi publik të mbeturinave” atributi për përcaktimin e tarifave është i NJQV-ve.

Rekomandim [34]: Rekomandohet të bëhen shtesa në Shtojcën 2 të VKM nr. 319, datë 31.5.2018, duke i lejuar NJQV-të të disponojnë lirinë në caktimin e tarifave.

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar një Kryetar i Bashkisë si autoritetin përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të NJQV, në kundërshtim me ligjin 139 i cili një NJQV-ve përgjegjësinë për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Rekomandim [35]: Rekomandohet ndryshimi i nenin 21, pika 12, të ligjit 10463/2011, ku përgjegjësia të ndryshojë nga Kryetari i NJQV-së të NJQV-ja.

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikon të rregullojë shërbimin e MIM në mënyrë të plotë duke përkrahur të gjitha proceset e nevojshme për kryerjen e shërbimit. Njëkohësisht ligji nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimi publik të mbeturinave”, rregullon disa aspekte për MIM nga NJQV-të, përkatësisht mbledhjen dhe largimin dhe transportimin e mbetjeve.

Ligji nr. 8094 ka terminologji të ndryshme nga ligji 10463, i cili nuk përputhet me terminologjinë e Direktivës Kuadër për Mbetjet 2008/98 të KE. Mbi parashikimet e ligjit 10463, ligji 8094, përcakton pronësinë e mbetjeve të NJQV-ve si dhe detyrimin e NJQV-ve për lidhjen e kontratave me operatorë privat për kryerjen e shërbimit. Lidhja e detyrueshme e kontratave me operatorë privat duhet të jetë një kompetencë në diskrecion të NJQV-ve si autoritet që e ushtron funksionin e vet në mënyrë autonome, jo si kompetencë e detyrueshme për to.

Rekomandim [36]: Rekomandohet shfuqizimi i ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, përcaktimi i pronësisë së mbetjeve për NJQV-të, caktimi i tarifës së këtij shërbimi nga NJQV-të si dhe dispozita të tjera të nevojshme të këtij ligji të shtohen në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Masat dhe afatet për zbatimin e rikuperimit, ripërdorimit dhe riciklimt të mbetjeve			
Kriteret, rregullat dhe afatet për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill		MTM/ AKM/ Inspektorati i Mjedisit dhe Pyjeve/ NJQV/ Operatorë Privat	
Kërkesat minimale për ambalazhe, masat prandaluese, afatet si dhe ngritjen e sistemeve për ripërdorimin apo rikuperimin e ambalazheve			
Rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve			Inspektorati i Mjedisit dhe Pyjeve
Rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve			
Kërkesat për operacionet që kryhen në lëndfille			
Rregulla, përmbajtjes dhe afatet për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta	NJQV/ Operator Privat	MIE/ AKUM/ NJQV	
Kriteret e studimit e projektzbatimit për ndërtimin e lëndfilleve dhe për mbylljen e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane			
Zbatimin e largimit të mbeturinave		NJQV	
Sistemi			
Procedurat e kontrollit e të monitorimit në lëndfille		KM	
Procedurat e kontrollit e të monitorimit për incinerimin e mbetjeve			
Porcedurat e programit të monitorimit e sistemit të MIM		AKUM	
Rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve		Këshilli Qarkut/ NJQV	

5.1.9 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE TË SISTEMIT SHKOLLOR PARAUNIVERSITAR, ME PËRJASHTIM TË SHKOLLAVE PROFESIONALE (NENI 23/11)

Kutiza 5

Drejtimet strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Drejtimet strategjike

- Rishikim i ndarjes së përgjegjësive dhe mekanizmave të llogaridhënies; rishikim dhe harmonizim i legjislacionit aktual, qartësim i kompetencave mes NJQV dhe DAR/ZA.
- Përcaktimi i kostove dhe standardeve minimale për mirëmbajtjen, sigurinë dhe performancën shëndetësore.
- Krijimi i mekanizma të reja për të forcuar rolin e drejtuesve vendorë në këshillat e institucioneve arsimore.
- Rritja e fondeve të akorduara nëpërmjet granteve konkurruese për infrastrukturën e arsimit fillor dhe parauniversitar dhe shpërndarja do të bëhet nëpërmjet një sistemi më transparent.
- Hartimi i një formule të re për njësi/nxënës nga MAS.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Ekzistojnë paqartësi në lidhje me emërimet e mësuesve të arsimit parashkollor; paqartësi për varësinë e sekretarëve të shkollave dhe punonjësve sociale; mospërputhje ndërmjet numrit të punonjësve të transferuara në disa raste si dhe paqartësi lidhur me transferimin e ish QKF.
- Ekzistojnë mospërputhje mes ligjit 139/2015 dhe ligjit për arsimin para-universitar, i cili ka dobësuar autoritetin administrues të sistemit parashkollor (kopshte e fëmijëve) nga bashkitë, në lidhje me rekrutimin e personelit.
- Një projektligj i rishikuar aktualisht në Parlament pritet që të adresojë këto mospërputhje.

Përkufizimi

Me ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, do të kuptojmë termat e mëposhtme:

Me “arsimi parauniversitar” përkufizuar nga ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kuptojmë nivelet arsimore që përfshihen me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:

- a. “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor;
- b. “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor;
- c. “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët;
- d. “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë;

Me “rindërtim” kuptojmë punimet që konsistojnë në prishjen dhe rindërtimin me të njëjtin vëllim dhe formë të objektit të mëparshëm.

Me “punime të mirëmbajtjes së zakonshme” kuptojmë ndërhyrjet për riparimin apo zëvendësimin e rifiniturave ekzistuese të ndërtesave, si dhe ato që janë të nevojshme për të mbajtur në eficiencë impiantet teknologjike ekzistuese.

Me “punime të mirëmbajtjes së jashtëzakonshme” kuptojmë punimet dhe ndryshimet e nevojshme për rinovimin ose zëvendësimin e pjesëve, edhe ato strukturore të ndërtesave, si dhe për realizimin e shërbimeve higjieno-sanitare dhe teknologjike, me kusht që këto punime të mos sjellin shtesë të numrit të njësive dhe/ose ndryshim të përdorimit, vëllimit apo sipërfaqes së njësive.

Me “punime rikonstruksioni” kuptojmë punimet që konservojnë, konsolidojnë apo transformojnë objektin ekzistues përmes punimesh sistematike, ku objekti që i nënshtrohet rikonstruksionit mund të pësojë ndryshime, ku përfshihen zëvendësimi, eliminimi, ndryshimi i pjesëve strukturore të tij dhe elementeve të reja.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 9: Organigrama e funksionit Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore ... (Neni 23/11)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Ndërtimi i ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Propozim për ndërtimin e një ndërtese të sistemit arsimor parauniversitar të ri	Kryetari i Bashkisë/ Njësia Arsimore Vendore
Miraton ndërtimin e ndërtesa të reja të sistemit parauniversitar	MASR
Planifikon, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore	NJQV/ Njësia Arsimore Vendore
Organizim	
Miratin ndërtimin e ndërtesa të reja të sistemit parauniversitar	MASR
Rehabilitimi i ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Propozon kryerjen e punimeve që konservojnë, konsolidojnë apo transformojnë objektin ekzistues përmes punimesh sistematike, ku objekti që i nënshtrohet rikonstruksionit mund të pësojë ndryshime, ku përfshihen zëvendësimi, eliminimi, ndryshimi i pjesëve strukturore të tij dhe elementeve të reja.	Kryetari i Bashkisë
Planifikon, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore	NJQV/ Njësia Arsimore Vendore
Organizim	
Miraton kryerjen e punimeve që konservojnë, konsolidojnë apo transformojnë objektin ekzistues përmes punimesh sistematike, ku objekti që i nënshtrohet rikonstruksionit mund të pësojë ndryshime, ku përfshihen zëvendësimi, eliminimi, ndryshimi i pjesëve strukturore të tij dhe elementeve të reja.	NJQV
Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	

Propozon mirëmbajtje të zakonshme për ndërhyrjet për riparimin apo zëvendësimin e rifiniturave ekzistuese të ndërtesave si dhe ndërhyrje të nevojshme për të mbajtur në eficiencë impiantet teknologjike ekzistuese

Kryetari
Bashkisë

Propozim mirëmbajtje të jashtëzakonshme për punimet dhe ndryshimet e nevojshme për rinovimin ose zëvendësimin e pjesëve, edhe ato strukturore të ndërtesave, si dhe për realizimin e shërbimeve higjieno-sanitare dhe teknologjike, me kusht që këto punime të mos sjellin shtesë të numrit të njësive dhe/ose ndryshim të përdorimit, vëllimit apo sipërfaqes së njësive.

Planifikon, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore

NJQV/
Njësia Arsimore
Vendore

Garanton paprekshmërisë e institucioneve arsimore si dhe mjediset e tyre;
Ruan dhe mirëmban institucionet arsimor publik;

Garanton kushte higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godina

Në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, kryen regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

NJQV

Mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, mbështet:

- a. nxënësit e familjeve në nevojë;
- b. nxënësit me arritje të shkëlqyera;
- c. punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin
- d. tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;
- e. pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

60

Organizim

Miraton mirëmbajtjet e zakonshme ose të jashtëzakonshme

Kryetari
Bashkisë

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti

Institucioni
Përgjegjës

Kriteret dhe procedurat për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike

Standardet e projektimit të shkollave

Standardet e projektimit të kopshteve

KM

Gjetje

Mungesë ligjore

Mirëmbajtja e ndërtesave sipas përkufizimeve në kuptim të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar nuk përfshin veprimtaritë e sigurimit të kushteve higjieno-sanitare, të ruajtjes, ndriçimit dhe të ngrohjes së ndërtesave.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe³ mirëmbajtja përkufizohet si më poshtë:

MIRËMBAJ kal. - Tregoj vazhdimisht kujdes për diçka (për një makinë, për një vegël, për një ndërtesë etj.) për ta mbajtur në gjendje të mirë, për t'i zgjatur kohën e përdorimit etj., mbaj mirë e pastër.

Sipas këtij përkufizimi, mirëmbajtja preventive, sigurimi i kushteve higjieno-sanitare dhe ruajtja e ndërtesave mund të jenë veprimtari e mirëmbajtjes, ndërsa veprimtaritë e ndriçimit apo të ngrohjes së ndërtesave nuk mund të përfshihen në mirëmbajtje, por mund të përcaktohen si veprimtari operacionale.

Rekomandim [37]: Rekomandohet të përcaktohet qartë përkufizim i termit “mirëmbajtje” me qëllimin bërjen të mundur dallimin nëse janë pjesë e funksionit sipas ligjit 139/2015, apo nëse përbëjnë pjesë të një funksioni të deleguar, kompetencat e mëposhtme të NJQV::

- Garantimi i paprekshmërisë e institucioneve arsimore si dhe mjediset e tyre;
- Ruajtja e institucioneve arsimore publike;
- Garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godina;
- Mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, mbështet:
 - a. nxënësit e familjeve në nevojë;
 - b. nxënësit me arritje të shkëlqyera;
 - c. punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;
 - d. pajis institucionet arsimore me mjete mësimore.

Mbivendosje ligjore

Sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 662, datë 8.10.2014 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike” NJQV-të me propozim të përbashkët të njësisë arsimore vendore propozojnë ndërtimin e një ndërtese të sistemit arsimor parauniversitar të ri.

Rekomandim [38]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 662 duke mënjanuar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës për propozimin e hapjes së institucioneve të reja arsimore parauniversitare publike.

³ Akademia e Shkencave, Fjalori i Gjuhës Shqipe, 1980.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Standardet e projektimit të shkollave	Shoqëritë e Ndërtimit	Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor	Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor
Standardet e projektimit të kopshteve			

5.1.10 ADMINISTRIMIN DHE RREGULLIMI I SISTEMIT ARSIMOR PARASHKOLLOR NË KOPSHTË DHE ÇËRDHE (NENI 23/12)

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 10: Organigrama e funksionit Administrimin dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe (Neni 23/12)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Administrimi i sistemit shkollor parashkollor në kopshte	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Garanton të drejtën e aksesit në kopshte	NJQV/ MASR
Zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar	
Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve	MASR
Harton dhe zbaton politika të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe akrediton programet trajnuese	
Miraton dokumentacionin kurrikular	
Miraton strukturën e vitit shkollor	
Miraton ngarkesën mësimore, javore e vjetore, të punonjësve arsimorë dhe numrin e nxënësve për klasë për institucionet arsimore publike	Ministri i Arsimit
Kryen regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.	NJQV/ Njësia Arsimore Vendore
Mbështet: a. nxënësit e familjeve në nevojë; b. punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; c. pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.	NJQV
Siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore	Njësia Arsimore Vendore
Organizim	
Hap dhe mbyll institucionet arsimore publike	
Lëshon certifikatave e të çmimeve për nxënësit dhe punonjësit e sistemit arsimor	Ministri i Arsimit
Ndërton dhe rikonstruktin godina të institucioneve arsimore	
Garanton paprekshmërisë e institucioneve arsimore si dhe mjediset e tyre	NJQV
Ruan dhe mirëmban institucionet e arsimot publik	
Garanton kushte higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godina	
Kryen regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.	NJQV/ Njësia Arsimore Vendore
Siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore	

Mbështet: a. nxënësit e familjeve në nevojë; b. punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; c. pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.	NJQV
---	------

Administrimi i sistemit shkollor parashkollor në çerdhe	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Garanton të drejtën e aksesit në çerdhe	
Planifikon funksionin	NJQV
Organizim	
Organizon funksionin	NJQV

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Standardet e projektimit të kopshteve	
Standardet e projektimit të çerdheve	KM
Kriteret dhe procedurat për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike	
Kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e regjistrimit të nxënësve	
Miraton rregulloren tip të institucioneve arsimore	Ministri i Arsimit
Kriteret për dhënien e certifikatave e të çmimeve	
Detyrat dhe funksionet e këshillit të mësuesve	
Harton kriteret dhe procedurat e hapjes dhe mbylljes së çerdheve	
Harton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e regjistrimit të fëmijëve në çerdhe	
Organizon çerdhet publike, për zgjedh programin e çerdheve	NJQV
Miraton rregullore e çerdheve	
Harton detyrat dhe funksionet e edukatoreve të çerdheve	

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Standardet e projektimit të shkollave	Shoqëritë e Ndërtimit	Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor	Inspektorati Ndërtimit
Standardet e projektimit të kopshteve			
Cilësia e Shërbimit	Njësitë arsimore	Inpektorati Shtetëror i Arsimit	Inpektorati Shtetëror i Arsimit

Gjetje

Mbivendosje Ligjore

Sistemi arsimor në kopshte është i rregulluar nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, administrimi dhe rregullimi që ligji 139 i ngarkon NJQV është i kufizuar. NJQV-ja sipas ligjit 69/2012 është përgjegjëse vetëm për disa veprimtari organizative; planifikimi dhe rregullimi i këtij funksioni kryhet plotësisht nga MASR.

Rekomandim [39]: Rekomandohet shfuqizimi i akteve që rregullojnë funksionin e administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

NJQV dhe njësitë arsimore vendore janë të ngarkuar bashkërisht për regjistrimin e nxënësve në shkolla sipas parashikimit në Ligjin nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Rekomandim [40]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 28, pika 3 e ligjit nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mënjanuar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës.

NJQV dhe njësitë arsimore vendore janë të ngarkuar bashkërisht për sigurimin në institucionet arsimore publike të mjeteve mësimore.

Rekomandim [41]: Rekomandohet shfuqizimi i germës ç të pikës 4, të nenit 30 i ligjit nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për heqjen e përgjegjësisë njësisë arsimore vendore për këtë kompetencë ose shfuqizimi i i germës ç të pikës 4, të nenit 28, për heqjen e përgjegjësisë NJQV-ve, për të mënjanuar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës.

5.1.11 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE TË SHËRBIMIT PARËSOR SHËNDETËSOR DHE ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE EDUKUESE E PROMOVUESE NË NIVEL VENDOR, TË CILAT LIDHEN ME MBROJTJEN E SHËNDETIT, SI DHE ADMINISTRIMIN E QENDRAVE E TË SHËRBIMEVE TË TJERA NË FUSHËN E SHËNDETIT PUBLIK (NENI 23/13)

• Kutiza 6 •

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik

Drejtimit strategjike

- Analizim i ndikimit të zbatimit aktual nga NJQV i funksioneve të përbashkëta në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor si rrjedhojë e reformës administrativo-territoriale.
- Rishikim i legjislacionit aktual për të sqaruar rolin dhe përgjegjësinë institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor, të cilat janë pjesë e aseteve në pronësi të pushtetit vendor.
- Përcaktim i kompetencave të NJQV lidhur me programe të ndryshme të shëndetit publik, të tilla si HIV, lufta kundër duhanit, etj.; hartim i standardeve të shërbimit dhe llogaritja e kostos për njësi.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Sipas ligjit organik të qeverisjes vendore, kompetencat bashkiake në kujdesin shëndetësor parësor kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e mjediseve të kujdesit shëndetësor parësor (në të njëjtën mënyrë si në arsimin parauniversitar) dhe me disa funksione të shëndetit publik. Në praktikë, të gjitha këto funksione mbahen plotësisht nga qeverisja qendrore, ndonëse disa qeverisje vendore kryejnë punime mirëmbajtjeje në shkallë të vogël për qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

Funksionet e shërbimeve parësore publike dhe të shëndetit publik të NJQV-ve, në përputhje me legjislacionin sektorial janë ndarë në 3 komponentë kryesorë, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor, zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese për mbrojtjen e shëndetit dhe administrimi i qendrave dhe shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni në aspektin e objekteve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 11: Organigrama e funksionit Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor ... (Neni 23/13)

Përkufizimi

Me “kujdesi shëndetësor” kuptojmë tërësinë e masave dhe veprimtarive të ndërmarra nga institucionet e kujdesit shëndetësor, punonjës shëndetësorë dhe shtetas, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme fizike, mendore dhe sociale të shtetasve.

Me “ndërtesa të shërbimit parësor shëndetësor” kuptojmë ndërtesat e njësisve vendore të kujdesit shëndetësor, qendrat shëndetësore të cilat janë në pronësi të NJQV.

Me “shëndet publik” kuptojmë tërësinë e përpjekjeve të organizuara të shoqërisë për zgjatjen e jetës, parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin e shëndetit të të gjithë popullsisë, të përbëra nga:

- Promovimi i shëndetit;
- Edukimi shëndetësor;
- Parandalimi i sëmundjeve, përfshirë imunizimin e depistimin;
- Siguria ushqimore;
- Shëndeti në punë;
- Shëndeti mjedisor, përfshirë monitorimin e mbetjeve urbane;
- Shëndeti riprodhues, përfshirë shëndetin e nënës, të fëmijës dhe shëndetin seksual;
- Parandalimi dhe kontrolli i përdorimit abuziv të substancave (produktet e duhanit, alkool, lëndë narkotike dhe psikotrope etj.);
- Shëndeti mendor;

- Sistemi i informacionit në shëndetin publik;
 - Mbikëqyrja epidemiologjike në shëndetin publik;
 - Laboratorët e shëndetit publik;
 - Monitorimi i shërbimeve të shëndetit publik në kujdesin shëndetësor parësor;
 - Kërkimi shkencor në shëndetin publik;
 - Trajnimet në shëndetin publik.
- alkool, lëndë narkotike dhe psikotrope etj.);
- Shëndeti mendor;
 - Sistemi i informacionit në shëndetin publik;
 - Mbikëqyrja epidemiologjike në shëndetin publik;
 - Laboratorët e shëndetit publik;
 - Monitorimi i shërbimeve të shëndetit publik në kujdesin shëndetësor parësor;
 - Kërkimi shkencor në shëndetin publik;
 - Trajnimet në shëndetin publik.

Zbatimi

Në vijim trajtohen kompetencat për administrimin dhe rregullimin i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

68

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor	Institucioni përgjegjës
Planifikim	
Drejton politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor	MSHMS
Organizon punën për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nëpërmjet veprimtarisë së qendrave/klinikave shëndetësore	OSHKSH
Analizon dhe zbërthen politikat, strategjitë e zhvillimit, programet, kuadrin rregullator në fushën e shëndetësisë, duke u përqendruar në komponentët që lidhen me ofrimin e shërbimit shëndetësor	
Vlerëson nevojat dhe problematikat e hasura në praktikë/terren gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor	
Identifikon dhe analizon nevojat publike për shërbim shëndetësor, që rezultojnë nga integrimi i nevojave të paraqitura në studime, analiza, kërkime nga ISHP-ja etj.	Drejtoria Qendrore e OSHKSH
Vlerëson gjendjen e shërbimeve shëndetësore dhe cilësinë e tyre, me qëllim analizimin e gjendjes ekzistuese dhe të nivelit ku dëshirohet të arrihet, si dhe çfarë duhet ndryshuar/përmirësuar te shërbimi i ofruar	
Garanton burimet (njerëzore, mallra/materiale, pajisje/teknologji, shërbime), në përputhje me kërkesat e përcjella nga strukturat e varësisë	
Vlerëson nevojën për burime e situatën ekzistuese në terren, planifikon volumin e burimeve dhe programon shpërndarjen e tyre	

Planifikon nevojat për shërbime të kujdesit shëndetësor në nivel rajoni	Drejtoria Rajonale e OSHKSH
Garanton që shërbimet shëndetësore të ofrohen brenda standardeve	
Organizim	
Administron objekte të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në pronësi të tyre	NJQV
Ndërton, rehabiliton, mirëmban qendrat shëndetësore	NJQV
Krijon dhe ruan një mjedisi të shëndetshëm	NJQV
Jep kontribute financiare për institucionet shëndetësore brenda juridiksionit të tyre	NJQV

Gjetje

Mungesë Ligjore

Në zbatim të nenit 9, pika 4 e ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në RSH”, i ndryshuar, me qëllim rregullimin e organizimit dhe funksionimit të kujdesit shëndetësor parësor është miratuar “Rregullorja e Përgjithshme për Kontraktimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor”. Kjo rregullore nuk përcakton procedurat e planifikimit, financimit dhe organizimit të funksionit të NJQV-ve për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor.

Rekomandim [42]: Rekomandohet, përcaktimi në rregulloren e përgjithshme “Për Kontraktimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor” i procedurave për mënyrën e planifikimit, financimit dhe organizimit duke rregulluar veçanërisht kriteret dhe procedurat për nismën për hapje, mbyllje dhe rehabilitim të këtyre ndërtesave.

Në lidhje me standardet ndërtimore të ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor nuk gjendet ndonjë akt që përcakton këto standarde.

Rekomandim [43]: Rekomandohet përcaktimi me akt të veçantë standardet ndërtimore të ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor.

Sipas nenit 5, pika 2, germa b e ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në RSH”, i ndryshuar, NJQV-të janë përgjegjëse për administrimin e objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në pronësi të tyre. Termi administrim në këtë ligj është i pa përkufizuar dhe mund të interpretohet shumë gjerë apo ndryshe nga përkufizimi në ligjin 139/2015.

Rekomandim [44]: Rekomandohet të përkufizohet termi “administrim” i objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor në ligjin nr. 10 107, e të harmonizohet në përputhje me përgjegjësinë për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e tyre, të përcaktuar në nenin 23, pika 13 e ligjit 139/2015.

Sipas nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 10 107, NJQV-ja merr masa për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor, në koordinim me MSHMS. Ky funksion nuk përputhet me fushën e përgjegjësisë të parashikuar në ligjin 139/2015, për rrjedhojë është funksion i deleguar. Njëkohësisht, nuk përcaktohen masat konkrete që duhet të marrë NJQV-të për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor.

Rekomandim [45]: Rekomandohet të përcaktohen masat konkrete për t’u ndërmarrë nga NJQV-të për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, gjithashtu parashikimi i fondit të nevojshëm për financimin e këtyre shërbimeve, si funksion i deleguar.

Zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese për mbrojtjen e shëndetit

Zbatimi

Në vijim trajtohen kompetencat për administrimin dhe rregullimin i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

Zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese për mbrojtjen e shëndetit	Institucioni përgjegjës
Planifikim	
Përcakton, bashkërendon dhe drejton politikat e shëndetit publik	MSHMS
Harton "Paketën e promovimit të shëndetit"	ISHP
Miraton "Paketën e promovimit të shëndetit"	MSHMS
Bashkërendon dhe zbaton veprimtaritë për promovimin e shëndetit	Strukturat rajonale të shëndetit publik
Planifikon aktivitete	NJQV
Organizim	
Zbaton edukimin shëndetësor dhe promovimin e shëndetit	Strukturat rajonale të shëndetit publik
Organizon aktivitete	NJQV

70

Administrimi i qendrave dhe shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni në aspektin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 12: Organigrama ne zbatimin e veprimtarive per zhvillimin e aktiviteve edukuese e promovuese per mbrojtjen e shendetit (Neni 23/13)

Administrimi i qendrave dhe shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik	Institucioni përgjegjës
Planifikim	
Përcakton, bashkërendon dhe drejton politikat e shëndetit publik	MSHMS
Realizon funksionet dhe shërbimet e shëndetit publik	
Mbikëqyr epidemiologjitë e sëmundjeve infektive dhe joinfektive	
Menaxhon regjistrat kombëtarë	ISHP
Kryen kërkimin shkencor në shëndetin publik	
Informon popullatën rreth çështjeve të shëndetit publik	

Bashkërendon dhe zbaton veprimtarinë në fushën e shëndetit publik	
Mbledh dhe përpunon informacionin shëndetësor	
Analizon gjendjen shëndetësore të popullatës dhe të faktorëve të riskut	
Analizon dhe ndërhyr për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të shëndetit publik në kujdesin shëndetësor parësor	Strukturat rajonale të shëndetit publik
Kontrollon dhe parandalon sëmundjet nëpërmjet programeve specifike të shëndetit publik	
Raportojnë periodikisht pranë strukturave të NJQV	
Informon popullatën rreth çështjeve të shëndetit publik	
Organizon punën për ofrimin e shërbimeve bazë të shëndetit publik dhe të shërbimeve të tjera ndihmëse, sipas paketës së shërbimeve të shëndetit publik.	OSHKSH
Koordinon administrimin e burimeve njerëzore në sistemin e shëndetit publik	
Garanton burimet (njerëzore, mallra/materiale, pajisje/teknologji, shërbime), në përputhje me kërkesat e përcjella nga strukturat e varësisë	Drejtoria Qendrore e OSHKSH
Vlerëson nevojën për burime e situatën ekzistuese në terren, planifikon volumin e burimeve dhe programon shpërndarjen e tyre	
Organizim	
Zbaton projekte të veçanta të shëndetit publik	Strukturat rajonale të shëndetit publik/ NJQV/ Pjesëmarrës të tjerë të sistemit të shëndetit publik
Mbështesin veprimtarinë e punonjësve të shëndetësisë, për zbatimin e masave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive.	NJQV
Funksion i deleguar	
Merr masa për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor, në koordinim me MSHMS	NJQV

Gjetje

Mungesë Ligjore

Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar, funksionet e strukturave rajonale të shëndetit publik mund të realizohen edhe përmes projekteve të veçanta, në bashkëpunim me NJQV-të e me pjesëmarrës të tjerë të sistemit të shëndetit publik. Mbi këtë bazë NJQV-të mund të ushtrojnë veprimtarinë për administrimin e shërbimeve të shëndetit publik të tjera, veçmas promovimit të shëndetit dhe edukimit shëndetësor.

Në lidhje me administrimin e qendrave për ofrimin e këtyre shërbimeve, në legjisllacionin në fuqi

nuk rregullohen përgjegjësitë e NJQV-ve dhe institucioneve të tjera të përfshira.

Rekomandim [46]: Rekomandohet rregullimi i administrimit të qendrave për ofrimin e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, baza ligjore në fuqi të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e NJQV-ve në këtë funksion.

Sipas informacionit në faqen zyrtare të MSHMS-së, NJQV-të aktualisht nuk administrojnë asnjë qendër ofruese të shërbimeve të shëndetit publik. Shërbimet e shëndetit publik mbështeten dhe mbikëqyren nga ISHP. Krahas tyre, ofrues të këtyre shërbimeve janë edhe një sërë institucionesh kombëtare si Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijës, Klinika Stomatologjike Universitare, etj. I vetmi rast i një qendre të tillë me pjesëmarrjen e NJQV për këto shërbime është rasti i krijimit si projekt pilot i Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR) të Tiranës me VKM nr. 394, datë 27. 7.2000 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e autoritetit”, i shfuqizuar me VKM nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”.

Rekomandim [47]: Duke qenë se shumë shërbime të NJQV-ve kanë nevojë të mbështeten me instrumente dhe fonde për mbrojtjen e shëndetit publik, të tilla si, sigurimi dhe kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm, monitorimi i kanalizimeve, monitorimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake si dhe shërbimet e NJQV-ve në fushën e mjedisit dhe mbrojtjes së tokës dhe biodiversitetit, rekomandohet zhvillimi i një strategjie për implementimin e krijimit të këtyre qendrave me pjesëmarrje e NJQV.

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Organizimin dhe funksionimin e kujdesit shëndetësor parësor	MSHMS
Normat higjieno- shëndetësore	KM
Paketa e shërbimeve ndihmëse të shëndetit publik	KM
Standardet e projektimi të qendrave shëndetësore	MIE

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosije dhe Sanksione
Standardet e ndërtimit	Shoqëritë e Ndërtimit	MIE/ Autoritetet e Inspektimit	Autoritetet e Inspektimit
Standardet e Veprimtarisë shëndetësore	Qendrat e shërbimit parësor shëndetësor private dhe publike	MSHMS/ ISHP/ Drejtoria Rajonale e OSHKSH NJQV kontroll administrativ	Inspektorati përgjegjës për Shëndetin

5.1.12 PLANIFIKIMINI, ADMINISTRIMI, ZHVILLIMI DHE KONTROLLI I TERRITORIT (NENI 23/14)

Kutiza 7

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e planifikimit, administrimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit

Drejtimit strategjike

- Rishikimi i taksës mbi tokën urbane dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë, si edhe disa instrumente të tjera financiare në ligjin e ri të financave vendor.
- Hartim dhe miratim i planeve territoriale nga çdo bashki, në harmoni me planet rajonale dhe me Planin Kombëtar të Zhvillimit, sipas ligjit të ri të planifikimit të territorit.
- Ndryshim i organizimit të brendshëm të NJQV, në mënyrë që ato të përshtaten me kërkesat e administrimit të një territori edhe më të madh.
- Sigurim i mbështetjes financiare për autoritetet vendore për rishikimin e të gjitha planeve të tyre territoriale dhe bazën e të dhënave të krijuara për territorin e tyre.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Janë hartuar modele organigramash dhe manuale për bashkitë, të cilat do të përmirësohen më tej sipas specifikave të reja.
- Ende mbetet i ulët progresi lidhur me përgatitjen e modelit të përshkrimeve të punës/misionit për secilin prej njësive tipike të administratës së re bashkiake për secilin funksion/proces kryesor, si dhe për secilin pozicion pune tipik.

Përkufizimi

Me “planifikim” kuptojmë kryerjen në kohë të planit të masave që duhen marrë, organizimin e punës, afatet, përcaktimin e detyrave dhe treguesve të nevojshëm për zhvillimin e harmonishëm e përpjesëtimor për veprimtarinë në lidhje me zhvillimin e territorit (fjalori i Gjuhës Shqipe).

Me “administrim” kuptojmë të drejtën për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e funksionit.

Me “zhvillim territori” kuptojmë procesin e ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja ose ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese.

Me “territor” kuptojmë hapësirën gjeografike tokësore, nëntokësore, ujore e ajrore, që përputhet me ndarjet administrative - territoriale të NJQV-ve, sipas legjislacionit në fuqi.

Me “kontroll zhvillimi” kuptojmë procesin, në bazë të të cilit autoriteti përgjegjës i planifikimit vlerëson dhe vendos nëse një kërkesë për zhvillim, kërkesë për ndërtim, kryerja e punimit ose ndërtimit përputhet me dokumentet e planifikimit, zhvillimit dhe të kontrollit të zhvillimit, të miratuara, kodin e ndërtimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 13: Organigrama e funksionit Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit (Neni 23/14)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Planifikimi i territorit	Institucioni Përgjegjës
Ndërmerr nismën për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve vendore të planifikimit	Kryetari i Bashkisë
Miraton nismën për hartimin apo rishikimin e planit të përgjithshëm vendor	Këshilli Bashkiak
Harton rishikon dokumente të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit	Kryetari i Bashkisë
Bashkëpunon me institucionet publike dhe alokon burimet njerëzore të nevojshme për hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel vendor	
Përcakton përputhshmërinë e dokumentit të planifikimit dhe kalimin e tij për miratim në KKT	AKPT
Miraton planin e përgjithshëm vendor	Këshilli Bashkiak/ KKT
Miraton planet e detajuara vendore	Kryetari i Bashkisë
Miraton nismën dhe dokumentet e planifikimit sektorial të qarkut	Këshilli i Qarkut
Mbështet bashkërendimin vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit gjatë proceseve të planifikimit në nivel vendor, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit	AKPT
Koordinon proceset e planifikimit në nivel qarku	Këshilli i Qarkut
Mbështet hartimin e dokumenteve vendore të planifikimit nga autoritetet përkatëse dhe ndihmon që ato të përmbushin standardet e përcaktuara në këtë ligj dhe ligje të tjera, duke udhëzuar për çështje që lidhen me fushën e përgjegjësisë së ministrive	Ministritë sipas linjave
Organizon, administron dhe mirëmban bazën e integruar të të dhënave të planifikimit të territorit – Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit – me të gjitha dokumentet e planifikimit të nivelit qendror dhe vendor, të cilat kanë hyrë në proces miratimi apo janë miratuar nga autoritetet përkatëse, si dhe të dhëna të tjera shtesë, të cilat ndërlidhen me planifikimin e territorit	AKPT
Propozon KM masat e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit	
Harton kuadrin ligjor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit	MIE

Zhvillimi dhe kontrolli i territorit	Institucioni Përgjegjës
Harton kuadrin ligjor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit	MIE
Jep leje zhvillimi, leje ndërtimi, pezullon leje për llojet e zhvillimit komplekse që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit	KKT
Lëshon certifikatën e përdorimit për llojet e zhvillimit komplekse që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit	Institucionet e përfshira/ NJQV
Zhvillon territorin vendor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit të territorit	Kryetari i Bashkisë
Jep leje zhvillimi dhe leje ndërtimi	
Pezullon leje zhvillimi dhe leje ndërtimi	
Lëshon certifikatën e përdorimit për lejet e ndërtimit	NJQV
Siguron një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.	
Vlerëson respektimit të kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh	

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Rregulloren e planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, Përmbytjen, strukturën dhe procedurën e hartimit, zbatimit/detajimin dhe monitorimin e zbatimit të planeve	KM

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ndryshimi i dokumenteve të planifikimit në hierarki më të lartë se plani i përgjithshëm vendor mund të sjellë nevojën për rishikimin e këtyre të fundit, me qëllim harmonizimin e zhvillimit. Nenin 12 i VKM-së nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" përcakton procedurën që duhet të ndiqet nga NJQV-të për të kryer rishikimin. Disa prej procedurave të këtij neni, si konsultimi dhe takimet me publikun, përmblen gjatë hartimit të dokumentit të planifikimit të hierarkisë më të lartë.

Rekomandim [48]: Rekomandohet të kryhen shtesa në VKM-në nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", duke përcaktuar një procedurë më të thjeshtuar për rastet e rishikimi si më sipër të planeve të përgjithshme vendore.

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Zbatimit të dokumenteve të planifikimit	NJQV/ Subjektet private	NJQV/ AKPT	
Zbatimin e planit të përgjithshëm vendor dhe planit sektorial vendor			
Respektimin e kuadrit ligjor për pjesëmarrjen dhe shqyrtimin publik të dokumenteve vendorë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, gjatë procesit të hartimit	Kryetari i Bashkisë	KB/ Inspektoratet Shtetërore	Autoriteti Kombëtar i Inspektimit
Vlerëson respektimin e kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh	Shoqëritë e Ndërtimit/ projektuesit/ Mbikëqyrësit/ Kolaudatorët	Kryetari i Bashkisë/ Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor	Autoritetet e Inspektimit Ndërtimor

5.2 FUSHA E SHËRBIMEVE SOCIALE

5.2.1 KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE, NË NIVEL VENDOR, PËR SHITRESAT NË NEVOJË, PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, FËMIJËT, GRATË, GRATË KRYEFAMILJARE, GRATË E DHUNUARA, VIKTIMA TË TRAFIKUT, NËNA APO PRINDËR ME SHUMË FËMIJË, TË MOSHUARIT ETJ., SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ.. (NENI 24/1), NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E QENDRAVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE VENDORE (NENI 24/3), KRIJIMIN, NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR MIRËQENIEN SOCIALE, TË FONDIT SOCIAL PËR FINANÇIMIN E SHËRBIMEVE, SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ (NENI 24/4)

• Kutiza 8 •

Drejtimet strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e përkujdesit social

Drejtimet strategjike

- Decentralizimi dhe kalimi i funksionit të shërbimit social vendor në kompetencë të bashkive.
- Krijimi i zyrave të integruara të shërbimit social në çdo bashki dhe hartimi i një “shporte me shërbime bazë” të cilat do të financohen nga buxheti shtetit; hartimi i planeve lokale sociale.
- Përmirësimi i kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së shërbimeve sociale në lidhje me jetimore, qendrat ditore, shtëpitë e të moshuarve, etj.
- Hartimi i standardeve minimale, nga ministria përgjegjëse, për ofrimin e shërbimeve.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Kuadri strategjik dhe ligjor për mbrojtën shoqërore dhe shërbimet e kujdesit shoqëror është në linjë me parimet e decentralizimit të përkufizuar në SKNDQV, duke njohur rolin e qeverisjeve vendore në identifikimin dhe mbështetjen për popullsinë në nevojë.
- Ligji për sektorin ka përkufizuar koncepte të standardeve minimale. Por në praktikë nuk është arritur progres i qartë.

Analiza e zbatimit të funksioneve të krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale në nivel vendor të specifikuar si mësipërme dhe në mbështetje të legjislacionit sektorial, është bërë në dy komponentë kryesorë: “administrimi i ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar” dhe “administrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”

Administrimi i ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e administrimit të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 14: Organigrama e funksionit në zbatimin e administrimi të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor	
Administrimi i Ndihmës Ekonomike për Shtresat në Nevojë dhe Personat me Aftësi të Kufizuar	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	

Harton politikat, legjislacionin, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore	MSHMS
Rishikon parametrat e programeve të ndihmës ekonomike, duke përfshirë rishikimin e kriterëve të vlerësimit për ndihmën dhe aftësinë e kufizuar dhe përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit	SHSSH
Organizim	
Zbaton programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror	
Administron shërbime shoqërore për individët në nivel kombëtar	SHSSH
Ngre dhe administron regjistrin elektronik kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror	
Verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror në regjistrin kombëtar elektronik të të dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse për familjet/individët në nevojë, të cilët janë propozuar me vendim të këshillit bashkiak, që të trajtohen me ndihmë ekonomike	Strukturat Rajonale të SHSSH
Vendos miratimin ose refuzimin për caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, si dhe masën e përfitimit të tyre	
Vendos për miratimin e përfituesve të pagesës për aftësinë e kufizuar	Komisionit Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
Merr vendimin për propozimin që familja/ individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit	
Miraton fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuar	
Miraton dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror	Këshilli Bashkiak
Miraton pagesën e personave me aftësi të kufizuar	
Njofton kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike brenda 24 orëve	NJQV
Harton projektvendimin për familjet/ individët në nevojë, nën juridiksionin e bashkisë, për trajtim me ndihmë ekonomike dhe përllogarit fondin për mbulimin e tyre	
Paraqet në këshillin bashkiak projektvendimin për propozimin për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit për këto familje/individë në nevojë	Strukturat pranë NJQV
Harton projektvendimin për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar	

Harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar

Grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar

Strukturat pranë
NJQV

Identifikon familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar

Verifikon gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dy herë në vit dhe, për familjet që shpallen përfituese për herë të parë

Paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki të dhënat për familjet/individët në nevojë, që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar

Ndihmon në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror, si edhe administron dokumentacionin

Harton kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për NJQV

Administratorët
Shoqërorë në
NJQV

Grumbullon dhe harton informacione, statistika dhe mban regjistrin e përfituesve, ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar

82

Hedh në regjistrin elektronik kombëtar të dhënat e deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike

Kontribuon në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin që familja /individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe të listës së personave me aftësi të kufizuar

Raporton pranë bashkisë të dhëna statistikore për numrin dhe fondin për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Kriteret, procedurat, dokumentacionit dhe kriterëve që duhet të plotësojnë familjet dhe individët në nevojë për përfitimin e ndihmës ekonomike	
Kritereve dhe detajet e formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike	
Kriteret, dokumentacionin dhe masën e përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar	
Procedurat e kontrollit të programit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore	KM
Treguesit të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore	
Masat, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe ndihmësit personal, si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre	
Përgjegjësitë e strukturave të NJQV	
Zbatimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike	MSHMS
Zbatimin e e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore	MSHMS

Gjetje

Mospërputhje Ligjore

Strukturat rajonale të SHSSH miratojnë ose refuzojnë që familja/individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit; gjithashtu Komisionit Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë miraton personat përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar, ndërsa VKM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, përcakton kriteret dhe masën e përfitimit.

Nga sa më sipër del në pah se roli i këshillit bashkiak dhe/apo strukturave pranë NJQV është shtesë burokratike për këtë funksion.

Rekomandim [49]: Rekomandohet që në ligjin nr. 9355, të shfuqizohen kompetenca e NJQV-ve e përshkruara më sipër; strukturat rajonale të SHSSH të kryejnë drejtpërdrejtë këto kompetenca. Ky rekomandim është në përputhje me projektligjin “Për mbrojtjen sociale në Republikën e Shqipërisë”.

VKM nr. 563, datë 12.8.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, përcakton ngritjen e strukturave të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, pranë këshillave të qarqeve me përgjegjësitë specifike.

Ligji “Për buxhetin e vitit 2019” në nenin 16 parashikon që personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta, në të njëjtën frymë me parashikimet e ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”. Gjithashtu nga shqyrtimi i strukturave organizative të disa këshillave të qarqeve, në shumë prej tyre nuk ka asnjë personel për kryerjen e

përgjegjësi për shërbimet e ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuar. Në kushtet e reduktimit të kapaciteteve njerëzore këto përgjegjësi të qarkut nuk janë më realisht të zbatueshme.

Rekomandim [50]: Në pamundësi reale të zbatimit të këtyre funksioneve, rekomandohet shfuqizimi i përgjegjësi të këshillave të qarkut për këtë funksion.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI			
Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Procedurat e kontrollit të programit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore	Strukturat pranë NJQV/ Administratorët Shoqërorë në NJQV	SHSSH/ Inspektorati i Ndihmës Ekonomike dhe PAK	Kryetari i Bashkisë
Programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore			
SISTEM			
Zbatimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike			
Zbatimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore		MSHMS	

84

Gjetje

Mospërputhje Ligjore

Në nenin 41 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, konstaton kundërvajtjet administrative për shkeljet e detyrimeve nga ana e strukturave të NJQV dhe i propozon kryetarit të NJQV vendosjen e masës administrative për shkelësit. Kjo formë rregullimi e procesit të monitorimit dhe vlerësimit nga ana e organeve qendrore është jo efektive në zbatim, duke qenë se masa administrative mbetet në nivel propozimi.

Rekomandim [51]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 41 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore të ushtrojë të drejtën për të vendosur masa administrative drejtpërdrejtë, duke mbyllur ciklin e monitorim dhe vlerësimit në nivel qendror.

Administrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror

• Kutiza 9 •

Drejtimet strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e krijimit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve

Drejtimet strategjike

- Përmirësimi i veprimtarisë së Fondit Social dhe krijimi i një Fondi Kombëtar për Shërbime Sociale dhe Fondet Rajonale për Shërbimet Sociale.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Kuadri rregullator është aktualisht duke u hartuar, Megjithatë, burimet e financimit dhe hollësitë operacionale për fondin social mbeten të paqarta.
- Krijimi i një fondi social, për të financuar krijimin dhe operimin e shërbimeve në nivelin vendor, pritet të mbështesë njësitë e qeverisjes vendore në krijimin dhe zgjerimin e games së shërbimeve të kujdesit social.

Funksion i deleguar: ndihma ekonomike

- Funksionet e qeverisjes vendore në mbrojtjen shoqërore – lehtësimin e varfërisë janë centralizuar dhe qeverisjet vendore veprojnë si agjentë të qeverisë qendrore në menaxhimin e skemës së lehtësimit të varfërisë me para në dorë (cash). Ky ndryshim në politikë është pasqyruar si duhet në kuadrin ligjor, por publiku nuk është ndërgjegjësuar plotësisht
- Amendimi i bazës ligjore për sektorin social në vitin 2016, përfshirë disa akte të reja nënligjore të miratuara lidhur me dhënien e ndihmës ekonomike në nivel qendror dhe vendor, kanë mundësuar edhe disa përparësi ligjore për NJQV: rritja e kufirit nga 3% në 6% .

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e administrimi të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 15: Organigrama e funksionit zbatimin e administrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe ndërtimi dhe administrimi i qendrave ...

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

Administrimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Ndërtimi dhe Administrimi i Qendrave për Ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton dokumentet e politikave të reformimit e të modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me synim rritjen e efektivitetit dhe ofrimin e tyre	MSHMS
Harton dhe/ose propozon akte ligjore e nënligjore për plotësimin e kuadrit rregullator të funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;	MSHMS
Harton dhe ndërmerr fushata ndërgjegjësimi që inkurajojnë ndihmën, punën vullnetare dhe format e tjera të mbështetjes në favor të individëve dhe familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror	MSHMS
Harton dokumente bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me qëllim koordinimin e bashkëpunimit në mënyrë efektive	MSHMS

Programon, si zë më vete në buxhet, fondet për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që u delegohet bashkive si transfertë në fondin social	MSHMS
Harton dhe miraton manuale trajnimi e edukimi për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ana e subjekteve ofruese, me qëllim zbatimin me uniformitet të ligjit	MSHMS
Këshillon dhe udhëzon NJQV në lidhje me strukturat që duhet të ngrihen prej tyre për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mënyrat e planifikimit e të ofrimit të shërbimeve	MSHMS
Harton dhe paraqet për miratim nevojat për financim nga Buxheti i Shtetit për aktivitetet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.	MSHMS
Harton planin social vendor	NJQV
Harton planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të NJQV	Këshilli i Qarkut
Vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pranimin në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror	Këshilli Bashkiak
Vendos ofrimin e shërbimeve të specializuara në bashkërendim rajonal të rasteve për shërbimet e kujdesit shoqëror të vendosura në nivel rajonal	Këshilli i Qarkut
Identifikon nevojat	NJQV
Vlerëson nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit	NJQV
Programon buxhetet vendore	NJQV
Planifikon shportën bazë të shërbimeve shoqërore	NJQV
Bashkërendon me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror	NJQV
Organizim	
Krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për NJQV, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale	MSHMS/ NJQV
Planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet e kujdesit shoqëror	NJQV
Kontraktin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit	NJQV
Pranon kërkesa dhe dokumentacioni për të përdorur shërbime të kujdesit shoqëror	Punonjësi social i NJQV
Verifikon gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve	Punonjësi social i NJQV
Ndihmon në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar	Punonjësi social i NJQV
Merr pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit	Punonjësi social i NJQV

Përgatit dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak	Punonjësi social i NJQV
Grumbullon dhe të harton informacione, statistika dhe mban regjistrin e përfituesve, ndjek shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror	Punonjësi social i NJQV
Grumbullon informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë	Punonjësi social i NJQV
Administron Regjistrin Elektronik Kombëtar aksesohet nga të gjitha NJQV	SHSSH
Akseson dhe hedh të dhëna në Regjistrin Elektronik Kombëtar	NJQV
Harton dokumentacionin tip për përfituesit e shërbimeve shoqërore	SHSSH
Kryen vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror	SHSSH
Mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raporton periodikisht në MSHMS	SHSSH
Harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike	SHSSH
Trajnon personelin e NJQV që mbulon aspektet e shërbimeve shoqërore	SHSSH
Bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare	SHSSH
Përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror	SHSSH
Dërgon ministrisë statistikave sociale të lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pagesat sociale	SHSSH
Bashkëpunon dhe u jep informacion organeve të tjera shtetërore për rastet që janë në kompetencë të tyre, në lidhje me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	Inspektorati i SHSSH
Raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale mbi rezultatet e inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	Inspektorati i SHSSH

88

RREGULLIMI I FUNKSIONIT	
Objekti	Institucioni Përgjegjës
Standardet minimale të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	MSHMS
Kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	MSHMS

MONITORIM DHE VLERËSIM			
Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve

Shërbimet e Kujdesit Shoqëror			
Standardet e shërbimeve	Strukturat pranë NJQV/ Punonjësi social i NJQV	Inspektorati i SHSSH	Inspektorati i SHSSH
Mjediset dhe dokumentacioni i subjekteve			

Gjetje

Mospërputhje Ligjore

Në nenin 47, pika 4 e ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet që KM miraton procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social, në zbatim të kësaj dispozite është miratuar VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”. Në këtë VKM përcaktohen burimet financiare për krijimin e fondit, ndërsa nuk përcaktohen mënyra e funksionimit të tij, konkretisht nuk përcaktohet (i) mënyra e shpërndarjes së fondit (kriteret) tek NJQV-të bazuar në planet përkatëse sociale të buxhetuara, (ii) autoriteti/et përgjegjës për miratimin e shpërndarjes së tij, duke mospërmbushur objektin e saj.

Në pikën 5 të këtij neni trajtohen mënyrat e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet organizatave jofitimprurëse dhe ofruesve privatë, në kushtet kur NJQV-të nuk mund të ofrojnë këto shërbime nëpërmjet fondit social, duke tejkaluar objektin e saj në bazë dhe për zbatim të ligjit. Gjithashtu, në këtë VKM nuk përcaktohet (iii) mënyra e bashkëpunimit midis autoriteteve qendrore dhe vendore për administrimin e fondit social, në përputhje me nenin 47, pika 1.

Rekomandim [52]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, duke përcaktuar (i) mënyrën e shpërndarjes së fondit (kriteret) tek NJQV-të bazuar në planet përkatëse sociale të buxhetuara, (ii) autoritetin/et përgjegjëse për miratimin e shpërndarjes së tij, si dhe (iii) mënyrën e bashkëpunimit midis autoriteteve qendrore dhe vendore për administrimin e fondit social.

5.2.2 NDËRTIMI DHE ADMINISTRIMI I BANESAVE PËR STREHIMIN SOCIAL (NENI 24/2)

Kutiza 10

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e ndërtimit dhe administrimit të banesave për strehimin social

Drejtimit strategjike

- Reformimi i strehimit social duke e harmonizuar me strategjinë e re të strehimit.
- Nxitja e NJQV-ve për të krijuar bashkëpunime me sektorin privat dhe/ose jofitimprurës.
- Hartimi i planeve 10-vjeçare të strehimit social nga çdo bashki dhe planifikimi i fondeve specifike për këtë funksion.
- Rritja e kapaciteteve të bashkive për administrimin e kërkesave për strehim social dhe menaxhimin e stokut të banesave sociale prioritet në periudhën afatmesme.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Progres është arritur në drejtim të hartimit të kuadrit strategjik dhe ligjor për strehimin social.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social paraqiten në organigramën e mëposhtme:

90




Figura 16: Organigramë e funksionit Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social (Neni 24/2)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton strategjinë kombëtare 10-vjeçare të strehimit	MSHMS
Miraton strategjinë kombëtare 10-vjeçare të strehimit	KM
Përditëson planin e veprimit të strategjisë kombëtare 10-vjeçare të strehimit, në bazë të programeve 5-vjeçare të NJQV për strehimin	MSHMS
Planifikon fondet e buxhetit të shtetit për mbështetjen e realizimit të programeve vjetore të strehimit, bazuar edhe në kërkesat e njësive të vetëqeverisjes vendore;	MSHMS
Harton dhe miraton programe 5-vjeçare strehimi	NJQV
Hartojnë planin e veprimit dhe projektbuxhetin përkatës për zbatimin e programeve afatgjata të strehimit	NJQV
Organizim	
Zbaton politikat e programit të strehimit	NJQV
Zbaton programet e strehimit në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe NJQV nuk përmbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme	MSHMS
Informohet për administrimin e kërkesave për strehim nga NJQV	MSHMS
Krijon bazën e të dhënave në nivel kombëtar	MSHMS
Përcakton, çdo vit, shpërndarjen e fondeve që financohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera financimi	MSHMS
Drejton dhe ndjek mbështetjen e NJQV për asistencën teknike, si dhe për studime e kërkime shkencore në fushën e projektimit dhe të ndërtimit për programe sociale strehimi	MSHMS
Identifikon nevojat për strehim dhe miraton listat e përfituesve	NJQV
Evidenton sheshet e ndërtimit dhe përgatit listën e tyre, në zbatim të programeve të strehimit	NJQV
Evidenton banesat në rrezik shembjeje dhe përgatit listën e tyre	NJQV
Parashikon sipërfaqen e truallit për ndërtimin e një numri të mjaftueshëm banesash sociale, bazuar në nevojat për strehim.	NJQV
Rregullon përdorimin e tokës në juridiksionin e saj, me qëllim zhvillimin e zonës	NJQV/ MSHMS
Paraqet pranë MSHMS kërkesën për financime, investime dhe subvencione	NJQV
Krijon bazën e të dhënave, në nivel vendor, për aplikimet e bëra për programet sociale të strehimit, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për strehimin	NJQV

Harton, miraton dhe publikon sistemin e pikëzimit	NJQV
Administron kërkesat dhe identifikon ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese	NJQV
Krijon dhe administron, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim	NJQV
Përcakton kostot maksimale të lejueshme për ndërtimin e banesave	NJQV
Siguron ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira	NJQV
Organizon fushata të informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve për mundësitë që ofrohen nga programet sociale të strehimit	NJQV
Merr masa për publicitetin dhe transparencën e organizimit të procedurave që lidhen me zbatimin e programeve të banesave sociale	NJQV
Njofton, çdo vit, ministrin përgjegjës për strehimin për ecurinë e programeve të strehimit	NJQV
Miraton masën e qirasë sipas metodikës për llogaritjen	Këshilli bashkiak
Kryen subvencionimin e qirasë	NJQV
Administron dhe mirëmban banesat e specializuara	NJQV
Ndërton, instalon dhe ngre strehë të përkohshme	NJQV

92

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Normat e strehimit	KM
Dokumentacioni për të përfituar strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat	KM
Rregullat për administrimin e kërkesave të NJQV për fonde nga buxheti i shtetit mbi subvencionimin e qirasë ose uzufruktin, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe MSHMS	KM
Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së subvencionit	KM
Kushtet, normat dhe standardet, që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira	KM
Normat dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së trullit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët	KM
Procedurat e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët	KM

Kriteret për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre	KM
Procedura e përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas marrëveshjes për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat.	KM
Institucionet publike që administrojnë strehët, kriteret, procedurat dhe kapacitetet e mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike	KM
Procedurat e zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional	KM
Përcakton kushtet e strehimit për personat me aftësi të kufizuar	KM
Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale	KM
Metodikën për llogaritjen e masës së qirasë	KM
Procedurat, kriteret dhe përparësive për grantin e menjëhershëm	KM
Kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara	KM
Procedurat për kalimin nën përgjegjësi të MSHMS në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe njëzia e vetëqeverisjes vendore nuk përmbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme	KM
Mënyrën e administrimit dhe e mirëmbajtjes të banesave të specializuara.	MSHMS/MFE
Përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave sociale	KM
Kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme	MFE
Mënyrën e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit	MFE
Rregulloren për shfrytëzimin e banesave sociale me qira nga qiramarrësit, ku përcaktohen, me hollësi, të drejtat dhe detyrat e qiramarrësit dhe të entit menaxhues	Këshilli bashkiak
Mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së fondit publik të banesave sociale me qira.	Këshilli bashkiak
Rregulloren për mënyrën e funksionimit të entit menaxhues, si dhe për kontrollin e mbikëqyrjen e këtij të fundit	Këshilli bashkiak
Miraton rregulloren për shfrytëzimin e banesave sociale me qira nga qiramarrësit, ku përcaktohen me hollësi të drejtat dhe detyrat e qiramarrësit dhe të entit menaxhues	Këshilli bashkiak

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Realizimin e investimeve në programet sociale të strehimit me financime ose bashkëfinancime nga buxheti i shtetit	NJQV	MSHMS	Nuk aplikohen
Shfrytëzimin e banesave sociale me qira	Enti Menaxhues	NJQV	Nuk janë përcaktuar

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”, nuk është shoqëruar ende nga aktet ligjore në zbatim të tij, gjithashtu aktet e ligjit të mëparshëm nuk janë lënë në fuqi si dispozitat kalimtare, duke e lënë këtë funksion aktualisht të pa zbatueshëm në disa komponentë.

Në zbatim të ligjit këtij ligji, KM miraton aktet e mëposhtme:

Rekomandim [53]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e normave të strehimit.

Rekomandim [54]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat.

Rekomandim [55]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e rregullave për administrimin e kërkesave të NJQV për fonde nga buxheti i shtetit mbi subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe MSHMS.

Rekomandim [56]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kritereve të dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së subvencionit.

Rekomandim [57]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kushteve, normave dhe standardet, që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira.

Rekomandim [58]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e metodikës për llogaritjen e masës së qirasë.

Rekomandim [59]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e normave dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët.

Rekomandim [60]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të shkëmbimit të banesës me kosto të ulët.

Rekomandim [61]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kritereve për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre.

Rekomandim [62]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas marrëveshjes për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat.

Rekomandim [63]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kritereve, procedurat dhe kapacitetet e mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike nga institucionet publike që administrojnë strehët.

Rekomandim [64]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional.

Rekomandim [65]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kushteve të strehimit për personat me aftësi të kufizuar.

Rekomandim [66]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e rasteve dhe mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe NJQV-ve për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale.

Rekomandim [67]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësitë për grantin e menjëhershëm.

Rekomandim [68]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kushteve dhe normave të projektimit të banesave të specializuara.

Rekomandim [69]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave për kalimin nën përgjegjësi të MSHMS në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk përmbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme.

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, MSHMS, MFE dhe KM miraton aktet e mëposhtme:

- Mënyrën e administrimit dhe e mirëmbajtjes të banesave të specializuara (MSHMS dhe MFE);
- Përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave sociale (KM);
- Kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme(MFE);
- Mënyrën e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit (MFE).

Rekomandim [70]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për mënyrën e administrimit dhe e mirëmbajtjes të banesave të specializuara.

Rekomandim [71]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për përcaktimin e koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave sociale.

Rekomandim [72]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme.

Rekomandim [73]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për mënyrën e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit.

5.3 FUSHA E KULTURËS, SPORTIT DHE SHËRBIMEVE ARGËTUESE

5.3.1 ZHVILLIMI, MBROJTJA DHE PROMOVIMI I VLERAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE ME INTERES VENDOR, SI DHE ADMINISTRIMI I OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE (NENI 25/1) ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE KULTURORE DHE PROMOVIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR E LOKAL, SI DHE ADMINISTRIMI I OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE (NENI 25/2) ZHVILLIMI, MBROJTJA DHE PROMOVIMI I BIBLIOTEKAVE E AMBIENTEVE PËR LEXIM, ME QËLLIM EDUKIMIN E PËRGJITHSHËM TË QYTETARËVE (NENI 25/3)

• Kutiza 11 •

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e zhvillimit, mbrojtjes dhe promovimit të vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve

Drejtimit strategjike

- Qartësim i mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- Mbështetje e NJQV për ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore.
- Rritja e fondeve të caktuara për NJQV për nxitjen dhe krijimin e kushteve që mundësojnë turizmin dhe trashëgiminë kulturore, veprimtari të përgjithshme kulturore që krijohen dhe realizohen në nivel vendor.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Në fushën e Kulturës është rishikuar kuadri ligjor për qartësimin i funksioneve; por ende nuk ka progres lidhur me ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor;
- Është kryer transferimi i disa qendrave për fëmijë, kompetencë e Ministrisë së Kulturës në disa Bashki.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore në këtë funksion paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 17: Organigrama e funksionit Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor ... (Neni 25)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton politikat shtetërore në fushën e trashëgimisë kulturore	MK
Harton strategjinë kombëtare të kulturës	KM
Harton plane menaxhimi në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike	IKTK/NJQV
Miraton strategjinë dhe programe të zhvillimit në fushën e trashëgimisë kulturore jo materiale	KKTKJ

Miraton programin e zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore	KKMPK
Miraton dhe vlerëson në parim planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore	KKTKM
Miraton planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore	MK
Harton plane zhvillimi, projekte, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve arkeologjike	NJAPKA
Përcakton politikat e kritereve që lidhen me veprimtarinë e planifikimit të territorit, si dhe për menaxhimin e ndërhyrjeve që janë pasojë e tyre, me qëllim garantimin e ruajtjes, rikuperimit dhe vlerësimit të tipareve e të karakteristikave të peizazhit kulturor	NJQV
Merr masave për përshtatjen e dokumenteve ekzistuese të planifikimit	
Harton planet e menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore	
Përcaktojnë programet e lidhura me studimet, hulumtimet dhe iniciativat shkencore në fushën e metodologjisë, inventarizimit e katalogimit	MK/ NJQV
Organizim	
Ruan, mbron, vlerëson dhe administron pasuritë të trashëgimisë kulturore nën administrimin e tyre	
Krijon kushte për garantimin e aksesit të barabartë të publikut te vlerat kulturore	NJQV
Monitoron pasuritë e peizazhit kulturor	
Jep në përdorim, për qëllim rijetëzimi, për funksione administrative e social-kulturore, pasuritë e paluajtshme me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore	
Ruan, mbron, si dhe ndërhyr si zëvendësues, në raste mosveprimi të vazhdueshëm ose në rastet e mospërfundimit brenda afateve ligjore të ndërhyrjeve të ndryshme në pasuritë kulturore nga NJQV	MK
Miraton përshtatshmërinë e nismave të sponsorizimit me nevojat e mbrojtje	
Propozon krijimin, organizimin dhe mbylljen e muzeve vendor	Kryetari i Bashkisë
Krijon, organizon mbyll muzetë vendor	Këshilli Bashkiak
Miraton krijimin, organizimin dhe mbylljen e muzeve vendor	KKM
Miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse	KKTKM
Miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme	KKTKM/ NJQV
Miraton statutet dhe strukturën organizative të muzeve vendor	Këshilli Bashkiak
Lëshon licenca për riprodhimin e vlerave kulturore	MK
Miraton tarifatat e përdorimit të pasurive kulturore, mënyrën e përdorimit dhe të destinacionit të tyre	KKMPK

Krijon, ruan dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar	IKRTK
Zbaton masat mbrojtëse mbi pasuritë kulturore të paluajtshme në të gjithë territorin kombëtar	
Zbaton masat ruajtëse të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, fonde muzeore, fonde të arkivave, fonde të bibliotekave dhe çfarëdolloj fondi tjetër	
Zbaton masa të ruajtjes, mbrojtjes dhe cilësisë së punimeve të restaurimit të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme	
Zbaton parashikimet e kontratave të nënshkruara nga autoritete të ndryshme shtetërore, në kuptim të këtij ligji, të marrëveshjeve të administrimit, rijetëzimit, përdorimit dhe të çdo lloj forme tjetër marrëveshjeje të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me institucione publike e private	IKMTK
Zbaton masat mbrojtëse të vlerave kulturore bibliografike e letrare, që mbahen në biblioteka dhe arkiva, dorëshkrime, artikuj të arkivit dhe libra të vjetër të shtypur	
Zbaton procedurat e qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme	
Gjurmon, hulumton, studion, projekton, konservon, restauron, mbikëqyr, kolaudon, promovon, publikon trashëgiminë kulturore materiale	
Ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike	IKTK
Harton, përditëson dhe publikon platformën digjitale për veprimtarinë arkeologjike	
Gjurmon dhe përgatit vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes	
Kryejnë verifikime dhe marrin masa, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në raste të situatave emergjente, kur rrezikohet gjendja e pasurive kulturore	DRTK
Harton dhe kryen punime konservimi dhe restaurimi në projekte në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendojnë punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendor	
Administron, studion, kërkon, evidenton, ruan, mbron, popullarizon dhe promovon pasuritë kulturore jomateriale dhe të diversitetit kulturor në nivel kombëtar	
Ruan, mbron, promovon dhe menaxhon trashëgiminë kulturore jomateriale	
Verifikon dhe studiojë vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale	QKVT
Krijon dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit, Regjistrin e Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale, Listën e Artizanëve, të cilët trashëgojnë dijetërbërje të ndryshme, Regjistrin e Kryeveprave të Trashëgimisë Jomateriale dhe Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Rrezik	
Harton plane zhvillimi, projekte, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve arkeologjike	
Administrojnë, koordinon plane zhvillimi, projekte, të detajuara në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e parqeve arkeologjike	NJAPKA
Kryen punime mirëmbajtjeje dhe mund të kryejnë punime me karakter restaurues e konservues, në funksion të masave ruajtëse dhe mbrojtëse për pasuritë kulturore që kanë në administrim	

Informon NJQV për zhvillime të karaktereve të ndryshme	NJAPKA
Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Miraton masa juridike, teknike, administrative dhe financiare përkatëse, me synim mbështetjen e propozimeve të NJQV për të promovuar festivale, konkurse, programe, projekte dhe veprimtari me karakter kombëtar e vendor në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale	MK
Miraton planin vjetor të aktiviteteve kombëtare	QKVT
Organizon festivale folklorike tipologjike kombëtare	QKVT/ NJQV
Propozimi dhe dhëna e titujve vendorë të nderit	
Organizimi i ceremonisë së dhënies së dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit	NJQV
Krijimi i institucioneve publike vendore të artit e të kulturës	
Miratimi i statut të institucionit publik vendor të artit e të kulturës	Këshilli Bashkiak
Miratimi i përbërjes së bordit artistik të institucionit publik vendor	
Emërimi i titullarit të institucionit artistik e kulturor publik vendor	
Planifikon aktivitete	NJQV
Organizim	
Organizon aktivitete	NJQV
Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave e i ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Haron politikat shtetërore në fushën e trashëgimisë kulturore	MK
Harton strategjisë kombëtare të kulturës	KM
Përcaktojnë politikën financiare të bibliotekave të sistemit të tyre përkatës	NJQV
Planifikimi dhe përcaktimi në buxhetet vjetore respektive një zë të veçantë për blerjen e librave për bibliotekat publike	KB
Organizim	
Siguron shërbim bibliotekar për popullsinë në ndarjet territoriale që janë në juridiksionin e tyre	NJQV
Siguron mjediset e bibliotekave sipas normativave të shërbimit të lexuesve dhe sasisë së koleksioneve, si dhe mjetet e pajisjet për zhvillim normal të veprimtarisë bibliotekare	NJQV
Krijon katalogë dhe siguron informacion të materialeve bibliotekare me karakter historik, kulturor, shkencor etj., për territorin ku ato zhvillojnë veprimtarinë	NJQV

Organizon shërbime të veçanta për anëtarë të bashkësisë që, për arsye të ndryshme, nuk kanë mundësi të përdorin shërbimet e zakonshme	NJQV
Emëron drejtuesit e bibliotekës publike	NJQV
Përcakton tarifat e shërbimit bibliotekar	KM

RREGULLIM I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	
Mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale	KM
Projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre	KM
Mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore	KM
Procedurat e përzgjedhjes për investimet me fonde publike	KM
Përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin	KM
Procedurat dhe kriteret e konkurrimit për tjetërsimin e pasurive kulturore jopublike në pronësi të shtetit	KM
Kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore	KM
Procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura	KM
Krijimin dhe funksionimin e sistemit të bazës së të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë	KM
Procedurat dhe kriteret e konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënie në përdorim të pasurive kulturore	KM
Përcaktimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme të kontratës së rijetëzimit	
Termet dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme	MK
Mënyrat e inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit të pasurive kulturore	MK
Funksionimin e “Sistemit digjital për bazën e të dhënave të pasurive kulturore”	MK
Procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshme	MK
Procedurën e kontrollit teknik të pasurive kulturore të luajtshme	MK
Mënyrën dhe formën e mbajtjes së informacionit nga subjektet publike ose private për pasuritë kulturore që kanë në pronësi ose administrim	MK

Mënyrat e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse	MK
Kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrat për dhënien e miratimit për ekspozimin e pasurive kulturore dhe masat e nevojshme për ruajtjen dhe garantimin e integritetit të tyre, si dhe për procedurat, mënyrat dhe kushtet e lëshimit të deklaratës së marrjes përsipër të rrezikut	MK
Kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve	MK
Administrimin e fondit të ruajtjes së vlerave kulturore jomateriale, masën dhe kriteret e shpërblimit artistik për veprimtari dhe aktivitete të fushës së vlerave jomateriale	MK
Masat për njohjen, respektimin, përhapjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale	MK
Rregullave për dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë të pasurive kulturore	MK
Rregullat e hollësishme për riprodhimin dhe përdorimin e tërthortë të pasurive kulturore	MK
Parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin	MK
Rregullat në lidhje me pasurimin e koleksioneve muzeore me prejardhje nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj	MK
Procedurën dhe metodën e rivlerësimit të objekteve muzeore	MK
Përcaktimin e formatit dhe metodën e mbajtjes së dokumentacionit muzeor, si dhe tarifat e shërbimeve për publikun	MK
Përcaktimin e akteve të nevojshme, kushteve, afatit, garancisë dhe tarifave për ofrimin e shërbimit të mbajtjes në ruajtje/magazininim të përkohshëm të objekteve muzeore	MK
Metodën e mbajtjes së regjistrit të kopjeve të objekteve muzeore, si dhe formën e vërtetimit për një kopje të autorizuar të një objekti muzeor	MK
Përcaktimin e kushteve dhe tarifat për riprodhimin e objekteve muzeore	MK
Rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore	MK
Nxjerr aktet që rregullojnë shfrytëzimin e pasurive nën administrim	NJQV
Standarde e kritere për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale	IKTK
Formati dhe çmimi i biletës për muzetë vendore	KB
Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	
Rregullat e administrimit të fondit për të mbështetur promovimin e festivale, konkurse, programe, projekte dhe veprimtari me karakter vendor në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale të propozuar na NJQV	MK
Masat dhe rregullat për dhënien e shpërblimit që shoqërojnë titujt e nderit	KM
Kriteret e emërimit të titullarit të institucionit artistik e kulturor publik vendor	KB

Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave e i ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve

Normat për krijimin dhe shpërndarjen e bibliotekave publike vendore, si dhe numrin e punonjësve të tyre

MK

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Pasuritë e paluajtshme kulturore			
Pasuritë e luajtshme kulturore			
Veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit	NJQV/ Subjektet private	MK/ organet në varësi/ NJQV	IKMTK IKRTK/ IKTK/
Veprimtarinë e muzeve vendorë			
Pasuritë e peizazhit			
Sistem			
Monitorimi i planeve të menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore		KM	
Rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore		MK	

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, është ligji bazë sektorial që rregullon funksionet e NJQV-ve në fushën e kulturës duke përcaktuar kompetencat. Ky ligj nuk është shoqëruar ende me aktet nënligjore në zbatim të tij. Në pjesën e raportit të rregulimeve të funksionit më sipër asnjë akt nënligjor nën përgjegjësinë e KM dhe MK nuk rezulton i miratuar duke sjell problematika në zbatimin e detyrimeve për NJQV-të. Gjithashtu, detyrimet e NJQV-ve për monitorimin dhe vlerësimin e funksionit në kuadër të këtij ligji kanë mungesa pasi sistemet e monitorimit të parashikuar në të nuk janë miratuar ende.

Rekomandim [74]: Rekomandohet pasurimi dhe plotësimi i bazës ligjore në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

532 ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE, ÇLODHËSE E ARGËTUESE, ZHVILLIMIN DHE ADMINISTRIMIN E INSTITUCIONEVE E TË OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE (NENI 25/4)

Kutiza 12

Drejtimit strategjike për funksionin e organizimit të aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve

- Rritje e aktiviteteve sportive dhe shtim i ambientet sportive përkatëse në dobi të komuniteteve vendore, në bashkëpunim me MAS.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore në këtë funksion paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 18: Organigrama e funksionit Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese ... (Neni 25/4)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve e i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sporti	MAS
Merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin	KLS
Harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitare	NJQV
Organizim	
Krijon institucione përgjegjëse për sportin	
Menaxhet objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës	NJQV
Mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre	
Mirëmban dhe rikonstrukt objekte sportive	

RREGULLIM I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Standardet dhe kushtet teknike për ndërtimin e objekteve sportive	FNS
Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive	KM

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Standardet dhe kushtet teknike për ndërtimin e objekteve sportive	Persona fizikë ose juridikë (Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive)	FNS	Nuk ka

5.4 FUSHA E MBROJTJES SË MJEDISIT

5.4.1 SIGURIMI, NË NIVEL VENDOR, TË MASAVE PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT, TOKËS DHE UJIT NGA NDOTJA. (NENI 26/1), SIGURIMI NË NIVEL VENDOR, I MASAVE PËR MBROJTJEN NGA NDOTJA AKUSTIKE (NENI 26/2), ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE EDUKUESE DHE PROMOVUESE, NË NIVEL VENDOR, TË CILAT LIDHEN ME MBROJTJEN E MJEDISIT (NENI 26/3)

• Kutiza 13 •

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për fushën e mbrojtjes së mjedisit

Drejtimit strategjike

- Përcaktimi i rolit të bashkive dhe qarqeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
- Forcimi i kompetencave të bashkive dhe qarqeve në planifikim dhe në mbikëqyrjen e mbrojtjes së mjedisit, përmes ndryshimeve ligjore dhe mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve.
- Ngritja e strukturave adekuate dhe funksionale në NjQV për mbrojtjen e mjedisit.
- Rritja e burimeve buxhetore për zbatimin e funksioneve në fushën e ndotjes së ajrit dhe fusha të tjera për të mbështetur kapacitetet e NJQV për zbatimin e funksioneve të tyre.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Mbetet e paqartë ndarja e autoritetit midis niveleve qendrore dhe vendore të qeverisjes. Ligji 139/2015 sanksionon mbrojtjen nga ndotja e ajrit, ujit dhe ajo akustike si funksione bashkiake. Megjithatë, ajo menaxhohet plotësisht si funksion qendror nën autoritetin e Inspektoratit Qendror.
- Bashkitë nuk kanë kompetenca rregullatore (d.m.th. leje, licenca) dhe përgjegjësia për të përpunuar plane të veprimit mjedisor shihet thjesht si një formalitet. Kompetencat administrative bashkiake janë jashtëzakonisht të kufizuara (pra kanë mundësi për sanksione minimale për shkelje nga policia bashkiake, thuajse pa asnjë ndikim).

106

Përkufizimi

“Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore në këtë funksion paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 19: Organigrama e funksionit për sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja ... (Neni 26)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Mbrojtja e cilësisë së ajrit nga ndotja	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit	MTM
Miraton strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit	KM
Miraton sistemin e matjes: metodat, pajisjet, rrjetet dhe laboratorët	MTM
Harton planin e kombëtar për cilësinë e ajrit	KM
Harton programin kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër	MTM
Harton planin e aglomeratit/zonës për cilësinë e ajrit në bazë të përfundimve të nxerra nga monitorimi i AKM/ARM	
Miraton planin e aglomeratit/zonës për cilësinë e ajrit	NJQV
Harton planin e veprimit afatshkurtër për aglomeratin/zonën në bazë të përfundimve të nxerra nga monitorimi i AKM/ARM	
Organizim	
Vlerëson cilësinë e ajrit në mjedis	AKM
Analizon metodat e vlerësimit dhe siguron saktësinë e matjeve	AKM
Harton dhe miraton raportin vjetor të vlerësimit të cilësisë së ajrit në mjedis	AKM
Zbaton planin e aglomeratit/zonës për cilësinë e ajrit	NJQV
Zbaton planin e veprimit afatshkurtër për aglomeratin/zonën	NJQV
Merr masa për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit	MTM/ NJQV
Mbrojtja e cilësisë së tokës nga ndotja	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	

Përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit	MTM
Miraton strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit	KM
Organizim	
Merr masa për mbrojtjen e cilësisë së tokës nga ndotja në kuadër të legjislacionit sektorial për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit	NJQV
Mbrojtja e cilësisë së ujit nga ndotja	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit	MTM
Miraton strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit	KM
Përgatisin programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre nga shkarkimet e lëngëta	ABU/ARM
Harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet	MTM
Miraton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si nitratet, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet	KKU
Nxjerr rregullore, ku përcaktohen programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, ashtu edhe ato që shkaktohen apo rrjedhin nga veprimtari të tjera bujqësore	MTM
Organizim	
Identifikon trupat ujorë, sipas procedurës përkatëse dhe në afatet kohore të përcaktuara	KKU
Siguron mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre	KBU

Përcaktim të teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura, në përputhje me llojin e natyrën e tyre;
 Hartim i planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në mënyre të integruar, si pjesë e planeve të menaxhimit të baseneve ujëmbledhëse përkatëse;
 Përsosja e rrjetit institucional përgjegjës;
 Kontrolli i vazhdueshëm i veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre

NJQV/MTM

Mbrojtja nga ndotja akustike

Institucioni Përgjegjës

Planifikim

Përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit

MTM

Miraton strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit

KM

Harton planin kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave

MTM

Miraton planin kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave

NJQV

Harton dhe zbaton planet vendore të veprimit për zhurmën

NJQV

Organizim

NJQV

Jep leje për zhvillimin e veprimtarive argëtuese, të veprimtarive me grumbullime, manifestime, me kohë të kufizuar, në mjedise të jashtme apo të mbyllura, të cilat mund të bëhen burim shqetësimi për banorët

NJQV

Drejton procesin e hartëzimit të zhurmës

NJQV

Shpall zona të qeta dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën

NJQV

Verifikon zbatimin e niveleve kufi për projektimin e ndërtesave, me përjashtim të banesave vetjake

NJQV

Kërkojnë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontrole, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo mbyllin një veprimtari

NJQV

Merr vendimin e kontrollit: cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë

NJQV

Lëshon lejen e mjedisit për personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve lëshojnë zhurmë në mjedis

AKM

Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit

Institucioni Përgjegjës

Planifikon aktivitete	NJQV
Zhvillon aktivitete	

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Vendos masat për pakësimin e shkarkimit në ajër nga burime të palëvizshme	KM
Vendos masat kundër ndotjes së ajrit dhe shkarkimit të ndotësve nga burimet e lëvizshme	
Vendos masat për kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm, e shkarkimit të tyre, dhe për kontrollin e shkarkimeve në ajër nga përbërësit organikë të avullueshëm	
Normat për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish të ajrit, si dhe afatet për arritjen e tyre	
normat e cilësisë së mjedisit për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish të tokës, si dhe afatet për arritjen e tyre	
Vlerat kufi, vlerat prag dhe vlerat e synuara për disa ndotës në ajër	
Metodat dhe kriteret për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit	
Cilësia e lëndëve djegëse	
Vlerat kufi të ndotësve për burimet e palëvizshme	
Normat për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish të tokës, si dhe afatet për arritjen e tyre	
Normat teknike të shkarkimit në mjedis për ujin	MTM
Normat për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish të ujit, si dhe afatet për arritjen e tyre	
Kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave	
Rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes	
Kërkesa dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave	
Treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike e metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës	
Udhëzime metodike për hartëzimin e zhurmës në nivel kombëtar dhe vendor dhe hartat strategjike të zhurmës	

MONITORIM DHE VLERËSIM

	Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosi e Sanksioneve
	Kontrolli për cilësinë e monitorimit, të matjeve, të zbatimit të metodikave, të pajisjeve të përdorura dhe vërtetësisë së rezultateve, të dala nga monitorimi	AKM	AKM	Nuk ka
	Kontrolli i zbatimit të dispozitave të ligjit 9774, 12.07.2007 dhe i akteve nënligjore		Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit / Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit / Inspektorati që mbulon fushën e punës / Struktura përgjegjëse për kontrollin e automjeteve / NJQV	
	Respektimi i normave të shkarkimeve të lëngëta			
112	Kontroll për programin e masave teknike, teknologjike e organizative të trajtimit të ujërave të ndotura	Persona fizikë apo juridikë	Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit	Inspektorati përgjegjës për mjedisin
	Kontroll për zbatimin e rregullave dhe kërkesave për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe kushtet e vendosura në lejen mjedisore		Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit	
	Monitorimi i veprimtarive që shkaktojnë ujëra të ndotura dhe veprimtarisë së trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane, industriale etj.		NJQV	
	Kontroll i rregullave teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma			NJQV
	Sistemi			
	Programi kombëtar i monitorimit të mjedisit		AKM	

Gjetje

Mospërputhje Ligjore

VKM nr. 633, datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", parashikon NJQV-të si një nga autoritete përgjegjëse për zbatimin e kësaj VKM-je. Në përcaktimet e Kodit rrugor, kontrolli teknik i mjeteve,

si veprimtaria kryesore për zbatimin e kësaj VKM-je, përcaktohet si përgjegjësi e qendrave të kontrollit teknik, të licencuara nga MIE, si dhe në rast kur kanë dyshime për ndotje për mjete me motor ose rimorkio të veçantë, organet e shërbimeve të policisë rrugore (përfshirë policia bashkiake neni 12 i Kodit Rrugor), mund të urdhërojnë në çdo kohë ndalimin e tyre, duke bërë shënimin në librezën e mjetit, për një kontroll teknik të menjëhershëm jashtë radhe. Në kushtet e mungesës së tagrit për kontrollin e mjeteve, veprimtaritë e përcaktuara në VKM-në nr. 633 nuk mund të zbatohet nga NJQV-të.

Rekomandim [75]: Rekomandohet ndryshimi i pikës 12 të VKM-së nr. 633. Përgjegjësia e NJQV-ve për zbatimin e kësaj VKM-je të shfuqizohet.

Mungesë Ligjore

Në nenin 12 të ligjit 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” përcaktohet KM si autoriteti përgjegjës për miratimin e masave për pakësimin e shkarkimit në ajër nga burime të palëvizshme. Kjo VKM nuk është miratuar ende.

Rekomandim [76]: Rekomandohet miratimi i VKM-së në zbatim të nenit 12 të ligjit 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

Për sigurimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, NJQV-së nuk i jepen kompetenca për matje, kontroll dhe monitorim të treguesve përkatës, për rrjedhojë, masat që mund të sigurojnë NJQV-të kufizohen në masa të cilat aktualisht merren në kuadër të administrimit të funksioneve të tjerat të veta sipas ligjit 139/2015, përkatësisht:

- Për cilësinë e ajrit, në funksionin e transportit publik vendor dhe parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike (neni 23/6 dhe 9);
- Për cilësinë e ujit të pijshëm, në funksionin e prodhimit, trajtimit, transmetimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm (neni 23/1);
- Për ujërat e ndotura, në funksionin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura (neni 23/2);
- Për ujërat e ujitjes dhe kullimit, në funksionin e administrimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (neni 27/1);
- Për mbrojtjen e cilësisë së tokës, në funksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore e të kategorive të tjera resurseve, si dhe mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit (neni 27);
- Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, NJQV-ja siguron masat për mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht për cilësinë e tokës, si pjesë e funksionit të planifikimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, (neni 23).

Në lidhje me aktivitetet e personave fizikë e juridikë që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj, NJQV-ja nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e ndotjes mjedisore.

Rekomandim [77]: Rekomandohet zgjerimi i kompetencave të NJQV-ve në lidhje me sigurimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, duke i shtuar kompetenca për kryerjen e matjes, kontrollit, monitorimit si dhe vendosjen e masave administrative drejtpërdrejtë ndaj personave fizikë apo juridikë kundërvajtës.

Rekomandohet që këto ndryshime të reflektohen në legjislacionin sektorial për mbrojtjen e mjedisit si dhe në legjislacionin sektorial që rregullon funksionet e tjera në NJQV, duke marrë shembull nga praktika e mirë e inspektorateve ndërtimore pranë NJQV-ve

5.5 FUSHA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL, PYJEVE DHE KULLOTAVE PUBLIKE, NATYRËS DHE BIODIVERISTETIT

5.5.1 ADMINISTRIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË TRANSFERUAR NË PRONËSI TË TYRE, SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ (NENI 27/1)

• Kutiza 14 •

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e administrimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të transferuar në pronësi të tyre.

Drejtimit strategjike

- Decentralizimi i funksionit të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit dytësor dhe terciar të ujitjes dhe kullimit.
- Përfshirja e këtij funksioni në ndryshimet e ligjit organik dhe aktet nënligjore përkatëse.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të sistemeve të ujitjes dhe kullimit për çdo bashki me ndihmën e autoriteteve qendrore dhe donatorëve.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Rishikimi i legjislacionit për decentralizimin e funksionit të mirëmbajtjes së rrjetit dytësor dhe tretësor të ujitjes dhe kullimit.
- Ligji i ri i cakton bashkive rol parësor në menaxhimin e sektorit të ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet: (i) transferimit të së drejtës së pronësisë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe kalimin e përgjegjësisë për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së transferuar; (ii) përcaktimit të tarifave të shërbimit të ujitjes/kullimit dhe mbledhjen e tyre duke synuar një mbulim gradual të kostove; (iii) mobilizimit të burimeve të tjera financiare nga vetë ato apo sigurimit të granteve nga buxheti i shtetit, mbi bazën e nevojave dhe performancës së arritur.
- Organizimi i shërbimit të ujitjes nga vetë bashkia do të bëhet në përshtatje me madhësinë e skemës ujitëse, gjendjen e saj, traditën, shkallën e kooperimit të fermerëve etj.
- Paralelisht me hartimin e kuadrit ligjor ka vijuar puna për hartimin e planeve lokale për menaxhimin dhe investimet në rrjetin dytësor dhe tretësor të ujitjes dhe kullimit.
- Në fushën e bujqësisë, është propozuar legjislacion që parashikon ricentralizimin e shërbimeve shtesë në bujqësi (kontrolli veterinar).

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore në këtë funksion paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 20: Organigrama e funksionit Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ... (Neni 27/1)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Miraton Plani Kombëtar të përbërë nga strategjia e bujqësisë dhe strategjia e zhvillimit të zonave rurale	KM
Miraton transferimin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe të veprave të mbrojtjes nga përmbytja	KM
Përcakton politikën kombëtare të ujitjes dhe të kullimit;	MBZHR
Kujdeset për ngritjen dhe menaxhimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit, si dhe merr masa të përshtatshme për mbrojtjen e tokave nga përmbytjet.	MBZHR

Këshillon e udhëzon drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, NJQV dhe organizatat e ujit për çështje ligjore, teknike e financiare	MBZHR
Organizim	
Administrimi	Institucioni Përgjegjës
Miratton ndryshimin e destinacionit të infrastrukturës	
Përcakton, në rast të humjes së funksionit për bujqësinë të infrastrukturës së për qëllime ujitje dhe kullimi : a) daljen jashtë përdorimi të infrastrukturës për qëllime ujitjeje dhe kullimi; b) përdorimin e këtyre aseteve për qëllime të tjera; c) privatizimin e këtyre aseteve, së bashku me sipërfaqen përkatëse të tokës, sipas legjislacionit në fuqi.	KM
Jep leje për përdorimin e burimeve ujore për ujitje	KKU
Mirëmbajtja	Institucioni Përgjegjës
Ndërmerr veprime të nevojshme në rast thatësire të zgjatur dhe përmbytjeje	MBZHR
Kërkon nga DUK, NJQV organizata të dhëna dhe dokumentacion për mirëmbajtjen e infrastrukturës që u është transferuar	MBZHR
Kërkon nga NJQV dhe organizatat e përdorimit të ujit, kur kjo është e nevojshme, të marrin përsipër punime specifike: a) për të siguruar mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture; b) për të parandaluar dëmet ose cenimin e kësaj infrastrukture; c) për të parandaluar dëmet e pronës shtetërore ose dëmet e pronës së të tretëve; ç) në interes publik.	MBZHR
Mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit në pronësi të saj	
Merr masat e nevojshme për të ruajtur dhe mirëmbajtur infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara në to, përfshirë edhe sipërfaqet e tokës bashkëngjitur	
Rehabiliton dhe rikonstruktin infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në zonat e banuara	
Kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së digave e të rezervuarëve për ujitje, kur është e nevojshme	NJQV
Merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të	
Pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitëse	
Shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe të kullimit	
Shfrytëzimi	Institucioni Përgjegjës
Urdhëron DUK, në raste të veçanta, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e përkohshme të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja të transferuara bashkisë, në raste të tilla si cenim i sigurisë së digave dhe përmbytje	MBZHR
Jep leje për veprimtarinë në akuakulturë	MBZHR

Shfrytëzojnë dhe mirëmban përkohsisht infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja të transferuara bashkisë, në raste të tilla si cenim i sigurisë së digave dhe përmbytje	DUK
Kërkon nga DUK, NJQV organizata të dhëna dhe dokumentacion për shfrytëzimin e infrastrukturës që u është transferuar	MBZHR
Shfrytëzojnë infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit në pronësi të saj	NJQV
Shfrytëzojnë dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe të kullimit	
Bashkëpunon për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me DUK përkatëse, në rastet kur kjo e fundit administron infrastrukturën kryesore në këto sisteme	DUK/ NJQV
Monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti	
Mban inventarin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja, të transferuar në pronësi të tyre	
Mban regjistra të anëtarëve të planimetrive, zonës së shërbimit nën ujitje dhe kullim, sasisë së ujit të marrë prej bashkisë/organizatës; sasisë së ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga anëtarët, së pagesave detyruara, tarifave për t'u paguar dhe ato të paguara, të inventarit të pasurive, të inspektimeve dhe kontrolleve të infrastrukturës së ujitjes dhe digave	NJQV
Mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke	
Shqyrton realizueshmërinë hidraulike dhe ekonomike të zonës së shërbimit të ujitjes së organizatave të përdorimit të ujit	DUK/ NJQV
Jep në përdorim infrastrukturën, për jo më pak se 10 vjet infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit	
Miraton statutin e organizatave të përdorimit të ujit dhe të bashkëpunimit bujqësor përpara regjistrimit në gjykatë	NJQV
Kontrollon llogaritë e çdo organizate	
RREGULLIMI I FUNKSIONIT	
Objekti	Institucioni Përgjegjës
Rregulla dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit	
Marrëveshjen tip për dhënie në përdorim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit shoqërive të bashkëpunimit bujqësor	
Statutin tip të organizatave të përdorimit të ujit	
Formën dhe përmbytjen e regjistrave për: a. planimetrinë që tregon zonën nën shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; b. inventarin e pasurive; c. regjistrin e kontratave të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës d. regjistrin për inspektimet në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja.	MBZHR
Tarifën e shërbimit	NJQV

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit nga ana teknike			
Kontrollin teknik e fizik të sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmytjet		MBZHR	
Cilësinë e ujërave të ujitjes e kullimit dhe të tokave nën sistemin e këtyre ujërave	Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit		Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës
Sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje		MBZHR/ NJQV	

Gjetje

Mungesë Ligjore

Në ligjin nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit” parashikohet miratimi i disa akte nënligjore për të mbështetur rregullimin e funksionit, përkatësisht për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nuk janë miratuar ende nga MBZHR, rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit.

Rekomandim [78]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit në zbatim të nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”.

Për të mundësuar dhënien në përdorim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit organizatave të përdorimit të ujit nga NJQV-të, disa akte nënligjore të nevojshme për të kryer këtë veprimtari nuk janë miratuar ende nga MBZHR, përkatësisht:

- marrëveshja tip për dhënien në përdorim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit shoqërive të bashkëpunimit bujqësor;
- statuti tip i organizatave të përdorimit të ujit.

Rekomandim [79]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit në zbatim të nenit 20 , pika 4 dhe e nenit 25, pika 3 e ligjit nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”..

5.5.2 ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKAVE BUJQËSORE E TË KATEGORIVE TË TJERA TË RESURSEVE, SI TOKA TË PAFRYTSHME ETJ., SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ (NENI 27/2)

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore në këtë funksion paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 21: Organigrama e funksionit 5.5.2
Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore... (Neni 27/2)

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Drejtimi Administrativ i Strukturave për Mbrojtjen e Tokës dhe Resurseve të tjera	Institucioni Përgjegjës
Organizim	
Kryen drejtimin administrativ të të gjitha strukturave shtetërore	MBZHR
Drejton administrativisht strukturat shtetërore në territorin e qarkut	Këshilli i Qarkut
Bashkërendon punën e MBZHR, MTM, NJQV, si dhe institucioneve të tjera të ngarkuara për mbrojtjen e tokës, për të gjitha veprimtaritë	KMSHT
Merr vendime të detyrueshme për t'u zbatuar nga NJQV në territorin e qarkut:	
a. për miratimin e fondeve të nevojshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga KMT-ja ose IMT-ja;	Këshilli i Qarkut
b. për harmonizimin e veprimtarisë për mbrojtjen e tokës bujqësore ndërmjet NJQV, kur territoret kufizohen ndërmjet tyre;	
Analizon, zbërthen dhe programon për qarkun vendimet e KSHMT-së, si dhe akte të tjera të ISHMT-së.	KMT
Mban dhe ruan arkivin me dokumentacionin themelor kadastral, si librat e tokës, librat e ngastrave, planimetritë, hartat kadastrale, topografike dhe dokumente të tjera ekzistuese të arkivit të kadastrës	
Krijon dokumentacionin e ri për administrimin e tokës, nëpërmjet GIS-së, të matjeve të thjeshta, inventarizimeve, rievimeve topografike, fotografimeve ajrore, pamjeve satelitore etj.	
Përditëson dhe pasqyron në dokumentacionin kadastral ndryshimet e ndodhura në kategoritë e resurseve si dhe ndryshimet në kategorinë e tokës bujqësore	DAMT
Kryen shërbime dhe jep informacione, për institucione shtetërore, si dhe për persona fizikë dhe juridikë	
Përgatit evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve të kategorive për të gjithë territorin në juridiksion të qarkut	
Miraton ndryshimin e tokës bujqësore sipas bonitetit	Këshilli Bashkiak
Miraton raportin teknik të ZMMT për ndryshimin e kategorive të tokës bujqësore sipas bonitetit	Kryetari i Bashkisë
Përgatit kërkesat dhe dokumentacionin e personave fizikë apo juridikë për qiradhënien, për dhënien e lejeve të shfrytëzimit ose për format e tjera të transferimit të të drejtave të tokave bujqësore të pandara dhe të brigjeve të lumenjve	ZMMT

Miraton kërkesat dhe dokumentacionin e personave fizikë apo juridikë për qiradhënien, për dhënien e lejeve të shfrytëzimit ose për format e tjera të transferimit të të drejtave të tokave bujqësore të pandara dhe të brigjeve të lumenjve	NJQV
Jep me qira tokat bujqësore në administrim	
Grumbullon informacionin gjeografik dhe ruan hartat e dokumentacionin që ka në varësi	
Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera	
Mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion të saj	
Përgjigjet për grumbullimin dhe sistemimin e dokumentacionit të ri kadastral për tokën bujqësore dhe të kategorive të resurseve të tjera që me ligj janë transferuar në përdorim/pronësi të bashkive	
Ndjek zbatimin e procedurave për qiradhënien e tokave bujqësore të pandara	
Evidenton sipërfaqet e dhëna me qira dhe i dërgon informacione periodike DAMT-së në qark.	ZMMT
Evidenton në nivel ngastre (parcele), fshati (zone kadastrale) dhe bashkie, ndryshimet dhe kalimet e ndërsjella të kategorive të resurseve, për të cilat janë marrë vendime nga organet shtetërore, që ligji i ka ngarkuar me kompetenca vendimmarrëse në këtë fushë.	
Përgatit “evidencën e gjendjes dhe ndryshimit të kategorive të resurseve”, që i dërgohet DAMT-së në qark, brenda datës 15 janar të vitit pasardhës	
Përgatit të dhëna e informacione për përdorimin e resurseve të tokës, sipas kërkesave që bëhen nga bashkia, DAMT-ja e qarkut dhe struktura të tjera të qeverisjes qendrore	
Mbi bazën e dokumentacionit, që disponohet, i dërgon DAMT-së së qarkut të dhënat dhe informacione, në çdo rast, kur këto kërkohen	
Shqyrton kërkesat e subjekteve të interesuara për ndryshim të kategorive të resurseve të tokës dhe përgatit raportet teknike për këto kërkesa	
Drejtimi Teknik i Strukturave për Mbrojtjen e Tokës dhe Resurseve të tjera	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton dhe zbaton politika për konsolidimin dhe miradministrimin e tokës bujqësore, si dhe mbrojtjen e tokës nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë	MBZHR
Kryen drejtimin teknik të strukturave shtetërore	
Drejton teknikisht strukturat shtetërore në territorin e qarkut	Këshilli i Qarkut
Bashkërendon punën, në fushën e veprimtarive për mbrojtjen e tokës dhe masave për rehabilitimin e tokave të dëmtuara, me struktura të tjera të ngarkuara për mbrojtjen e tokës	ISHMT
Bashkërendon punën e MBZHR, MTM, NJQV, si dhe institucioneve të tjera të ngarkuara për mbrojtjen e tokës, për të gjitha veprimtaritë	KMSHT

Bashkërendon veprimtarinë për mbrojtjen e tokës bujqësore brenda fshatrave, ndërmjet fshatrave, brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe ndërmjet shoqatave të ndryshme, kur veprimtaria e tyre ka si objekt token bujqësore në këtë territor;	
Bashkërendon veprimtarinë e tij për mbrojtjen e tokës bujqësore	Këshilli Bashkiak
Bashkërendon veprimtarinë e tij për mbrojtjen e tokës bujqësore me bashkitë e tjera, kur territoret e tokave kufizohen me njeri-tjetrin;	
Bashkërendon veprimtarinë me këshillin e qarkut, me KMT-ne dhe IMT-ne e qarkut, si dhe të ndjeke zbatimin e vendimeve të organeve eprore kur kanë si objekt territorin në juridiksionin e tyre;	
Vendos për programet dhe projektet afatgjata, afatmesme dhe vjetore, që kanë si objekt: <ul style="list-style-type: none"> a. përmirësimin e sistemit të kullimit dhe të ujitjes në hapësirën e tokës bujqësore dhe që përfshihen në territorin e dy ose më shumë qarqeve; b. përmirësimin e masave antierozive, nëpërmjet ndërtimit ose ngritjes së disa veprave të veçanta antierozive, brenda një territori të caktuar, si pyllëzime, kanale të ujërave të larta, prita malore etj; c. përmirësimin e masave mbrojtëse të brigjeve të lumenjve, rrjedha e të cilave përshkon territoret e dy ose më shumë qarqeve 	KMSHT
Merr vendime për mbrojtjen e tokës bujqësore edhe kur: <ul style="list-style-type: none"> a. objekti i vendimit shtrihet për dy ose më shumë qarqe; b. një NJQV parashtron vërejtje ose kundërshtime për vendimet që janë marrë nga këshilli i qarkut dhe KMT-ja në qark c. NJQV nuk ka nxjerrë vendimin e vet në kohën e përshtatshme e të përcaktuar në aktet nënligjore ose vendimi që është nxjerrë, nuk rezulton i plotë 	KMSHT
Merr vendime të detyrueshme për t'u zbatuar nga NJQV në territorin e qarkut për masat konkrete të mbrojtjes së tokës bujqësore si dhe afatet e përfundimit të rehabilitimit të tokës bujqësore të dëmtuar	Këshilli i Qarkut
Nxjerr vendime të detyrueshme për zbatim, për mbrojtjen e tokës bujqësore nga pronaret dhe poseduesit e ligjshëm të tokës bujqësore, si dhe për persona fizike e juridike, veprimtaria e të cilëve në çfarëdo lloj mënyrë ndikon mbi funksionet që përmbush toka bujqësore	Këshilli Bashkiak
Vendos dhe dërgon në formë rekomandimi këshillit të qarkut dhe këshillave bashkiak vendimet e marra për programeve dhe projekteve afatgjata, afatmesme dhe vjetore, që kanë si objekt: <ul style="list-style-type: none"> a. përmirësimin e sistemit të kullimit dhe ujitjes në hapësirën e tokës bujqësore, që përfshihet brenda territorit të qarkut, kur me të lidhet veprimtaria e dy ose më shumë NJQV-ve; b. përmirësimin e masave antierozive, kur këto përfshihen në hapësira të tokave bujqësore të dy ose më shumë NJQV-ve; c. përmirësimin e masave mbrojtëse të brigjeve të lumenjve, rrjedha e të cilëve përshkon territorin e dy ose më shumë NJQV-ve. 	KMT/pranë Qarkut
Shqyrton propozimet e njësive të qeverisjes vendore për përdorimin e tokës bujqësore për zhvillime të ndryshme urbane	
Analizon raportet e të dhënave 6-mujore të paraqitura nga zyrat e menaxhimit dhe mbrojtës së tokës, në komuna dhe/ose bashki dhe raportin e Seksionit të Administrimit të Mbrojtjes së Tokës për gjendjen, masat mbrojtëse dhe rehabilituese të tokës bujqësore, për të cilat merr edhe vendimet përkatëse.	

Organizim	
Shpall zona të tokave bujqësore në mbrojtje, në territorin e qarkut	Këshilli i Qarkut
Miraton vendngritjes e terreneve të vëzhgimit të tokës	KMT/pranë Qarkut
Propozon vendngritjes e terreneve të vëzhgimit të tokës	
Kryen raportin teknik ku përcaktohet afati i përfundimit të rehabilitimit të tokës bujqësore të dëmtuar	DAMT
Urdhëron kryerjen e analizave në çdo rast kur ekzistojnë dyshime ose vërehen se janë cenuar funksionet natyrore të tokës bujqësore	
Rehabiliton tokën bujqësore të dëmtuar, duke e kthyer atë në gjendjen e mëparshme në çdo rast kur: <ul style="list-style-type: none"> a. shkaktari të dëmtimit të tokës bujqësore nuk i mundësohet rehabilitimi i saj, por ai përmbush detyrimet financiare të rehabilitimit të plote të tokës së dëmtuar; b. shkaktari i dëmtimit të tokës bujqësore vdes dhe nuk figuron trashëgimtar, sipas përcaktimit në Kodin Civil; c. pronari i tokës së dëmtuar heq dorë ligjërisht mbi të drejtën e tij të pronësisë mbi tokën bujqësore 	NJQV
Raporton në KMT -në e qarkut për gjendjen në territorin e tij	
Zbaton vendimet dhe urdhëresat e këshillit të qarkut dhe KMT-së, që kanë si objekt territorin e bashkisë	
Mbron tokat bujqësore nga dëmtimet dhe rreziqet e mundshme, miradministron atë dhe siguron qëndrueshmërinë e funksioneve që përmbush toka	Kryetari i Bashkisë
Njofton pronareve të tokës bujqësore, duke marrë njëkohësisht masa dhe vendime të nevojshme mbrojtëse në çdo rast, që kanë të dhëna për ekzistencën e faktorëve, që rrezikojnë dëmtimin e tokave bujqësore.	
Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera	ZMMT
Kontrolli Administrativ dhe Teknik për Mbrojtjen e Tokës dhe Resurseve të tjera	Institucioni Përgjegjës
Organizim	
Bashkërendon punën, në fushën e veprimtarive për mbrojtjen e tokës dhe masave për rehabilitimin e tokave të dëmtuara, me struktura të tjera të ngarkuara për mbrojtjen e tokës	ISHMT
Programon punën vjetore të kontrollit të zbatimit të masave për mbrojtjen e tokës bujqësore, për të gjithë territorin e qarkut, në mbështetje të vendimeve të KSHMT -së, ISHMT -së dhe KMT-së së qarkut	IMT

Programon dhe ushtron kontrolle:

- a. metodike, të zakonshme, që organizohen dy herë në vit. Kontrolli i parë ushtrohet gjatë muajve prill-maj, ndërsa kontrolli i dytë në muajt shtator-tetor
- b. operative për çështje e territore të veçanta, të cilat organizohen në vijimësi nga IMT-ja ose grupe të veçanta të ngritura me vendim të KMT-së, për të cilat ndiqet e njëjta procedurë si për kontrollet metodike, të zakonshme.

IMT

Organizon grupe te veçanta me specialiste te institucioneve të ndryshme ne territorin e qarkut për të verifikuar, kontrolluar ose studiuar çështje të veçanta për masat mbrojtëse për token bujqësore

KMT/pranë
Qarkut

Përcakton çështjet e veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore, që do të verifikohen, kontrollohen ose studiohen nga grupet e kontrollit që krijon për këtë qëllim.

KMT/pranë
Qarkut

Grumbullon, përpunon dhe analizon të dhëna nga KMT dhe IMT në qarqe, në bazë të të cilave përgatiten raportet 6-mujore dhe vjetore për KSHMT-në, si dhe raporte të veçanta për çështje konkrete, të kontrolluara drejtpërdrejt ose nëpërmjet SAMT

ISHMT

Përgatit raportet përkatëse për KMT-në e qarkut, si dhe ISHMT në bazë të të dhënave që rezultojnë nga kontrollet e ushtruara dhe të treguesve të tjerë që merr nga zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki

IMT

Vendos në bazë të raporteve përmbledhëse të hartuar nga IMT në qark.

ISHMT

Shqyrton dhe vendos për ankesat që i paraqiten nga persona fizike e juridike, për sanksionet që janë vendosur ndaj tyre nga IMT në qark, si dhe për vendimet që janë marre ndaj tyre nga NJQV

Kryetari i
Qarkut

Shqyrton raportet e kontrolleve për dëmtimin e tokave bujqësore dhe nxjerr vendimet përkatëse

Këshilli
Bashkiak

Shqyrton ankesat, që i paraqiten nga persona fizike e juridike, që kane si objekt masat mbrojtëse për token bujqësore, si dhe shmangien e rreziqeve te dëmtimit te tokës bujqësore nga faktorë natyrore e artificiale

Këshilli
Bashkiak

Kryen dhe harton aktin e kontrollit, ku përfshihen edhe të dhëna të tjera për kontrollin e ushtruar, përcakton detyrat dhe masat e veçanta që duhen marrë, të cilat ia paraqet kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë së kontrolluar

IMT

Mban regjistrin e mbrojtjes së tokës dhe dokumente të tjera, ku evidentohen treguesit thelbësorë për gjendjen dhe masat mbrojtëse për token bujqësore.

IMT

Verifikojnë evidentimin e elementeve dhe te faktorëve, te cilët shkaktojnë dëmtimin e funksioneve që përmbush toka bujqësore

IMT

Konkludojnë kontrollin dhe nxjerrin vendimin që përmban:

- a. shkaqet e dëmtimit te tokës bujqësore;
- b. shkakaret e dëmtimit te tokës bujqësore dhe personat përgjegjës;
- c. detyrimin e mbulimit te shpenzimeve për kryerjen e analizave nga personat përgjegjës qe shkaktuan demin;
- d. raportin përfundimtar për organet vendimmarrëse përgjegjëse, te përcaktuara nga dispozitat e këtij ligji.

IMT

Plotëson aktet e marrjes së tokës në pronësi	Kryetari i bashkisë
Raporton çdo muaj për ecurinë e procesit te prefekti i qarkut	

RREGULLIMI I FUNKSIONIT	
Objekti	Institucioni Përgjegjës
Intervalet kohore të analizave të detyrueshme të vlerave të treguesve të tokës, tretësirës në tokë dhe lëndëve të gazta	
Përbërjen, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e KMSHT, ISHMT, KMT, si dhe të IMT në qark	KM
Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të DAMT dhe ZMMT	
Llojin e dokumentacionit kadastral që mbahet e përdoret, në bazë të të cilit kryhen veprimet administrative e ligjore për resurset	
Normat teknike për mbrojtjen e tokës bujqësore	
Sistemin e të dhënave, përmbajtjen dhe formën e regjistrit të mbrojtjes së tokës bujqësore	MBZHR
Rregulloren e funksionimit të terreneve të vëzhgimit zonal	
Drejtimin metodik dhe teknik të administrimit dhe menaxhimit të tokës	

Gjetje

Mospërputhje Ligjore

Administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore dhe e kategorive të tjera të resurseve si toka të pafrytshme rregullohet nga 2 ligje kryesore (i) ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, dhe (ii) ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar. Të dy ligjet ndryshimet e fundit i kanë pësuar më tetor të 2014, pra përpara miratimit të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015. Gjithashtu nuk janë të ndikuara nga miratimi i ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në organigramën e mësipërme ky funksion paraqitet me një ndërvarësi të drejtpërdrejt të NJQV-ve nga institucionet qendrore, madje edhe varësi nga Këshilli i Qarkut.

Përkatësisht ligji nr. 9244 përcakton MBZHR si drejtuese teknike dhe administrative e të gjitha strukturave shtetërore të përfshira në aktivitetet e mbrojtës së tokës, përfshirë strukturat pranë NJQV-ve, në kundërshtim me parimin e autonomisë vendore (neni 4/1 i ligjit 139/2015).

Rekomandim [80]: Rekomandohet të kryhen ndryshime në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar; të shfuqizohet drejtimi i strukturave të NJQV-ve nga MBZHR, dhe përgjegjësitë e NJQV-ve në lidhje me administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore të jenë të përcaktuara duke garantuar parimin e autonomisë vendore.

Këshilli i qarkut drejton teknikisht dhe administrativisht strukturat shtetërore në territorin e qarkut, duke dhënë vendime të detyrueshme për t’u ndërmarrë nga NJQV-të, ushtron inspektimin nëpërmjet IMT, etj.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” në nenin 16 parashikon që personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta, ashtu si dhe në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”. Për rrjedhojë, në strukturat organizative të këshillave të qarqeve është reduktuar veçanërisht personeli i IMT-së, dhe në përgjithësi personeli për kryerjen e përgjegjësiave për shërbimet e mbrojtës së tokës.

Në kushtet e reduktimit të kapaciteteve njerëzore ky funksion i qarkut nuk është më realisht i zbatueshëm.

Rekomandim [81]: Në pamundësi reale të zbatimit të funksioneve nga këshilli i qarkut, rekomandohet ndryshimi i ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar dhe ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kalimi i përgjegjësiave NJQV-ve për përmbushjen efektive të veprimtarive për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

5.53 KRIJIMI DHE ADMINISTRIMI I SISTEMIT VENDOR TË INFORMACIONIT DHE KËSHILLIMIT BUJQËSOR E RURAL, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI

Administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni nuk ka rregullime në legjislacioni sectorial, NJQ e administrojnë dhe rregullojnë lirisht këtë funksion.

126

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT			
Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi		Institucioni Përgjegjës	
Planifikim		NJQV	
Organizim		NJQV	
RREGULLIMI I FUNKSIONIT			
Objekti		Institucioni Përgjegjës	
Përcakton rregullimet e funksionit		NJQV	
MONITORIM DHE VLERËSIM			
Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Zbatimin e funksionit	NJQV	NJQV	Nuk ka

Gjetje

Mungesë Ligjore

Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi, rregullohet nga ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, si dhe nga VKM nr. 709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020”, të ndryshuar në zbatim të tij. Në këto akte nuk përcaktohen NJQV-të si organe përgjegjëse për zbatimin e përgjegjësive të parashikuara. Gjithsesi NJQV-të mund ta ushtrojnë këtë funksion lirisht në mbështetje të nenit 32/2 të ligjit 139/2015.

Rekomandim [82]: Rekomandohet të kryhen ndryshime në ligjin sektorial nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, duke (i) përcaktuar kompetencat e NJQV-ve dhe (ii) bashkërenduar aktivitetet midis MBZHR dhe NJQV-ve.

5.5.4 KRIJIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMAVE VENDORE TË GRANTEVE PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, TË FINANCUARA NGA BUXHETI LOKAL DHE/OSE ME BASHKËFINANCIM NGA TË TRETËT, DUKE GARANTUAR AKSES TË BALANCUAR GJINOR (NENI 27/4)

Gjetje

Mospërputhje Ligjore

Ky funksion nuk është i rregulluar nga legjislacioni sektorial, NJQV-të nuk kanë asnjë kompetencë të parashikuara.

Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, në nenin 6, parashikon krijimin e programeve për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të administruar nga MBZHR-ja, nëpërmjet agjencisë së pagesave me qëllim të mbështesë zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, duke i kushtuar vëmendje nevojës së planifikimit të zbatimit të projekteve dhe të masave mbështetëse.

Burimet financiare të programit përfshijnë edhe buxhetet e NJQV-ve.

Duke u parashikuara agjencia e pagesave, si organ ekskluziv për administrimi e programeve, NJQV nuk mund të aplikojnë këtë funksion në kundërshtim me përgjegjësinë e ngarkuar në ligjin 139/2015, neni 27, pika 4.

Rekomandim [83]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 6 i ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, të përfshihen NJQV-të në administrimin e programeve për bujqësinë e zhvillimin rural.

5.5.5 ADMINISTRIMIN E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI

Kutiza 15

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e administrimit të fondit pyjor dhe kullor publik

Drejtimit strategjike

- Decentralizim tërësor i funksionit të pyjeve dhe kullotave vendore; bashkitë do të jenë aktori kryesor për menaxhimin e tyre si aset ekonomik por edhe mjedisor.
- Rritja e bashkëpunimit mes shërbimit këshillimor bujqësor dhe NJQV, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e qeverisë vendore në procesin përkatës të hartimit të politikave dhe menaxhimit të zonave pyjore.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Shërbimi Pyjor është ristrukturuar dhe është decentralizuar tek bashkitë, duke shfuqizuar mbi 300 VKM të mëparshme për transferimin tek ish-komunat.
- Hartimi i bazës ligjore ka mundësuar: (i) përgatitjen e inventarit të fondit pyjor dhe kullor për bashkitë, (ii) planin e shpërndarjes të transferimit, të personelit, aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe buxhetin përkatës dhe (iii) përgatitjen e aktive nënligjore për transferimin dhe rregullimin e ushtrimit të funksionit nga bashkitë.
- Megjithatë, RAM raporton se në administrimin e pyjeve, vazhdojnë problemet me menaxhimin e aseteve, mbrojtjen dhe zhvillimin, si dhe me kompetencat dhe kapacitetet e monitorimit.

128

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore në këtë funksion paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 22: Organigrama e funksionit Administrimi i fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Administrimi i fondit pyjor vendor	Intitucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton politika, strategji	
Miraton planet e menaxhimit për fondin pyjor	MTM
Miraton programin e zhvillimit të sektorit të pyjeve	
Harton planin e mbarështimit të pyjeve vendore	NJQV
Miraton planin e mbarështimit të pyjeve	MTM
Harton planin e shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore	NJQV
Miraton planin e shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore	MTM
Planifikon fonde për investimet në pyjet e kullota, për planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregtimit të prodhimeve pyjore, si dhe për krijimin e sektorit të agropylltarisë	NJQV
Organizim	
Administrim i të dhënave	
Pasqyron të dhënat e kadastrës së fondit pyjor	MTM
Mban dhe administron dokumentet për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit pyjor, të kadastrës pyjore, të projekteve, të financës, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, të të dhënave bazë për tërësinë e fondit pyjor e kullosor dhe të tokave pyjore, si dhe të punimeve e përgjithësimeve statistikore	MTM
Mbledh të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private	NJQV
Mban dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor privat brenda njësisë administrative të bashkisë	NJQV
Mban të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyjet e kullotat e bashkisë	NJQV
Zhvillimi	
Administron dhe zhvillon pyjet vendore, sipas planeve të mbarështimit	NJQV
Merr masa për investimet në pyjet	NJQV

Mirëmban dhe siguron funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor bashkiak	NJQV
Drejton punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;	NJQV
Ndërpret punimet, që nuk janë në përputhje me projektet e hartuara e të parashikuara në kontratat e nënshkruara	Policia Pyjore
Mbikëqyr zhvillimit e florës e faunës së egër dhe propozon metoda për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik	NJQV
Veprimtaria Ekonomike	
Miraton heqjen sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor	MTM
Jep në përdorim pjesë të fondit pyjor bashkiak në bazë të kontratave	NJQV
Jep lejen për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor, duke bashkënduar punën me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të pajisë subjektet fizike e juridike me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarive në fushën që mbulon	MTM
Lidh marrëveshje për shërbimet dhe mirëmbajtjen e fondit pyjor, brenda sipërfaqes së miratuar për zhvillimin e turizmit, për ruajtjen nga dëmtimet dhe prerjet e paligjshme, nga sëmundjet dhe insektet, nga zjarret, si dhe për llojin e pemëve të reja që do të mbillen në territorin e caktuar	MTM
Vlerëson kapacitetin dhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit për nevojat e komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri	NJQV
Miraton kapacitetin dhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit për nevojat e komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri	MTM
Kontraktin shfrytëzimin e fondit pyjor për nevojat e komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri	NJQV
Jep leje për grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore	NJQV
Jep leje për krasitje për gjethe, kullotje bagëtie, kositje apo grumbullimi i barit në fondin pyjor publik	NJQV
Jep leje për gërmimet në fondin pyjor, publik e privat, dhe në rretin e përrenjve për të nxjerrë humus, gurë, rërë, zhavorr, plisa bari ose të tjera si këto, vendosja e kaminave të qymyrit të drurit dhe e eshkës së kovaçit, të furrave të gëlqeres apo hapja e guroveve	NJQV
Merr masa për përmirësimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregimit të prodhimeve pyjore, si dhe për krijimin e sektorit të agropylltarisë	NJQV
Bllokon veprimtarinë e ushtruar nga çdo person fizik a juridik, që nuk shlyen detyrimet ligjore në afatet e caktuara dhe/ose që nuk respekton kushtet e kontratave	Policia Pyjore
Mbrojta nga Zjarri	

Miraton planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor e kullosor kombëtar, për të gjitha format e pronësisë dhe/ose të përdorimit për qarkun	Prefekti
Organizon punën për parandalimin e zjarrit në fondin pyjor vendor	NJQV/ Policia Pyjore
Organizon punën për shuarjen e zjarreve në fondin pyjor	Policia Pyjore
Kryen drejtimin organizativ dhe teknik të operacionit për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota	NJQV
Kontrollon dhe merr në dorëzim punimet e kryera në kullota	MTM/NJQV
Kontrolli i fondit pyjor	
Institucioni Përgjegjës	
Siguron mbrojtjen, qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor	NJQV
Ruan ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor;	
Mbron dhe miradministron fondin pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, nga dëmtimi, prerjet ose kullotjet pa leje, sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi	NJQV
Ruan ekuilibrin mjedisor, nëpërmjet ruajtjes ekologjike në ndërhyrjet në ekosistemet pyjore e kullosore dhe përdorimi i standardeve bashkëkohore për përtëritjen e tyre dhe të mjedisit natyror	NJQV
Bën bllokimin e fondit pyjor kur vëren se bimët dhe prodhimet pyjore janë të infektuara nga parazitë karantinorë dhe se janë kryer shkelje të dispozitave ligjore	MTM/ NJQV/ Policia Pyjore
Mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve	NJQV
Mbikëqyr zhvillimin e florës e faunës së egër dhe propozimin e metodave për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik	NJQV
Kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe propozon heqjen e licencave kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozita;	Policia Pyjore
Parandalon, zbulon dhe lufton dëmtimin, pushtimin, shpërdorimin, tjetërsimin, shketrimin dhe degradimin e pyjeve e të tokës pyjore, cenimin nga ndërhyrjet e pakontrolluara në fondin pyjor dhe në mjedisin natyror burimet pyjore e jopyjore, në pronësi apo në përdorim të bashkive ose në pronësi private	Policia Pyjore

Parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të krimit në sektorin e pyjeve, kullotave, zonat e mbrojtura e pyjet me funksion të veçantë, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, të prodhimeve pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, si dhe çdo veprimtari tjetër	Policia Pyjore
Kontrollon veprimtaritë e subjekteve që grumbullojnë, përpunojnë dhe tregtojnë prodhimet e përftuara nga shfrytëzimi i pyjeve (trupa, lëndë ndërtimi, shtylla miniere, degë voze, dru zjarri, qymyr druri etj.) dhe prodhimet gjysmë të përpunuara (dërrasë, elemente etj.) në qendrat e përpunimit (gatrat, sharrat, cirkularet etj.) në magazinat dhe sheshet e depozitimit;	Policia Pyjore
Kontrollon zbatimin e punimeve që kryhen sipas projekteve në pyje, kullota, rezervate të gjuetisë dhe zona të mbrojtura	Policia Pyjore
Administrimi i fondit kullosor vendor	
Planifikim	
Harton strategji	MTM/ NJQV
Miraton strategji	KM
Miraton planet e menaxhimit për fondin kullosor	MTM
Miraton programin e zhvillimit të sektorit të kullotave	MTM
Harton planin e mbarështimit të kullotave	NJQV
Miraton planin e mbarështimit të kullotave	MTM
Planifikon përdorimin e fondeve për studime në ekonomitë kullosore, për vlerësimin dhe rritjen e aftësisë mbajtëse të kullotave dhe livadheve, si dhe për kryerjen e punimeve e të ndërtimeve në to, sipas projekteve, në nivel kombëtar	MTM
Planifikon fonde për investimet në pyjet e kullota, për planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregtimit të prodhimeve pyjore, si dhe për krijimin e sektorit të agropylltarisë	NJQV
Përgatit projekte për investimet në kullota	NJQV
Organizim	
Administrim i të dhënave	
Mban dhe administron të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit pyjor, të kadastrës pyjore, të projekteve, të financës, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, të të dhënave bazë për tërësinë e fondit kullosor, si dhe të punimeve e përgjithësimeve statistikore	MTM
Ndjek përpunimin e metodologjive për mbledhjen e të dhënave të zhvillimit të sektorit të kullotave, përpunimin e këtyre të dhënave dhe përgatitjen e informacionit për publikun	MTM

Regjistron kullotat dhe livadhet shtetërore, së bashku me infrastrukturën e tyre në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme	NQJV
Mban të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në kullotat	NQJV
Raportojnë në MTM të dhënat, që u kërkohen për inventarizimin dhe regjistrimin në regjistrin e fondit kullosor të kullotave dhe livadheve	NQJV
Zhvillimi	
Drejton dhe mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve	NJQV
Kontrollon dhe merr në dorëzim punimet e kryera në kullota	MTM/NJQV
Ndjek zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit të kullotave, të florës e të faunës së egër, si dhe të shmangies së sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve	MTM
Kontrollon zbatimin e punimeve që kryhen sipas projekteve në pyje, kullota, rezervate të gjuetisë dhe zona të mbrojtura	Policia Pyjore
Kontrollon zbatimin e punimeve që kryhen sipas projekteve në kullota	Policia Pyjore
Veprimtaria Ekonomike	
Organizon punën për përcaktimin e ekonomive kullosore dhe ndarjen e tyre në ngastra e nënngastra	MTM
Ruan, administron dhe i përdor kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e ligjit	NJQV
Jep në përdorim kullotat apo livadheve për kullotje ose kositje	NQJV
Parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm në sektorin e kullotave	Policia Pyjore
Mbrojtja e Fondit kullosor	
Kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar	Policia Pyjore
Merr masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre	NJQV
Miraton djegien e kullotës apo livadhit në raste të veçanta	NQJV
Njofton MTM për infeksionet dhe dëmtuesit, që shfaqen në kullota e livadhe	NQJV
Mbikëqyr zhvillimit e florës e faunës së egër dhe propozon metoda për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik	NJQV
Siguron mbështetje teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit	NJQV
Organizon trajnime dhe shërbimeve këshillimore për pronarët privatë	NJQV

RREGULLIM I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Mënyrën e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve,	MTM
Kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor	KM
Rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive të shuarjes së zjarreve	KM
Procedurat, rregullat, pagesa për mbrojtjen e fondit pyjor privat nga Policia Pyjore dhe marrëveshja tip	MTM
Shpenzimet dhe sigurimi i mjeteve e i pajisjeve për mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar nga zjarret, ndotjet dhe për luftimin e sëmundjeve, të insekteve e të barërave të këqija dhe parazitare përballohen nga Buxheti i Shtetit, në bazë të kriterëve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.	KM
Rregullat e hollësishme për krijimin dhe mbajtjen e Kadastrës Kombëtare të Fondit Pyjor, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet në gjendjen e tij	MTM
Rregullat për kullotja dhe kalimin e bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave	MTM
Kriteret e Inventarizimit të pyjeve	MTM
Rregullat për lejin e ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruar me funksion mbrojtës e të veçantë	MTM
Tarifat për të gjitha veprimtaritë, që zhvillohen në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, për shërbimet publike e mjedisore, që zhvillohen në fondin pyjor publik, si dhe ato të vlerësimit të dëmeve në pyje	KM
Kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga bashkitë	KM
Kërkesat, që duhet të plotësojnë subjektet për pjesëmarrje në konkurrimin publik me qëllim trajtim dhe shfrytëzim të fondit pyjor kombëtar	MTM
Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore.	KM
Mënyrën e përdorimit, madhësinë dhe formën e çekiç-damkës për shënimin e drurërëve pyjore përpara prerjes së drurëve pyjorë në fondin pyjor kombëtar	MTM

Kriteret dhe kontigjentët për grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore	MTM
Kriteret për krijimin dhe organizimin e masiveve pyjore ose të pellgjeve ujëmbledhëse, si njësi prodhimi, për sigurimin e vazhdimësisë së procesit të prodhimit pyjor në nivel rajoni	MTM
Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlerës së dënimit të shkaktuar nga kundravajtësit	KM
Rregullat e procedurat, që realizojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet e strukturave menaxhuese të pyjeve	MTM
Standarde shërbimi	Ligj nr. 9385
Rregullat për mbajtjen e regjistrit të fondit kullosor, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet e gjendjes së kullotave e livadheve	MTM
Tarifat për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit	KM
Rregullat e hollësishme për dhënien në përdorim të kullotave apo livadheve për kullotje ose kositje	KM
Rregulloren e biomonitorimit	MTM
Rregullat për mbajtjen e regjistrit të fondit kullosor, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet e gjendjes së kullotave e livadheve	MTM
Tarifat për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit	KM
Rregullat e hollësishme për dhënien në përdorim të kullotave apo livadheve për kullotje ose kositje	KM
Rregulloren e biomonitorimit	MTM

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar nuk është shoqëruar ende me disa akte nënligjore në zbatim të tij, duke sjell problematika në zbatimin e detyrimeve për NJQV-të në këtë funksion. Përkatësisht mungon VKM-ja për miratimin e kriterëve dhe mënyra e caktimit të vlerës së dëmit të shkaktuar nga kundërvajtësit.

Rekomandim [84]: Rekomandohet miratimi i VKM-së, në zbatim të nenit 41/1, pika 4 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar.

Mungojnë udhëzimet e mëposhtme nga MTM-ja:

- për mënyrën e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve;
- për caktimin e rregullave për kullotje dhe kalimin e bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në

pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave;

- për caktimin e rregullave për lejimin e ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë;
- për caktimin e kriteve dhe kontingjentet për grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore.

Rekomandim [85]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për mënyrën e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve, në zbatim të nenit 5, pika 6 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar.

Rekomandim [86]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për caktimin e rregullave për kullotje dhe kalimin e bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave, në zbatim të nenit 21, pika 10 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar.

Rekomandim [87]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për caktimin e rregullave për lejimin e ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë, në zbatim të nenit 21, pika 14 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar.

Rekomandim [88]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për caktimin e kriteve dhe kontingjenteve për grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, në zbatim të nenit 26, pika 14 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar.

MONITORIM DHE VLERËSIM			
Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendorsjen e Sanksioneve
Zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit të pyjeve, të kullotave, të florës e të faunës së egër, si dhe të shmangies së sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve			
Marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota		NJQV/ MTM/ Policia Pyjore	
Administrimin e qëndrueshëm e shumëfunksional të fondit pyjor vendor	NJQV/ Subjektet Private		
Zbatimin e planit të shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore.			Policia Pyjore
Cilësinë e monitorimit, të matjeve, zbatimin e metodikave, kualifikimin e specialistëve që marrin pjesë, pajisjet e përdorura dhe vërtetësinë e rezultateve		AKM	
Marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota			
Punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve	Subjektet private	NJQV	
Sistem			
Skemën për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve, për vazhdimësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm, masat për mbrojtjen e pyjeve dhe të mjedisit pyjor nga ndotja atmosferike, ruajtja e ekuilibrave të sistemeve ekologjike natyrore, duke shmangur sëmundjet dhe shfaqjen e insekteve në pyje, si dhe masat parandaluese nga zjarri		NJQV	
Miraton programin e monitorimit që përfshin monitorimin e treguesve cilësorë dhe sasiorë të tyre, të biodiversitetit në pyje, të dukurive natyrore dhe të ndotjes e të dëmtimit të tyre		MTM	
Përpunimin metodologjik për mbledhjen e të dhënave të zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, përpunimin e këtyre të dhënave dhe përgatitjen e informacionit për publikun		MTM	
Sistemi i të dhënave për monitorimin e pyjeve		Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve/ MTM/ NJQV/ Policia Pyjore	

Gjetje

Mospërputhje ligjore

Në lidhje me aktivitetet e personave fizikë e juridikë që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj, NJQV-ja nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e kundërvajtjeve në sektorin e pyjeve dhe kullotave. Strukturat e pyjeve dhe kullotave janë të detyruar në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve të njoftojnë policinë pyjore për vënien e masave administrative, të cilët për shkak vonese për shkaqe largësie nga vendi i ngjarjes, pamundësi të arritjes në vendin e ngjarjes nuk zbatojnë masën administrative.

Rekomandim [89]: Rekomandohet zgjerimi i kompetencave të NJQV-ve, shtimi i kompetencës për vendosjen e masave administrative drejtpërdrejt ndaj personave fizikë apo juridikë kundërvajtës, në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar, duke marrë shembull nga praktika e mirë e inspektorateve ndërtimore pranë NJQV-ve.

556 MBROJTJEN E NATYRËS E TË BIODIVERSITETIT, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI (NENI 27/6).

Gjetje

Mbivendosje Ligjore

138

Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar rregullon funksionin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

Neni 7 i tij parashikon si organe për administrimin e burimeve, organet shtetërore, qendrore dhe vendore. Në të gjitha përgjegjësitë që ngarkon ky ligj ai përcakton bashkërisht organet shtetërore, pa ndarë specifikisht përgjegjësitë. Ngarkimi njëkohësisht i disa organeve qeverisëse sjell për pasojë paqartësi në ndarjen e përgjegjësive dhe rrjedhimisht paqartësi në ndarjen e fondeve financiare të nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive nën këtë funksion. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në ndryshim nga ligji i mëparshëm heq ndarjen në “funksione të veta” dhe “funksione të përbashkëta”. Ky ndryshim vjen në përputhje me Kushtetutën, e cila nuk e njuh konceptin e “funksionit të përbashkët” midis qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore. Kjo praktikë sjell mos koordinim të veprimtarive të nevojshme për t’u ndërmarrë nga institucionet e përfshira.

Rekomandim [90]: Rekomandohet ndryshimi i ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar në tërësi, rekomandohet të përcaktohen qartë përgjegjësitë e organeve qendrore dhe përgjegjësitë e NJQV-ve, si dhe mënyrat e bashkëveprimit midis këtyre autoriteteve.

5.6 FUSHA E ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR

• Kutiza 16 •

Drejtimit strategjike dhe gjetjet nga RAM në fushën e zhvillimit ekonomik vendor

Drejtimit strategjike

- Projektimi dhe zbatimi i kuadrit të përshtatshëm të politikave dhe mekanizmave të bashkërendimit të tyre për zhvillimin ekonomik vendor.
- Promovimi dhe nxitja e klimës së biznesit në nivel vendor si funksion i ri i qeverisjes vendore.
- Hartimi i Planeve Strategjike të Zhvillimit nga çdo bashki, si instrumenti kryesor planifikues për zhvillimin ekonomik vendor, të harmonizuara me planet kombëtare dhe rajonale të zhvillimit.
- Përdorimi i PPP-ve në nivel vendor do të lehtësohet nëpërmjet ndryshimeve në legjislacion.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Një sërë ndryshimesh ligjore sektoriale fuqizojnë rolin e NJQV-ve për investimet strategjike, partneritetin publik-privat, menaxhimin e aseteve vendore. Paralelisht po punohet për përcaktimin e akteve nënligjore përkatëse.

5.6.1 HARTIMIN I PLANEVE STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT E TË PROGRAMEVE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR (NENI 28/1), NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I TREGJEVE PUBLIKE DHE TË RRJETIT TË TREGTISË, (NENI 28/2) MBËSHTETJA PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT TË VOGËL, NËPËRMJET VEPRIMTARIVE NXITËSE, TË TILLA SI PANAIRE E REKLAMA NË VENDE PUBLIKE (NENI 28/3), ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR, SI INFORMACIONI PËR BIZNESET, AKTIVITETET PROMOVUESE, VËNIA NË DISPOZICION E ASETEVE PUBLIKE ETJ. (NENI 28/4), PUBLIKIMI I BROSHURAVE INFORMATIVE, KRIJIMI I PORTALEVE ME PROFIL EKONOMIK ETJ (NENI 28/5) SI DHE DHËNIEN E GRANTEVE FINANCIARE PËR MBËSHTETJEN E AKTIVITETEVE TË BIZNESIT TË VOGËL E TË MESËM, SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, DUKE GARANTUAR AKSES TË BALANCUAR GJINOR (NENI 28/6)

Funksionet nën kategorinë e zhvillimit ekonomik janë funksione kryesisht të pa rregulluara nga dispozitat ligjore, si rrjedhojë këto funksione kryhen nga NJQV vendore lirisht duke përcaktuar rregullimin dhe funksionim e këtyre. Nga baza ligjore e rishikuar janë përfshirë disa elementë të cilët rregullojnë disa prej këtyre funksioneve si më poshtë:

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 23: Organigrama e funksionit : Zhvillimi Ekonomik Vendor

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Hartimi i planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Hartimi i politikave dhe planeve për zhvillimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;	
Hartimi i rregulloreve të funksionimit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;	
Identifikimi i zonave potenciale dhe përgatitja e procedurave për shpalljen e tyre;	
Nxijtja dhe asistimi i zhvilluesit, operatorëve dhe përdoruesve për krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e zonave;	MFE
Miratimi i fillimit të veprimtarisë ekonomike të përdoruesit në zonë, duke mbajtur parasysh nxitjen e industrive të reja, teknologjive novatore, teknologjive të informacionit, industrive që përmbushin standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, industrive eficiente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë, në raport me punonjësit.	
Përgatitja e planit strategjik të zhvillimit të njësisë	NJQV
Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë	Institucioni Përgjegjës
Hap tregje	NJQV
Pastron hapësirat e tregjeve	NJQV
Kryen kontrollin higjieno-sanitar të tregimit të artikujve ushqimorë	AKU
Përcakton vendndodhjen dhe administrimi e tregjeve të kafshëve të gjalla	NJQV
Kryen shërbimin veterinar në mjediset e thertoreve dhe të njësisve të therjes, për kontrollin shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit	NJQV
Rrit kapacitetet përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë	NJQV
Jep leje për shfrytëzimin e hapësirës publike në funksion të zhvillimit të aktivitetit të tregtisë	NJQV
Pajis me librezë shëndetësore të gjithë personat që punojnë në objektet e prodhimit, të ruajtjes, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore	NJQV
Lëshon certifikatë veterinare, që shoqëron mishin dhe nënproduktet e tij	NJQV
Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike	Institucioni Përgjegjës
Krijon sistem taksash lehtësuese	
Përmirëson sistemin e taksave	NJQV
Bën të mundur kryerjen e pagesave të taksave në rrugë elektronike	
Dhënia e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm	Institucioni Përgjegjës
Vlerëson dhe autorizon skema të ndihmës shtetërore	KNSH
Mbikëqyr përdorimin e ndihmës shtetërore dhe rezultatin ekonomik të përftuar nga dhënia e saj	KNSH

Funksion i deleguar	Institucioni Përgjegjës
Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve	QKB/ NJQV

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave publike	NJQV
Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve	
Rregullat për zhvillimin e panairove dhe reklamave në hapësirat publike	
Kushtet, kriteret, intensitetin e ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për ndërmarrjet e vogla e të mesme	
Kritereve: përfituesit potencial nga plani i ndihmës; kategorinë e aktiviteteve të cilat kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë; vlerën minimale dhe maksimale të mbështetjes me ndihmë shtetërore	
Treguesit për matjen e performancës dhe impaktit, me qëllim monitorimin e ndihmës shtetërore.	

142

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosijen e Sanksioneve
Respektimin e orarit të shërbimit të njësisve tregtare	Shoqëri tregtare	NJQV	Policia Bashkiake
Të parandaloje veprime të kundërligjshme në fushën e tregtimit			Policia Bashkiake
Veprimtarinë në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit apo ushqimit për kafshë		AKU	AKU
Objektivat specifike të punës dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve	QKB	MMS	

5.7 FUSHA E SIGURISË PUBLIKE

5.7.1 MBROJTJA CIVILE NE NIVEL VENDOR DHE ADMINISTRIMI I STRUKTURAVE PËRKATËSE (NENI 29/1)

• Kutiza 17 •

Drejtimet strategjike dhe gjetjet nga RAM për funksionin e mbrojtjes civile

Drejtimet strategjike

- Strategjia dhe ligji i ri për mbrojtjen civile do të rishikojë dhe përmirësojë kompetencat dhe rolin e autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Rishikimi i Ligjit të Prefektit ishte një nga arritjet drejt eliminimit të mbivendosjes së kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruar në nivel vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore.
- Përfundoi procesi ligjor për rishikimin e funksioneve në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile duke i përshtatur me ndarjen e re administrative.
- Qeveria qendrore do të ofrojë mbështetje për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së emergjencës civile dhe për ngritjen e kapaciteteve të staftit.

Mbrojtja civile në nivel vendor përbëhet nga nën komponentët kryesorë: parandalimi, parandalimi nga përmytjet i rregulluar me legjislacion specifik, shpallja e emergjencës civile, përballimi, vlerësimi i dëmeve dhe rindërtimi.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 24: Organigrama e funksionit mbrojtja civile ne nivel vendor dhe administrimi i strukturave perkatëse

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Mbrojtja Civile në Nivel Vendor dhe Administrimi i Strukturave Përkatëse	
Parandalim	Institucioni Përgjegjës
Miraton politikat dhe programet kombëtare për planizimin	KM
Planifikon fonde për mjete e pajisje rezervë të shtetit për parandalimin	
Bën vlerësimin e rreziqeve mbi të cilat bazohet plani kombëtar	Ministritë sipas fushës së përgjegjës
Zhvillon dhe menaxhon programet e planizimit	
Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar	
Përgatit dhe zbaton planin kombëtar të planizimit dhe përballimit	MM/ DPPEC
Planifikon përdorimin e burimeve financiare e materiale	DPPEC

Grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë për zbatimin e detyrave të planizimit	
Ndjek dhe kërkon nga organet vartëse skemat e lajmërimit dhe të funksionimit të tyre	Prefekti
Parashikon burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, për sistemin e popullsisë	
Grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë për zbatimin e detyrave të planizimit	
Zbaton detyrat e caktuara nga strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror	Kryetari i Bashkisë
Planifikon dhe zbaton ngritjen e kulturës qytetare në përballimin e emergjencave civile	
Parandalim i përmytjeve	Institucioni Përgjegjës
Miraton planin e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet	KM
Harton planin e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet	AMBU/ ZABU
Vendos kufizime për përdorimin e zonave të përmytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit	KKU
Jep mendimin për vendosje kufizimi për përdorimin e zonave të përmytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit	AMBU/ NJQV
Parandalon përmytjet	
Mbledh të dhënat për digat/dambat	SKDM
Ndihmon për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave të aparaturave të dëgjimit, të vendosura në trupin e digës	KKDM
Vendos detyra për përmbushjen e sigurisë së digave	
Shpallja e Gjendjes së Emergjencës	Institucioni Përgjegjës
Vendos për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes ose rrafshimit e pasojave të situatave	KM
Aprovon zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve	Kuvendi i RSH
Përballim	Institucioni Përgjegjës
Miraton politikën dhe programet për përballimin	
Miraton programin kombëtar dhe krijimit të kushteve për arsimimin, trajnimin, planizimin dhe përballimin	KM
Planifikon fonde për mjete e pajisje rezervë të shtetit	

Koordinon veprimet e institucioneve shtetërore e subjekteve private dhe të burimeve materiale e financiare për përballimin e emergjencave civile e të krizave	KKECK
Bashkërendon veprimet e forcave të shërbimit	
Bashkërendon menaxhimin e rezervave shtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre	KNEC
Përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare	
Cakton drejtuesin e operacionit për menaxhimin e saj	
Zhvillon dhe menaxhon programet e përballimit	
Përpunon zbatimin e programeve të arsimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera	Ministritë sipas fushës së përgjegjësisë
Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes	
Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar	
Përgatit dhe zbaton planin kombëtar të planizimit dhe përballimit	MM/ DPPEC
Kryen bashkërendimin e veprimeve në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile ndërmjet autoriteteve të ndryshme dhe organizatave vullnetare	Komisioni Teknik Këshillimor
Planizon emergjencat civile në qarkun përkatës	
Organizon dhe bashkërendon punën për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes	
Grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë për zbatimin e detyrave të përballimit	
Realizon organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale	
Ndjek realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar	Prefekti
Ndjek riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera	
Paraqet kërkesë për ndihmë në qarqet fqinjë dhe në instancat qendrore nëse është e nevojshme	
Cakton drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij	
Bashkërendon veprimtarive të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare	Komisioni i Qarkut
Drejton organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë dhe përkatëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes	
Grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile	Kryetari i Bashkisë
Organizon sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit	

Parashikon burimet dhe rezervat e nevojshme për sistemimin e popullatës në raste të emergjencës nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera	
Realizon organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale	
Ndjek realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar	
Ndjek riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera	
Paraqet kërkesë për ndihmë në bashkitë fqinje e në qark, nëse është e nevojshme;	Kryetari i Bashkisë
Analizon gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencës civile në bashki dhe njofton në qark	
Zbaton detyrat e caktuara nga strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror	
Cakton drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile në territorin e bashkisë.	
Përballon gjendjen e shkaktuar nga përmytjet	AMBU/ NJQV
Bashkërendon veprimet e autoriteteve të bashkisë dhe organizatave vullnetare për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e vet	Komisioni vendor për emergjencat civile në bashki
Vlerësim Dëmi	
Vlerëson nivelin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera	Institucioni Përgjegjës
Vendos paraprakisht për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera	KM
	KNEC
Rindërtim dhe Riaftësim	
Vlerëson rindërtimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për të parandaluar dëmet e mundshme në të ardhmen dhe në sigurimin e kushteve bazë të jetesës	Komiteti Ndërmnistror
Rehabiliton gjendjen e shkaktuar nga përmytjet	AMBU/ NJQV
RREGULLIMI I FUNKSIONIT	
Objekti	Institucioni Përgjegjës

Planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet	
Mënyrat e planifikimit dhe e përballimit të kostos përkatëse për parashikimin, parandalimin dhe shmangien e pasojave të fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera;	
Kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile	KM
Tarifat për përdorim të përkohshëm të mjeteve në situata emergjente	
Organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile	
Përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisioni vendor për emergjencat civile pranë qarkut	MB
Përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisioni vendor për emergjencat civile pranë bashkive	

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Ndërtimi i infrastruktura e mbledhjes dhe largimit	Shoqëri Ndërtimi	Inspektorati Ndërtimor	Inspektorati Ndërtimor
Ndërtimi i digave		ITD/ KTPD/ NJQV	ITD
Sigurinë e digave	NJQV		
Zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese	NJQV/ Subjektet juridike dhe fizike	MM/ DPPEC/ Kryetari i Bashkisë	Shërbimi i Emergjencave Civile/ Baza e Mbrojtjes Civile/ Forcat e Armatosura/ Policia e Shtetit
Ndjek riaftësimin		MM/ Kryetari i Bashkisë	

148

5.7.2 GARANTIMI I SHËRBIMIT TË ZJARRFIKËSVE, NË NIVEL VENDOR, DHE ADMINISTRIMI I STRUKTURAVE PËRKATËSE (NENI 29/2)

Kutiza 18

Drejtimet strategjike dhe gjetjet për funksionin e garantimit të shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse

Drejtimet strategjike

- Decentralizimi i funksionit të shërbimit të mbrojtjes kundra zjarrit në nivel vendor.
- Ndryshimet ligjore për rristrukturoimin e PMZNSH-s si dhe transferimin tek bashkitë organikat dhe strukturat e PMZNSH-së; transferim i burimeve financiare dhe ngritja e kapaciteteve.

Gjendja afatmesme e funksionit

- Shërbimi zjarrfikës nga niveli rajonal (në varësi të prefekturave) është decentralizuar dhe ka kaluar pranë bashkive plotësisht.
- Rishikuar legjislacioni, por bashkitë ndeshin vështirësi për shkak të pajisjeve të vjetërsuara dhe kostove të larta, përfshirë edhe për personelin.

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore të përfshira në zbatimin e këtij funksioni paraqiten në organigramën e mëposhtme:




Figura 25: Organigrama e funksionit Garantimi i shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimi i strukturave përkatëse

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht.

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT	
Garantimi i shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimi i strukturave përkatëse	Institucioni Përgjegjës
Planifikim	
Harton politika, koordinon dhe mbikëqyr shërbimet e mbrojtjes nga zjarri Përcakton objektivat për zbatimin e politikave të përgjithshme dhe të programit të qeverisë	MB

	Harton rregullore për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin	
	Mban e përpunon statistika për aktivitetin e veprimtarisë	
	Organizon kualifikimin, trajnimin e personelit të shërbimit vendor të MZSH-së, të personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike dhe të shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në Akademinë e Sigurisë dhe qendrat e tjera të sigurisë e të inspektimit	DPMZSH
	Ngre dhe kompletton me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së	
	Planifikon fondet	
	Siguron gatishmërinë e përhershme të stacioneve të shërbimit zjarrfikës me automjete, pajisje speciale, personel zjarrfikës	Kryetari i Bashkisë
	Merr masa për mbajtjen në gjendje funksionimi të rrugëve të kalimit, për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse	
	Siguron, nëpërmjet mjeteve të informimit publik që ka në dispozicion, informimin për edukimin e komunitetit me njohuritë dhe masat e mbrojtjes kundër zjarrit	
	Vendos lidhje dhe bashkëpunon me partnerë ose dhurues të shteteve të tjera, për të siguruar asistencë teknike, kualifikime e specializime për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe për furnizimin materialo-teknik të stacioneve zjarrfikëse	
	Drejton shërbimin e MZSH-së për gatishmërinë e personelit, të automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse	
	Bashkëpunon, koordinon veprimet e strukturave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me strukturat e tjera operuese dhe inspektuese që veprojnë në territorin e bashkisë	
	Mban dhe administron dokumentacionit e shërbimit të MZSH-së, si dhe përpilon statistika për aktivitetin dhe veprimtarinë e shërbimit	Drejtoria/Spektori i MZSH-së pranë NJQV
	Kontrollon dhe mbikëqyr veprimtarinë e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike dhe të shërbimit vullnetar	
	Drejton dhe përgjigjet për rritjen e aftësive profesionale të personelit të MZSH-së, të shërbimit vullnetar, për zbatimin e programit të përgatitjes së tyre profesionale, dhe zhvillon mësimet treguese për dhënien e njohurive	
	Miraton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që shoqëron dokumentacionin tekniko-ligjor të lejeve zhvillimore, lejeve të ndërtimit	
	Miraton çdo ndryshim destinacioni të përdorimit të objekteve apo aktiviteteve të ushtruara në to	
	Organizim	
	Koordinon veprimtarinë e stacioneve të MZSH-ve të bashkive	
	Urdhëron ndërhyrjen me forca, automjete e pajisje zjarrfikëse të tyre në rastet e zjarreve masive apo situatave të tjera, për operacione komplekse shpëtimi	
	Koordinon veprimtarinë e shërbimit të MZSH-së me strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, të Mbrojtjes Civile, Shërbimit të Urgjencës Mjekësore dhe të institucioneve të tjera qendrore, për rritjen e sigurisë publike	DPMZSH
	Unifikon metodologjinë për masat e parandalimit, ndërhyrjes dhe inspektimit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	

Kërkon dhe detyrohet të japë ndihmë me personel, automjete e pajisje nga stacionet zjarrfikëse të tij, nga/për bashkitë fqinje ose më gjerë

Bashkërendon veprimet e shërbimit zjarrfikës me forcat e tjera operuese

Kërkon nga institucionet përgjegjëse kompletimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në objektet e çdo lloji, pyjet, kullotat etj.,

Kërkon instalimin dhe kompletimin me sisteme hidrike funksionale për shërbimin e MZSH-së, konform normave dhe standardeve në fuqi

Kërkon për çdo objekt, për miratimin e lejeve zhvillimore/ndërtimore, projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

Bashkëpunon, koordinon veprimet e strukturave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me strukturat e tjera operuese dhe inspektuese që veprojnë në territorin e bashkisë

Merr masa të inspektimit, parandalimit dhe ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin në territorin e bashkisë

Ndërhyn me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjësë së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme

Harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri

Organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme

Ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike

Bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera

Përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;

Bllokon, deri në plotësimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, veprimtarinë, në të gjitha kategoritë e proceseve teknologjike të veprave, strukturave dhe institucioneve në mjediset publike, pajisjet, materialet, lëndët e rrezikshme, që sjellin pasoja për jetën e njerëzve ose pronën, si lëndët plasëse, municionet, helmet e forta, lëndët lehtësisht të ndezshme e të djegshme, lëndët radioaktive etj.,

Bllokon të gjitha mjediset ku ka rënë zjarr, për të ruajtur të paprekur vendin e ngjarjes

Urdhëron largimin e menjëhershëm, nga mjediset, të pajisjeve dhe materialeve e lëndëve të rrezikshme, që sjellin pasoja për jetën e njerëzve dhe të pronës

Kontrollon tregtimin e pajisjeve, sistemeve manuale e automatike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin

Kryetari
i bashkisë

Drejtoria/Spektori
i MZSH-së pranë
NJQV

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i MZSH-së	KM
Rregullore për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin	
Mënyra e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe procesverbali i konstatimit të shkeljes	MB
Strukturat, uniforma dhe shenjat dalluese të veçanta, të punonjësit të shërbimit vullnetar të MZSH-së	Këshilli Bashkiak
Standarde shërbimi	Ligj nr. 152/2015

MONITORIM DHE VLERËSIM

Objekti	Subjekti	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Përgjegjës për Vendosjen e Sanksioneve
Standarde shërbimi	NJQV	MB/ DPMZSH	DPMZSH
Zbatimi i kërkesave ligjore	Subjektet private	MB/ DPMZSH/ NJQV/ Inspektorati vendor MZSH-së	Inspektorati vendor i MZSH-së

152

Gjetje

Mungesë Ligjore

Ligj nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ka disa mungesa në bazën ligjore, përkatësisht mungon VKM-ja për miratimin e rregullores për mbrojtjen nga zjarri si dhe udhëzimi i ministrit për evidentimin dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe procesverbali i konstatimit të shkeljes.

Rekomandim [91]: Rekomandohet miratimi i rregullores për mbrojtjen nga zjarri në zbatim të nenit 10, germa a, e ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

Rekomandim [92]: Rekomandohet udhëzimi për evidentimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe procesverbali i konstatimit të shkeljes në zbatim të nenit 50, pika 8, e ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

Mbivendosje Ligjore

Ligj nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në nenin 7, pika 4, përcakton drejtorinë/sektorin e MZSH-së në nivel vendor nën varësinë e kryetarit të bashkisë.

Në të njëjtën kohë ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar, në nenin 12 përcakton vartësinë e inspektoratit të Mbrojtjes nga Zjarri në nivel vendor nga Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë.

Rekomandim [93]: Rekomandohet të shfuqizohet neni 12 i ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”.

5.7.3 GARANTIMI I MBARËVAJTJES SË MARRËDHËNIEVE NË KOMUNITET, PARANDALIMIN DHE NDËRMJETËSIMIN PËR ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NË KOMUNITET (NENI 29/3), PARANDALIMIN E KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE, FORCIMIN, INSPEKTIMIN DHE MONITORIMIN E ZBATIMIT TË RREGULLOREVE E TË AKTEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE BRENDIA JURIDIKSIONIT TË TYRE VENDOR DHE NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET LIGJORE (NENI 29/4)

Kutiza 19

Drejtimet strategjike dhe gjetjet për funksionin e garantimit të mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

Drejtimet strategjike

- Harmonizim i legjislacionit, për të eliminuar mbivendosjen e funksioneve ndërmjet policisë së shtetit dhe policisë bashkiake në kontrollin e trafikut urban.
- Rishikim i strukturave të policisë bashkiake në bazë të organizimit të ri të NJQV; numri i stafit do të optimizohet në bazë të kriterëve të përcaktuara.
- Forcim i kapaciteteve të NJQV do të forcohen përmes trajnimit të ofruar për inspektorët e policisë vendore për fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me kompetencat e tyre.

Zbatimi

Në vijim trajtohet administrimi dhe rregullimi i këtij funksioni duke përcaktuar institucionet e përfshira përkatësisht

ADMINISTRIMI I FUNKSIONIT

Garantimi i mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet

Institucioni
Përgjegjës

Planifikim

Harton një program nxitjeje për restaurimin apo rikonstruksionin e ndërtesave të dëmtuara, duke kontribuar me financime pjesore

NJQV

Organizim

Mban regjistrin e administratorëve të bashkëpronësive

NJQV

Mund të kontribuojë në financimin pjesor për ngritjen e një ndërtese të re, kur bashkëpronarët vendosin për ta shembur atë, me kusht që pjesë nga ndërtesa e re t'i kalojnë në pronësi bashkisë/komunës, për t'ua dhënë në përdorim apo pronësi familjeve në vështirësi për strehim

NJQV

Nëse një asamble bashkëpronarësh nuk konstituohet, kryetari i bashkisë ushtron kompetencën e administratorit për 3 muaj, me të drejtë rizgjatjeje, derisa asambleja të konstituohet ose kryesia të kontraktojë një administrator apo një shoqëri administruese

Zbaton vendimet e marra nga asambleja e bashkëpronarëve

Ndërmerr veprime të nevojshme për mirëmbajtjen e bashkëpronësisë, përfshirë edhe kontraktimin e subjekteve të treta, kur një gjë e tillë është miratuar nga asambleja e bashkëpronarëve

Ndërmerr kontrolleve periodike, teknike dhe higjieno-shëndetësore për gjendjen e pronës e të objekteve në bashkëpronësi, si sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit, sistemi i ngrohjes qendrore, ashensorëve, tarracave, sistemi i ndriçimit, prania e insekteve dhe e parazitëve etj. dhe i veprimeve për të zhdukur dëmtimet e pronës apo praninë e faktorëve, që mund të përbëjnë rrezik për epidemi sëmundje etj.

154

Mbledh, faturon ose kontrollon për derdhjen në llogari bankare të tarifave mujore

Kryetari i
Bashkisë

Mban buxhetin për mirëmbajtje dhe riparime, në zëra të veçantë, në emër të asamblesë

Kontrollon kostot e pagesave të të gjitha faturave në emër të asamblesë

Mban librin e llogarive të asamblesë dhe atyre bankare

Përgatit raportin për gjendjen financiare, katër mujore dhe vjetore dhe raportimin në mbledhjen vjetore të asamblesë

Përgatit planin e veprimeve vjetore të buxhetit përkatës, masës dhe kohës së kryerjes së pagesës së tarifave mujore dhe paraqitjen e tyre në mbledhjen vjetore të asamblesë për vendimmarrje

Kontrollon zbatimin e rregullave të bashkëjetesës

Regjistron ashensorin pranë strukturave përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut

Këshillon asamblesën ose kryesinë, kur është e nevojshme

Parandalimi i kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të NJQV

Institucioni
Përgjegjës

Siguron zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe të këshillit që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike

Merr masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë apo të komunës si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj

Siguron zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë (komunës) në lidhje me personat juridikë ose fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale, ndaj bashkisë apo komunës, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre

Mbikëqyr dhe verifikon nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve bashkiake

Konsataton dhe parandalon ndotjet e mjedisit, hedhjet e mbeturinave të ndryshme, si dhe sinjalizon kryetarin e bashkisë për shfaqjet e parazitëve të dëmshëm e të rrezikshëm si dhe për rastet e shfaqjes së epidemive

Ndalon, shmang e prishë ndërtimet e paligjshme, ndalon zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë si dhe të organizojë lirimim e tyre

Kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zëniet, mënjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, autoparlantet e radiove e magnetofoneve, rënia pa vend e burive të automjeteve në rrugë, banesa, plazhe e mjedise të tjera publike, që sjellin shqetësime për të tjerët

Merr masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro, pallate e salla sportive, objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike

Inspekton respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjedise publike

Kujdeset për respektimin e orarit të shërbimit të njësisë tregtare, bufeve, restoranteve, bilardove, lojrave të fatit e të objekteve të tjera me veprimtari publike, si dhe për zbatimin nga ana e tyre të rregulloreve apo urdhërave të nxjerra nga kryetari i bashkisë

Kontrollon marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore si dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre duke u dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në raste urgjence

Merr masa të përkohshme ndaj të sëmurëve psikikë në gjendje të rëndë, që krijojnë shqetësime për rendin publik

Kujdeset për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike si dhe heqjen e atyre të paligjshme ose të paautorizuara

Policia
Bashkiake

RREGULLIMI I FUNKSIONIT

Objekti	Institucioni Përgjegjës
Përcakton standardet minimale, të domosdoshme për t'u respektuar nga bashkëpronësit për: a. ruajtjen e higjienës dhe të shëndetit publik; b. mbrojtjen kundër zjarrit; c. mirëmbajtjen fizike të mjediseve të brendshme, të fasadave, mjediseve rrethuese, që janë pjesë e aktit të bashkëpronësisë, si dhe të sjelljes qytetare në këto mjedise.	Këshilli Bashkiak
Procedurat e aplikimit, afatet, shuma e financimit dhe çdo rregull tjetër, për përfshirjen në programet e nxitjes për restaurim dhe rikonstruksion dhe në investimet në ndërtesa të reja	Këshilli Bashkiak
Llogarit tarifën e administrimit	MSHMS

6. MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE

6.1 PARIMI I MJAFTUESHMËRISË FINANCIARE

Karta Evropiane për Vetëqeverisje Vendore parashikon të drejtën e vetëqeverisjes vendore për burime financiare të mjaftueshme, sipas politikës ekonomike kombëtare. Burimet financiare të vetëqeverisjes vendore janë të mjaftueshme kur janë përpjesëtimore me kostot e përmbushjes së përgjegjësisë të saj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njih detyrimin e qeverisjes qendrore për të përballuar shpenzimet për ushtrimin e kompetencave dhe detyrimeve që ajo i delegon qeverisjes vendore me ligj. Të drejtat për vetëqeverisje të njësisë të qeverisjes vendore mbrohen në gjykatë.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” njih mjaftueshmërinë financiare të vetëqeverisjes vendore si parim themelor të financave të saj, dhe, njëkohësisht, si parim të ushtrimit të funksioneve të saj.

I. Si parim i financave të vetëqeverisjes vendore, politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore, neni 34/1. Në mënyrë të veçantë:

- *funksionet që delegohen nga qeverisja qendrore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre, neni 34/2;*
- *në rast ndryshimi të politikës fiskale kombëtare e cila shoqërohet me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësisë të vetëqeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, neni 34/5.*

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet sipas politikave kombëtare dhe rajonale, dhe sipas standardeve e normave kombëtare të përcaktuara me ligj nga qeverisja qendrore.

II. Si parim i ushtrimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore, në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare ligjore, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare, neni 22/3. Në mënyrë të veçantë:

- *për funksionet që delegohen nga qeverisja qendrore, kjo e fundit siguron mjete dhe burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard, i cili është përcaktuar me ligj.*

Në këtë mënyrë, ligji 139/2018 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton mjaftueshmërinë financiare të funksioneve të vetëqeverisjes vendore në varësi të standardeve dhe normave kombëtare ligjore të tyre; nga ana tjetër, nuk e përcakton atë në përpjesëtim me kostot e ushtrimit ose realizimit të tyre, si në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Ndërkohë, në ligj nuk ka përkufizim të standardeve dhe normave të ushtrimit të një funksioni.

6.2 RREGULLIMI I MJAFTUESHMËRISË FINANCIARE

Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në linjë me ligjin 139/2015, ka qëllim të sigurojë mjaftueshmërinë e burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve të tyre.

III. *Si parim i autonomisë fiskale:*

- funksionet që u transferohen apo delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe vendosja e një standardi të ri kombëtar për kryerjen e funksioneve, shoqërohen kurdoherë me burimet e nevojshme financiare për ushtrimin e tyre;
- në rastet kur ulen apo hiqen taksa ose tarifa vendore nga qeverisja qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen plotësisht, nëpërmjet rritjes së transfertës së pakushtëzuar, taksave të ndara, transferimit në nivel vendor të një takse tjetër kombëtare ose kombinimi i tyre.

Përtej bazës së mësipërme, në vijim hidhet një vështrim më i hollësishëm në rregullimin e mjaftueshmërisë financiare nga ligji 68/2017, duke marrë në analizë metodologjinë e përcaktimit të shumës së transfertave të qeverisjes qendrore, si instrumente kryesore të financimit të vetëqeverisjes vendore.

6.2.1 MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE TË VETA QË FINANCOHEN NGA TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR

Në kuadër të sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve të veta, ligji 68/2017 përcakton se shuma totale vjetore e fondeve për t'u ndarë ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar është jo më pak se 1% e produktit të brendshëm bruto; në çdo rast, ajo nuk mund të jetë më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor.

Sipas këtij përcaktimi, madhësia e transfertës së pakushtëzuar për funksionet e veta nuk është shprehimisht në përpjesëtim me koston e ushtrimit të funksioneve, dhe as në varësi të standardeve ligjore të ushtrimit të tyre.

Sipas të dhënave nga MFE-ja, madhësia e transfertës së pakushtëzuar për funksionet e veta të vetëqeverisjes ka në bazë koston historike të përmbushjes së këtyre funksioneve nga ministrinë e linjës përgjegjëse para reformës së decentralizimit të ndërmarrë për herë të parë me ndryshimet politike dhe ekonomike të vendit pas vitit 1990. Qendrat e këtyre kostove historike kanë përfshirë:

1. burimet njerëzore (paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore)
2. operim
3. investime kapitale

Kostot historike kanë qenë baza e vetme e përdorur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vlerësimin e kostove të funksioneve të veta të vetëqeverisjes vendore në periudhën 2016-2018.

6.2.2 MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE TË REJA TË VETA

Më tej, në kuadër të sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve të veta, ligji 68/2017 përcakton që çdo transferim i funksioneve të reja te njësitë e vetëqeverisjes vendore shoqërohet me rritjen e burimeve të financimit në përpjesëtim me kostot e ushtrimit

të tyre. Ato përlogariten nga njësia e qeverisjes qendrore përgjegjëse për funksionin që transferohet në masën e shpenzimeve të përgjithshme vjetore të kryera prej tyre në tre vitet e fundit, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në këtë mënyrë, madhësia e burimeve financiare për funksione të reja të veta është shprehimisht në përpjesëtim me koston e ushtrimit të funksioneve; nga ana tjetër, kostoja nuk përcaktohet në varësi të standardeve ligjore të ushtrimit të tyre por si mesatare e shpenzimeve të kryera gjatë tre viteve të fundit nga qeverisja qendrore për nivelin përkatës të standardeve të arritur prej saj gjatë këtyre viteve, i cili jo domosdoshmërisht është në nivelin e kërkuar në ligj.

Në ligjin 139/2015, vetëqeverisjes vendore i njihen disa funksione të reja të veta, të cilat në ligjin e vjetër për vetëqeverisjen vendore kanë qenë funksione të përbashkëta me qeverinë qendrore. Këto funksione janë:

- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar dhe parashkollor;
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor;
- Ndërtimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve shoqërore vendore;
- Mbrojtja e mjedisit ;
- Mbrojtja e natyrës e të biodiversitetit;
- Administrimi i qendrave e shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik;

Funksionet e reja të veta nuk janë pjesë e grupit të funksioneve të financuara nëpërmjet transfertës së specifike, sipas ligjit 68/2017 "Për vetëqeverisjen vendore"; rrjedhimisht, ato duhet të jenë pjesë e financimit nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar.

Mbi këtë bazë, sipas të dhënave nga MFE-ja:

- a. ndërtimi dhe rehabilitimi:
 - i. i ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar dhe parashkollor,
 - ii. i ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor,
 - iii. i qendrave për ofrimin e shërbimeve shoqërore vendore,

gjatë gjithë periudhës 2016-2018 është kryer në nivel qendror nëpërmjet granteve konkurruese dhe fondit të zhvillimit të rajoneve; në këtë mënyrë, këto funksione përmbushen ende në nivel qendror edhe pse janë përgjegjësi e vetëqeverisjes vendore.

- b. mirëmbajtja:
 - i. e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar dhe parashkollor,
 - ii. e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor,

është kryer vazhdimisht nëpërmjet të ardhurave të veta të vetëqeverisjes vendore dhe nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar; kosto historike e ushtrimit të këtyre funksioneve nga ministritë e linjës përgjegjëse për to në fillim të reformës së decentralizimit në vend janë baza e vlerësimit të kostove të mirëmbajtjes për këto ndërtesa;

- c. mbrojtja e mjedisit, e natyrës dhe e biodiversitetit, që prej përcaktimit të tyre si funksione të veta, gjatë gjithë periudhës 2016-2018 nuk janë financuar nga qeveria qendrore; nga ana tjetër, qeveria vendore nuk krijon të ardhura nga taksat, tarifatat apo burime të tjera të cilat të jenë të lidhura drejtpërdrejt me ushtrimin e këtij funksioni, ndërsa gjobat për ndotje të ajrit, ujit, tokës apo ndotjes akustike, të cilat janë një veprimtari që gjeneron fonde financiare, sipas legjislacionit sektorial, nuk janë kompetencë e saj.
- d. administrimi i qendrave e shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, që prej përcaktimit të tyre si funksione të veta, gjatë gjithë periudhës 2016-2018 nuk janë financuar nga qeveria qendrore.

6.2.3 MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA QË FINANCOHEN NGA TRANSFERTA SPECIFIKE

Ligji 68/2017 përcakton financimin e një grupi funksionesh të reja të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore me transfertë specifike, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi.

Si një rast i transferimit të funksioneve të reja, madhësia e transfertës specifike, e përlogaritur për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, është të paktën sa mesatarja vjetore e shpenzimeve totale që qeverisja qendrore ka kryer për të njëjtin funksion në tre vitet e fundit para transferimit të funksionit. Niveli i standardeve për këtë kosto është niveli i arritur nga qeverisja qendrore gjatë tre viteve, i cili jo domosdoshmërisht është në nivelin e kërkuar në ligj

Në ligjin 139/2015 vetëqeverisjes vendore i janë transferuar disa funksione të reja të veta. Për të financuar këto funksione është parashikuar transfertë specifike. Funksionet e transferuara janë:

- Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi;
- Rugët rurale;
- Administrimi i pyjeve;
- Administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve shoqërore vendore;
- Arsimi parashkollor – personeli mësimor dhe jo mësimor;
- Arsimi parauniversitar – personel jo mësimor;
- Ujitja dhe Kullimi;

160

Sipas të dhënave nga MFE-ja, që prej transferimit të tyre, në periudhën 2016-2018, këto funksione janë financuar nëpërmjet transfertës specifike, madhësia e së cilës është përcaktuar sipas koston historike të ushtrimit të këtyre funksioneve. Qendrat e këtyre kostove historike kanë përfshirë:

1. burimet njerëzore (paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore)
2. operim
3. investime kapitale

Kjo mënyrë financimi do të vazhdojë dhe në vitin 2019, ndërsa në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2019" transfertat specifike riemërtohen transfertat të pakushtëzuara sektoriale.

6.2.4 MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA TË FINANCUARA NGA TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

Gjithashtu në kuadër të sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve të deleguara, madhësia e transfertës së kushtëzuar ka në bazë koston e ushtrimit të funksionit nga njësitë e qeverisjes qendrore para delegimit të tij, dhe nivelin e standardeve të arritura prej tyre deri në vitin e fundit.

Nëpërmjet legjislacionit sektorial, vetëqeverisjes vendore në nivel qarku i delegohen funksione. Për të financuar këto funksione parashikohet transfertë e kushtëzuar. Funksionet e deleguara qarkut janë:

- Administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore

Sipas të dhënave nga MFE-ja, madhësia e transfertës së kushtëzuar si bazë fillestare ka koston historike të funksionit të ushtruar nga ministria përkatëse e linjës.

6.2.5 FINANCIMI I FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA 2019-2021

Financimi i funksioneve të transferuara për periudhën 2016-2018 është bërë nëpërmjet transfertës specifike. Për vitin 2019 është planifikuar kthimi i transfertës specifike në një transfertë të pakushtëzuar sektoriale, sipas parashikimit të ligjit 68/2017.

Sipas të dhënave nga MFE-ja , pjesa sektoriale e transfertës së pakushtëzuar për këto funksione nuk shpërndahet sipas formulës së kësaj të fundit të përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Baza e përllogaritjes mbetet kostoja historike e funksioneve të transferuara.

Përgjatë bën vetëm funksioni i administrimit të sistemit të arsimit parashkollor në kopshte, për të cilin, me buxhetin e vitit 2019 ndërmerret një reformë në financimin e këtij shërbimi mbi bazën e një standardi të ri: numrit të fëmijëve; ky standard pritet të përmirësojë performancën e shërbimit të ofruar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet përshtatjes së numrit të edukatoreve për grupe më të vogla fëmijësh.

6.2.6 SISTEMI I PLANIFIKIMIT FINANCIAR TË FUNKSIONEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Sipas rregullimit të mësipërm të parimit të mjaftueshmërisë financiare, për ta përcaktuar atë nga ana sasiore, pra për të vlerësuar shumën e burimeve financiare të ushtrimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore që janë të mjaftueshme, komponenti kyç është kostoja dhe metodologjia e përllogaritjes/vlerësimit të saj. Në këtë drejtim, programi i shpenzimeve buxhetore afatmesme për funksionet e vetëqeverisjes vendore, i rregulluar në ligjin 68/2017 dhe udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 në zbatim të tij, përbën strukturën e vetme analitike prej nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe MFE-ja mund të përllogarisin ose vlerësojnë koston e ushtrimit të secilit prej funksioneve.

Megjithatë, në vijim vlen të shqyrtohet me kujdes lidhja ndërmjet ligjit 139/2015, i cili njeh dhe rregullon së pari parimin e mjaftueshmërisë financiare, me ligjin 68/2017, i cili e rregullon më tej atë dhe gjithashtu edhe sistemin e planifikimit financiar të vetëqeverisjes vendore.

Edhe një herë si në paragrafin e parë, sipas ligjit 139/2015, njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet mbi bazën e:

1. politikave kombëtare dhe rajonale,
2. standardeve e normave (minimale) kombëtare.

Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore administrojnë ushtrimin e funksioneve nëpërmjet një sistemi administrimi të performancës, i cili ndërtohet mbi bazën e standardeve e normave minimale kombëtare (e vendore), dhe një sistemi treguesish për matjen e saj.

Në përputhje me këtë, sipas ligjit 68/2017 dhe udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton planin strategjik të zhvillimit/planin e përgjithshëm vendor në bazë të planeve strategjike kombëtare dhe rajonale të zhvillimit, sektoriale e ndër-sektoriale, sipas fushave të saj të përgjegjësisë.

Ky dokument strategjik zhvillimi zbatohet nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësisë, ku shpenzimet e nevojshme të vetëqeverisjes vendore organizohen dhe planifikohen mbi bazën e programeve të shpenzimeve për një funksion ose grup funksionesh.

Programet e shpenzimeve të funksioneve kanë **qëllimet** dhe **objektivat** në përputhje me dokumentin e zhvillimit strategjik të njësisë, dhe përmbajnë vlerësimin nga njësia e vetëqeverisjes vendore të koston së **aktiviteve** për përmbushjen e tyre. Programet përmbajnë **treguesit e performancës** së njësisë në drejtim të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave gjatë periudhës afatmesme të planifikimit.

Si tregues vlerësimi të performancës së një programi të shpenzimeve buxhetore afatmesme mund të shërbejnë produktet e aktiviteteve, por edhe standarde e norma të vendosura me ligj për një funksion.

Ndërkohë, çdo program shoqërohet me informacionin për standardet e normat minimale kombëtare apo vendore përkatëse dhe nivelin e përmbushjes së tyre nëpërmjet programit.

Në këtë sistem të planifikimit financiar të funksioneve të vetëqeverisjes vendore lidhja e kostos së ushtrimit të një funksioni me (i) standardet e normat minimale kombëtare të funksionit dhe me (ii) treguesit e performancës të programit të shpenzimeve buxhetore afatmesme për funksionin, është thelbësore për të vlerësuar nga ana sasiore mjaftueshmërinë financiare të ushtrimit të tij.

Nga sa më sipër, masa e përfshirjes së standardeve ligjore të një funksioni në koston e ushtrimit të tij nëpërmjet programit të shpenzimit është e paqartë dhe jo e drejtpërdrejtë; ndërsa standardet ligjore nuk përbëjnë domosdoshmërisht tregues performance të programit. Së paku, standardet ligjore të një funksioni do të përfshihen në koston e ushtrimit të tij në atë masë që ato do të jenë qëllimi dhe objektivat e programit të shpenzimit të funksionit; për rrjedhojë, ato do të jenë baza edhe e treguesve të performancës së programit.

Në tërësi, ky sistem i planifikimit financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore drejtohet nga politikat kombëtare dhe rajonale, porse nuk është e qartë si dhe në çfarë mase drejtohet nga standardet dhe normat minimale kombëtare, ndërkohë që të dyja njëkohësisht janë baza të ushtrimit të funksioneve, sipas parimit përkatës në ligjin 139/2015. Në mungesë të një përkufizimi për standardet dhe normat minimale kombëtare, lidhja e tyre me politikat kombëtare dhe rajonale nuk është e përcaktuar. Për pasojë, sistemi i planifikimit financiar të funksioneve të vetëqeverisjes vendore nuk ka një drejtim të vetëm e të qartë, i cili të mundësojë vlerësimin e shumës së burimeve financiare që janë të mjaftueshme për ushtrimin e këtyre funksioneve.

Rëndësia e një sistemi të planifikimit financiar të vetëqeverisjes vendore me një drejtim të vetëm të qëllimit dhe objektivave të funksioneve të tyre nuk qëndron thjesht në vlerësimin e shumës së burimeve financiare që janë të mjaftueshme për t'i përmbushur ato, por, para të gjithave, në dhënien e një drejtimi të vetëm të administrimit të funksioneve nga NJQV-të, çfarë mundëson rritjen e efektivitetit të punës së tyre. .

6.2.7 MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE NË LIDHJE ME POLITIKËN FISKALE TË QEVERISË QENDRORE

Sipas të dhënave nga MFE-je, gjatë dekadës së fundit janë bërë shume ndërhyrje dhe ndryshime në ligjet për taksat dhe tarifave vendore, të cilat kanë ndikuar në ndryshime të vazhdueshme të të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njëkohësisht kanë ndikuar në uljen e parashikueshmërisë së buxheteve vendore. Gjithashtu, ndryshimet kanë pasur efekte edhe sa i përket administrimit të taksave dhe tarifave vendore. Ndryshimet e shpeshta kanë rritur kostot e administrimit të taksave dhe tarifave vendore gjithashtu, kanë ndikuar dhe në nxitjen e evazionit fiskal në nivel vendor.

Taksa e biznesit të vogël: baza, niveli dhe administrimi i taksës së biznesit të vogël në 12 vitet e fundit kanë pësuar ndryshime të shpeshta.

Ndërhyrjet në administrimin e taksës janë si më poshtë:

Deri në vitin 2007 taksa është mbledhur nga administrata qendrore dhe të ardhurat i janë transferuar njësive të vetëqeverisjes vendore; 2007 deri në vitin 2014 kjo taksë është mbledhur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; 2015 e në vazhdim taksa mblidhet nga administrata qendrore dhe të ardhurat i transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ndërhyrjet në bazën dhe nivelin e taksës janë si vijon:

- Në fund të vitit 2005 u miratua ligji nr. 9432, datë 13.10.2005 "Për një ndryshim në ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore për biznesin e vogël", i ndryshuar me ligjin nr. 9327, datë 6.12.2004, ku u përgjysmua niveli i taksës vendore mbi biznesin e vogël.

Për rrjedhojë, të ardhurat nga kjo taksë që i kalonin vetëqeverisjes vendore për vitin 2006 u ulën me 1,561 milion lekë.

- Në vitin 2013 u miratua ligjin 181/2013, ku nga 1 janari 2014 biznesit të vogël iu përgjysmua tatimi mbi fitimin nga 15% në 7.5% dhe u bë heqja e kufizimit për vendosjen e tarifave.

Efekti nga kjo masë vlerësohet rreth 666 milionë lekë më pak të ardhura për vetëqeverisjen vendore.

- Me ligjin 142/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar ndodhën këto ndryshime:
- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit;
- Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë lekë, është 5%.
- Efekti financiar nga ky ndryshim duke filluar nga 1 janari 2016 dhe në vazhdim është përlllogaritur në vlerën 1,300 milionë lekë, dhe është kompensuar.

Me ligjin nr. 10117, datë 23.04.2009 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar u bënë ndryshime që cenonin autoritetin fiskal vendor duke ulur ndjeshëm diskrecionin vendor në vendosjen e disa taksave si dhe duke kufizuar barrën fiskale nga disa taksa të tjera vendore në jo më shumë se 10% të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël. Këto ndryshime kanë pasur ndikim në buxhetin vendor në uljen e të ardhurave në rreth 2 miliard lekë, dhe është kompensuar.

Me VKM nr. 502, datë 16.04.2008, "Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, në vitin 2009 kaloi në nivel vendor përgjegjësia e administrimit të konvikteve të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm. Kjo përgjegjësi kaloi nga Ministria e Arsimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Burimi i financimit që u transferua në këtë periudhë në njësitë e qeverisjes vendore ishte rreth 40% e kostos së ofrimit të këtij shërbimi. Sipas një vlerësimi të përafërt për këtë funksion nuk i janë transferuar njësive të qeverisjes vendore rreth 1 miliardë lekë.

Për rrjedhojë të këtyre ndryshimeve, nga taksa e biznesit të vogël në fund të vitit 2005 mblidheshin dhe transferoheshin në buxhetin vendor 3,793 milionë lekë, ndërsa në buxhetin e vitit 2019 nga kjo taksë janë parashikuar të mblidhen dhe të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore 640 milionë lekë. Pra në harkun kohor të 12 viteve të fundit i mungojnë buxhetit të pushtetit vendor nga kjo taksë 3,153 milion lekë, dhe në krahasim me vitin 2005 sot merr vetëm 16.8 % të ardhura të cilat nuk i janë kompensuar njësive të vetëqeverisjes vendore.

Funksioni i furnizimit me ujë të pijshëm: Në kohën kur përgjegjësia për këtë funksion ka qenë e qeverisjes qendrore para reformës së parë të decentralizimit, shuma e subvencioneve ka arritur në rreth 2 miliardë lekë, ndërkohë aktualisht është vetëm 400 milionë lekë. Nga ky funksion konstatohet një financim i munguar për 1,600 milionë lekë.

Funksione të tjera: Gjithashtu, për disa funksione që i janë akorduar me ligj nuk i është transferuar asnjë burim financimi. Ndër këto funksione përmenden: turizmin, zhvillimin ekonomik, emergjencat civile dhe siguria në nivel vendor.

Që pas vitit 2015, njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kuadër të një funksioni të deleguar sipas ligjit 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, plotësojnë aktet e marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe raporton çdo muaj për ecurinë e procesit tek prefekti i qarkut. Për këtë funksion, për ushtrimin e të cilit nevojiten burime njerëzore të konsiderueshme në terren, nuk janë dhënë mjetet apo burimet e nevojshme financiare nga qeverisja qendrore.

Nevojat për investime për funksionet e vetëqeverisjes vendore ndër vite janë mbuluar nëpërmjet skemave të ndryshme si: (i) grante konkurruese në fillim, dhe pastaj (ii) fondi i zhvillimit të rajoneve, ku në vendimmarrje kanë dominuar autoritetet qendrore. Që kur është përcaktuar fatura financiare që trashëgohej nga ministrinë e linjës dhe në vazhdimësi, nevojat për investime kanë mbetur të nën-financuara. Megjithatë sipas këtyre skemave janë dhënë shumë fonde dhe janë mbështetur shumë projekte investimesh në nivel vendor, kjo skemë ka qenë në qendër të kritikave të vetë njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë monitorues për Shqipërinë.

Në total, që prej fillimit të reformës së decentralizimit në vend, efekti financiar i vlerësuar i ndryshimeve në politikat fiskale kombëtare dhe i transferimeve të funksioneve, i pa financuar apo kompensuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, është rreth 8 miliardë lekë.

6.3 MBROJTJA NË GJYKATË E TË DREJTËS PËR BURIME FINANCIARE TË MJAFTUESHME

Kushtetuta, sipas neneve 112 dhe 113, ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji 68/2017 janë instrumentet kryesore ligjore të vetëqeverisjes vendore për të mbrojtur në gjykatë të drejtën për fonde financiare të mjaftueshme nga qeveria qendrore. Nga ana tjetër, paqartësia e mënyrës së përcaktimit të shumës së burimeve financiare që është e mjaftueshme, veçanërisht në lidhje me transferimin dhe delegimin e funksioneve, realisht pengon NJQV-të në mbrojtjen e kësaj të drejte.

6.4 PROJEKTET NË ZHVILLIM PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E PARIMIT TË MJAFTUESHMËRISË FINANCIARE

Projekti “Strengthening Subnational Public Financial Management in Albania”, i financuar nga Qeveria Zvicerane në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka qëllim të zhvillojë menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke synuar evidentimin real të mjaftueshmërisë së burimeve financiare të njësitë të vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e funksioneve.

Projekti “Strong Municipality” i financuar nga Qeveria Zvicerane në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka qëllim të analizojë dhe standardizojë një pjesë të shërbimeve dhe funksioneve të vetëqeverisjes vendore, në mënyrë që për këto funksione të llogaritet kosto e plotësimi të standardeve.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është në proces të hartimit dhe miratimit të një udhëzimi për treguesit e performancës për çdo program - jo më pak se dy tregues performancë të detyrueshëm dhe të unifikuar, në zbatim të ligjit 68/2017. Udhëzimi do hartohet dhe miratohet nga brenda vitit 2019.

Gjetje

Në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Vendore, ashtu si dhe në legjislacionin shqiptar mbi vetëqeverisjen vendore, parimi i mjaftueshmërisë financiare për ushtrimin e funksioneve të

veta e të deleguara ka si kriter të vetëm përpjesëtueshmërinë e burimeve financiare me koston e ushtrimit të tyre. Për rrjedhojë, përbushja e këtij parimi është në varësi të metodologjisë së përlogaritjes ose vlerësimit të koston së ushtrimit të funksioneve.

Në ndryshim nga Karta, ligji 139/2015 parashikon se burimet financiare të vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e funksioneve duhet të jenë të mjaftueshme për të përbushur standardet dhe normat ligjore përkatëse; këto të fundit, për rrjedhojë, duhet të jenë pjesë e koston së ushtrimit të funksioneve. Ky rregullim nuk reflektohet i plotë në ligjin 68/2017, i cili përcakton se burimet e nevojshme financiare kanë madhësinë e koston historike të ushtrimit të funksioneve nga qeverisja qendrore para decentralizimit të tyre; në koston historike, niveli i standardeve dhe normave ligjore që është arritur nga institucioni qendror përkatës nuk është domosdoshmërisht niveli i kërkuar nga ligji. Në këtë mënyrë, në krahasim me ligjin 139/2015, ligji 68/2017 redukton madhësinë potenciale të financimit të mjaftueshëm që qeverisja qendrore duhet të sigurojë për vetëqeverisjen vendore.

Madhësia e transfertës së pakushtëzuar për funksionet e veta nuk është shprehimisht në përpjesëtim me koston e ushtrimit të funksioneve, dhe as në varësi të standardeve ligjore të ushtrimit të tyre, në ligjin 68/2017.

Ligji 139/2015 nuk ka një përkufizim të termit standard dhe norma (minimale) kombëtare të ushtrimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Në veçanti, nuk ka një përcaktim të lidhjes së tyre me politikat kombëtare dhe rajonale; kjo lidhje është e rëndësishme, për sa kohë edhe standardet e normat edhe politikat janë të dyja njëkohësisht baza të parimit të ushtrimit të funksioneve që vendos ligji, ndërsa vetëm standardet e normat janë kriter i mjaftueshmërisë financiare të funksioneve.

Mënyra e sigurimit të përbushjes së parimit të mjaftueshmërisë financiare nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore nuk është e qartë. Veçanërisht, nuk është e qartë masa e përfshirjes së standardeve e normave ligjore të një funksioni në koston e ushtrimit të tij nëpërmjet programit të shpenzimit.

Sistemi i planifikimit financiar të funksioneve të vetëqeverisjes vendore, e për rrjedhojë dhe i administrimit të tyre, nuk ka një drejtim të vetëm e të qartë, i cili të mundësojë vlerësimin e shumës së burimeve financiare që janë të mjaftueshme për ushtrimin e këtyre funksioneve; sistemi drejtohet nga politikat kombëtare dhe rajonale, porse nuk është e qartë si dhe në çfarë mase drejtohet nga standardet dhe normat minimale kombëtare.

Nëpërmjet sistemit të buxhetimit afatmesëm të funksioneve të vetëqeverisjes vendore, baza kryesore e informacionit të MFE-së për koston e ushtrimit të funksioneve të saj vjen nga përlogaritjet dhe vlerësimet e vetë administratës së njëjësive të vetëqeverisjes vendore, ndërsa nuk parashikohen instrumente të drejtpërdrejta të MFE-së për të kryer këto përlogaritje dhe vlerësime.

Raporte të qeverisë qendrore, sipas kërkesës së ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 26 dhe 27, të cilat duhet të japin informacion (dhe të konsultohen në Këshillin Konsultativ) për standardin e ofrimit të shërbimit dhe nivelin e shpërndarjes së tij sipas njëjësive të vetëqeverisjes vendore, nuk janë hartuar asnjëherë deri më sot.

Rekomandime

Rekomandim [94]: Rekomandohet të përkufizohen në ligjin 139/2015 standardet dhe normat (minimale) kombëtare ligjore të një funksioni të vetëqeverisjes vendore, dhe veçanërisht lidhja e tyre me politikat kombëtare dhe rajonale përkatëse të funksionit.

Rekomandim [95]: Rekomandohet të bëhet një shtesë në udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 të ligjit 68/2017 ku të qartësohet mënyra se si standardet dhe normat ligjore të një funksioni

bëhen pjesë e programit të shpenzimeve buxhetore afatmesme dhe e kostos së tij. Në veçanti, rekomandohet të njësohet drejtimi i planifikimit financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore përgjatë ciklit: politika kombëtare dhe rajonale përkatëse të një funksioni – standarde e norma kombëtare të funksionit – qëllimi dhe objektivat e programit të shpenzimeve për funksionin – tregues të performancës së programit të shpenzimeve.

Rekomandim [96]: Rekomandohet të hartohen raportet sipas neneve 26 dhe 27 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Rekomandim [97]: Rekomandohet të rregullohet nëpërmjet një udhëzimi metoda e përlllogaritjes së të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore, e cila mbështet vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare të vetëqeverisjes vendore.

Rekomandim [98]: Rekomandohet që politikat fiskale dhe transferimi i përgjegjësive të reja të cilat kanë efekte financiare të drejtpërdrejta në vetëqeverisjen vendore të shoqërohen me faturë të detajuar financiare dhe proces transparent të llogaritjes së kësaj fature.

Rekomandim [99]: Rekomandohet hartimi i procedurave dhe metodologjisë që rregullojnë transferimet e funksioneve në nivel vendor në mënyrë transparente dhe në konsultim me strukturat konsultative qeveri qendrore – vetëqeverisje vendore.

Rekomandim [100]: Në kuadër të ligjit 139/2015, neni 34, pika 5, rekomandohet hartimi i një plani financiar nga MFE për kompensimin e uljes së të ardhurave të vetëqeverisjes vendore si pasojë e ndryshimit të politikës fiskale në vite.

Rekomandim [101]: Rekomandohet që, pas një periudhe 2-3 vjeçare të zbatimit të ligjit të financave të vetëqeverisjes vendore, të kryhet një analizë e plotë e menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe të hartohen plane për shtesa ose ndryshime të nevojshme të dispozitave ligjore e nënligjore.

Rekomandim [102]: Në kuadër të rolit të tyre monitorues sipas ligjit 139/2015, rekomandohet që këshillat bashkiakë të zhvillojnë kapacitetet njerëzore për të kontribuar nëpërmjet instrumentit të Këshillit Konsultativ në analiza sasiore të gjendjes së financimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore dhe nismave ligjore që vijnë nga qeveria qendrore me ndikim në mjaftueshmërinë e burimeve financiare vendore – transferim, delegim funksionesh ose ndryshim në politikat fiskale kombëtare. Veçanërisht, rekomandohet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të këshillave bashkiakë mbi parimin dhe rregullimin e autonomisë së vetëqeverisjes vendore dhe zbatimit të saj në secilën fushë të funksioneve sipas ligjit 139/2015.

7. PËRFUNDIMI I ANALIZËS

7.1 PËRMBLEDHE MBI GJËNDJEN E AUTONOMISË SË QEVERISË VENDORE

Nëpërmjet shpërndarjes së veprimtarive të administrimit dhe rregullimit të secilit prej funksioneve të vetëqeverisjes vendore ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, qendror dhe vendor, mund të vërehet përqendrimi i përgjegjësive për ushtrimin e tyre në njërin ose në tjetrin nivel.

Kështu, vetëqeverisja vendore përgjithësisht nuk karakterizohet nga elementi i rregullimit të funksioneve të saj, i cili është gjerësisht i përqendruar tek qeveria qendrore, dhe kryesisht tek Këshilli i Ministrave; rregullime të qenësishme nga vetëqeverisja vendore vihen re vetëm në funksionin e transportit publik vendor si dhe në administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollor në çerdhe.

Sa i përket administrimit të funksioneve, vërehet një shpërndarje jo e njëtrajtshme e përgjegjësive ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, në varësi të sektorit.

Funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë qenë historikisht nën përgjegjësinë e tyre nuk kanë sjell zhvillime të qenësishme në objektivat e decentralizimit, mund të përmendim një nga funksionet më të rëndësishme të NJQV, prodhimi, furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura (Neni 23/1/2), i cili përveç rregullimeve kryesore nga institucionet qendrore, përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të funksionit.

Gjithashtu administrimi dhe rregullimi i kopshteve nuk është aspak një kompetencë që mund të konsiderohet si funksion i vet i NJQV-ve. Të gjitha rregullimet dhe pjesa kryesore e administrimit të këtij funksioni kryhen ende nga qeveria qendrore.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake (Neni 23/10), si një nga funksionet historikisht nën përgjegjësinë e NJQV-ve ka pësuar elementë centralizimi, me heqjen e kompetencave të përcaktimit nga NJQV-të, të tarifës së shërbimit.

Nga funksionet e reja të kaluara NJQV-ve, vihet re një rregullim më i përshtatshëm për të ushtruar funksionet nga NJQV-të në mënyrë autonome, se funksionet historikisht nën përgjegjësinë e NJQV-ve. Vlen për t'u përmendur garantimi i shërbimit zjarrfikës (Neni 29/2), administrimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (Neni 27/1), si dhe administrimi i fondit pyjor dhe kullosor (Neni 27/5).

Në të njëjtën kohë shumë funksione të reja të vetëqeverisjes vendore nuk janë shoqëruar ende me ndryshimet ligjore të nevojshme duke vështirësuar ushtrimin e funksioneve nga NJQV-të, vlen për tu përmendur funksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës bujqësore, ku njësitë e qeverisjes vendore janë të ndërvarura ende nga këshillat e qarqeve që kanë kompetenca kryesore për zbatimin e këtij funksioni (inspektimin dhe marrjen e vendimeve për marrjen e masave).

Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit (Neni 27/6), e lidhur ngushtësisht me administrimin, mbrojtjen e tokës bujqësore, administrimin e pyjeve dhe kullotave nuk ka pësuar asnjë ndryshim për të reflektuar fushën e re të përgjegjësive të NJQV-ve, në linjë me ndryshimet në legjislacionin sektorial për shërbimet në fondin pyjor dhe kullosor.

Një nga funksionet që mund të konsiderohet i përzgjedhur nga NJQV-të është funksioni i administrimit të granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural (Neni 27/4). Ligji sektorial parashikon ekskluzivisht Agjencinë e Pagesave si institucionin përgjegjës për administrimin e këtij funksioni.

Mungesa ligjore qenësisht të nevojshme për tu miratuar me qëllim lehtësimin e zbatimit të funksioneve nga NJQV-të vihen re në funksionin e mbledhjes dhe largimit të ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara (Neni 23/3), ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social (Neni 24/2), fusha e kulturës (Neni 25/1/2/3), krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi (Neni 27/3). Gjithashtu, funksionet në fushën e ndërtimit të ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor, dhe administrimi i qendrave të shëndetit publik, kanë nevojë për rregullime në lidhje me planifikim e tyre, për t'i bërë këto funksione të realizueshme.

Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm si dhe mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura

Ky funksion qëndron në të njëjtin nivel centralizimi si më parë, paraqitet tërësisht i rregulluar nga institucionet qendrore, veprimtaritë e planifikimit hartohen dhe zbatohen nga MIE, gjithashtu organizimi i veprimtarive rregullohet nga VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK", dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.", ku përcaktohet mënyra e organizimit të funksionit nëpërmjet shoqërive aksionare.

Kompetencat e NJQV-ve janë të kufizuara dhe përbëhen nga (i) detyrimi i subjekteve për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit, (ii) monitorimi i veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe monitorimi i subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre (iii) monitorimi i shoqërive U.K sh.a, në lidhje me standardet e punës, cilësinë, eficiencën, vazhdimësinë e shërbimit, çmimet, tarifat dhe gjendjen e shërbimit. Për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare, të përcaktuara në legjislacionin përkatës, institucionet qendrore nuk kanë kompetencë për mbikëqyrjen e këtij funksioni nga NJQV-të, por drejtpërdrejtë mbikëqyrin UK sh.a.

Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara

Në këtë funksion problematika kryesore qëndron në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë midis NJQV-ve dhe organeve të menaxhimit të integruar të ujërave. Nevojiten miratimi i planit dhe rregullave për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet, duke ndarë përgjegjësitë midis institucioneve për të mundësuar zbatimin sa më efektiv të funksionit.

Ndriçimi i mjediseve publike

Ndryshimi i rregullave të prokurimit publik duke përcaktuar në dokumente e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë do të bënte të mundur realizimin e efikasitetit energjetikë në përputhje me ligjin për eficiencën e energjisë. Me plotësimin e këtij kuadri ligjor do të rritej cilësia e shërbimit si dhe menaxhimi më i mirë i burimeve financiare për shkak të jetëgjatësisë më të lartë të produkteve që ndikojnë në eficiencën energjetikë.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, parashikon të rregullojë shërbimin e MIM në mënyrë të plotë duke përshkruar të gjitha proceset e nevojshme për kryerjen e shërbimit. Njëkohësisht ligji nr. 8094, datë 21.3.1996 "Për largimi publik të mbeturinave", rregullon disa aspekte për MIM nga NJQV-të, përkatësisht mbledhjen, largimin dhe transportimin e mbetjeve.

Ligji nr. 8094 ka terminologji të ndryshme nga ligji 10463 i cila nuk përputhet me terminologjinë e Direktivës Kuadër për Mbetjet 2008/98 të KE. Mbi parashikimet e ligjit 10463, ligji 8094, përcakton pronësinë e mbetjeve të NJQV-ve si dhe detyrimin e NJQV-ve për lidhjen e kontratave me operatorë privat për kryerjen e shërbimit.

Lidhja e detyrueshme e kontratave me operatorë privat duhet të jetë një kompetencë nën gjykimin e NJQV-ve, si autoriteti që e ushtron funksionin e vet në mënyrë autonome, dhe jo një kompetencë e detyrueshme për to. Është e nevojshme shfuqizimi i ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, përcaktimi i pronësisë së mbetjeve për NJQV-të, caktimi i tarifës së këtij shërbimi nga NJQV-të si dhe dispozita të tjera të nevojshme të këtij ligji të shtohen në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

VKM nr. 608, datë 17.09.2014, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, VKM 418/2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” si dhe VKM 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave për mbetjet”, rregullojnë aspekte të veçanta të zbatimit të ligjit për 10463, ngarkojnë përgjegjësi, vendosin objektiva dhe afatet për përmbushjen e tyre, por karakterizohen nga një veçori e përbashkët lidhur me obligimin e bashkive për të vendosur një sistem me tre kontejnerë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve; në këtë kontekst, këto VKM nuk janë zbatuar pasi kanë mospërputhje - pamundësinë për tu zbatuar dhe mungesën e mbështetjes me financime për çdo akt, përgjegjësi apo objektivi që ato përcaktojnë”. Këto akte për sa i përket objektivave dhe tregueseve për realizimin e tyre dhe afatet e vendosura në to, në shumë raste janë të parealizueshme, pasi janë tejkaluar afatet duke i bërë të pavlefshme. Këto akte duhet të rishikohen, të përditësohen, lidhur me afatet kohore dhe rishikimin e nivelit të synuar të treguesve sipas objektivave. Disa prej tyre nuk janë në përputhje me ligjin për MIM, ndaj është e domosdoshme të bëhet rishpërndarja e përgjegjësi dhe veçanërisht llogaritja e faturës dhe burimet e financimit për veprimet që ato përmbajnë.

VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, dalë në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 10 463, veç shtojcës për llogaritjen e kostove, përmban edhe shtojcën për llogaritjen e tarifave, përkatësisht shtojcat 1 dhe 2 të aktit. Shtojca për llogaritjen e tarifave tejkalon atributet që i jep neni 20 i ligjit nr. 10 463, i cili, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij ka objekt rregullimi vetëm për kostot duke përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së tarifës, dhe duke detyruar NJQV-të për zbatimin e saj, tërthorazi përcaktohen tarifatat duke cenuar autonominë e NJQV-ve, pasi, sipas ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimi publik të mbeturinave” atributi për përcaktimin e tarifave është i NJQV-ve.

Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe

Sistemi arsimor në kopshte është i rregulluar nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Administrimi i funksionit në lidhje me sistemin para arsimor në kopshte është i kufizuar. NJQV-të janë përgjegjëse vetëm për disa veprimtari organizative, planifikimi dhe rregullimi i këtij funksioni kryhet plotësisht nga MASR. NJQV-të dhe njësitë arsimore vendore janë të ngarkuar bashkërisht për regjistrimin e nxënësve në shkolla si dhe për sigurimin në institucionet arsimore publike të mjeteve mësimore.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik

Ky funksion paraqet mungesa ligjore të qenësishme në lidhje me mundësinë e zbatimit të tij. Rregullorja e përgjithshme “Për Kontraktimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor” e dalë në zbatim të nenit 9, pika 4 e ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në RSH”, i ndryshuar, me qëllim rregullimin e organizimit dhe funksionimit të kujdesit shëndetësor parësor, nuk rregullon procedurat e planifikimit, financimit dhe organizimit të funksionit për NJQV-të. Për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor, nevojiten kriteret, procedurat për marrjen e nismës për hapje, mbyllje dhe rehabilitim të këtyre ndërtesave, standardet ndërtimore të këtyre ndërtesave etj.

Në lidhje me administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve të shëndetit publik, në legjislacionin në fuqi nuk rregullohen përgjegjësitë e NJQV dhe institucioneve të tjera të përfshira. Aktualisht NJQV-të nuk administrojnë asnjë qendër ofruese të shërbimeve të shëndetit publik.

Fusha e shërbimeve sociale

Krijimi, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve

Për procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social, është miratuar VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social". Në këtë VKM përcaktohen burimet financiare për krijimin e fondit, ndërsa nuk përcaktohen mënyra e funksionimit të tij, konkretisht nuk përcaktohet (i) mënyra e shpërndarjes së fondit (kriteret) tek NJQV-të bazuar në planet përkatëse sociale të buxhetuara, (ii) autoriteti/et përgjegjës për miratimin e shpërndarjes së tij, duke mos përmbushur objektin e saj. Në këtë VKM trajtohen mënyrat e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet organizatave joftimprurëse dhe ofruesve privatë, në kushtet kur NJQV-të nuk mund të ofrojnë këto shërbime nëpërmjet fondit social, duke tejkaluar objektin e saj në bazë dhe për zbatim të ligjit. Gjithashtu, në këtë VKM nuk përcaktohet (iii) mënyra e bashkëpunimit midis autoriteteve qendrore dhe vendore për administrimin e fondit social. Kjo VKM nuk përmbush qëllimin e saj.

Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social

Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", nuk është shoqëruar ende nga aktet ligjore në zbatim të tij. Gjithashtu aktet e ligjit të mëparshëm nuk janë lënë në fuqi në dispozitat kalimtare, duke e lënë këtë funksion aktualisht të pa zbatueshëm në disa komponentë.

Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve

Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", është ligji bazë që rregullon funksionet e NJQV-ve në fushën e kulturës duke përcaktuar kompetencat. Ky ligj nuk është shoqëruar ende me aktet nënligjore në zbatim të tij. Në pjesën e raportit të rregullimeve të funksionit më sipër asnjë akt nënligjor nën përgjegjësinë e KM dhe MK nuk rezulton i miratuar duke sjell problematika në zbatimin e detyrimeve për NJQV-të.

Fusha e mbrojtjes së mjedisit

Sigurimi, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.

Për sigurimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, NJQV-së nuk i jepen kompetenca për matje, kontroll dhe monitorim të treguesve përkatës, për rrjedhojë, masat që mund të sigurojnë NJQV-të mbeten të kufizuara.

Në lidhje me aktivitetet e personave fizikë, juridikë që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj, NJQV-ja nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e ndotjes mjedisore.

Mbetet e nevojshme zgjerimi i kompetencave të NJQV-ve në lidhje me sigurimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, duke i shtuar kompetenca për kryerjen e matjes, kontrollit, monitorimit si dhe vendosja e masave administrative.

Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit

Administrimin dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme

Ndryshimet e fundit në legjislacionin sektorial për këtë funksion janë kryer më tetor të 2014, përpara miratimit të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015. Gjithashtu këto ndryshime nuk janë të ndikuara nga miratimi i ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të

qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky funksion paraqitet me një ndërvarësi të drejtpërdrejt të NJQV-ve nga institucionet qendrore, madje edhe varësi nga Këshilli i Qarkut, duke cenuar parimin e autonomisë vendore.

Këshilli i Qarkut kryen ende drejtimin teknik dhe administrativ të strukturave shtetërore në territorin e qarkut, duke dhënë vendime të detyrueshme për t'u ndërmarrë nga NJQV-të. Këshillat e qarqeve ushtrojnë inspektimit nëpërmjet IMT edhe pse strukturave të tyre i është reduktuar personeli, veçanërisht personeli i IMT-së.

Mbetet e nevojshme ndryshimi i legjislacionit sektorial, me qëllim kalimin e përgjegjësive të këshillave të qarqeve NJQV-ve.

Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor

Ky funksion nuk është i rregulluar nga legjislacioni sektorial. Krijimi i programeve për bujqësinë dhe zhvillimin rural, administrohen ekskluzivisht nga MBZHR-ja, nëpërmjet Agjencisë së Pagesave.

Duke u parashikuar agjencia e pagesave, si organ ekskluziv për administrimi e programeve, NJQV-të nuk mund të aplikojnë këtë funksion në kundërshtim me përgjegjësinë e ngarkuar në ligjin 139/2015.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullësor publik

Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar nuk është shoqëruar ende me disa akte nënligjore në zbatim të tij, duke sjellë problematika në zbatimin e detyrimeve për NJQV në këtë funksion.

Në lidhje me monitorimin e aktiviteteve të personave fizikë, juridikë që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj, NJQV-ja nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e kundërvajtjeve në sektorin e pyjeve dhe kullotave. Strukturat e pyjeve dhe kullotave janë të detyruar në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve të njoftojnë policinë pyjore për vënien e masave administrative, në këtë mënyrë hasen vonesa ose moszbatim të masave administrative duke e bërë mbrojtjen e fondeve pjesërisht të pa efektshëm.

Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

Ligj për mbrojtjen e biodiversitetit, përcakton bashkërisht organet shtetërore (vendore dhe qendrore), duke sjellë paqartësi në ndarjen e përgjegjësive dhe rrjedhimisht paqartësi në ndarjen e përgjegjësive. Në këto kushte përballemi me mungesa në koordinim e veprimtarive si dhe të mënyrës së shpërndarjes së fondeve të nevojshme për të përmbushur funksionin

SHTOJCA A: REKOMANDIME PËR RREGULLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKTORIAL

PRODHIMI, TRAJTIMI, TRANSMETIMI DHE FURNIZIMIN ME UJË TË PIJSHËM (NENI 23/1), DHE MBLEDHJA LARGIMI DHE TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA (NENI 23/2)

GJETJE DHE REKOMANDIME							
Përkufizimi i Funksionit		Administrimi i Funksionit				Monitorimi dhe Vlerësimi	
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, përkufizon termin "prodhimi i ujit" që ka të bëjë me të gjitha burimet natyrore të ujit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuiferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky term është i paqartë jo shterues.		VKM-së nr. 643, datë 14.09.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve" i ka kaluar afatit për përbashkjen e objektivave të përcaktuara në të. Ky sektor aktualisht është pa strategji.		VKM nr. 431 në pikën 13/g përcakton AKUKM përgjegjës për të mbështetur politikëbërësit për hartimin dhe zbatimin e akteve nenligjore e të procedurave për procesin e kallimit të administrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë nga pushteti vendor në atë qendror, në rastet e mos përbashkjes së detyrimeve kontraktuale, sipas kontratës së performancës, të lidhur ndërmjet palëve. Ky parashikim është në kundërshtim me objektivat kryesorë të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 si dhe me Kartën Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore ku theksohet që qeverisja vendore duhet të jetë sa më e lirë dhe e pavarur sa të jetë e mundur gjatë ushtrimit të përgjegjësi të tyre publike, dhe të decentralizohen deri në atë nivel qeverisës që është më i afërt me popullatën. Ky pushtet i dhënë do të jetë sa më ekskluziv që të jetë e mundur dhe nuk do të kufizohet apo zhvlerësohet përmes mospërputhjeve të legjislacionit. Pavarësisht se forma të centralizimit mund të konsiderohen të arsyeshme ng		Ligji 8102 në nenin 14 i njeh ERRU kompetencë për inkurajimin e standardeve dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin. Termi "inkurajim" krijon paqartësi pasi kjo kompetencë e ERRU nuk mund të konsiderohet si e detyrueshme për NIQV-të.	
Rekomandim [1]: Rekomandohet përkufizimi i termit "prodhimi i ujit" në mënyrë më shteruese, përkufizim i bërë nga ligji 8102 nuk është i kuptueshëm. Një përkufizim për këtë term mund të jetë: tërësia e proceseve inxhinierike të projektimit, zhvillimit, zbatimit, operimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit për shfrytëzimin e të gjitha burimeve natyrore të ujit, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuiferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore deri në nxjerrjen e një produkti me normat e caktuara nga legjislacioni sektorial ose në një formë tjetër teknikiisht të përshatshme.		Rekomandim [3]: Rekomandohet rishikimi, përditësimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.		Rekomandim [5]: Rekomandohet shfuqizimi i pikës 13/g të VKM-së 431.		Rekomandim [8]: Rekomandohet riformulimi i nenit 14 i ligjit 8102, në mënyrë që përkufizimi i kësaj kompetence të ERRU të jetë shteruese.	
Ligji nr. 8102 nuk përkufizon termin "transmetim", këtë term mund ta kuptojmë si procesi i transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm pas prodhimit dhe trajtimit.		KM si kërkesë e ligjit Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar; është përgjegjës për shpalljen e zonave të mbrojtura higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm. Ky vendim nuk rezulton të jetë miratuar.		VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për Miratimin e Modelit të Rregullores "Për Furnizimin me Ujë dhe për Kanalizimet në Zonën e Shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve Sh.a." nuk ka dalë si kërkesë e ligjit dhe për rrjedhojë është në kundërshtim me Nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, i jep KM të drejtën e miratimit të politikave dhe strategjive kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura; në asnjë moment në këtë ligj nuk parashikohet që KM të miratojë rregulloren për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a. Ndosur në këto kushte kjo VKM bie ndesh me ligjin 139/2015, pasi nuk mund t'i njihen njësi të vetëqeverisjes vendore funksione apo kompetenca pa u bazuar në ligj (neni 21/2,3 ligjit 139/2015).		Siç mund të vërehet nga skema për monitorim dhe vlerësimin e funksionit asnjë autoritet nuk monitoron NIQV-të si autoritet përgjegjës në bazë të ligji të saj organik për ofrimin e këtij funksioni.	
Rekomandim [2]: Rekomandohet përkufizimi i termit "transmetim".		Rekomandim [4]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për shpalljen e zonave të mbrojtura higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm.		Rekomandim [6]: Rekomandohet shfuqizimi i VKM nr. 1304. Nëse disa të drejta dhe detyrimet të përcaktuara në VKM nr. 1304 vlerësohen të nevojshme për kryerjen në më tërësi të funksionit të PTFUP dhe MLTUN, rekomandohet që këto kompetenca të miratohen nga ERRU, që nxjerr rregulla për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuar në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Gjithashtu duhet mbajtur parasysh që disa nga rregullimet e kësaj VKM-je si mënyra e organizimit të UK-sha shkelin autonominë e NIQV-ve për mënyrën e administrimit të funksionit duke i dhënë detyrime në tejkalim të atribueteve që jep ligji sektorial dhe neni 32 "Administrimi i shërbimeve publike" në ligjin 139/2015.		Rekomandim [9]: Rekomandohet që ERRU si institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e këtij funksioni të monitorojë përveç operatorit UK-sha edhe NIQV-në në lidhje me përgjegjësinë e saj për ofrimin e këtij shërbimi. Ky rekomandim kërkon që në ligjin organik të ERRU të bëhet një ndarje e qartë e kompetencave të NIQV-së për këtë funksion, si dhe për trajtimin e UK-sha, ndërmarrjeve shtetërore apo çdo instrument tjetër të zgjedhur nga NIQV sipas mënyrës më të përshatshme të vendosur prej saj për ofrimin e shërbimit.	
				VKM-ja nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK" nuk ka dalë si kërkesë e ligjit në kundërshtim me Nenin 118 të Kushtetutës së Shqipërisë. Kjo VKM bie ndesh me ligjin 139/2015, pasi nuk mund t'i njihen NIQV-ve funksione apo kompetenca pa u bazuar në ligj (neni 21/2,3 ligjit 139/2015). Rregullimet e kësaj VKM-je për mënyrën e organizimit të UK-sha shkelin autonominë e NIQV-ve për të drejtën e vendosjes së mënyrës së administrimit të funksionit dhe bien ndesh me parashikimet e neni 32 "Administrimi i shërbimeve publike" në ligjin 139/2015.		Në përmbledhje të rekomandimeve të shumta të hasura në këtë sektor, duke qenë se vërehen mungesa dhe mospërputhje si në administrim, rregullim dhe në monitorim dhe vlerësim, mund të konsiderohet e arsyeshme hartimi dhe miratimi i një ligji të ri sektorial.	
				Rekomandim [7]: Rekomandohet shfuqizimi i VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK".		Rekomandim [10]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i një ligji të ri sektorial duke përcaktuar qartësisht përgjegjësitë e institucioneve të përfshira, në një model të përafërt me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.	

MBLEDHJA DHE LARGIMI I UJËRAVE TË SHIUT DHE MBROJTJA NGA PËRMBYTJET NË ZONAT E BANUARA (NENI 23/3)

GJETJE DHE REKOMANDIME				
Përkufizimi i Funkcionit		Administrimi i Funkcionit		
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mbivendosje Ligjore
Nuk ka legjislacion sektorial që rregullon këtë pjesë të funksionit. Termi “mbledhje dhe largim të ujërave të shiut” nuk përkufizohet në legjislacionin sektorial për ujërat.		Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar në nenin 70 ngarkon KM, me propozimin e ministrit përgjegjës për emergjencat civile, pas miratimit paraprak nga KKKU, të miratojë aktin nënligjor për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, të hartuara nga AMBU.		Neni 68, pika 2 e ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, ngarkon organet e menaxhimit dhe administrimit burimeve ujore në bashkëpunim me organet e NJQV-ve me përgjegjësi parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktohet nga përmbytjet. Ngarkimi njëkohësisht i dy organeve qeverisëse sjell për paqartësi në ndarjen e përgjegjësi dhe rrjedhimisht paqartësi në ndarjen e fondeve financiare të nevojshme ndërmjet tyre. Duke marrë parasysh mbrojtja nga përmbytjet realizohet kryesisht nëpërmjet marrjes së masave të sigurimit, dhe veprimeve të ndërvarura nëpërmjet institucioneve kjo shtetërisht mund të sjell problematika. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisje vendore” në ndryshim nga ligji i mëparshëm heq ndarjen në “funsione të përbashkëta”. Ky ndryshim vjen në përputhje me Kushtetutën dhe cila nuk e njeh konceptin e “funsionit të përbashkët” midis qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore. Kjo praktikë
Rekomandim [11]: Rekomandohet përkufizimi i termit “mbledhje dhe largim të ujërave të shiut” në mënyrën si më poshtë ose në një mënyrë teknikisht më të përshtatshme.		Rekomandim [12]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet. Në këtë VKM të përcaktohen udhëzimet për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, standardet si dhe institucionet dhe mjetet për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të funksionit.		Rekomandim [14]: Rekomandohet ndryshimi i paragrafit 2 i nenit 68 të ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar përcaktohen qartë përgjegjësitë e organeve menaxhuese dhe administrimit burimeve ujore dhe përgjegjësitë e NJQV-ve.
		Mbledhja, largimi i ujërave të shiut nuk ka standarde të drejtpërdrejta ndërtimi.		
		Rekomandim [13]: Rekomandohet që MIE në përputhje me fushën e përgjegjësisë së saj për vendosjen e standardeve ndërtimore të miratojë standarde ndërtimore specifike për këtë pjesë të funksionit.		

NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE VENDORE DHE SINJALIZIMI RRUGOR, TË TROTUAREVE DHE SHESHEVE PUBLIKE VENDORE (NENI 23/4)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funksionit

Mungesë Ligjore

NP

Udhëzimi për përcaktimin e normave për përmasat, karakteristikat, vendvendosjen e mjeteve reklamuese përgjatë rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës dhe në stacionet e shërbimit dhe furnizimit me karburant nuk rezulton i miratuar nga MIE.

Rekomandim [15]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për përcaktimin e normave për përmasat, karakteristikat, vendvendosjen e mjeteve reklamuese përgjatë rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës dhe në stacionet e shërbimit dhe furnizimit me karburant.

Udhëzimi për përcaktimin e kriterëve për hartimin dhe përditësimin e Planeve Urbane dhe Interurbane të Trafikut nuk rezulton i miratuar.

Rekomandim [16]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për përcaktimin e kriterëve për hartimin dhe përditësimin e Planeve Urbane dhe Interurbane të Trafikut.

NDRIÇIMI I MJEDISEVE PUBLIKE (NENI 23/5)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funksonit

Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
Udhëzimi për përcaktimin e standardeve teknike ndërtimore për këtë funksion nuk rezulton të jetë miratuar nga MIE.		Ligji nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë", në nenin 9 të tij parashikon përfshirjen në rregullat e prokurimit publik parashikime, të cilat detyrojnë autoritetet kontraktore që të përcaktojnë në dokumentet e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, specifikime teknike, që përmbushin kërkesat minimale të eficiencës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nuk rezulton e ndryshuar me këto elementë.		Në lidhje me ndriçimin e hapësirave publike në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë nuk janë parashikuar objektiva individuale për kursimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj.	
Rekomandim [17]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit të MIE për përcaktimin e standardeve teknike ndërtimore për këtë funksion.		Rekomandim [19]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", për tu përshtatur me kërkesat e ligjit nr. 124/2015.		Rekomandim [21]: Rekomandohet përfshirja në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë objektivi lidhur me ndriçimin e mjediseve publike, si një sektor që kryesisht përfshihet si konsumator i madh energjie elektrike.	
VKM-ja për miratimin e standardeve dhe normave, që synojnë, para së gjithash, në përmirësimin e eficiencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmirësimet në ndërtesat nuk rezulton e miratuar.		VKM-ja për miratimin e kategorive, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë nuk rezulton e miratuar.			
Rekomandim [18]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e standardeve dhe normave, që synojnë, para së gjithash, në përmirësimin e eficiencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve.		Rekomandim [20]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e kategorive, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë.			

TRANSPORTI PUBLIK VENDOR (NENI 23/6)

GJETJE DHE REKOMANDIME					
Përkufizimi i Funksionit		Administrimi i Funksionit			
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP
Transporti publik vendor rrugor, nuk përkufizohet në ligjin 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, por nënkuptohet që përfshinë transportin qytetës dhe rrethqytetas.		Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, në nenin 85 parashikon që KM përcakton masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e tarifave të transportit publik për udhëtarët që përfitojnë lehtësira në bazë të ligjeve të veçanta. Kjo VKM nuk rezultoi e miratuar.		Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar ka pësuar disa ndryshime gjatë viteve. Këto ndryshime kanë sjellë përdorime të termave të ndryshëm për të njëjtin qëllim. Në ligj janë lënë terma të përgjithshëm për rregullimin e shërbimeve të transportit rrugor. Ligji shfaq shumë paqartësi, është i pandarë në kapituj dhe shpesh nuk ka referenca të qarta në kalimin nga një nen në tjetrin. Gjithashtu në ligj mungojnë përkufizime si "transporti publik vendor rrugor".	
Rekomandim [22]: Rekomandohet të përkufizohet termi "transporti publik vendor rrugor", duke bërë një ndarje të qartë të funksioneve të veta të NJQV-ve dhe funksioneve të deleguara si shërbime të rregullta, të specializuara, transporte për llogari të vet dhe transporte të rastit.		Rekomandim [23]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e masave, kriterëve dhe procedurave për kompensimin e tarifave të transportit publik për udhëtarët që përfitojnë lehtësira në bazë të ligjeve të veçanta.		Rekomandim [24]: Rekomandohet hartimi i një ligji të ri për transportet rrugore i cili të jetë i qartë, i njëtrajtshëm në terminologjinë e shprehur në të gjithë dispozitat e tij, termat kryesore të përkufizohen, të jetë i ndarë në kapituj sipas tematikës, në përputhje edhe me përkufizimet e ligjeve të tjera në fuqi, dhe veçanërisht të përcaktojë qartë autoritetin rregullator dhe monitorues të NJQV-ve.	

NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMI I SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT (NENI 23/7)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funkcionit

Mungesë Ligjore

NP

Udhëzimi për përcaktimin e kriterëve të licencimit të agjencive të shërbimit të varrimit nuk rezulton i miratuar.

Rekomandim [25]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit të MIE përcaktimin e kriterëve të licencimit të agjencive të shërbimi të varrimit.

MBLEDHJA, LARGIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE TË NGURTA SHTËPIAKE (NENI 23/10)

GJETJE DHE REKOMANDIME							
Përkufizimi i Funksonit		Administrimi i Funksonit					
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP
Ligj nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" nuk përkufizon termat mbledhje dhe largim të mbetjeve të ngurta bashkiake ose përndryshe shtëpiake dhe të ngjashme. Ky ligj nuk parashtron përgjegjësitë e NIQV-ve për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to.		Në zbatim të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, KM miraton aktet e mëposhtme: - Specifikimet e rasteve të përgjegjësisë së krijuesit të mbetjeve; - Masat për hartimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve; - Masa për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve; - Rregullat për garancitë që duhet të ofrohen në lidhje me lejet e mjedisit për lëndfilllet; - Rregullat dhe specifikimet për incinerimin e mbetjeve, procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre; - Normat teknike minimale për operacionet e trajtimit të mbetjeve.		Në veçanti, disa VKM janë hartuar dhe janë miratuar në zbatim të ligjit nr. 10 463. Vlen të përmenden disa prej tyre si p.sh.: VKM nr. 608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; VKM 418/2014 "për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM 687/2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave për mbetjet". Këto akte trajtojnë aspekte të veçanta të zbatimit të ligjit për 10 463, ngarkojnë përgjegjësi, vendosin objektiva dhe afatet për përbushjen e tyre, por karakterizohen nga një veçori e përbashkët lidhur me detyrimin e NIQV-ve për të vendosur një sistem me tre kontejnerë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve; në këtë kontekst, këto VKM nuk janë zbatuar pasi kanë mospërputhje - pamundësi për tu zbatuar dhe mungesë të mbështetjes me financime për çdo akt, përgjegjësi apo objektivi që ato përcaktojnë. Gjithashtu, këto akte përsa i përket objektivave dhe treguesve për realizimin e tyre dhe afatet e vendosura në këto akte në shumë raste janë tejkaluar duke i bërë ato të pa zbatueshme.		VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", dalë në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 10 463, veç shtojcës për llogaritjen e kostove, përmban edhe shtojcën për llogaritjen e tarifave, përkatësisht shtojcat 1 dhe 2 të akteve. Shtojca për llogaritjen e tarifave tejkalon atributet që i jep neni 20 i ligjit nr.10 463, i cili, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij ka objekt rregullimi vetëm për kostot. Nga ana tjetër, duke përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së tarifës, dhe duke detyruar NIQV-të për zbatimin e saj, nëpërmjet kësaj VKM-je përcaktohen tarifat. Në këtë mënyrë, përcaktimi i metodologjisë së tarifës cenon autonominë e NIQV-ve, pasi, sipas ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 "Për largimi publik të mbeturinave" atributi për përcaktimin e tarifave është i NIQV-ve.	
Rekomandim [26]: Rekomandohet përkufizimi i termave "mbledhje dhe largim i mbetjeve të ngurta urbane" dhe parashtrimi i përgjegjësisë të NIQV-ve për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake në ligjin 10 463.		Rekomandim [27]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për specifikimet e rasteve të përgjegjësisë së zgjeruar të krijuesit të mbetjeve.		Rekomandim [33]: Rekomandohet rishikimi dhe përditësimi i VKM nr. 608/2014, VKM 418/2014, VKM 687/2015, lidhur me afatet kohore dhe rishikimin e nivelit të synuar të treguesve sipas objektivave. Disa prej tyre nuk janë në përputhje me ligjin për MIM, ndaj është e domosdoshme të bëhet rishpërndarja e përgjegjësisë dhe veçanërisht llogaritja e faturs dhe burimet e financimit për veprimet që ato përmbajnë.		Rekomandim [34]: Rekomandohet të bëhen shtesa në Shtojcën 2 të VKM nr. 319, datë 31.5.2018, duke i lejuar NIQV-të të disponojnë lirinë në caktimin e tarifave.	
		Rekomandim [28]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për masat për hartimin dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.				Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar nje Kryetarit e Bashkisë si autoritetin përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të NIQV, në kundërshtim me ligjin 139 i cili nje NIQV-ve përgjegjës për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.	
		Rekomandim [29]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për masat për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve.				Rekomandim [35]: Rekomandohet ndryshimi i nenin 21, pika 12, të ligjit 10463/2011, ku përgjegjësia të ndryshojë nga Kryetari i NIQV-së të NIQV-ja.	
		Rekomandim [30]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për përcaktimin e rregullave për garancitë që duhet të ofrohen në lidhje me lejet e mjedisit për lëndfilllet.				Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, parashikon të rregullojë shërbimin e MIM në mënyrë të plotë duke përshkruar të gjitha proceset e nevojshme për kryerjen e shërbimit. Njëkohësisht ligji nr. 8094, datë 21.3.1996 "Për largimi publik të mbeturinave", rregullon disa aspekte për MIM nga NIQV-të, përkatësisht mbledhjen dhe largimin dhe transportimin e mbetjeve.	
		Rekomandim [31]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për përcaktimin e rregullave dhe specifikimeve për incinerimin e mbetjeve, procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre.				Rekomandim [36]: Rekomandohet shfuqizimi i ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 "Për largimin publik të mbeturinave", përcaktimi i pronësisë së mbetjeve për NIQV-të, caktimi i tarifës së këtij shërbimi nga NIQV-të si dhe dispozita të tjera të nevojshme të këtij ligji të shtohen në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.	
		Rekomandim [32]: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i VKM-së për përcaktimin e normave teknike minimale për operacionet e trajtimit të mbetjeve.					

NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE TË SISTEMIT SHKOLLOR PARAUNIVERSITAR, ME PËRJASHTIM TË SHKOLLAVE PROFESIONALE (NENI 23/11)

GJETJE DHE REKOMANDIME			
Përkufizimi i Funkcionit		Administrimi i Funkcionit	
Mungesë Ligjore	NP	Mbivendosje Ligjore	NP
<p>Mirëmbajtja e ndërtesave sipas përkufizimeve në kuptim të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar nuk përfshin veprimtaritë e sigurimit të kushteve higjieno-sanitare, të ruajtjes, ndriçimit dhe të ngrohjes së ndërtesave.</p> <p>MIRËMBAJ kal. - Tregoj vazhdimisht kujdes për diçka (për një makinë, për një vegël, për një ndërtesë etj.) për ta mbajtur në gjendje të mirë, për t'i zgjatur kohën e përdorimit etj., mbaj mirë e pastër.</p> <p>Sipas këtij përkufizimi, mirëmbajtja preventive, sigurimi i kushteve higjieno-sanitare dhe ruajtja e ndërtesave mund të jenë veprimtari e mirëmbajtjes, ndërsa veprimtaritë e ndriçimit apo të ngrohjes së ndërtesave nuk mund të përfshihen në mirëmbajtje, por mund të përcaktohen si veprimtari operacionale.</p> <p>Rekomandim [37]: Rekomandim [37]: Rekomandohet të përcaktohet qartë përkufizim i termit “mirëmbajtje” me qëllimin bërjen të mundur dallimin nëse janë pjesë e funksionit sipas ligjit 139/2015, apo nëse përbëjnë pjesë të një funksioni të deleguar, kompetencat e mëposhtme të NJQV:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Garantimi i paprekshmërisë e institucioneve arsimore si dhe mjediset e tyre; - Ruajtja e institucioneve arsimore publike; - Garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godina; - Mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore. 		<p>Sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 662, datë 8.10.2014 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike” NJQV-të me propozim të përbashkët të njësisë arsimore vendore propozojnë ndërtimin e një ndërtese të sistemit arsimor parauniversitar të ri.</p> <p>Rekomandim [38]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 662 duke mënjanuar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës për propozimin e hapjes së institucioneve të reja arsimore parauniversitare publike.</p>	

ADMINISTRIMI DHE RREGULLIMI I SISTEMIT ARSIMOR PARASHKOLLOR NË KOPSHTË DHE ÇËRDHE (NENI 23/12)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funkcionit

Mbivendosje Ligjore	NP	Mbivendosje Ligjore	NP
<p>Sistemi arsimor në kopshte është i rregulluar nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, administrimi dhe rregullimi që ligji 139 i ngarkon NJQV është i kufizuar. NJQV-ja sipas ligjit 69/2012 është përgjegjëse vetëm për disa veprimtari organizative; planifikimi dhe rregullimi i këtij funksioni kryhet plotësisht nga MASR.</p>		<p>NJQV dhe njësia arsimore vendore janë të ngarkuar bashkërisht për sigurimin në institucionet arsimore publike të mjeteve mësimore.</p>	
<p>Rekomandim [39]: Rekomandohet shfuqizimi i akteve që rregullojnë funksionin e administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>		<p>Rekomandim [41]: Rekomandohet shfuqizimi i germës ç të pikës 4, të nenit 30 i ligjit nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për heqjen e përgjegjësisë njësive arsimore vendore për këtë kompetencë ose shfuqizimi i i germës ç të pikës 4, të nenit 28, për heqjen e përgjegjësisë NJQV-ve, për të mënjeluar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës.</p>	
<p>NJQV dhe njësia arsimore vendore janë të ngarkuar bashkërisht për regjistrimin e nxënësve në shkolla sipas parashikimit në Ligjin nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>			
<p>Rekomandim [40]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 28, pika 3 e ligjit nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mënjeluar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës.</p>			

NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE TË SHËRBIMIT PARËSOR SHËNDETËSOR DHE ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE EDUKUESE E PROMOVUESE NË NIVEL VENDOR, TË CILAT LIDHEN ME MBROJTJEN E SHËNDETIT, SI DHE ADMINISTRIMI I QENDRAVE E TË SHËRBIMEVE TË TJERA NË FUSHËN E SHËNDETIT PUBLIK (NENI 23/13)

Administrimi i Funkcionit			
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor			
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
<p>Në zbatim të nenit 9, pika 4 e ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në RSH", i ndryshuar, me qëllim rregullimin e organizimit dhe funksionimit të kujdesit shëndetësor parësor është miratuar "Rregullorja e Përgjithshme për Kontraktimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor". Kjo rregullore nuk përcakton procedurat e planifikimit, financimit dhe organizimit të funksionit të NIQV-ve për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor.</p>		<p>Sipas nenit 5, pika 2, germa b e ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në RSH", i ndryshuar, NIQV-të janë përgjegjëse për administrimin e objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në pronësi të tyre. Termi administrim në këtë ligj është i pa përkufizuar dhe mund të interpretohet shumë gjerë apo ndryshe nga përkufizimi në ligjin 139/2015.</p>	
<p>Rekomandim [42]: Rekomandohet, përcaktimi në rregulloren e përgjithshme "Për Kontraktimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor" i procedurave për mënyrën e planifikimit, financimit dhe organizimit duke rregulluar veçanërisht kriteret dhe procedurat për nismën për hapje, mbyllje dhe rehabilitim të këtyre ndërtesave.</p>		<p>Rekomandim [44]: Rekomandohet të përkufizohet termi "administrim" i objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor në ligjin nr. 10 107, e të harmonizohet në përputhje me përgjegjësinë për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e tyre, të përcaktuar në nenin 23, pika 13 e ligjit 139/2015.</p>	
<p>Në lidhje me standardet ndërtimore të ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor nuk gjendet ndonjë akt që përcakton këto standarde.</p>		<p>Sipas nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 10 107, NIQV-ja merr masa për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor, në koordinim me MSHMS. Ky funksion nuk përputhet me fushën e përgjegjësisë të parashikuar në ligjin 139/2015, për rrjedhojë është funksion i deleguar. Njëkohësisht, nuk përcaktohen masat konkrete që duhet të marrë NIQV-të për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor.</p>	
<p>Rekomandim [43]: Rekomandohet përcaktimi me akt të veçantë standardet ndërtimore të ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor.</p>		<p>Rekomandim [45]: Rekomandohet të përcaktohen masat konkrete për t'u ndërmarrë nga NIQV-të për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, gjithashtu parashikimi i fondit të nevojshëm për financimin e këtyre shërbimeve, si funksion i deleguar.</p>	

Administrimi i Funkcionit			
Administrimi i qendrave dhe shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik			
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
<p>Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar, funksionet e strukturave rajonale të shëndetit publik mund të realizohen edhe përmes projekteve të veçanta, në bashkëpunim me NIQV-të e me pjesëmarrës të tjerë të sistemit të shëndetit publik. Mbi këtë bazë NIQV-të mund të ushtrojnë veprimtarinë për administrimin e shërbimeve të shëndetit publik të tjera, veçmas promovimit të shëndetit dhe edukimit shëndetësor. Në lidhje me administrimin e qendrave për ofrimin e këtyre shërbimeve, në legjislationin në fuqi nuk rregullohen përgjegjësitë e NIQV-ve dhe institucioneve të tjera të përfshira.</p>		<p>Sipas informacionit në faqen zyrtare të MSHMS-së, NIQV-të aktualisht nuk administrojnë asnjë qendër ofruese të shërbimeve të shëndetit publik. Shërbimet e shëndetit publik mbështeten dhe mbikëqyren nga ISHP. Krahas tyre, ofruet të këtyre shërbimeve janë edhe një sërë institucionesh kombëtare si Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku, Qendra Kombëtare e Mirëritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijës, Klinika Stomatologjike Universitare, etj. I vetmi rast i një qendre të tillë me pjesëmarrjen e NIQV për këto shërbime është rasti i krijimit si projekt pilot i Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR) të Tiranës me VKM nr. 394, datë 27. 7.2000 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e autoritetit", i shfuqizuar me VKM nr. 419, datë 4.7.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor".</p>	
<p>Rekomandim [46]: Rekomandohet rregullimi i administrimit të qendrave për ofrimin e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, baza ligjore në fuqi të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e NIQV-ve në këtë funksion.</p>		<p>Rekomandim [47]: Duke qenë se shumë shërbime të NIQV-ve kanë nevojë të mbështeten me instrumente dhe fonde për mbrojtjen e shëndetit publik, të tilla si, sigurimi dhe kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm, monitorimi i kanalizimeve, monitorimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake si dhe shërbimet e NIQV-ve në fushën e mjedisit dhe mbrojtjes së tokës dhe biodiversitetit, rekomandohet zhvillimi i një strategjie për implementimin e krijimin të këtyre qendrave me pjesëmarrje e NIQV.</p>	

PLANIFIKIMI, ADMINISTRIMI, ZHVILLIMI DHE KONTROLLI I TERRITORIT (NENI 23/14)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funkcionit

Mungesë Ligjore

NP

184

Ndryshimi i dokumenteve të planifikimit në hierarki më të lartë se plani i përgjithshëm vendor mund të sjellë nevojën për rishikimin e këtyre të fundit, me qëllim harmonizimin e zhvillimit. Nenin 12 i VKM-së nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” përcakton procedurën që duhet të ndiqet nga NJQV-të për të kryer rishikimin. Disa prej procedurave të këtij neni, si konsultimi dhe takimet me publikun, përmbushen gjatë hartimit të dokumentit të planifikimit të hierarkisë më të lartë.

Rekomandim [48]: Rekomandohet të kryhen shtesa në VKM-në nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, duke përcaktuar një procedurë më të thjeshtuar për rastet e rishikimi si më sipër të planeve të përgjithshme vendore.

KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE, NË NIVEL VENDOR, PËR SHITRESAT NË NEVOJË, PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, FËMIJËT, GRATË, GRATË KRYEFAMILJARE, GRATË E DHUNUARA, VIKTIMA TË TRAFIKUT, NËNA APO PRINDËR ME SHUMË FËMIJË, TË MOSHUARIT ETJ., SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ.. (NENI 24/1), NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E QENDRAVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE VENDORE (NENI 24/3), KRIJIMIN, NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR MIRËQENIEN SOCIALE, TË FONDIT SOCIAL PËR FINANCIIMIN E SHËRBIMEVE, SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ (NENI 24/4)

GJETJE DHE REKOMANDIME					
Administrimi i Funksonit			Monitorimi dhe Vlerësimi		
Administrimi i ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara					
Mospërputhje Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP
<p>Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, në lidhje me përfitimën e ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësi të kufizuar nëpërmjet sistemit të pikëzimit, parashikon që Strukturat rajonale të SHSSH miratojnë ose refuzojnë që familja/individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit; gjithashtu Komisionit Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë miraton personat përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar, ndërsa VKM nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", përcakton kriteret dhe masën e përfitimit.</p> <p>Ndërkohë këshillat bashkiakë miratojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - propozimin që familja/individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit; - fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuara; - pagesën e personave me aftësi të kufizuara. <p>Gjithashtu strukturat pranë NIQV kanë këto përgjegjësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Harton projektvendimin për familjet/individët në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike dhe përlogarit fondin për mbulimin e tyre; - Paraqet në këshillin bashkiak projektvendimin për propozimin për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit; - Harton projektvendimin për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar; - Harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara. <p>Nga sa më sipër del në pah se roli i këshillit bashkiak dhe/apo strukturave pranë NIQV është shtesë burokratike për këtë funksion, përveçse mbledhja në mënyrë jo të rregullt e këshillave bashkiakë bëhet pengesë për zbatimin e procedurave deri në marrjen e përfitimeve.</p>		<p>VKM nr. 563, datë 12.8.2005 "Për përcaktimin e përgjegjësisë të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore", përcakton ngritjen e strukturave të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, pranë këshillave të qarqeve me përgjegjësi të si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon nevojat për fonde për institucionet e përkujdesjes shoqërore në administrim të këshillit të qarkut dhe paraqet kërkesën për fonde nga burimet e veta, nga Buxheti i Shtetit dhe nga donatorët; - Propozon në komisionin e vlerësimit të nevojave dhe planifikimit të shërbimeve, i cili pas vlerësimit e dërgon për miratim në këshillin e qarkut, nevojën për hapjen ose mbylljen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, kur këto shërbime ngrihen pranë çdo këshilli qarku; - Bashkërendon punën për realizimin e shërbimeve ndërmjet drejtorive të shërbimit shëndetësor, të arsimit, rendit, sistemit gjyqësor, që veprojnë pranë çdo këshilli qarku; - Propozon, për miratim, pranimin e përfituesve të këtyre shërbimeve në institucionet rezidenciale publike, në administrim të këshillit të qarkut; - Organizon programe kualifikimi për punonjësit e sistemit të ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që veprojnë pranë çdo këshilli qarku; - Programon dhe mbështet shërbimet e përkujdesjes shoqërore të specializuara për fëmijët, gratë dhe vajzat e trafikuar, personat e varur nga alkooli dhe droga, që nuk mund të realizohen nga një bashki; - Përgatit hartën e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në nivel rajonal, sipas të dhënave që ofrohen nga bashkitë. <p>Ligji "Për buxhetin e vitit 2019" në nenin 16 parashikon që personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta, në të njëjtën frymë me parashikimet e ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018". Gjithashtu nga shqyrtimi i strukturave organizative të disa këshillave të qarqeve, në shumë prej tyre nuk ka asnjë personel për kryerjen e përgjegjësisë për shërbimet e ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuara. Në kushtet e reduktimit të kapaciteteve njerëzore këto përgjegjësi të qarkut nuk janë më realisht të zbatueshme.</p>		<p>Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, konstaton kundërvajtjet administrative për shkeljet e detyrimeve nga ana e strukturave të NIQV dhe i propozon kryetarit të NIQV vendosjen e masës administrative për shkelësit. Kjo formë rregullimi e procesit të monitorimit dhe vlerësimit nga ana e organeve qendrore është jo efektive në zbatim, duke qenë se masa administrative mbetet në nivel propozimi.</p> <p>Mbi këtë bazë, procesi i monitorimit dhe vlerësimit nga ana e organeve qendrore është më efektive nëse ndahet nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të vetë NIQV-ve. Në këtë këndvështrim, organet e qeverisë qendrore duhet të kenë të drejtën e vendosjes së masës administrative drejtpërdrejt për shkelësit, duke mbyllur ciklin e një procesi të pavarur në nivel qendror.</p>	
<p>Rekomandim [49]: Rekomandohet që në ligjin nr. 9355, të shtuqizohen kompetenca e NIQV-ve e përshkuara më sipër; strukturat rajonale të SHSSH të kryejnë drejtpërdrejtë këto kompetenca. Ky rekomandim është në përputhje me projektligjin "Për mbrojtjen sociale në Republikën e Shqipërisë".</p>		<p>Rekomandim [50]: Në pamundësi reale të zbatimit të këtyre funksioneve, rekomandohet shtuqizimi i përgjegjësisë të këshillave të qarkut për këtë funksion sipas VKM nr. 563, datë 12.8.2005 "Për përcaktimin e përgjegjësisë të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore".</p>		<p>Rekomandim [51]:Rekomandohet ndryshimi i nenit 41 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore të ushtrojë të drejtën për të vendosur masa administrative drejtpërdrejtë, duke mbyllur ciklin e monitorimit dhe vlerësimit në nivel qendror.</p>	

GJETJE DHE REKOMANDIME	
Administrimi i Funksonit	
Administrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror	
Mospërputhje Ligjore	NP
<p>Në nenin 47, pika 4 e ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", parashikohet që KM miraton procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social, në zbatim të kësaj dispozite është miratuar VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social". Në këtë VKM përcaktohen burimet financiare për krijimin e fondit, ndërsa nuk përcaktohen mënyra e funksionimit të tij, konkretisht nuk përcaktohet (i) mënyra e shpërndarjes së fondit (kriteret) tek NIQV-të bazuar në planet përkatëse sociale të buxhetuara, (ii) autoritetin/et përgjegjës për miratimin e shpërndarjes së tij, duke mospërbushur objektin e saj. Në pikën 5 të këtij neni trajtohen mënyrat e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet organizatave jofitimprurëse dhe ofruesve privatë, në kushtet kur NIQV-të nuk mund të ofrojnë këto shërbime nëpërmjet fondit social, duke tejkaluar objektin e saj në bazë dhe për zbatim të ligjit. Gjithashtu, në këtë VKM nuk përcaktohet (iii) mënyra e bashkëpunimit midis autoriteteve qendrore dhe vendore për administrimin e fondit social, në përputhje me nenin 47, pika 1.</p>	
<p>Rekomandim [52]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", duke përcaktuar (i) mënyrën e shpërndarjes së fondit (kriteret) tek NIQV-të bazuar në planet përkatëse sociale të buxhetuara, (ii) autoritetin/et përgjegjës për miratimin e shpërndarjes së tij, si dhe (iii) mënyrën e bashkëpunimit midis autoriteteve qendrore dhe vendore për administrimin e fondit social.</p>	

NDËRTIMI DHE ADMINISTRIMI I BANESAVE PËR STREHIMIN SOCIAL (NENI 24/2)

GJETJE DHE REKOMANDIME			
Administrimi i Funksionit			
Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
<p>Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", nuk është shoqëruar ende nga aktet ligjore në zbatim të tij gjithashtu aktet e ligjit të mëparshëm nuk janë lënë në fuqi në dispozitat kalimtare, duke e lënë këtë funksion aktualisht të pa zbatueshëm në disa komponente.</p> <p>Në zbatim të ligjit këtij ligji, KM miraton aktet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Normat e strehimit; - Dokumentacionin për të përfutur strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat; - Rregullat për administrimin e kërkesave të NJQV për fonde nga buxheti i shtetit mb subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe MSHMS; - Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së subvencionit; - Kushtet, normat dhe standardet, që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira; - Metodikës Metodikën për llogaritjen e masës së qirasë; - Normat dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së trullit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët; - Procedurat e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët; - Kriteret për përfuttesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfuttesve që janë zhvendosur prej tyre; - Procedura e përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas marrëveshjes për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat; - Kriteret, procedurat dhe kapacitetet e mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike nga institucionet publike që administrojnë strehët; - Procedurat e zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional; - Kushtet e strehimit për personat me aftësi të kufizuara; - Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe NJQV-ve për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale; - Procedurat, kriteret dhe përparësitë për grantin e menjëhershëm; - Kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara; - Procedurat për kalimin nën përgjegjësi të MSHMS në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe njësisë e vetëqeverisjes vendore nuk përbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme. 	<p>Rekomandim [53]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e normave të strehimit.</p> <p>Rekomandim [54]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat;</p> <p>Rekomandim [55]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e rregullave për administrimin e kërkesave të NJQV për fonde nga buxheti i shtetit mb subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe MSHMS.</p> <p>Rekomandim [56]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kriterëve të dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së subvencionit.</p> <p>Rekomandim [57]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kushteve, normave dhe standardet, që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira.</p> <p>Rekomandim [58]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e metodikës për llogaritjen e masës së qirasë.</p> <p>Rekomandim [59]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e normave dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së trullit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët.</p> <p>Rekomandim [60]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të shkëmbimit të banesës me kosto të ulët.</p> <p>Rekomandim [61]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kriterëve për përfuttesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfuttesve që janë zhvendosur prej tyre.</p> <p>Rekomandim [62]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas marrëveshjes për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat.</p> <p>Rekomandim [63]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kriterëve, procedurat dhe kapacitetet e mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike nga institucionet publike që administrojnë strehët.</p> <p>Rekomandim [64]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional.</p> <p>Rekomandim [65]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kushteve të strehimit për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>Rekomandim [66]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e rasteve dhe mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe NJQV-ve për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale.</p> <p>Rekomandim [67]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësitë për grantin e menjëhershëm.</p> <p>Rekomandim [68]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kushteve dhe normave të projektimit të banesave të specializuara.</p> <p>Rekomandim [69]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave për kalimin nën përgjegjësi të MSHMS në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe njësisë e vetëqeverisjes vendore nuk përbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme.</p>	<p>Rekomandim [70]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për mënyrën e administrimit dhe e mirëmbajtjes të banesave të specializuara.</p> <p>Rekomandim [71]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për përcaktimin e kostos mesatare vjetore të ndërtimit të banesave sociale.</p> <p>Rekomandim [72]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme.</p> <p>Rekomandim [73]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për mënyrën e aplikimit dhe kriteret për përfuttesit e fondeve nga buxheti i shtetit.</p>	

ZHVILLIMI, MBROJTJA DHE PROMOVIMI I VLERAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE ME INTERES VENDOR, SI DHE ADMINISTRIMI I OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE (NENI 25/1); ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE KULTURORE DHE PROMOVIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR E LOKAL, SI DHE ADMINISTRIMI I OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE (NENI 25/2); ZHVILLIMI, MBROJTJA DHE PROMOVIMI I BIBLIOTEKAVE E AMBIENTEVE PËR LEXIM, ME QËLLIM EDUKIMIN E PËRGJITHSHËM TË QYTETARËVE (NENI 25/3)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funkcionit

Mungesë Ligjore

NP

Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, është ligji bazë sektorial që rregullon funksionet e NJQV-ve në fushën e kulturës duke përcaktuar kompetencat. Ky ligj nuk është shoqëruar ende me aktet nënligjore në zbatim të tij. Në pjesën e raportit të rregullimeve të funksionit më sipër asnjë akt nënligjor nën përgjegjësinë e KM dhe MK nuk rezulton i miratuar duke sjell problematika në zbatimin e detyrimeve për NJQV-të. Gjithashtu, detyrimet e NJQV-ve për monitorimin dhe vlerësimin e funksionit në kuadër të këtij ligji kanë mungesa pasi sistemet e monitorimit të parashikuar në të nuk janë miratuar ende.

Rekomandim [74]: Rekomandohet pasurimi dhe plotësimi i bazës ligjore në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

SIGURIMI, NË NIVEL VENDOR, TË MASAVE PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT, TOKËS DHE UJIT NGA NDOTJA. (NENI 26/1), SIGURIMI NË NIVEL VENDOR, I MASAVE PËR MBROJTJEN NGA NDOTJA AKUSTIKE (NENI 26/2), ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE EDUKUESE DHE PROMOVUESE, NË NIVEL VENDOR, TË CILAT LIDHEN ME MBROJTJEN E MJEDISIT (NENI 26/3)

GJETJE DHE REKOMANDIME					
Administrimi i Funkcionit			Monitorimi dhe Vlerësimi		
Mospërputhje Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
<p>VKM nr. 633, datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", parashikon NJQV-të si një nga autoritete përgjegjëse për zbatimin e kësaj VKM-je. Në përcaktimet e Kodit rrugor, kontrolli teknik i mjeteve, si veprimtaria kryesore për zbatimin e kësaj VKM-je, përcaktohet si përgjegjësi e qendrave të kontrollit teknik, të licencuara nga MIE, si dhe në rast kur kanë dyshime për ndotje për mjete me motor ose rimorkio të veçantë, organet e shërbimeve të policisë rrugore (përfshijtur policia bashkiake neni 12 i Kodit Rrugor), mund të urdhërojnë në çdo kohë ndalimin e tyre, duke bërë shënimin në librezën e mjetit, për një kontroll teknik të menjëhershëm jashtë radhe. Në kushtet e mungesës së tagrit për kontrollin e mjeteve, veprimtaritë e përcaktuara në VKM-në nr.633 nus së natyrës dhe biodiversitetit</p>		<p>Në nenin 12 të ligjit 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" përcaktohet KM si autoriteti përgjegjës për miratimin e masave për pakësimin e shkarkimit në ajër nga burime të palëvizshme. Kjo VKM nuk është miratuar.</p>		<p>Për sigurimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, NJQV-së nuk i jepen kompetenca për matje, kontroll dhe monitorim të treguesve përkatës, për rrjedhojë, masat që mund të sigurojnë NJQV-të kufizohen në masa të cilat aktualisht merren në kuadër të administrimit të funksioneve të tjerat të veta sipas ligjit 139/2015, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për cilësinë e ajrit, në funksionin e transportit publik vendor dhe parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike (neni 23/6 dhe 9); - Për cilësinë e ujit të pijshëm, në funksionin e prodhimit, trajtimit, transmetimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm (neni 23/1); - Për ujërat e ndotura, në funksionin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura (neni 23/2); - Për ujërat e ujitjes dhe kullimit, në funksionin e administrimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (neni 27/1); - Për mbrojtjen e cilësisë së tokës, në funksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore e të kategorive të tjera resurseve, si dhe mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit (neni 27); - Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, NJQV-ja siguron masat për mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht për cilësinë e tokës, si pjesë e funksionit të planifikimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, (neni 23). <p>Në lidhje me aktivitetet e personave fizikë, juridikë që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj, NJQV nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e ndotjes mjedisore.</p>	
<p>Rekomandim [75]: Rekomandohet ndryshimi i pikës 12 të VKM-së nr. 633. Përgjegjësia e NJQV-ve për zbatimin e kësaj VKM-je të shfuqizohet.</p>		<p>Rekomandim [76]: Rekomandohet miratim i VKM-së në zbatim të nenit 12 të ligjit 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis".</p>		<p>Rekomandim [77]: Rekomandohet zgjerimi i kompetencave të NJQV-ve në lidhje me sigurimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, duke i shtuar kompetenca për kryerjen e matjes, kontrollit, monitorimit si dhe vendosjen e masave administrative drejtpërdrejtë ndaj personave fizikë apo juridikë kundërvajtës. Rekomandohet që këto ndryshime të reflektohen në legjislacionin sektorial për mbrojtjen e mjedisit si dhe në legjislacionin sektorial që rregullon funksionet e tjera në NJQV, duke marrë shembull nga praktika e mirë e inspektorateve ndërtimore pranë NJQV-ve.</p>	

ADMINISTRIMI, SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË TRANSFERUAR NË PRONËSI TË TYRE, SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ (NENI 27/1)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funksionit

Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP
Në ligjin nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit” parashikohet miratimi i disa akte nënligjore për të mbështetur rregullimin e funksionit, përkatësisht për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nuk janë miratuar ende nga MBZHR, rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit.		Për të mundësuar dhënien në përdorim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit organizatave të përdorimit të ujit nga NJQV-të, disa akte nënligjore të nevojshme për të kryer këtë veprimtari nuk janë miratuar ende nga MBZHR, përkatësishtL - marrëveshja tip për dhënien në përdorim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit shoqërive të bashkëpunimit bujqësor; - statuti tip i organizatave të përdorimit të ujit.	
Rekomandim [78]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit në zbatim të nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”.		Rekomandim [79]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit në zbatim të nenit 20 , pika 4 dhe e nenit 25, pika 3 e ligjit nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”.	

ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKAVE BUJQËSORE E TË KATEGORIVE TË TJERA TË RESURSEVE, SI TOKA TË PAFRYTSHME ETJ., SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ (NENI 27/2)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funksionit

Mospërputhje Ligjore

NP

Mospërputhje Ligjore

NP

Administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve si toka të pafrytshme rregullohet nga 2 ligje kryesore (i) ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar dhe (ii) ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar. Të dy ligjet ndryshimet e fundit i kanë pësuar më tetor të 2014, pra përpara miratimit të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015. Gjithashtu nuk janë të ndikuara nga miratimi i ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në organigramën e mësipërme ky funksion paraqitet me një ndërvarësi të drejtpërdrejt të NJQV nga institucionet qendrore, madje edhe varësi nga Këshilli i Qarkut.

Përkatësisht ligji nr. 9244 përcakton MBZHR si drejtuese teknike dhe administrative të të gjitha strukturave shtetërore të përfshira në aktivitetet e mbrojtës së tokës, ~~nërfshirë strukturat pranë NJQV-ve në kundërshtim me parimin e autonomisë~~

Rekomandim [80]: Rekomandohet të kryhen ndryshime në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar dhe ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, të shfuqizohet drejtimi i strukturave të NJQV-ve nga MBZHR dhe përgjegjësitë e NJQV-ve në lidhje me administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore të jenë të përcaktuara duke garantuar parimin e autonomisë vendore.

Këshilli i qarkut drejton teknikisht dhe administrativisht strukturat shtetërore në territorin e qarkut, duke dhënë vendime të detyrueshme për t'u ndërmarrë nga NJQV, ushtron inspektimit nëpërmjet IMT, etj.

Projektligji "Për buxhetin e vitit 2019" në nenin 16 parashikon që personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta, ashtu si dhe në ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018". Për rrjedhojë, në strukturat organizative të këshillave të qarqeve është reduktuar veçanërisht personeli i IMT-së, dhe në përgjithësi personeli për kryerjen e përgjegjësisë për shërbimet e mbrojtës së tokës.

Në kushtet e reduktimit të kapaciteteve njerëzore ky funksion i qarkut nuk është më realisht i zbatueshëm.

Rekomandim [81]: Në pamundësi reale të zbatimit të funksioneve nga këshilli i qarkut, rekomandohet ndryshimi i ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar dhe ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, kalimi i përgjegjësisë NJQV-ve për përmbushjen efektive të veprimtarive për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

KRIJIMI DHE ADMINISTRIMI I SISTEMIT VENDOR TË INFORMACIONIT DHE KËSHILLIMIT BUJQËSOR E RURAL, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI (NENI 27/3); KRIJIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMAVE VENDORE TË GRANTEVE PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, TË FINANCUARA NGA BUXHETI LOKAL DHE/OSE ME BASHKËFINANCIM NGA TË TRETËT, DUKE GARANTUAR AKSES TË BALANCUAR GJINOR (NENI 27/4); MBROJTJA E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI (NENI 27/6)

GJETJE DHE REKOMANDIME		
Administrimi i Funkcionit		
Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi (Neni 27/3)	Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor (Neni 27/4)	Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi (neni 27/6)

Mungesë Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP	Mbivendosje Ligjore	NP
Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi, rregullohet nga ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", si dhe nga VKM nr. 709, datë 29.10.2014 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020", të ndryshuar në zbatim të tij. Në këto akte nuk përcaktohen NJQV-të si organe përgjegjëse për zbatimin e përgjegjësi të parashikuar. Gjithsesi NJQV-të mund ta ushtrojnë këtë funksion lirisht në mbështetje të nenit 32/2 të ligjit 139/2015.	Ky funksion nuk është i rregulluar nga legjislacioni sektorial, NJQV-të nuk kanë asnjë kompetencë të parashikuar. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", në nenin 6, parashikon krijimin e programeve për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të administruar nga MBZHR-ja, nëpërmjet agjencisë së pagesave me qëllim të mbështesë zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, duke i kushtuar vëmendje nevojës së planifikimit të zbatimit të projekteve dhe të masave mbështetëse. Burimet financiare të programit përfshijnë edhe buxhetet e NJQV-ve. Duke u parashikuar agjencia e pagesave, si organ ekskluziv për administrimi e programeve, NJQV nuk mund të aplikojnë këtë funksion në kundërshtim me përgjegjësinë e ngarkuar në ligjin 139/2015, neni 27, pika 4.	Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar rregullon funksionin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Në neni 7 të tij parashikon si organe për administrimin e burimeve organet shtetërore, qendrore dhe vendore. Në të gjitha përgjegjësitë që ngarkon ky ligj ai përcakton bashkërisht organet shtetërore, pa ndarë specifikisht përgjegjësitë. Ngarkimi njëkohësisht i disa organeve qeverisëse sjell për pasojë paqartësi në ndarjen e përgjegjësi dhe rrjedhimisht paqartësi në ndarjen e fondeve financiare të nevojshme për ushtrimin e përgjegjësi nën këtë funksion. Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në ndryshim nga ligji mëparshëm heq ndarjen në "funksione të veta" dhe "funksione të përbashkëta". Ky ndryshim vjen në përputhje me Kushtetutën, e cila nuk e njeht konceptin e "funksionit të përbashkët" midis qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore. Kjo praktikë sjell mos koordinim të veprimtarive të nevojshme për t'u ndërmarrë nga institucionet e përfshira.	Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar në tërësi, rekomandohet të përcaktohen qartë përgjegjësitë e organeve qendrore dhe përgjegjësitë e NJQV, si dhe mënyrat e bashkëveprimit midis këtyre autoriteteve.		
Rekomandim [82]: Rekomandohet të kryhen ndryshime në ligjin sektorial nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", duke (i) përcaktuar kompetencat e NJQV-ve dhe (ii) bashkërendimin e aktivitete midis MBZHR dhe NJQV-ve.	Rekomandim [83]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 6 i ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, të përfshihen NJQV-të në administrimin e programeve për bujqësinë e zhvillimin rural.	Rekomandim [90]: Rekomandohet ndryshimi i ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar në tërësi, rekomandohet të përcaktohen qartë përgjegjësitë e organeve qendrore dhe përgjegjësitë e NJQV, si dhe mënyrat e bashkëveprimit midis këtyre autoriteteve.			

ADMINISTRIMI I FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI (NENI 27/5)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funkslonit

Mungesë Ligjore	NP	Mungesë Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP
<p>Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar nuk është shoqëruar ende me disa akte nënligjore në zbatim të tij, duke sjellë problematika në zbatimin e detyrimeve për NJQV-të në këtë funksion. Përkatesisht mungon VKM-ja për miratimin e kritereve dhe mënyra e caktimit të vlerës së dënimit të shkakuar nga kundërvajtësit.</p>					
<p>Rekomandim [84]: Rekomandohet miratimi i VKM-së, në zbatim të nenit 41/1, pika 4 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar.</p>	<p>Mungojnë udhëzimet e mëposhtme nga MTM-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për mënyrën e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve; - për caktimin e rregullave për kullotje dhe kalimin e bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave; - për caktimin e rregullave për lejimin e ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë; - për caktimin e kritereve dhe kontingjentët për grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore. 	<p>Rekomandim [85]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për mënyrën e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve, në zbatim të nenit 5, pika 6 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar.</p>		<p>Në lidhje me aktivitetet e personave fizikë, juridikë që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj, NJQV nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktrimin e kundërvajtjeve në sektorin e pyjeve dhe kullotave. Strukturat e pyjeve dhe kullotave janë të detyruar në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve të njoftojnë policinë pyjore për vënien e masave administrative, të cilët për shkak vonese për shkaqe largësie nga vendi i ngjarjes, pamundësi të arritjes në vendin e ngjarjes nuk zbatojnë masën administrative.</p>	
		<p>Rekomandim [86]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për caktimin e rregullave për kullotje dhe kalimin e bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave, në zbatim të nenit 21, pika 10 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar.</p>		<p>Rekomandim [89]: Rekomandohet zgjerimi i kompetencave të NJQV-ve, shtimi i kompetencës për vendosjen e masave administrative drejtpërdrejt ndaj personave fizikë apo juridikë kundërvajtës, në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, duke marrë shembull nga praktika e mirë e inspektorateve ndërtimore pranë NJQV-ve.</p>	
		<p>Rekomandim [87]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për caktimin e rregullave për lejimin e ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë, në zbatim të nenit 21, pika 14 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar.</p>			
		<p>Rekomandim [88]: Rekomandohet miratimi i udhëzimit për caktimin e kritereve dhe kontingjenteve për grumbullimin e prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, në zbatim të nenit 26, pika 14 e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar.</p>			

GARANTIMI I SHËRBIMIT TË ZJARRFIKËSVE, NË NIVEL VENDOR, DHE ADMINISTRIMI I STRUKTURAVE PËRKATËSE (NENI 29/2)

GJETJE DHE REKOMANDIME

Administrimi i Funkcionit

Mungesë Ligjore	NP	Mbivendosje Ligjore	NP
<p>Ligj nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", ka disa mungesa në bazën ligjore, përkatësisht mungon VKM-ja për miratimin e rregullores për mbrojtjen nga zjarri si dhe udhëzimi i ministrit për evidentimin dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe procesverballi i konstatimit të shkeljes.</p>	<p>Rekomandim [91]: Rekomandohet miratimi i rregullores për mbrojtjen nga zjarri në zbatim të nenit 10, germa a, e ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".</p> <p>Rekomandim [92]: Rekomandohet udhëzimi për evidentimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe procesverballi i konstatimit të shkeljes në zbatim të nenit 50, pika 8, e ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".</p>	<p>Ligj nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", në nenin 7, pika 4, përcakton drejtorinë/vektorin e MZSH-së në nivel vendor nën varësinë e kryetarit të bashkisë.</p> <p>Në të njëjtën kohë ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës", të ndryshuar, në nenin 12 përcakton vartësinë e inspektoratit të Mbrojtjes nga Zjarri në nivel vendor nga Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë.</p>	<p>Rekomandim [93]: Rekomandohet të shfuqizohet neni 12 i ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës".</p>

MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE

GJETJE DHE REKOMANDIME					
MJAFTUESHMËRIA FINANCIARE E FUNKSIONEVE					
Mungesë Ligjore	NP	Mospërputhje Ligjore	NP	Zbatim	NP
Ligji 139/2015 nuk ka një përkufizim të termit standard dhe norma (minimale) kombëtare të ushtrimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Në veçanti, nuk ka një përcaktim të lidhjes së tyre me politikën kombëtare dhe rajonale; kjo lidhje është e rëndësishme, për sa kohë edhe standardet e normat edhe politikën janë të dyja njëkohësisht baza të parimit të ushtrimit të funksioneve që vendos ligji, ndërsa vetëm standardet e normat janë kriter i mjaftueshmërisë financiare të funksioneve.		Ligji 139/2015 parashikon se burimet financiare të vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e funksioneve duhet të jenë të mjaftueshme për të përbushur standardet dhe normat ligjore përkatëse; këto të fundit, për rjedhje, duhet të jenë pjesë e kostos së ushtrimit të funksioneve. Ky rregullim nuk reflektohet i plotë në ligjin 68/2017, i cili përcakton se burimet e nevojshme financiare kanë madhësinë e kostos historike të ushtrimit të funksioneve nga qeverisja qendrore para decentralizimit të tyre; në koston historike, niveli i standardeve dhe normave ligjore që është arritur nga institucioni qendror përkatës nuk është domosdoshmërisht niveli i kërkuar nga ligji.		Që prej fillimit të reformës së decentralizimit në vend, efekti financiar i vlerësuar i ndryshimeve në politikën fiskale kombëtare dhe i transferimeve të funksioneve, i pa financiar apo kompensuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, është rreth 8 miliardë lekë.	
Rekomandim [94]: Rekomandohet të përkufizohen në ligjin 139/2015 standardet dhe normat (minimale) kombëtare ligjore të një funksioni të vetëqeverisjes vendore, dhe veçanërisht lidhja e tyre me politikën kombëtare dhe rajonale përkatëse të funksionit.		Mënyra e sigurimit të përbushjes së parimit të mjaftueshmërisë financiare nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësitë të vetëqeverisjes vendore nuk është e qartë. Veçanërisht, nuk është e qartë masa e përfshirjes së standardeve e normave ligjore të një funksioni në koston e ushtrimit të tij nëpërmjet programit të shpenzimit.		Rekomandim [100]: Në kuadër të ligjit 139/2015, neni 34, pika 5, rekomandohet hartimi i një plani financiar nga MFE për kompensimin e uljes së të ardhurave të vetëqeverisjes vendore si pasojë e ndryshimit të politikës fiskale në vite.	
Rekomandim [101]: Rekomandohet që, pas një periudhe 2-3 vjeçare të zbatimit të ligjit të financave të vetëqeverisjes vendore, të kryhet një analizë e plotë e menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe të rishikohen planet e mundshme për shtesa ose ndryshime të dispozitave ligjore e nënligjore.		Rekomandim [95]: Rekomandohet të bëhet një shtesë në udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 të ligjit 68/2017 ku të qartësohet mënyra se si standardet dhe normat ligjore të një funksioni bëhen pjesë e programit të shpenzimeve buxhetore afatmesme dhe e kostos së tij. Në veçanti, rekomandohet të njehsohet drejtimi i planifikimit financiar të njësitë të vetëqeverisjes vendore përgjatë ciklit: politika kombëtare dhe rajonale përkatëse të një funksioni – standarde e norma kombëtare të funksionit – qëllimi dhe objektivat e programit të shpenzimeve për funksionin – tregues të performancës së programit të shpenzimeve.		Rekomandim [99]: Rekomandohet hartimi i procedurave dhe metodologjisë që rregullojnë transferimet e funksioneve në nivel vendor në mënyrë transparente dhe në konsultim me strukturat konsultative qeveri qendrore – vetëqeverisjes vendore.	
				Rekomandim [97]: Rekomandohet të rregullohet nëpërmjet udhëzimeve metoda e përlogaritjes së të ardhurave të njësitë të vetëqeverisjes vendore, e cila mbështet vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare të vetëqeverisjes vendore.	
				Rekomandim [98]: Rekomandohet që politikën fiskale dhe transferimi i përgjegjësisë të reja të cilat kanë efekte financiare të drejtpërdrejta në vetëqeverisjen vendore të shoqërohen me faturë të detajuar financiare dhe proces transparent të llogaritjes së kësaj fature.	
				Raporte të qeverisë qendrore, sipas kërkesës së ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 26 dhe 27, të cilat duhet të japin informacion (dhe të konsultohen në KK) për standardin e ofrimit të shërbimit dhe nivelin e shpërndarjes së tij sipas njësitë të vetëqeverisjes vendore, nuk janë hartuar asnjëherë deri më sot.	
				Rekomandim [96]: Rekomandohet të hartohen raportet sipas neneve 26 dhe 27 të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".	
				Rekomandim [102]: Në kuadër të rolit të tyre monitorues sipas ligjit 139/2015, rekomandohet që këshillat bashkiakë të zhvillojnë kapacitetet njerëzore për të kontribuar nëpërmjet instrumentit të Këshillit Konsultativ në analiza sasiore të gjendjes së financimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore dhe nismave ligjore që vijnë nga qeveria qendrore me ndikim në mjaftueshmërinë e burimeve financiare, transferim, delegim funksionesh ose ndryshim në politikën fiskale kombëtare. Veçanërisht, rekomandohet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të këshillave bashkiakë mbi parimin dhe rregullimin e autonomisë së vetëqeverisjes vendore dhe zbatimit të saj në secilin fushë të funksioneve sipas ligjit 139/2015.	

SHTOJCA B: BAZA LIGJORE E FUNKSIONEVE

Funksioni	Baza Ligjore
Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Ligj nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar; • VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a."; • VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për Miratimin e Kategorive të Licencave dhe të Procedurave të Aplikimit për Licencë të Personave Fizikë dhe Juridikë, që ushtrojnë Veprimtari në Sistemet e Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura»; • VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK; • Ligj nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar; • VKM nr. 73, datë 7.2.2018 Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027; • VKM nr. 379, datë 25.5.2016 "Për Miratimin e Rregullores "Cilësia e Ujit të Pijshëm" • Ligj nr. 9115, date 24.7.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura", i ndryshuar; • VKM nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse»; • Ligj nr.7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar", i ndryshuar; • Ligj nr.9863, date 28.1.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar; • VKM nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësijellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve"; • Vendim i KKRR nr. 35, datë 14.10.2013 "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014"; • Vendim i KKRR nr.4, datë 29.02.2012 "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë"; • Vendim i KKRR nr.31, datë 27.04.2018 "Për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr.4, datë 29.02.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë"; • Vendim i KKRR nr. 50, datë 30.12.2013 "Për miratimin e formatit të licencës dhe disa ndryshime në rregulloren e licencimit"; • Vendim i KKRR nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit"; • Vendim i KKRR nr. 15, datë 09.06.2014 "Për zbatimin e kontratës model"; • Vendim i KKRR nr. 22, datë 14.11.2014 "Për Miratimin e Përqindjes së Pagesës Rregullatore për Vitin 2015"; • Vendim i KKRR nr. 25, datë 08.07.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime"; • Vendim i KKRR nr. 13, datë 23.02.2016, "Për licencimin e operatoreve dhe miratimin e tarifave të shërbimit UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit të shoqërive UK"; • Vendim i KKRR nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; • Vendim i KKRR nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura"; <ul style="list-style-type: none"> • Vendim i KKRR nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura"; • Vendim i KKRR nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura"; • Vendim i KKRR nr. 18, datë 22.03.2018 "Vendim për fillimin e procedurës për ndryshimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave"; • Vendim i KKRR nr. 21, datë 30.03.2018 "Për tarifën dhe dhënien e informacionit (dokumentacionit) të kërkuar"; • Vendim i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 71, datë 21.09.2018 për miratimin e "Rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave"; • Vendim i KKRR nr. 58 datë 29.12.2017 për miratimin e "Rregullore e inspektimit dhe monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit në sektorin ujësjellës kanalizime (UK)"; • Ligj nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit , i ndryshuar; • Ligji nr. 9290 , datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".

Funksioni	Baza Ligjore
<p>Mbledhja dhe largimi i ëjurave të shiut dhe mbrojtjen nga përmblytjet në zonat e banuara</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; • VKM nr. 73, datë 7.2.2018 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027”; • VKM nr. 655, datë 18.12.2002 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtare të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile”; • VKM nr. 531, datë 01.08.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile”; • VKM nr. 502, datë 13.9.2017 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar; • Ligj nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; • VKM nr. 408 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; • Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”; • Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, i ndryshuar; • VKM nr. 147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”.
<p>Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë”, i ndryshuar; • VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; • VKM nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, i ndryshuar; • Udhëzim nr. 9, datë 3.7.2012 “Mbi Auditimin dhe Inspektimin e Sigurisë Rrugore”; • Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; • Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
<p>Ndriçimi i mjediseve publike</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 124/2015 datë. 05.11.2015 “Për eficientë e energjisë”; • VKM nr. 709, datë 1.12.2017 “Për miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficientë e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020”; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë”; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar; • Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; • VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; • Ligji nr. 116/2016 datë 10.11.2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

Funksioni	Baza Ligjore
Transporti Publik Vendor	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar; • VKM nr. 811, datë 16.11.2016 "Për miratimin e strategjisë së transportit dhe planit të veprimit 2016-2020" (e pa publikuar në fletore zyrtare); • VKM nr. 325, datë 19.3.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë", i ndryshuar; • Udhëzim nr. 5627, datë 18/11/2016 "Për Përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar; • Udhëzim nr. 1726/1, datë 21/04/2008 "Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi"; • Udhëzim nr. 446, datë 10.05.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve", i ndryshuar; • Udhëzim nr. 3743, datë 10.07.2017 "Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve", i ndryshuar; • Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; • VKM nr. 153, datë 7.4.2000 "Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; • VKM nr. 504, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës.
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimin e shërbimit të varrimit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9220, datë 15.4.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", i ndryshuar; • VKM nr. 711, datë 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"; • VKM nr. 712, datë 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"; • VKM nr. 151, datë 4.2.2015 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për ngritjen e varrezave private"; • VKM nr. 426, datë 9.7.1998, i Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", të ndryshuar; • Udhëzim nr. 4, datë 9.12.2015 "Për mënyrat e kryerjes së zhvarrosjes dhe zhvarrosjes murale të rasteve të veçanta"; • Udhëzim i MRTT nr. 2, datë 19.7.2004 "Mbi përcaktimin dhe plotësimin e modelit të regjistrimit të shërbimit të varrimit"; • Udhëzim i MRTT nr. 7, datë 16.12.2004 "Mbi përcaktimin e normave teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave publike"; • Udhëzim i MRTT nr. 8, datë 17.12.2004 "Mbi përcaktimin e kushteve të përdorimit të varrezave publike, mënyrës së hapjes së varreve dhe të dhënat teknike të arkivoleve që përdoren"; • Udhëzim i MRTT nr. 3, datë 28.6.2005 "Për përcaktimin e kushteve teknike të ndërtimit dhe përdorimit të varrezave mbitokësore"; • Udhëzim i MPPTT dhe MSH nr. 1, datë 31.3.2006 "Mbi përcaktimin e kushteve të veçanta që duhet të plotësojnë automjetet e varrimit"; • Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë".
Shërbimet e Dekorit Publik	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 8926, datë 22.7.2002 "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre"; • VKM nr. 473, datë 10.7.2003 "Për mënyrën e përdorimit të flamurit kombëtar në mjediset e jashtme dhe të brendshme, të institucioneve publike, si dhe raporti i përmasave të tij"; • VKM nr. 473, datë 10.7.2003 "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj".

Funksioni	Baza Ligjore
Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; • VKM nr. 671, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit".
Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake	<ul style="list-style-type: none"> • Ligj nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar; • Ligji nr. 8094, datë 21.3.1996 "Për largimi publik të mbeturinave"; • VKM nr. 175, datë 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"; • VKM nr. 418, 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; • VKM nr. 452, 11.07.2012 "Për lëndfilltet e mbetjeve", i ndryshuar; • VKM nr. 608, 17.9.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; • VKM nr. 177, 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", i ndryshuar; • Udhëzim nr. 6, datë 27.11.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta"; • Udhëzim nr. 1738, datë 12.3.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"; • VKM nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar; • Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit "Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet, që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim"; • Udhëzim nr. 6, datë 27.11.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta"; • VKM nr. 806, datë 4.12.2003 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave e procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi"; • Rregullorja nr. 4, datë 15.10.2003 e Ministrit të Mjedisit "Për kërkimin, shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të eksportimit dhe të transmetimit të mbetjeve". • Ligji nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar; • VKM nr. 509, datë 13.9.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësive Shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit"; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësive Shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë"; • VKM nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbetjeve"; • Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, i ndryshuar; • VKM nr. 46, datë 29.1.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave".

Funksioni	Baza Ligjore
<p>Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, i ndryshuar; • Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • VKM nr. 662, datë 8.10.2014 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike"; • Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar; • Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; • Ligji nr. 116/2016 datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave"; • VKM nr. 505, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë"; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë"; • VKM nr. 319, datë 12.4.2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave"; • VKM nr. 159, datë 1.3.2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve".

Funksioni	Baza Ligjore
<p style="text-align: center;">Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe në çerdhe</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligj nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; • Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, i ndryshuar; • Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • VKM Nr. 662, datë 8.10.2014 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike"; • VKM nr. 352, datë 3.4.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të arsimit"; • VKM nr. 662, datë 8.10.2014 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike"; • VKM nr. 140, datë 18.2.2015 për miratimin e rregullores "Për ushtrimin e veprimtarisë së këshillit kombëtar të arsimit parauniversitar"; • Urdhër i MASR nr. 343, datë 19.8.2013 "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar"; • Udhëzim nr.21, datë 23.7.2010 "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar; • Udhëzim nr. 8, datë 19.3.2013 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve"; • Udhëzim nr. 2, datë 12.2.2015 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve" <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzim nr. 30, datë 2.8.2013 "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore"; • Udhëzim nr. 37, datë 13.8.2013 "Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 56, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 38, datë 7.10.2014 "Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar"; • Urdhër nr. 343, datë 19.8.2013 "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar"; • Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9290 , datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; • Ligji nr. 116/2016 datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave"; • VKM nr. 505, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë"; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë"; • VKM nr. 159, datë 1.3.2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve"; • VKM nr. 530, datë 20.7.2016 "Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve"; • VKM nr. 352, datë 3.4.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të arsimit"; • VKM nr. 662, datë 8.10.2014 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike"; • VKM nr. 140, datë 18.2.2015 për miratimin e rregullores "Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar"; • Udhëzim nr. 21, datë 23.7.2010 "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar; • Udhëzim nr. 8, datë 19.3.2013 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve"; • Udhëzim nr. 2, datë 12.2.2015 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve"; • Udhëzim nr. 30, datë 2.8.2013 "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore"; • Udhëzim nr. 37, datë 13.8.2013 "Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit <ul style="list-style-type: none"> • të institucionit publik të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 56, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 55, datë 19.11.2014 "Për organizimin e testimit të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar"; • Udhëzim nr. 40, datë 9.10.2015 "Për organizimin e testimit të kandidatëve për ushtrimin <ul style="list-style-type: none"> • e profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar"; • Udhëzim nr. 38, datë 7.10.2014 "Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 35, datë 30.9.2014 "Për procedurat lëvizjes paralele, të emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar"; • Udhëzim nr. 38, datë 6.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar".

Funksioni	Baza Ligjore
<p>Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në RSH", i ndryshuar; • Ligji nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar; • VKM nr. 419, datë 4.7.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor"; • VKM nr. 737, datë 5.11.2014 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor"; • VKM nr. 101, datë 4.2.2015 "Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", i ndryshuar; • VKM nr.797, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores higjeno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes"; • Udhëzim i MShMS për miratimin e rregullores së përgjithshme "Për kontraktimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor"; • Udhëzim i MShMS nr. 56 datë 29.01.2015 "Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 737, datë 5.11.2014 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor".
<p>Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"; • VKM nr. 725, datë 2.9.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë së zhvillimit të territorit"; • VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"; • VKM 1096, datë 28.12.2015, "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; • VKM 671, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"; • Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 30.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore", i ndryshuar; • Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 17, datë 07.06.2016 "Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të rëndësisë kombëtare", i ndryshuar.

Funksioni	Baza Ligjore
	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar; • VKM nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot"; • Udhëzim nr. 3, datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike"; • VKM nr. 618, datë 7.9.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", ndryshuar; • VKM nr. 821, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale"; • VKM nr. 822, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore"; • VKM nr. 823, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat ditore"; • VKM nr. 425, datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore", ndryshuar; • VKM nr. 904, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot", ndryshuar me VKM nr. 375 datë 11.06.2014; nr. 8381 datë 3.12.2014; nr.197 datë 9.3.2016; • VKM nr. 114, datë 31.1.2007 "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror", ndryshuar; • VKM nr. 904, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot", ndryshuar; • VKM nr. 431, datë 8.6.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", ndryshuar; • Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; • VKM nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare"; • VKM nr. 111, datë 23.2.2018 Për krijimin dhe funksionimin e fondit social"; • Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar; • Udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018 "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale"; • Udhëzim nr. 911, data 27.12.2018 "Për miratimin e standartet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore"; • VKM nr. 136, datë 7.3.2018 "Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror"; • Udhëzim nr. 689, datë 2.10.2018 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore"; • Udhëzim nr. 597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara"; • Udhëzimi nr. 7, datë 21.4.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot"; • Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit"; • Udhëzim nr. 582, datë 18.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, në qendrat shtëpi familje, për fëmijët 16–18 vjeç"; • Udhëzim nr. 597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara"; • VKM nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"; • VKM nr. 135, datë 7.3.2018 "Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror"; • VKM nr. 752, datë 8.9.2010 "Për miratimin e "standardeve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në nevojë"; • Ligji nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit"; • VKM nr. 18, datë 12.1.2018 "Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë"; • VKM nr. 231, datë 20.3.2013 "Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë, në qendrat ditore publike dhe jopublike"; • VKM nr. 505, datë 13.7.2011 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike"; • VKM nr. 752, datë 8.9.2010 "Për miratimin e "standardeve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në nevojë"; • Udhëzim nr. 6, datë 21.05.2014 "Për procedurat e sistemit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, publike dhe jopublike".

Funksioni	Baza Ligjore
Ndiertimin dhe administrimin e banesave për strehimin social	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social"
Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"; • Udhëzim nr. 5110, datë 13.10.2015 "Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi"; • Ligji nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", të ndryshuar; • Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar; • Ligji nr. 8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • Ligji nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
Sporti dhe shërbimet argëtuese	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 79/2017 "Për sportin" ; • VKM nr. 306, datë 24.5.2006 "Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe procedurat e përjashtimit", të ndryshuar.
Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji 10431, 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; • Ligji 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"; • Ligji 9774, 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"; • Ligji 9774, 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar me ligjin 39/2013; • Ligji 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"; • Ligji 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore"; • VKM 633, datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete"; • VKM 908, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime"; • VKM 352, 29.04.2015, "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"; • VKM 246, 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore"; • VKM 177, 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse»; • Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

Funksioni	Baza Ligjore
Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 24/2017, datë 9.3.2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit"; • Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; • Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve Ujor", i ndryshuar; • VKM nr. 709, datë 29.10.2014 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimi Rural dhe Bujqësor 2014-2020"; • Ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar; • VKM nr. 121 datë 17.02.2011 "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki"; • VKM nr. 64, datë 23.1.2003 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, në këshillat e qarqeve dhe të zyrave të menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës, në komuna dhe/ose ", i ndryshuar; • Ligji nr. 9244 datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar; • VKM nr. 59, datë 28.1.2005 "Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore"; • VKM nr. 80, datë 28.1.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore"; • VKM nr. 512, datë 13.9.2017 "Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural"; • VKM nr. 437, date 17.5.2017 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë"; • VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, "Për transferimin, nga Ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit"; • Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave"; • VKM nr. 147, datë 18.3.2004, "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave".

Funksioni	Baza Ligjore
Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar; • VKM nr. 121, datë 17.02.2011 "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki"; • VKM nr. 64, datë 23.1.2003 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, në këshillat e qarqeve dhe të zyrave të menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës, në komuna dhe/ose bashki", i ndryshuar; • Ligji nr. 9244 datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar; • VKM nr. 59, datë 28.1.2005 "Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore"; • VKM nr. 80, datë 28.1.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore"; • Ligji nr. 7836 datë 22.6.1994 "Për çmimin e tokës bujqësore "Për efekt kompensimi", i ndryshuar; • Ligji nr. 8053 datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërbllim të tokës bujqësore i ndryshuar; • Ligji nr. 8110 datë 28.3.1996 "Për faljen e tatimit "Për tokën bujqësore"; • Ligji nr. 8312 datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara"; • VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar; • Udhëzim i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara"; • Urdhër MBUMK nr. 234, datë 9.7.2007 "Për miratimin e "Përmbajtjes dhe formës së "kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore"; • Ligji nr. 8318 datë 1.4.1998 "Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar; • VKM nr. 830, datë 28.12.1998 "Për kriteret e llogaritjes së vlerës vjetore të qirasë së tokave bujqësore, pyjore, me bimë pyjore, livadheve dhe kullotave, pasuri shtetërore", i ndryshuar; • VKM nr. 460, datë 22.5.2013 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", i ndryshuar; • Udhëzim i MBUMK nr. 6, datë 5.6.2013 "Për kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e përllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit"; • Ligji nr. 8337 datë 30.4.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave"; <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9948 datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar; • VKM nr. 224, datë 19.2.2009 "Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë"; <ul style="list-style-type: none"> • VKM nr. 253, datë 6.3.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish - kooperativave bujqësore", i ndryshuar; • Ligji nr. 171/2014 datë 18.12.2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar; • VKM nr. 337, datë 22.4.2015 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar; • VKM nr. 138, datë 23.2.2018 "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të "Përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për Fondin e Mbështetjes së Investimeve Strategjike"; <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr.33/2012 datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar; • Ligji nr. 7501 datë 19.7.1991 "Për tokën Ndryshuar", i ndryshuar; • Vendimi i KM nr. 255, datë 2.8.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës ", i ndryshuar; • VKM nr. 371, datë 11.10.1991 "Për kriteret dhe rregullat e ndërtimit të ngrehinave e të instalimeve në tokat bujqësore në pronësi e përdorim, që i shërbejnë shfrytëzimit bujqësor e blegtoral"; <ul style="list-style-type: none"> • VKM nr. 231, datë 19.5.1993 "Për tokat që refuzohen të merren në pronësi"; • VKM nr. 97, datë 15.2.2006 "Për përbërjen e komisionit qeveritar të tokës"; • Ligji nr. 8752 datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave "Për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar; • VKM nr. 410, datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës"; • Udhëzim i MBUMK nr. 1, datë 20.2.2006 "Për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore dhe kategorizimit të resurseve"; • Udhëzim i MBUMK nr. 11, datë 10.10.2007 "Për pasqyrimin në dokumentacion të ndryshimeve të kategorisë së resurseve dhe kalimin e zërave kadastralë"; • Urdhër i MBUMK nr. 183, datë 26.5.2011 "Për tarifën e shërbimeve që kryhen nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark"; • Udhëzim i MBZHAU nr. 5, datë 13.3.2017 "Për krijimin e informacionit mbi tokën bujqësore nga zbatimi i programit "Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore"; • VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", i ndryshuar; • Ligji nr. 7832 datë 16.6.1994 "Për çmimin e truallit që kompensohet", i ndryshuar; • Ligji nr. 7980 datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", i ndryshuar; • VKM nr. 201, datë 26.3.1998 "Për kriteret e përdorimit të ardhurave nga shitja dhe qiraja e truallit", i ndryshuar; • VKM nr. 35, datë 24.1.2007 "Për procedurat dhe format e shitjes së truallit, të pajisur me infrastrukturë, për qëllime tregu"; • VKM nr. 456, datë 16.4.2008 "Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët"; • VKM nr. 1129, datë 5.8.2008 "Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit, të vënë, nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit"; • Ligji nr. 133/2015 datë 5.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar; • VKM nr. 221, datë 23.3.2016 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Trajtit të Pronës"; • VKM nr. 222, datë 23.3.2016 "Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës", i ndryshuar; • VKM nr. 223, datë 23.3.2016 "Për "Përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave", i ndryshuar; • Ligji nr. 10 239 datë 25.2.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", i ndryshuar; • Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; • VKM nr.1269, datë 17.9.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".

Funksioni	Baza Ligjore
<p>Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; • VKM nr. 709, datë 29.10.2014 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020", të ndryshuar.

Funksioni	Baza Ligjore
Administrimi i shërbimit pyjor dhe kullosor vendor	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar,; • Ligji nr. 9693, date 19.3.2007 "Për fondin kullosor" i ndryshuar; • Ligji nr. 5/2016, date 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje"; • VKM nr. 814, datë 31.12.2018 "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030"; • VKM nr. 433, date 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të pyjeve dhe kullotave, bashkive"; • VKM nr. 632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje"; • VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës dhe procedurave të heqjes nga fondi pyjor", i ndryshuar; • VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës dhe procedurave të heqjes nga fondi kullosor" i ndryshuar; • VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar; • VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për caktimin e vlerës së dëmit në fondin kullosor"; • VKM nr. 438, datë 8.6.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjen e materialit drusor"; • VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 "Për rregullat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijim e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve"; • VKM nr. 22, datë 09.1.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal"; • VKM nr. 48, datë 31.1.2007 "Për përcaktimin e rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera, në përdorim të punonjësve të shërbimit pyjor"; • Udhëzimi nr. 2, datë 3.3.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje"; • Udhëzim nr. 4, datë 12.9.2008 "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor"; • Udhëzimi nr. 2, datë 20.7.2017 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kullotje"; • Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 "Për rregullat procedurat e kërkimit shqyrtimit dhe kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"; • Udhëzimi nr. 1 datë 26.1.2017 "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor"; • Udhëzimi nr. 4, datë 25.8.2010 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore», i ndryshuar; • Udhëzim nr. 4, datë 25.8.2010 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore".

Funksioni	Baza Ligjore
Mbrotjtja e natyrës dhe biodiversitetit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar; • Ligji nr. 81 datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura"; • Ligji nr. 9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar; • Ligji nr. 8905, datë 6.6.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi", të ndryshuar; • Ligji nr. 9362, datë 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve"; • VKM nr. 31, datë 20.1.2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit"; • Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; • Ligji nr. 91 datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"; • Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"; • Ligji nr. 10 120, datë 23.4.2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore"; • Ligj nr. 75/2016 Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të komebeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike; • VKM nr. 762, datë 16.9.2015 "Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Komebeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike"; • Ligji nr. 9108, datë 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike", të ndryshuar; • Ligji nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë"; • Ligji nr. 8531, datë 23.9.1999 "Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike"; • Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar; • Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" i ndryshuar; • Ligj nr. 5/2016, datë 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje"; • VKM nr. 814, datë 31.12.2018 "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030"; • VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar; • VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për caktimin e vlerës së dëmit në fondin kullosor"; • VKM nr. 438, datë 8.6.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjen e materialit drusor"; • VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 "Për rregullat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijim e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve"; • VKM nr. 22, datë 09.1.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal"; • Udhëzimi nr. 2, datë 3.3.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje"; • Udhëzimi nr. 2, datë 20.7.2017 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kullotje"; • Udhëzimi nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat procedurat e kërkimit shqyrtimit dhe kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"; • Udhëzimi nr. 4, datë 25.8.2010 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore», i ndryshuar.

Funksioni	Baza Ligjore
Zhvillimi ekonomik vendor	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; • Ligji nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", ndryshuar ligjin nr. 54/2015, datë 28.05.2015; • Ligji nr. 45/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 "për shëndetin publik dhe inspektoratin sanitar shtetëror", të ndryshuar; • VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit"; • Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë", i ndryshuar; • Ligji nr. 10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; • Udhëzim nr. 23, datë 30.7.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"; • Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; • Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; • Ligji nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; • Urdhër nr. 1556.1, datë 30.3.2016 "Për miratimin e numrit dhe përhapjes në territor të sporteve të Qendrës Kombëtare të Biznesit"; • Urdhër nr. 2513, datë 30.03.2016 "Për miratimin e formatit të formularëve dhe certifikatave për kryerjen nga Qendra Kombëtare e Biznesit të funksioneve të regjistrimit, licencimit dhe lejimit»; • Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", ndryshuar me ligjin nr. 10 183, datë 29.10.2009, nr. 21/2016, datë 10.3.2016; • VKM nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit".

Funksioni	Baza Ligjore
Mbrojtja civile ne nivel vendor dhe administrimi i strukturave perkatëse	<ul style="list-style-type: none"> • Ligj nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar; • VKM nr. 206, datë 26.3.1998 "Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në rast fatkeqësish; • VKM nr.835, date 3.12.2004 "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile"; • VKM nr. 664, datë 18.12.2002 "Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile; • VKM nr. 655, datë 18.12.2002 "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile"; • VKM nr. 663, datë 18.12.2002 "Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e komisionit teknik këshillimor të specialisteve për emergjencat civile"; • VKM nr. 654, datë 18.12.2002 "Për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat"; • VKM nr. 532, datë 1.8.2003 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e departamentit të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile"; • VKM nr. 531, datë 1.8.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile"; • VKM nr. 533, datë 1.8.2003 "Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile"; • Ligjin nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar; • VKM nr. 73, datë 7.2.2018 "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018-2027"; • Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat civile", i ndryshuar; • VKM nr. 655, datë 18.12.2002 "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile"; • VKM nr. 531, datë 01.08.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile"; • VKM nr. 965, datë 2.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave"; • VKM nr. 502, datë 13.9.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme", i ndryshuar; • Ligj nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; • VKM nr. 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, i ndryshuar; • Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit , i ndryshuar; • Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar; • Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; • Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar; • Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; • VKM nr. 504, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë"; • Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave, i ndryshuar; • VKM Nr.147, datë 18.3.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave".

Funksioni	Baza Ligjore
<p>Garantimi i shërbimit të zjarrifikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"; • VKM nr. 502, datë 13.9.2017 "Për Përcaktimin e fushës së Përgjegjësive Shtetërore të Ministrisë së Brendshme"; • VKM nr. 284, datë 27.06.2002 "Për tarifat e Shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave juridik dhe fizik, vendas dhe të huaj"; • VKM nr. 707, datë 12.10.2016 "Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së"; • VKM nr. 366, datë 18.5.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së brendshme, për prefektët në qarqe dhe nënprefektët, administratën e tyre, për drejtorinë e përgjithshme të emergjencave civile, (drejtorinë e PMNZSH-së)", të ndryshuar; • VKM nr. 350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; • VKM nr. 294, datë 5.4.2017 "Për miratimin e listës së bashkive të cilat do të ngrënë stacione të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; • Urdhër nr. 424, datë 24.7.2015 "Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim".
<p>Garantimi i mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet, parandalimi i kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 Kodi Civil i RSH, i ndryshuar; • Ligji nr. 10 112, datë 9.4.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"; • Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës", i ndryshuar.

SHTOJCA C: RAPORTE DHE DOKUMENTE TË KONSULTUAR

Autoriteti Rregullator i Ujit, 2017, "Raport mbi performancën në sektorin e ujit dhe kanalizimeve 2017".

dldp, (2016). Raporti i monitorimit SNDQV për periudhën korrik 2015 – gusht 2016.

dldp, (2017). Raport i dytë i monitorimit SNDQV.

Këshilli i Evropës, (1985). Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore.

Këshilli i Evropës, (2015). Opinion i Këshillit të Evropës për projektligjin mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Shqipëri.

Këshilli i Evropës, Rekomandimet e Kongresit për Demokracinë Vendore dhe Rajonale, (2016). Analizë krahasuese në Zbatimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në 47 shtete anëtare.

Ministri për Çështjet Vendore (2015). Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015 – 2020.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, (2018). Raport Auditimi Performance - Funksionimi i Bashkive, në kuadër të reformës administrative-territoriale.

Shapo, O., Pfaeffli, S., Titka, M., (2016). Monitorimi i funksioneve të reja që pushteti qendror u transferoi bashkive., dldp.

UNDP, (2016). Vlerësimi Mbarëkombëtar i Situatës së Qeverisjes Vendore në Shqipëri.

Vokopola, E. (2014). Krijimi i një mekanizmi efektiv të dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore në Shqipëri.

Vokopola, E. (2016). Organizimi vendor i territorit të Shqipërisë.

Ymeri, S., Titka, M., Pfaeffli, S., Clavelle, P. (2018). Raport i rishikimit Afat-Mesëm i Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015-2020).

SHTOJCA D: AKTORËT E KONSULTUAR NË NIVEL BASHKIE

Nr	Emri Mbiemër	Institucioni	Drejtoria
1	Astrit Vata	Bashkia Kamëz	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale
2	Fatma Tane	Bashkia Kamëz	Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave
3	Vjollca Smaçi	Bashkia Kamëz	Drejtoria e Financës
4	Odetta Bajraktari	Bashkia Kamëz	Drejtoria Juridike
5	Gani Berisha	Bashkia Kamëz	Drejtoria e Arsimit dhe Sportit
6	Ardian Peka	Bashkia Kamëz	Drejtoria e Arsimit dhe Sportit
7	Gentiana Bushi	Bashkia Kamëz	Zyra DTTV
8	Bardhyl Gjana	Bashkia Kamëz	Drejtoria MZSH
9	Xhelal Muça	Bashkia Kamëz	Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit
10	Tomorr Kotarja	Bashkia Kamëz	Ndërmarrja Ujësjiellës-Kanalizime
11	Alti Doçi	Bashkia Kamëz	Ndërmarrja Ujësjiellës-Kanalizime
12	Fiqerete Resulaj	Bashkia Kamëz	DPKZHT
13	Enkeleda Balshi	Bashkia Kamëz	Drejtoria e Shërbimeve Publike
14	Ndriçim Halili	Bashkia Kamëz	Drejtoria Juridike
15	Thasan Koroveshi	Bashkia Korçë	Spektori i Bujqësisë
16	Johan Marko	Bashkia Korçë	Spektori i Pyjeve
17	Irma Themeli	Bashkia Korçë	Spektori për Mbrojtjen e Mjedisit
18	Mirela Balli	Bashkia Korçë	Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social
19	Koço Cicko	Bashkia Korçë	Drejtoria MZSH
20	Denada Tabaku	Bashkia Korçë	Drejtoria e Financës
21	Elia Pendavinji	Bashkia Korçë	Drejtoria Tregtare
22	Kristina Dishnica	Bashkia Korçë	Drejtoria Tregtare
23	Pandush Nando	Bashkia Korçë	Drejtorë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
24	Leonard Gjançi	Bashkia Korçë	Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave
25	Tatjana Marash	Bashkia Korçë	Klubi Shumësportësh
26	Xhorxh Korllorof	Bashkia Korçë	Spektori i Emergjencat Civile
27	Zhaneta Lubonja	Bashkia Korçë	Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit
28	Lorenc Palodhi	Bashkia Korçë	Spektori i Kontrollit Ushqimor
29	Asgesi Ruko	Bashkia Roskovec	Drejtoria e Bujqësisë
30	Delina Hoxha	Bashkia Roskovec	Drejtoria Juridike
31	Isa Hoxha	Bashkia Roskovec	Zv/Kryetar
32	Rakip Hyrrej	Bashkia Roskovec	DPZHT
33	Habibe Hajdini	Bashkia Roskovec	Spektori i Mjedisit
34	Mariglen Rroko	Bashkia Roskovec	Spektori i Emergjencave Civile
35	Shkëlqim Plaku	Bashkia Roskovec	KIMT
36	Donika Goga	Bashkia Roskovec	Spektori i Tatim - Taksave
37	Elis Apostoli	Bashkia Roskovec	Spektori i Shërbimeve Sociale
38	Selman Çepele	Bashkia Roskovec	Drejtoria e Financës
39	Arben Dukaj	Bashkia Roskovec	Drejtoria e Shërbimeve Publike
40	Manjola Vrapit	Bashkia Roskovec	Zyra e Projekteve
41	Brisilda Nazëraj	Bashkia Roskovec	Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizime
42	Vilson Naçi	Bashkia Roskovec	Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizime

SHTOJCA E: AKTORËT E KONSULTUAR NË NIVEL MINISTRIE

Nr.	Emri Mbiemër	Institucioni	Drejtoria
1	Fran Ibrahim	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Drejtoria e Financave Vendore
2	Dukate Dodaj	Ministria e Mbrojtjes	Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit
3	Shaban Qesaraku	Ministria e Mbrojtjes	DPKEC
4	Alfred Kutali	Ministria e Mbrojtjes	MZSH
5	Fit Tola	Ministria e Mbrojtjes	MZSH
6	Klodiana Marika	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Drejtoria e Programit të Zhvillimit të Mjedisit
7	Ornela Shoshi	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Spektori VNM - VSM
8	Elvana Ramaj	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Spektori Mjedisit, Natyrës dhe Biodiversitetit
9	Rezart Fshazi	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Spektori Programi i Mbrojtjes së Mjedisit
10	Rovena Agalliu	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Drejtoria e Politikave të Mjedisit
11	Admir Jeci	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Spektori i Pyjeve dhe Kullotave
12	Ilir Hoxha	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Spektori i Pyjeve dhe Kullotave
13	Ermal Halimi	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	DPZHM - MTM
14	Enea Hoti	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi
15	Arben Mukaj	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Spektori i Ujitje Kullimit
16	Mimoza Shahini	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Spektori i Administrimit të Tokës
17	Arjan Kospiri	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Spektori Transporti Publik
18	Arjan Budo	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Spektori Transporti Publik
19	Ina Kacorri	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Shërbimi Social Shtetëror
20	Denada Seferi	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Shërbimi Social Shtetëror
21	Eneida Capo	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Spektori të programeve të Zhvillimit të Aftësisë së Kufizuar dhe Ndhmës Ekonomike
22	Anjeza Koroni	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Shërbimi Social Shtetëror
23	Xhilda Papajani	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Spektori i Programeve të Zhvillimit të Shërbimeve Shoqërore
24	Lida Leskaj	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Shërbimi Social Shtetëror

SHTOJCA DIGJITALE

Bashkëlidhur raportit në format digjital [CD]

1. Matricat MS EXCEL sipas funksioneve

Faqe 1: Organigrama

Faqe 2: Administrim

Faqe 3: Rregullim

Faqe 4: Monitorim dhe Vlerësim

Faqe 5: Baza Ligjore

Faqe 6: Rekomandime

2. Matricat KOMPOZIM sipas funksioneve

